Trenutni odnos poitičkih elita prema ovim pitanjima iz bliske prošlosti je nezadovoljavajući. Prijedor je danas grad koji iz ugla žrtava i organizacija koje se bave pitanjima i problemima tranzicione pravde i suočavanja sa prošlošću predstavlja mjesto potpunog zaborava i negiranja patnje preživjelih. Tome svjedoči nepostojanje ijednog memorijala stradanju nesrpskih civilnih žrtava, za razliku od tri impozantna spomenika u centru grada palim srpskim borcima i mnogim drugim spomenicima i spomen pločama na cijeloj teritoriji grada. Osim toga, zabrane komemoracija i protestnih šetnji organizovanih od strane udruženja koja okupljaju preživjele žrtve i porodice žrtava, kao i kršenje ljudskih prava su svakodnevica ovih do sada već nebrojeno puta traumatizovanih osoba. Poznata je izjava gradonačelnika Prijedora, koji je tužnu komemoraciju organizovanu prilikom obilježavanja Međunarodnog dana bijelih traka ove godine nazvao „običnom pederskom paradom".

Otkrivanje Tomašice, jedne od najvećih masovnih grobnica u Evropi nakon Drugog svjetskog rata, na manje od 20 kilometara od centra Prijedora još dodatno usložnjava društvenu realnost ovog grada i njegovih stanovnika. Iskopavanje je prekinuto krajem 2013. godine zbog vremenskih prilika i planirano je nastavljanje ekshumacija tokom2014. Do sada je iz ove masovne grobnice ekshumirano više od 430 tijela, dok su procjene da bi do kraja iskopavanja ovaj broj mogao dostići i više od 800 tijela iskopanih iz ove grobnice.

Suočavanje sa nasleđem zločina iz bliske prošlosti, posebno iz pozicije mjesta kao Prijedor, smatramo ključnim polazištem za djelovanje u smislu kreiranja novih odnosa prema društvenoj realnosti.

## 4. Memorijali u Prijedoru

Na teritoriji opštine Prijedor se nalaze mnogobrojni spomenici civilnim žrtvama i poginulim borcima narodnooslobodilačke borbe, od kojih se kao najznačajniji izdvaja Spomenik na Mrakovici, autora Dušana Džamonje. Osim toga, centrom grada dominiraju i memorijali palim borcima Vojske Republike Srpske. U najužem centru grada se nalaze tri ovakva spomenika, dok na teritoriji čitave opštine postoji neutvrđen broj spomenika i spomen ploča poginulim borcima.[318]





Spomenik srpskim borcima na mjestu koncentracionog logora Trnopolje

317 Jasmin Medić, *Genocid u Prijedoru,* (Grafis doo: Cazin, 2013), str. 48.

318 Podaci iz opštinske administracije o odlukama na osnovu kojih su podignuti navedeni memorijali su nedostupni.

Centrom grada dominira kompleks spomenika koji se sastoji iz tri zasebne cjeline. Preko puta zgrade gradske administracije, tik ispred spomenika Mladenu Stojanoviću, na mjestu gdje je tokom Drugog svjetskog rata obješena narodna heroina Mira Cikota, smješten je spomenik u obliku šupljeg krsta u čijoj šupljini su izrezbareni obrisi ljudskih tijela. Ovaj spomenik, pod nazivom „Za krst časni", podignut je 171 borcu iz Prijedora i okolnih gradova, palom u „Otadžbinskom ratu".

U neposrednoj blizini prethodnog, podignut je i memorijal u obliku kupole na čijim zidovima sa unutrašnje strane su ispisana imena vojnika Vojske Republike Srpske iz Prijedora koji su poginuli u ratu. Na vanjskom zidu kupole je zastava RS, stilizovana u geografskom obliku Republike Srpske iz koje izranja sunce. Unutrašnjost kupole je zatvorena za javnost i otvara se jedino prilikom komemoracija. Ovaj memorijal se nalazi na području srednjoškolskog centra.

Iza zgrade opštinske administracije se nalazi treći memorijal koji čini dugačka mermerna postavka na kojoj su ispisana imena zaposlenih u Rudniku željezne rude Ljubija a koji su poginuli u ratu kao pripadnici Vojske Republike Srpske.

Brojnim civilnim žrtvama u Prijedoru je podignut spomenik u Kozarcu, te je to jedini memorijal civilnim žrtvama nesrpske nacionalnosti stradalim u proteklom ratu. Neučestvovanje opštine Prijedor u finansiranju ili na bilo koji drugi način u podizanju ovog spomenika je svakako bitno uzeti u obzir pri ocjeni ostvarenja simboličkih reparacija žrtvama u ovom gradu. Osim spomenika u Kozarcu postoji i spomen ploča u neposrednoj blizini objekta u kojem je bio smješten logor Keraterm. Ova spomen ploča malih dimenzija (60 cm x 60 cm) je postavljena od strane aktiviste Udruženja Prijedorčanki „Izvor", bez bilo kakve dozvole i teško da se može ubrojiti u legalne memorijale.

Iako je evidentna potreba za podizanjem spomenika nesrpskim civilnim žrtvama, ostaje neodgovoreno pitanje zbog čega oni ne postoje, iako su mnoga udruženja koja okupljaju porodice preživjelih žrtava i porodica žrtava pokretale brojne inicijative za podizanja ovih memorijala. Dodatno zbunjuje i otpor multinacionalne kompanije Arcelor Mittal koja danas posjeduje rudnik željezne rude Omarska, u kojem je bio smješten koncentracioni logor Omarska, da se dozvoli podizanje spomen-ploče kojom bi se obeležilo stradanje više hiljada žrtava ovog logora. Njihov zvanični stav upućuje na nemogućnost velikih finansijskih izdavanja za izmještanje postojećih postrojenja rudnika koja su i danas u funkciji. O opravdanosti ovog stava dovoljno govori spremnost lokalnih udruženja na kompromis u smislu iznalaženja alternativa koje bi omogućile izgradnju memorijala bez izmještanja rudničkih postrojenja. Takođe, neizostavan je utisak da je zvaničan stav manjkav, obzirom na imidž ove velike multinacionalne kompanije koja u svom radu njeguje princip društvene odgovornosti i u te svrhe izdvaja velika novčana sredstva.

Do sada nije postojala inicijativa koja bi dolazila od lokalnih vlasti a koja bi pokušala pronaći adekvatan način za izgradnju memorijala nesrpskim civilnim žrtvama iz proteklog rata.

### 5. Izjave i izvinjenja zvaničnika

Od kraja proteklog rata su zabeležene mnoge izjave lokalnih zvaničnika koje su se odnosile na pokušaje pružanja verbalne zadovoljštine preživjelim nesrpskim žrtvama i porodicama žrtava. Međutim, prema izjavama predstavnika lokalnih udruženja koja okupljaju preživjele žrtve, to nikako nije ostvareno. Uglavnom se navedene izjave odnose na izjave saučešća, dok izjava koja bi sadržavala i izvinjenje nikada nije javno izrečena. Izjave saučešća su dolazile uglavnom prilikom vjerskih ukopa ekshumiranih civilnih žrtava, na koje gradonačelnik jeste dolazio. Ne postoji, ili je bar nedostupna široj javnosti, video ili audio snimka tih izjava. O njima se zna samo po svjedočanstvima prisutnih porodica i predstavnika udruženja koja okupljaju žrtve i njihove porodice.

Osim toga, karakterističan je i svakodnevni odnos lokalnih vlasti prema udruženjima koja okupljaju žrtve i njihove porodice. Njega karakteriše odbijanje uspostavljanja bilo kakvog dijaloga i saradnje po pitanju uspostavljanja odnosa prema bliskoj prošlosti. Jedan od takvih primera je i izjava gradonačelnika Prijedora Marka Pavića, koji je pred novinarkom Al Jazeere komemoraciju u Prijedoru 2013. godine nazvao „običnom pederskom paradom" sa kojom on nema ništa. Podsjećanja radi, u pitanju je bila komemoracija povodom Međunarodnog dana bijelih traka, 31. maja 2013. godine, dana kada su 1992. godine lokalne vlasti izdale naredbu da svi građani nesrpske nacionalnosti moraju svoje kuće obilježiti bijelim platnom, a ukoliko izlaze iz kuća imati vidno istaknutu bijelu traku povezanu oko nadlaktice.

Nadalje, u emisiji na BN Televiziji povodom otkrivanja najveće masovne grobnice u BiH, za koju se procjenjuje da u njoj leže posmrtni ostaci oko 800 mučki ubijenih osoba samo zbog nacionalne pripadnosti i imena i prezimena, gradonačelnik Prijedora je rekao da su to, što se njega tiče, „poginuli i sahranjeni ljudi", te da je to za njega završena priča.[319]

Ovakav način javnog odnosa zvaničnika opštine Prijedor prema žrtvama i njihovim porodicama nikako ne predstav-

lja vid simboličke reparacije, već naprotiv njegovu potpunu suprotnost. Upornim odbijanjem da se žrtve priznaju, kao i sistematski otpor da se obeleže mjesta stradanja žrtava Prijedora nesrpske nacionalnosti, predstavljaju kontinuitet viktimizacije žrtava i njihovih članova porodica.

## 6. Komemoracije

Tokom poslijeratnih godina pa sve do danas su u Prijedoru održane mnogobrojne komemoracije nesrpskim civilnim žrtvama iz proteklog rata. Uglavnom se radilo o vjerskim manifestacijama na kojima su povremeno prisustvovali i predstavnici lokalnih vlasti sa gradonačelnikom Markom Pavićem na čelu. U pitanju su zatvoreni događaji, mahom u vjerskim objektima, na kojima su uglavnom bile prisutne preživjele žrtve, porodice žrtava i građani iste nacionalne pripadnosti kao i žrtve. Na komemoracijama u javnom prostoru nikada nisu prisustvovali lokalni zvaničnici srpske nacionalnosti.

Prva zvanična obilježavanja počinju sa masovnijim povratkom, pa se tako prvo obilježavanje stradalog nesrpskog stanovništva desilo 21. avgusta 2002. godine na desetu godišnjicu egzekucije civila na Korićanskim stijenama. Nakon toga su uslijedile i druge komemoracije, organizovane uglavnom od strane Udruženja logoraša „Prijedor 92" i Udruženja Prijedorčanki „Izvor".

Osim toga, postojali su pokušaji organizovanja komemoracija, ali i protesta u javnom prostoru povodom nezadovoljavajućeg odnosa dominantnog političkog diskursa prema događajima iz nedavne prošlosti. Na ovim događajima nisu do sada ni učestvovali, a ni organizovali ih predstavnici lokalnih vlasti. Nasuprot, često su ova javna okupljanja bila predmet zabrana od strane policijskih institucija.

Svakako jedan od najznačajnijih događaja u kome je obilježeno stradanje građana Prijedora nesrpske nacionalnosti jeste obilježavanje Međunarodnog dana bijelih traka, 31. maja, organizovano od strane inicijative civilnog društva „Jer me se tiče", neformalne *grassroots* građanske platforme za suočavanje sa prošlošću.

Ovakvi slučajevi dovoljno ukazuju na odnos zvaničnika, predstavnika lokalnih vlasti i legalno izabranih predstavnika naroda o teškim događajima iz prošlosti.

## 7. Zaključak

Ostvarivanje simboličkih reparacija, kao mjere vlasti preduzete sa ciljem da se na simbolički način prizna istina o zločinima i kršenju ljudskih prava u prošlosti, predstavlja jedan od najvažnijih preduslova saniranja posljedica sukoba i masovnog kršenja ljudskih prava.[320] Iako su njihove funkcije mnogostruke - od edukativne zbog podizanja svijesti budućih generacija, te samim tim i prevencije budućih konflikata, do odavanja počasti žrtvama, izražavanja solidarnosti i izgradnji kolektivog sjećanja na masovna kršenja ljudskih prava iz prošlosti - treba posebno istaći i da one sve češće, pogotovo u kontekstima gdje je posebno komplikovano napraviti sveobuhvatan program materijalnih reparacija, predstavljaju i prihvatljiv način izgradnje i vraćanja povjerenja žrtava u institucije sistema, kroz simbolički vid priznanja njihove patnje. One takođe treba da predstavljaju i jedan od najsnažnijih mehanizama koji treba da spriječi negiranje zločina.[321]

Sa druge strane, prethodna analiza stanja simboličkih reparacija u Prijedoru tjera na zaključak da u ovom slučaju simboličke reparacije ne ispunjavaju nijednu od svojih funkcija.

U nekim slučajevima, poput memorijala poginulim pripadnicima oružanih snaga Vojske Republike Srpske podignutim na mjestima stradanja civila nesrpske nacionalnosti, simboličke reparacije predstavljaju spomenike zvaničnom narativu o prošlosti u lokalnoj zajednici, prepunom poricanja patnje drugoga. Izjave zvaničnika lokalne zajednice o događajima iz bliske prošlosti i zločinima, dodatno unizuju i vrijeđaju preživjele žrtve i članove porodica. Sa druge strane, inicijative civilnog društva ili udruženja članova porodica žrtava, iako značajne, ne mogu predstavljati adekvatnu zamjenu za ono što lokalne političke elite imaju obavjezu da čine ali to uporno odbijaju.

Slučaj Prijedor stoga predstavlja jedan od najboljih primjera kako simboličke reparacije, kada su neadekvatne, djelimične, bazirane na iskrivljenoj slici o prošlosti, ili samo rezultat privatnih inicijativa, mogu postati uspješan mehanizam za ponovnu viktimizaciju žrtava i nastavak njihovih patnji.



319 Snimak emisije „Puls" BN Televizije od 31. oktobra 2013. godine u vlasništvu Centra za mlade „KVART" iz Prijedora.

320 Fond za humanitarno pravo, *Vodič kroz reparacije*, 2010, str. 7.

321 *Ibid.*

# Shkolla Rajonale e Drejtësisë Tranzicionale - Buletin

# Përmbajtja

**Autorët** ..... 95

**Hyrje** ..... 97

Drejtësia tranzicionale në Serbi (e drejta në reparacion) - Rasti i memorialeve në Serbi ..... 99

*Luka Z. Božović*

Drejtësia Tranzicionale në Bosnje dhe Hercegovinë:E drejta për të vërtetën ..... 107

*Jasmin Hamzić*

Ndikimi i Aktigjykimit të GJEDNJ-së në Lëndën Maktouf dhe Damjanović Kundër BEH, i 18 Korrikut 2013, në proceset E Drejtësisë Tranzicionale në BEH ..... 116

*Maja Kapetanović*

Mediat dhe mohimi ..... 135

*Dejana Nešić*

Drejtësia tranzicionale në BeH: E Drejta mbi të Vërtetëen ..... 142

*Denis Puteš*

Gjykimet para TPNJ – Rasti Srebrenica – Popović dhe të tjerët ..... 150

*Jovana Spremo*

Srebrenica – Gjykimi ndaj Radislav Krstić ..... 162

*Srđan Vidačković*

Roli i mediave në procesin e pajtimit ..... 170

*Aldin Zenović*

Prijedor: Reparacionet Simbolike ..... 179

*Goran Zorić*

# Autorët

*Luka Božović*, Sekretari i Përgjithshëm i Rinisë Social Demokratike dhe nënkryetar i Bashkimit Social Demokratik, Serbi

*Jasmin Hamzić*, Forumi Rinor Stolac, Bosnjë dhe Hercegovinë

*Maja Kapetanović*, Këshilltare ligjore, Zyra e Kryetarit të Gjykatës së BeH, Bosnjë dhe Hercegovinë

*Dejana Nešić*, studente e doktoraturës, Kulturë dhe Media, Fakulteti i shkencave politike, Serbi

*Denis Puteš*, Fondacioni Mikrokredit Mikra, Bonsjë dhe Hercegovinë

*Jovana Spremo*, Hulumtuese, YUCOM, Serbi

*Srđan Vidačković*, projekt menagjere, World Vision, Bosnjë dhe Hercegovinë

*Aldin Zenović*, Shoqata "Flores", Serbi

*Goran Zorić*, Qendra për Rini "Kvart", Bosnjë dhe Hercegovinë.

# Hyrje

Jetojmë në një rajon i cili ka përjetuar historikisht luftëra shkatërruese. Një numër i madh njerëzish, kryesisht civilë të pafajshëm, humbën jetën, shumë eshtra kurrë nuk u gjetën, të tjerët kanë mbetur pa shtëpitë e tyre të cilat i kanë braktisur në kërkim të një vendi të sigurt. Si rregull, ata të cilët ishin përgjegjës për krimet nuk janë dënuar, viktimat nuk janë kompensuar në mënyrë adekuate ndërsa historia tregon se nuk janë ndalur cikle të reja të dhunës.

Çfarë dinë brezi i ri i sotëm në lidhje me këto ngjarje fatkeqe në të kaluarën. Pothuajse asgjë, për shkak se këto ngjarje zakonisht përdoren për tu ndërtuar mitet, të cilat në masë të madhe kanë ndikuar kryesisht në krijimin e paragjykimeve madje dhe urrejtje ndaj të tjerëve. Çdo ngjarje e rëndësishme në të kaluarën, ka të paktën dy apo me më shumë rrëfime. Çdo komb ose komunitet etnik e ka rrëfimin e vet dominues, i cili është në kundërshtim me rrëfimet e të tjerëve. Gjenerata të tëra janë edukuar në një frymë që është në përputhje me "historinë" e një komuniteti etnik, i cili ngre "heronjtë" e tyre, ndërsa të tjerët janë të prezantuar si "kriminelë". Në gjithë këtë viktimave u jepet rëndësi më e vogël, vrasja e të cilëve përfundimisht u zhduk nga kujtesa kolektive. Viktimat i kujtojnë vetëm familjet e tyre, të cilat mbeten të izoluara në pikëllimin e tyre. Nga ana elitës politike në rajon, viktimat janë përdorur zakonisht vetëm si pjesë e një të dhëne të njëanshme statistikore, pa treguar një respekt të vërtetë për vuajtjet e tyre.



Si të ndryshohet kjo praktikë dhe si të ndikohet në brez të ri qe ata të zvogëlojnë hendekun ekzistues mes kombeve në rajon? Kjo nuk mund të bëhet duke harruar të kaluarën ose me prezantim të njëanshëm të ngjarjeve historike. Për fat të keq, kjo ende praktikohet, dhe madje edhe ngjarjet e viteve 1990 në tekstet shkollore ofrojnë informacione të pasakta dhe të njëanshme, të cilat zakonisht heshtin në lidhje me viktimat e komuniteteve tjera etnike dhe ku shpesh ndaj popujve tjerë përdoret gjuha e urrejtjes, jo rrallëherë edhe me fjalor të turpshëm u drejtohen pjesëtareve të komuniteteve tjera. Në një situatë të tillë, zgjidhja e vetme e mundshme për zvogëlimin dhe zhdukjen e paragjykimeve ndaj njëri-tjetrit është që të flitet për të kaluarën. Së pari të flitet brenda sistemit arsimor, ku të rinjtë mësojnë për krimet e së kaluarës në një mënyrë objektive. Kjo do të thotë se sistemi arsimor duhet të përfshijë në librat e historisë dhe / ose në edukatën qytetare, në shkolla fillore, të mesme dhe në universitete, kapitujt mbi luftërat e viteve 1990, të cilat do të bazohen në faktet e vërtetuara - gjyqësore dhe mjekësisë ligjore. Çdo shoqëri në shtetet post-jugosllave duhet të lejoj që gjeneratat e reja të mësojnë për të kaluarën në një mënyrë objektive, duke përfshirë edhe krimet e kryera në emër të tyre kundër pjesëtarëve të etniteteve tjera. Vetëm duke mësuar për të kaluarën në një mënyrë të paanshme, ne mund të krijojmë kushtet për dialog dhe mirëkuptim midis popujve të ish-Jugosllavisë, të cilat garantojnë një të ardhme paqësore në rajon, respekt për diversitetin dhe

vlerësimin e të gjitha viktimave. Procesi i ballafaqimit me të kaluarën mund të çojë shoqërinë tonë tek një situatë ku nuk do të ketë vend për manipulim me numrin e viktimave, ku viktimat do ishin të respektuara në mënyrë të barabartë dhe ku pandëshkueshmëria për krimet nuk do të ishte e pranueshme. Një shoqëri e tillë do të garantonte që në të ardhmen nuk do të përsëritej cikli i dhunës dhe krimit.

Edhe pse shoqëritë post-jugosllave ende nuk e kanë treguar pjekurinë për t'u marrë me të kaluarën në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të vërtetë, e as nuk kanë marrë iniciativa serioze zyrtare që bashkërisht të përpiqen dhe të arrijnë një konsensus mbi ngjarët e së kaluarës, shoqëria civile ka marrë përsipër barrën më të madhe të punës mbi ndërtimin dhe avokimin e këtyre proceseve. Nisma për KOMRA është iniciativa më serioze në shoqërinë civile, e ndërmarr ndonjëherë në rajon dhe ka për qëllim për të bindur shtetet e ish-Jugosllavisë për të krijuar një Komisioni Rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në ish-Jugosllavi në periudhën nga viti 1991 deri në vitin 2001. Ky komision rajonal ka për detyrë për të verifikuar faktet mbi krimet e luftës në mënyrë objektive, pa marrë parasysh përkatësinë etnike të kryeseve të krimeve apo viktimave. Raporti i Komisionit Rajonal do të paraqiste bazën ligjore për të gjitha vendet e rajonit, duke u bazuar në përmbajtjen e këtij raporti, shtetet do të përcaktojnë faktet dhe të cilat do të inkorporohen në librat e historisë, në këtë mënyrë gjeneratave të reja ju ofron një narrativ në lidhje me krimet e luftërave të viteve 1990.

Derisa institucionet relevante të të gjitha vendeve të rajonit nuk e krijojnë një program gjithëpërfshirës të edukimit për të kaluarën në bazë të fakteve të verifikuara, organizatat e shoqërisë civile punojnë për të zhvilluar programin e arsimit jo-formal në lidhje me procesin e ballafaqimit me të kaluarën. Ndër projektet më të rëndësishme të këtij lloji është Shkolla Rajonale e drejtësisë transicionale cila është organizuar bashkërisht me Fondin për të Drejtën Humanitare dhe organizatat e saj partnere, shoqata "Jurist" nga B&H dhe FDH Kosovë. Në mungesë të edukimit formal mbi të kaluarën dhe mekanizmat për tejkalimin e dhunës, Shkolla Rajonale e Drejtësisë Transicionale ofron mundësi të mirë për të rinjtë nga Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova për të zgjeruar horizontet e tyre në lidhje me krimet e kryera në të kaluarën dhe njëkohësisht krijimin e një dialogu me bashkëmoshatarët e tyre me qëllim për të ndërtuar pajtim të qëndrueshëm në Ballkan.



Bekim Blakaj

Drejtor Ekzekutiv
FDH Kosovë

# Drejtësia tranzicionale në Serbi (e drejta në reparacion) - Rasti i memorialeve në Serbi

Luka Z. Božović

Luftërat në hapësirën e Jugosllavisë së dikurshme, gjatë viteve të nëntëdhjeta, janë shënuar me shkelje masovike të drejtave të njeriut, krime të luftës dhe pjesëmarrje të krerëve ushtarakë dhe politikë të Serbisë si në planifikimin ashtu edhe në kryerjen e krimeve. Gjatë luftërave, krimet dhe veprimet ushtarake në përgjithësi, janë arsyetuar me mbrojtjen e interesave kombëtare serbe dhe të popullit serb në republikat tjera të së dikurshmes Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Në këtë "mbrojtje të interesave" Armata Kombëtare Jugosllave, ndërsa më vonë Ushtria e Jugosllavisë, nën ndihmën e formacioneve të rregullta dhe paramilitare, nën kontrollin e saj, kanë kryer numër të madh të krimeve në Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci dhe në Kosovë, por edhe në territorin e Republikës së Serbisë.

Tregim dominues gjatë vitit 1999 dhe pas përfundimit të regjimit totalitar të Slobodan Milošević dhe marrjes së pushtetit pas ndryshimeve të pesë tetorit, ka qenë edhe mohimi i krimeve, derisa populli serb është theksuar si viktima më e madhe. Shembulli, që është paradigmatik dhe i cili në të njëjtën kohë flet për mungesën e fakteve, edhe përkundër këtij lëshimi, por edhe postulim për qëndrimin se populli serb është viktima më e madhe është Propozimi i Deklaratës për dënimin e krimeve të luftës në hapësirën e së dikurshmes Jugosllavi, të cilën partia Demokratike e Serbisë, së pari e nxjerr më 15 qershor të vitit 2005[1], ndërsa më vonë prapë në vitin 2010, si kundërpropozim ndaj deklaratës që e kishte bërë koalicioni qeverisës. Në këtë propozim të deklaratës, theksohet se "populli serb ka qenë viktima më e madhe"[2]. Ky është një prej shembujve që na flet për tregimin dominues në Serbi, në të cilin numri i viktimave serbe nuk vihet në pyetje, gjersa viktimat e kombësive tjera relativizohen (Tadić), mohohen (Nikolić, Koštunica etj), numri i tyre zvogëlohet por, edhe pretendohet se janë vrarë nga bashkëkombësit e tyre. Kështu kryetari i Serbisë Tomislav Nikolić disa ditë pas fillimit të detyrës ka deklaruar "Në Srebrenicë nuk ka pasur gjenocid. Në Srebrenicë ka pasur krim të madh, të cilin e kanë bërë disa pjesëtarë të popullit serb, të cilët duhen gjetur, sjellë para gjykatës, dhe të dënohen."[3] Me këtë kryetari Nikolić në mënyrë të drejtpërdrejtë ka mohuar kualifikimin e krimeve në disa aktgjykime para Tribunalit të Hagës dhe para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Paraardhësi i tij, në rolin e kryetarit të Serbisë, Boris Tadić, në vitin 2004 deklaroi se "mohimi i gjenocidit dhe krimeve janë pjesë



1 Me 28 maj të vitit 2005, Dr. Žarko Korać dhe Nataša Kandić nga klubi i ambasadorëve i partisë Liberal Demokrate kanë paraqitur Propozimin e Deklaratës për dënim të krimeve në Srebrenicë me iniciativë të tetë organizatave joqeveritare.

2 *Deklarata për dënim të krimeve të luftës në hapësirën e Jugosllavisë së dikurshme,* Partia Demokratike e Serbisë, qasur me 8.1.2014 në http://dss.rs/ëp-content/uploads/2012/09/60_Deklaracija-o-osudi-ratnih-zlocina-na-prostoru-nekadasnje-Jugoslavije-2-februar-2010.pdf.

3 "Nikolić mohon gjenocidin në Srebrenicë", qasur më 16.2.2014. në http://www.dë.de/nikoli%C4%87-negira-genocid-u-srebrenici/a-15993945.

përbërëse e debatit demokratik dhe e drejtë e garantuar me kushtetutë për liri të mendimit dhe të shprehjes"[4]. Me kohë qëndrimi është korrigjuar, mirëpo në emisionin e popullarizuar në Radio-televizionin Kroat, ai ka thënë se: si qytetar e ka një qëndrim lidhur me këtë çështje, mirëpo si bartës i funksionit politik për deklarim do të presë derisa të përfundohen proceset gjyqësore.[5] Në momentin e deklarimit të Tadić, deri atëherë janë sjellë shumë aktgjykime të plotfuqishme, të cilat vërtetonin se në Srebrenicë është kryer gjenocid. Lëshime të tilla janë relativizim i drejtpërdrejtë i krimit, i cili ka kulmuar me miratimin e deklaratës, e cila nuk përmban fjalën "gjenocid".

Tema e këtij punimi është një prej mekanizmave të drejtësisë tranzicionale – reparacionit. Punimi do të merret me memorialet si reparacione simbolike në territorin e Serbisë, për kontributin e tyre në kulturën e të kujtuarit. Rëndësia e kuptimit të tregimit dominues në Serbi është e domosdoshme, pasi që pikërisht ai është në lidhje të pandashme me temën e punimit. Në punim përveç cilësimeve themelore teorike, që do të shërbejnë si hyrje në temë, do të bëhet fjalë edhe për dy memoriale – një në Kragujevc dhe të dytin në Beograd. Këto dy memoriale janë paradigmatik në kontekstin, në të cilin duhet të shpjegohet teza e etnifikimit të memorialit dhe etnifikimit të kujtimeve, si dhe për karakterin ekskluzivisht fetar të memorialit. Memorialet, që do të përshkruhen dhe përmenden shërbejnë për të arsyetuar tregimin dominues, që ta përkrahin dhe të ndërtojnë kujtime që nuk janë të bazuara në fakte, që në rastin e Serbisë sjell deri te zvogëlimi i përgjegjësisë së saj për krime të luftës dhe arsyetim të veprimeve gjatë viteve të nëntëdhjeta.

Është e rëndësishme të përmendet se që të dy monumentet, për të cilat do të bëhet fjalë janë ngritur nga ana e shtetit, dhe se temë e kësaj analize nuk do të jenë përmendoret e ngritura nga vetë familjet. Siç thekson Todor Kuljić, në librin e tij *Kultura e kujtimit: shpjegime teorike të përdorimit të së kaluarës: "*Në përditshmëri janë të pranishme pamje të ndryshme të së kaluarës, paralele dhe konkurrente. Në brendësi të saj dominon pamja hegjemone e së kaluarës, të cilën e imponon grupi qeverisës."[6] Siç përmendet, tregimi i përkrahur nga memorialet në Serbi janë produkt i sundimit të Milošević, ndërsa pas ndryshimeve të pesë tetorit, qeveria e zgjedhur në mënyrë demokratike në Serbi nuk ka pasur guxim dhe vullnet të mjaftueshëm për ta ndryshuar, ndërsa në momente të caktuara edhe ka përkrahur një tregim të tillë. Ajo çfarë Kulić, poashtu ka thënë është se "kujtimi i përmbajtjes të së kaluarës kombëtare është i pallogaritshëm dhe selektiv", dhe se "harresa selektive ka formuar [...] disa hapësira historike, por përmbajtja e anashkaluar (trashëgimia e harruar) pas përmbysjeve shoqërore janë bërë qendër ideore e pamjes së re hegjemoniste të së kaluarës",[7] në Serbi nuk ka ndodhur pas përmbysjes shoqërore, karakteri i së cilës mund të sjellë në pikëpyetje nëse merret parasysh kjo që u tha.

## Hyrje në cilësimet teorike

Çështja e ndërtimit të memorialeve është *par excellencë* çështje e drejtësisë tranzicionale, pra duhet të fillohet nga definimi i kësaj disipline. "Drejtësia tranzicionale përqendrohet në sfidat, me të cilat shoqëria në tranzicion, qoftë nga lufta në paqe ose nga pushteti autoritar drejt demokracisë, ballafaqohet kur duhet të luftojë me trashëgiminë e shkeljeve masovike të drejtave të njeriut."[8] Ky definicion mund të shërbejë si një hyrje e mirë në çështjen e memorialeve si një prej mënyrave që të përballemi me trashëgiminë e shkeljeve masovike të drejtave të njeriut në Jugosllavinë e dikurshme, dhe përgjegjësisë së Serbisë për të njëjtat. Domethënë, nëse drejtësinë tranzicionale e shikojmë si krejt çfarë një popull bën me qëllim të ballafaqimit me të kaluarën, atëherë memorializimi, shënimi i vendeve të rrënjës ose ngritja e përmendoreve të viktimave, gjithsesi është një prej çështjeve kryesore me të cilat merret kjo disiplinë.

Me qëllim të kuptimit më të mirë të vendit të memorialeve në procesin e Drejtësisë Tranzicionale duhet të theksohet se cilat janë të drejtat e viktimave dhe çfarë obligimesh shtetërore rrjedhin nga to. Louis Joinet ka definuar të drejtën për reparacion si një prej të drejtave të viktimave, e cila

4 „Fillimi i fundit të mohimit të gjenocidit ", qasur më 28.2.2014. në http://balkans.aljazeera.net/vijesti/pocetak-kraja-negiranja-genocida.

5 „NVO: Edhe Tadić edhe Nikolić mohojnë faktet gjyqësore në Srebrenicë", qasur më 28.2.2014. në http://www.blic.rs/Vesti/Politika/350672/NVO-I-Tadic-i-Nikolic-negiraju-sudske-cinjenice-o-Srebrenici.

6 Todor Kuljić, *Kultura e kujtimit: shpjegime teorike të shpjegimit të kaluarës* "Čigoja štampa", Beograd, 2006, faqe 9.

7 *Ibid*, faqe 17.

8 Mark Friman, „Çka është drejtësia tranzicionale?", *Forumi i drejtësisë tranzicionale 1* (2007), "Fondi për të Drejtën Humanitare", 2007, faqe 7.

mund të realizohet individualisht ose kolektivisht.[9] Masat kolektive janë në të shumtën e rasteve simbolike: "nderimet vjetore ndaj viktimave ose pranimi publik i shtetit se është përgjegjëse... "[10] Më tej në raport, në pjesën kushtuar masave të reparacionit, thuhet se "Masat simbolike do të merren në këto fusha si reparacione morale dhe kolektive, që të përmbushet obligimi i kujtimit "[11], ndërsa si një ndër masat përmendet edhe ndërtimi i memorialëve, përkatësisht përmendoreve. Obligimi, i cili rrjedh nga kjo e drejtë e viktimave, e të cilën e ka shteti, është që "t'u ofrojë viktimave reparacion adekuat"[12], me çfarë mendohet në mënyra jomonetare të reparacionit siç janë memorialet. Mark Friman, rreth reparacioneve, thotë se ato janë "metoda jashtëgjyqësore, që kanë qëllim primar kontributin në përmirësimin e pasojave materiale dhe morale të shkeljes së drejtave të njeriut".[13] Në rastin e përmendoreve dhe memorialeve, fjala është për reparacione simbolike.

Ngritja e përmendoreve viktimave të luftës nuk është tendencë e re dhe ekziston që disa shekuj: "Gjatë kohës së Napoleon Bonapartës forcohet kultura e përmendoreve, si mënyrë e kujtimit të së kaluarës monumentale të shtetit. Në të njëjtën kohë edhe kujtimi zyrtar edhe demokratizohet: shënohet vdekja jo vetëm e mbretërve dhe udhëheqësve ushtarakë, mirëpo edhe e qytetarëve të thjeshtë."[14]

Kur flitet për memorialet dhe ndikimin e tyre në tregimin dominues të së kaluarës si dhe rreth marrëdhënies me të njëjtin, është e rëndësishme të flitet diçka edhe për kujtimin. Memorialet gjithsesi se formësojnë kujtimin për të kaluarën, ndërsa siç thekson profesor Kuljić "kujtimi ka (1) rol kognitiv pra, mund të jetë tentim i njohjes reale të së kaluarës, por është edhe (2) metodë e krijimit të njohurive grupore selektive për të kaluarën. Me fjalë tjera, ekziston e kaluara praktike dhe historike. Tek kujtimi selektiv mbizotëron e kaluara praktike."[15] Në kontekstin e këtij punimi do të flasim për kujtimin kolektiv dhe të kaluarën praktike. Kur flasim për memorialet, veçanërisht për ato që do të bëhet fjalë, si një funksion gjithsesi se mund të merret që ato janë mjete të krijimit të njohurive *selektive* grupore të së kaluarës. Memorialet e ndërtuara në Serbi pikërisht krijojnë njohuri grupore selektive, me çfarë do të merremi në vazhdim të tekstit. Njohuritë e tilla grupore selektive anashkalojnë faktet, duke mjegulluar përgjegjësinë e Serbisë dhe në rend të parë nuk e kanë respektimin e viktimave, ndërtimin e paqes ose diçka të tillë, por pikërisht formësimin e pamjes të së kaluarës duke ndërtuar tregimin dominues që i përshtatet.

## Përmendorja „Uznesenje" në Kragujevc

Përmendorja „Uznesenje" është ngritur në Kragujevc, në qershor të vitit 2007, dhe është vendosur në pjesën më qendrore të qendrës së qytetit. Është vepër e arkitektes Nataša Atanasijević dhe skulptorit Zoran Ilić. Ndërtimi i përmendores, të lartë nëntë metra e gjysmë, është financuar nga buxheti i qytetit dhe ka kushtuar katër milion e gjysmë dinarë. Edhe pse mund të dëgjohet të thuhet se u kushtohet viktimave të luftërave nga viti 1991 deri në vitin 1999, përmendorja në fakt u dedikohet qytetarëve të Kragujevcit, që kanë vdekur në front në këto luftëra. Emrat e 82 personave janë të gdhendura në piedestal të përmendores me stemën e qytetit të Kragujevcit dhe Shoqatës së Invalidëve të Luftës.[16] Në anën tjetër edhe pse përmendorja u është kushtuar kragujevasve, të cilët kanë vdekur si pjesëmarrës në luftërat e viteve nëntëdhjetë, është e paqartë nëse u dedikohet nëse bëhet fjalë për persona, që kanë vdekur në njësitë e rregullta të JNA, më vonë Ushtrisë së Jugosllavisë, ose si vullnetarë. Përveç kësaj, askund nuk shënohet nëse në mes të tyre gjenden edhe ata, që si pjesëmarrës në luftë kanë qenë përgjegjës për krime, posaçërisht pasi që dimë se Brigada e 80-të mo-



9 *Question of the impunity of perpetrators of human rights violations (civil and political), Final report prepared by Mr. Joinet pursuant to Sub-Commission decision 1996/119*, faqe 9, qasur në: http://www.dealingëiththepast.ch/fileadmin/user_upload/2013_Course/Readings_2013/1_Joinet-Question_of_the_impunity_of_perpetrators_of_HR_Violations.pdf, prevod L.B.

10 *Ibid*, faqe 9, përkthimi L.B.

11 *Ibid*, faqe 26.

12 Juan E. Mendez, *Accountability for Past Abuses, Working Paper #233*, 1996, faqe 7, qasur në: https://kellogg.nd.edu/publications/workingpapers/WPS/233.pdf.

13 Mark Friman, "Çfarë është drejtësia tranzicionale ?", *Forumi i drejtësisë tranzicionale 1* (2007), "Fondi për të Drejtën Humanitare", 2007, faqe 11.

14 Todor Kuljić, *Kultura e kujtimit: shpjegim teorik i përdorimit të kaluarës*, "Čigoja štampa", Beograd, 2006, faqe 33–34.

15 *Ibid*, faqe 10.

16 Çdo vit në raportet e mediave lokale por, edhe kombëtare, ky numër varion nga 82 e deri te mbi 93 persona dhe deri në "mbi njëqind", siç është mundur të dëgjohet në një reportazh të Radiotelevizionit të Kragujevcit.

torike e Kragujevcit ka marrë pjesë në sulmin në Vukovar, dhe se njësia e saj e policisë ushtarake ka marrë pjesë në rruajtjen e robërve, të cilët më vonë janë vrarë në Ovqar.[17]

Vetë pamja e përmendores ka ngritur komentime të ndryshme, ndërsa për shkak të pamjes edhe vetë banorët e Kragujevcit e thërrasin "lëpiza". Një nga figurat njerëzore të gdhendura në përmendore në dorën e ngritur mban kryqin, ndërsa ka mbetur tërësisht e panjohur pse është pjesë e përmendores edhe skulptura e një shëtitësi me një skulpturë qeni, i cili shikon përmendoren.

Ja vlen të analizohet se cila është rëndësia e përmendores për popullsinë lokale dhe nëse ajo është bërë vend i kujtimit, ose është vetëm një projekt i pakuptimtë i qytetit. Vetë estetika e projektit është bërë problematike disa herë, ndërsa nga ajo ka arritur edhe emërtimi jozyrtar i përmendores. Kur bëhet fjalë për artin në hapësira publike, çka është përmendorja, pritet që ajo të jetë e këndshme edhe nga ana estetike, të jetë respektabile. Sidoqoftë, tek përmendorja kjo nuk është e domosdoshme, pasi që mund të udhëhiqet nga ideja që me estetikë mund të krijohet shqetësim tek vëzhguesi, ndoshta edhe frikë, konfuzion dhe ndjenja negative, e cila dërgon deri të rishikimi i qëndrimit vetanak. Në anën tjetër, në mënyrë që përmendorja të bëhet pjesë e komunitetit nuk duhet të krijojë averzion. Ndoshta më e keqja është ajo se çfarë ka ndodhur me këtë përmendore, i cili ka mbetur në mes të rrugës dhe ka shkaktuar indiferencë.

Ndërkohë, përmendej se mediat e qytetit shpesh ndërrojnë numrin e të vrarëve, të cilëve u është kushtuar përmendorja, dhe mund të dëgjohet se bëhet fjalë për 86 persona, por edhe "mbi njëqind", 103 ose 104, ndërsa konfuzion të mëtutjeshëm sjell Shoqata e Invalidëve të Luftës, të cilët nuk dinë as vetë se kujt i kushtohet përmendorja, ku në një deklaratë të përfaqësuesve kanë thënë se bëhet fjalë për 79 banorët e Kragujevcit, ndërsa numri prej 96 personave përfshinë të vrarët, që nuk kanë qenë nga Kragujevci, mirëpo kanë qenë refugjatë dhe persona të zhvendosur brenda shtetit, që janë stacionuar në Kragujevc[18]. Gjithashtu për marrëdhënien ndaj përmendores flet edhe fakti se Radio Televizioni i Kragujevcit, në disa raporte, përmendoren e quan "Uznesenje", ndërsa në disa "Uspenje". Përmendorja që nga vendosja është bërë vend ku mbahen tubimet komemorative çdo 24 mars nga Shoqata e Invalidëve të Luftës dhe Familjet e Viktimave.[19] Përveç kësaj, disa nga protestat e invalidëve të luftës (dhe të paqes) janë mbajtur në këtë vend, si përkujtime të ditëve tjera[20].

Nëse kthehemi në tezën fillestare të etnicitetit të memorialeve, përmendorja në Kragujevc e konfirmon këtë. Përmendorja i përket vetëm një grupi etnik – serbëve, qytetarëve të Kragujevcit, që është e qartë pasi që shihen simbolet kombëtare të etnitetit serb (ocila). Teza e dytë, ajo për karakterin religjioz të përmendores, gjithashtu mund të konfirmohet me faktin se në majë të përmendores, një nga figurat e skalitura në dorën e ngritur mban kryqin. Ajo që është e rëndësishme të theksohet është pikërisht fakti se kjo përmendore është e ngritur për ushtarët, pjesëmarrësit e luftës, të cilët kanë humbur jetën në luftë. Në të njëjtën kohë, Kragujevci nuk ka asnjë përmendore për viktimat civile të luftës në hapësirën e ish-Jugosllavisë. Jovan Bajford, në librin e ti për kampet e përqendrimit, në sheshin e vjetër të panaireve thotë se me përfundim të Luftës së Dytë Botërore, së pari u janë ngritur përmendore ushtarëve të vrarë: "Menjëherë pas luftës, aktivitetet komemorative në vend janë drejtuar kryesisht drejt zbulimit dhe shënimit të duhur të varrezave të luftëtarëve të rënë. Lidhja e Luftëtarëve të Luftës Nacionalçlirimtare, e cila që nga fillimi, në vitin 1947, ka qenë 'kreatori kryesor, agjitator dhe ruajtës i kujtimit zyrtar për luftën' ka drejtuar vëmendjen në ata, të cilët me 'vendosmërinë e tyre, mosfrikën dhe dashurinë për liri kanë dhënë jetët' në luftën kundër 'pushtuesve dhe tradhtarëve të huaj'. "[21] Pra, ngritja e përmendores luftëtarëve të LNÇ-së është caktuar me karakterin e LNÇ-së, lufta ka qenë çlirimtare, është bërë kundër okupatorit fashist dhe bashkëpunëtoreve të tij, ndërsa në të bashkësitë lokale kanë pasur rol të rëndësishëm, mirëpo viktimat lokale janë anashkaluar shumë në krahasim me ato ushtarake. Nëse krahasojmë ngritjen e përmendores pjesëtarëve të luftës së nëntëdhjetave, para viktimave civile



17 Është gjetur nga deklarimet e dëshmitarëve në gjykimin para Njësisë për krime lufte të Gjykatës Rajonale të Beogradit, sipas raportit nga gjykimi: http://www.hlc-rdc.org/ëp-content/uploads/2013/01/Ovcara-V-Izve%C5%A1taj-sa-sudenja-24-01-2013-.pdf.

18 Thënë sipas http://www.rtk.co.rs/kragujevac/item/12711-udruzenje-rvi-proslavilo-mitrovdan.

19 Fillimi i bombardimit i Republikës së Jugosllavisë.

20 Data e miratimit të Ligjit të parë për invalidët e luftës dhe data e rifillimit të punës së Shoqatës së Invalidëve të Luftës në Kragujevc.

21 Jovan Bajford, *Vendi i vjetër i panairit: vend i kujtimit, harresës dhe polemikës*, "Qendra për të Drejta të Njeriut në Beograd", Beograd, 2011, faqe 85–86.

në Kragujevc, ose cilindo qytet tjetër në Serbi, me situatën për të cilën flet Bajfordi, vijmë deri te një çështje e rëndësishme: çështja e karakterit të luftës së viteve nëntëdhjeta, të përshkruar nga këndi i Serbisë. Në tregimin dominues të Serbisë, luftërat në Kroaci dhe Bosnje e Hercegovinë kanë karakter qytetar, fetar, por edhe të luftërave mbrojtëse për serbët që kanë jetuar në këto rajone dhe të cilëve u kanë ndihmuar qytetarët e Serbisë në këto luftëra. Nuk mund të thuhet se të gjithë pjesëmarrësit e luftës që janë vrarë, në këtë rast nga Kragujevci, kanë qenë kriminelë lufte e as që kanë marrë pjesë në kryerjen e krimeve të luftës, por disa pa dyshim që po. Pa përcaktim të qartë të karakterit të luftës, një përmendore e tillë lehtë mund të përdoret për manipulim të së kaluarës. Përveç kësaj, kësaj pyetjeje mund t'i qaset me përfshirje më të madhe të bashkësisë lokale, që nuk ka qenë në rastin e Kragujevcit. Dëshmi për këtë është edhe sjellja e mediave ndaj memorialit poashtu edhe qytetarëve të Kragujevcit, që përmendores i kanë dhënë emër ironik. Një përmendore e tillë qartë ka kuptim vetëm për familjet e të vrarëve dhe pavarësisht nga porositë që dërgohen çdo vit nga mbledhjet komemorative[22], përmendorja në asnjë rast nuk kontribuon në kuptimin më të mirë të së kaluarës. Me shikim laik në këtë përmendore, i cili më së lehti përshtatet në tregimin dominues, veçanërisht tek të rinjtë është e tillë që të konkludohet logjikisht: përmendorja u është ngritur pjesëmarrësve të luftës, të cilët kanë humbur jetët, luftërat në të cilat kanë marrë pjesë kanë qenë të arsyeshme dhe të drejta, e me vetë këtë pjesëmarrja e tyre në luftërave ka qenë heroike.

## Përmendorja në Beograd

Nëse përmendorja në Kragujevc ka shërbyer si shembull e memorialit të keq, i cili nuk plotëson qëllimin, memoriali, i cili e ka hapur dilemën se cilëve pjesëmarrës të luftërave iu ka kushtuar, përmendorja në Beograd është shembull edhe më drastik i praktikës së këtillë. Përmendorja në Beograd është ngritur në vetë sheshin e Savës, në trembëdhjetëvjetorin e fillimit të bombardimit të Republikës Socialiste të Jugosllavisë, në vitin 2012. Në përmendore është shkruar fjalia e mëposhtme: "Viktimave të luftës dhe mbrojtësve të atdheut nga viti 1990 deri në vitin 1999". Pas hyrjes në një analizë më të thellë të kësaj fjalie dhe vetë memorialit, vlen të jepet edhe një rishikim i tentimeve të mëhershme të ngritjes së kësaj përmendoreje. Iniciativat e para që në Beograd të ngrihet një përmendore kanë ardhur që nga viti 1997 nga ana e shoqatave të luftëtarëve, ndërsa hapat e parë konkret janë marrë në vitin 2002, kur Kuvendi Komunal i Beogradit ka hapur konkurs për zgjidhjen ideore të memorialit "luftëtarëve të rënë dhe viktimave të luftërave nga viti 1990 deri në 1999 në territorin e ish-Jugosllavisë".[23] Që vitin tjetër, qyteti e anulon konkursin pasi që, siç u tha, emërtimit të gabueshëm dhe më vonë në të njëjtin vit shpallë konkursin, i cili u kushtohej vetëm viktimave. Në vitin 2005 Sekretariati për Kulturë prapë shpallë konkurs, me specifikën se ai tani nuk ka të bëjë vetëm me përmendoren, por rregullimin e tërë sheshit Sava, në brendësi të cilit duhet të jetë edhe përmendorja që u dedikohet "viktimave të luftës dhe mbrojtësve të atdheut që nga viti 1990 e deri më 1999." pastaj, një vit më vonë u përzgjedh ideja që fitoi jo vendin e parë, por të dytin, por që kishte marrë rekomandim për realizim.[24] Autori dhe autorja e zgjedhjes ishin studentë të Fakultetin Arkitektonik. Është interesante se në konkursin e vitit 2003 nuk ka pasur fitues, pasi që është arritur në përfundim se asnjë nga punimet e arritura nuk ka mesazh të fortë dhe të qartë artistik, ndërsa ky kriter thuajse u harrua kur është bërë zgjedhja përfundimtare.[25]

Qenësore për këtë përmendore, nëse nuk anashkalojmë estetikën dhe zgjidhjen, është fjalia e shkruar në të, ku përmendorja është qartësisht e dedikuar "viktimave të luftës" dhe "mbrojtësve të atdheut". Me këtë, në të njëjtin vend futen viktimat, të cilat janë vrarë si viktima të krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut dhe ata, të cilët ndoshta kanë kryer këso krimesh. Kjo mënyrë e shlyerjes së vijës në mes të viktimave dhe kryerësve të krimeve sjell deri te: "Mjegullim i së kaluarës duke shtrembëruar marrëdhënien në mes të viktimave dhe xhelatit ose nëpërmjet vendosjes së vijës nga ana e qendrave të monopolizuara të fuqisë, të cilët thurin kulturën hegjemoniste të kujtimit, kushtëzon shikim ndryshe nga gjeneratat e reja në vendkujtime (llogore). "[26] Edhe pse Kuljić në librin e tij flet për llogoret si vendkujtime, duhet të tërhiqet paralelja me këtë përmendore. Një përmendore e tillë, *de facto* përfaqëson



22 E cila kryesisht merret me mospërsëritjen e konfliktit dhe pozitës së invalidëve të luftës.

23 Slobodan Kostiq, "Përmendore viktimave të panjohura, luftëtarëve dhe atdheut", *Vreme: 1108*, 2012, qasur me 28.2.2014. në http://www.vreme.com/cms/vieë.php?id=1043515http://www.vreme.com/cms/vieë.php?id=1043515.

24 *Ibid.*

25 *Ibid.*

26 Todor Kuljić, *Kultura e kujtimit: shpjegime teorike dhe përdorimi i së kaluarës*, "Čigoja štampa", Beograd, 2006, faqe 190.

mjegullim të së kaluarës dhe marrëdhënie të shtrembëruar nëpërmjet viktimës dhe kryerësve.

Vetë fjala "atdhe" bëhet problematike kur futet në kontekst të luftërave në hapësirën e Jugosllavisë së dikurshme, në të cilat Serbia ka marrë pjesë. Nëse "atdheun" e kuptojmë si vendin ku kanë ndodhur luftërat, atëherë kjo hapësirë është shumë më e madhe se territori i Serbisë dhe përfshinë hapësira të shteteve tani të pavarura. Një kuptim i tillë përputhet me tregimin dominues dhe kontribuon në mjegullimin e përgjegjësisë së Serbisë. Ky tregim dominues na tregon se Serbia ka udhëhequr luftëra çlirimtare, siç është thënë në përmendore, luftëra për atdhe. Kjo mund të pranohet vetëm nëse i vlerësojmë qëndrimet e rrymave ekstreme politike, të cilët i kanë vizatuar hartat e Serbisë duke i shkelur rëndë ato të shteteve tjera.[27] Pushteti në Serbi, në vitet pas vitit 2000, është profilizuar politikisht si kundër këtyre ideve. Prapëseprapë, në vitin 2012 me një përmendore të tillë, pushteti gati se ka nënshtruar atë për çfarë janë munduar grupet ekstreme në vitet e nëntëdhjeta.

Moment të rëndësishëm në analizën e këtij memoriali përfaqëson edhe arsyetimi i qeverisë së qytetit, që është përdorur si përgjigje në kritika. Zëvendësi i kryetarit të kuvendit të qytetit të Beogradit, Zoran Alimpić, i ka definuar viktimat dhe mbrojtësit në këtë mënyrë: "Nën mbrojtësit e atdheut kuptohen, normalisht, njerëzit që kanë qenë nën armë. Ndërsa nën-viktima nënkuptohen civilët, dëmi kolateral (ital. L.B.), dhe unë mendoj se të gjithë e kanë të qartë."[28], me të cilën vrasjet e viktimave civile, në luftërat e 1990-tës, janë vendosur në nivelin e rastësisë dhe pa qëllim. Alimpiq poashtu ka dhënë interpretimin e mbrojtësve duke u përgjigjur në pyetjen se a i dedikohet përmendorja edhe atyre që kanë rrënuar Vukovarin, Dubrovnikun dhe kanë granatuar Sarajevën: "Kjo është përmendore e mbrojtësve, njerëzve që janë ftuar në ushtri që të mbrojnë vendin e tyre, që i janë përgjigjur, të cilët kanë dhënë jetën e tyre. Këta meritojnë përmendore. Në luftë, normalisht, ka pasur viktima. Është normale që kanë gjuajtur nga topat dhe është normale që ka pasur shkatërrime. Të gjitha përmendoret në botë u kushtohen ushtarëve në luftë, në një mënyrë janë përmendore për njerëz, që kanë vrarë, që kanë shkrepur armë. Pra kjo nënkuptohet."[29]

Një prej arsyeve se përse ngritën përmendoret, përpos njohjes së viktimave, është edhe çështja e mospërsëritjes së krimeve. Memorialet janë aty për të përkujtuar për të keqen që ka ndodhur, për përgjegjësi por, edhe të dërgojnë mesazhin e mospërsëritjes. Një mesazh absolutisht të kundërt ka dërguar Alimpić: "Prapë ndoshta do të vijmë në situatë ku do të jemi viktima të ndonjë agresioni dhe duhet të thërrasim njerëz të rinj dhe t'u tregojmë se qëndrojmë prapa tyre."[30] Një mesazh i tillë nuk flet për mospërsëritje por, për domosdoshmërinë e përgatitjes për konflikte të reja.

Milica Tomić, artistja nga grupi "Spomenik/Përmendorja", tha se memoriali në sheshin e Savës në Beograd, në fakt, paraqet pamjen e gjendjes në Serbi: "Kjo përmendore, prej konkursit të parë e deri më sot, përfaqëson konfuzionin e shtetit të Serbisë dhe qytetarëve të saj në raport në luftërat, të cilat i ka udhëhequr gjatë viteve nëntëdhjetë. Në Serbi nuk është e qartë se ku janë bërë luftërat, kush i ka kryer, në emër të kujt dhe cili shtet qëndron pas kësaj."[31] Prapë, nëse merret në konsideratë ajo çfarë është shkruar më herët, këtu nuk është fjala për konfuzion, përkundrazi bëhet fjalë për përvetësim të vetëdijshëm të tregimit dominues dhe normalizimit të tij në diskursin publik.

## Domosdoshmëria e ndryshimeve

Përgjigjja në pyetje se çfarë duhet të jetë kultura e përmendoreve, për të cilën u fol dhe se çfarë duhet të jenë memorialet në Serbi, nuk është as e lehtë e as e thjeshtë. Në dhënien e përgjigjes përfundimtare duhet domosdosh-



27 Kështu Partia Radikale Serbe një prej partive udhëheqëse në vitet e 1990-ta ka dashur që "në kufijtë e shtetit të lirë dhe pavarur serb [...] hyjnë përveç të tanishmes, edhe njësitë e ndara federale dhe Maqedonia serbe, Mali i Zi serb, Hercegovina serbe, Dubrovniku, Dalmacija serbe, Lika serbe, Banija dhe Korduni, Slavonija dhe Baranja Serbe. Ne konsiderojmë se kufijtë perëndimor të shtetit serb kufizohen me vijën Karlobag-Ogulin-Karlovac-Virovitic." Vojislav Šešelj, "Amputimi i padhembshëm i Kroacisë', *Serbia: çdo gjë për programin nacional serb (botim special),* 1991, faqe 34.

28 Branka Mihajlović „Beogradi ngrit përmendoren viktimave dhe vrasësve të nëntëdhjetave ", Slobodna Evropa, 2012, qasur me 28.2.2014. në http://www.slobodnaevropa.org/content/spomenik_zrtvama_i_zlocincima/24485192.html.

29 *Ibid*.

30 Marko Lovrić "Përmendorja e shifruar ", *NIN: 3193*, 2012, qasur më 28.2.2014. në http://www.nin.co.rs/pages/article.php?id=67099.

31 Slobodan Kostić, "Përmendore viktimave të panjohura, luftëtarëve dhe atdheut", *Vreme: 1108*, 2012, qasur me 28.2.2014. në http://www.vreme.com/cms/vieë.php?id=1043515.

mërisht të marrin rol më të madh viktimat dhe familjet e tyre, artistët, të rinjtë dhe grupet tjera shoqërore. Praktika e deritanishme dominonte është shembull negativ dhe më shumë e thellon problemin. Para së gjithash, qeveria në Serbi duhet të pranojë faktet e vendosura për krimet e luftës dhe të bëjë tentime të mëtutjeshme në këtë shikim si dhe të pranojë se krimet e luftës janë kryer, se individë të caktuar janë shpallur përgjegjës për to, që do të dërgojnë edhe më tutje në atë se Serbia shumë më qartë dhe vendosmërisht e pranon përgjegjësinë për pjesëmarrje në luftë. Nga kjo mund të rrjedhë një praktikë tjetër e ngritjes së memorialit. Debati, i cili u bë rreth asaj se nëse duhet që kryerësve të krimeve vetanake t'u ngritën përmendore, tanimë është bërë në Gjermani pas Luftës së Dytë Botërore dhe kështu Valter dhe Augshtajn kanë pohuar se "nuk mund t'i ngritë përmendore turpit vetanak"[32], ndërsa Habermas ka qenë në qëndrimin tjetër: "Habermas ka tërhequr vërejtjen se të menduarit e tillë qëndron në kultin e viktimës. Domethënë se vetëm viktimës aktive për komb mund t'i ngritët përkujtimore. Nëse pasardhësit e xhelatit sot i ngrenë përmendore një vepre monstruoze, pra viktimave të huaja, kjo është një perspektivë tjetër. Kjo përmendore nuk do ta tërheqë vëmendjen e vizitorëve për të vrarët e tyre, kjo nuk është përmendore si ajo në Uashington, që është ngritur për amerikanët e vrarë në Vietnam. Kjo është përmendore, të cilën gjermanët e ngritën për viktimat e terrorit të vet, të cilët vetë i kanë shënuar si armiq dhe qenie më të ulët. Kjo është tashmë kalim i kufirit autokritik. Holokausti kërkonte nga gjermanët përgjegjësi morale personale, që është e papajtueshme me mënyrat konvencionale të kultit nacional të të vdekurve (Habermas 1999)."[33] Serbia do të duhej të udhëhiqej më fjalët e Habermasit para mendimit "konkurrent" nëse dëshiron që të vendoset sipas rolit të saj në luftërat e viteve të nëntëdhjeta. Vërtetim i mëtutjeshëm i kësaj është marrëdhënia e tanishme ndaj Holokaustit dhe viktimave të nazizmit. Deri te ky përfundim vjen Kulj kur thotë: "Pra, shembull i kulturës antifashiste të kujtimit nuk duhet të jetë përmendorja e Uashingtonit për Amerikanët e rënë në Vietnam, por Holokausti i Berlinit përmendorja e viktimave të krimeve gjermane."[34]

Të gjitha tentimet e mëtutjeshme të ballafaqimit me të kaluarën mund të dështojnë nëse një praktikë e tillë nuk ndryshohet dhe nuk ndalet me tregim dominant. E vetmja mënyrë që të ndërpritet me këtë praktikë është që të ndryshojë tregimi dominues e që është e mundur të bëhet ekskluzivisht më anë të rrugës së vendosjes së fakteve dhe formimit të tregimit të ri bazuar në to. Një punë e tillë nuk është e lehtë, kërkon vullnet politik, duhet të bëhet në nivelin rajonal dhe kërkon shoqëri civile të fortë dhe të organizuar. Roli i shoqërisë civile është që të iniciojë procese që dërgojnë rreth ballafaqimit serioz me të kaluarën, e për çka shtetet sot nuk kanë vullnet krahas mungesës së guximit ose mohimit të krimeve të luftës ose të vetë konfliktit. Një aktivitet i tillë i shoqërisë civile duhet të bëhet në nivel rajonal, që të marrin pjesë të gjitha palët që dikur kanë qenë në konflikt. Secili investim në procesin e vendosjes së fakteve, e cila merret me të gjitha aspektet e krimeve, që janë kryer gjatë konfliktit, nuk është e mundur që të kryhen në mënyrë unilaterale, por vetëm me bashkëpunim me shtetet tjera të krijuara në hapësirën e Jugosllavisë së dikurshme. Puna e mëtutjeshme e vendosjes e një tregimi ndryshe kërkon që faktet e vendosura të jenë të pranuara nga ana e qytetarëve dhe qytetareve, gjë që kërkon aktivitet të madh të shoqërisë civile dhe rol të saj në informimin dhe edukimin, të paktën deri në atë moment kur shtetet marrin hapa konkretë në reforma institucionale dhe edukative.

Prapë është vështirë të pritet që shoqëria civile do të jetë ajo që procesin e ballafaqimit me të kaluarën dhe vendosjen e fakteve do ta "bartë në shpinën e vet". Aktor kryesor, ose të themi aktorët që duhet t'i zgjedhin këto çështje janë shtetet, që janë formuar me shpërbërjen e Jugosllavisë. Në vetë fillim janë përmendur Louis Joinet, i cili i ka përcaktuar të drejtat që viktimat i kanë dhe Juan Mendez, i cili i ka përcaktuar përgjegjësitë që i kanë shtetet në realizimin e këtyre të drejtave. Në raportin, të cilin e ka përpiluar Joinet, e drejta në të vërtetën është e përcaktuar më gjerë se e drejta e anëtarëve të familjes dhe më të afërmëve që të dinë se çfarë ka ndodhur. Ajo është e formuluar si e drejtë kolektive.[35] "E drejta në të vërtetën është gjithashtu e



32 Todor Kulić, *Kapërcimi i së kaluarës: shkaqet dhe drejtimet e ndryshimit të formës së historisë në fund të shekullit XX*, "Këshilli i Helsinkit për drejtat e njeriut në Serbi", Beograd, faqe 202.

33 *Ibid*, str. 212.

34 *Ibid*, str. 420.

35 *Question of the impunity of perpetrators of human rights violations (civil and political), Final report prepared by Mr. Joinet pursuant to Sub-Commission decision 1996/119*, faqe 5, qasur me: http://www.dealingwiththepast.ch/fileadmin/user_upload/2013_Course/Readings_2013/1_Joinet-Question_of_the_impunity_of_perpetrators_of_HR_Violations.pdf.

drejtë kolektive, e cila bazohet në histori, në mënyrë që të evitohen konfliktet në të ardhmen. Pasojë e kësaj të drejte është "obligimi i kujtimit", që është obligim i shtetit: që të përgatitet për shtrembërim të historisë, siç është revizionizmi, sepse historia e periudhës së represionit është pjesë e trashëgimisë kombëtare të popujve dhe si e tillë duhet të ruhet. Këto pra janë qëllimet kryesore të së drejtës kolektive."[36] Historia e represionit, siç e ka quajtur Joinet atë çfarë ne shpesh e quajmë shkelje masive të të drejtave të njeriut, në kontekstin e këtij punimi është periudha prej 1990 deri në vitin 1999. Tregimi dominant i përmendur është pikërisht shtrembërimi i historisë dhe paraqet shikim revizionist në të kaluarën. Nga të lartpërmendurat mund të arrihet në përfundim se e drejta në të vërtetën, si e drejtë kolektive, është e drejtë që u takon jo vetëm viktimave të shkeljeve masive të drejtave të njeriut por, edhe shoqërisë në përgjithësi. Juan Mendez e ka formuluar këtë në këtë mënyrë: " Shkeljet sistematike të drejtave të njeriut gjenerojnë obligime që shteti ua ka borxh viktimave dhe shoqërisë."[37] E drejta në të vërtetën do të thotë edhe se shteti, përkatësisht shtetet, të vendosin faktet për shkeljet masive të drejtave të njeriut, nga të cilat duhet të rrjedhin hapat tjerë. Edhe pse theksi në Serbi është vendosur në gjykimet për krime të luftës, shteti duhet të shkojë një hap më tutje dhe nëpërmjet mekanizmave jashtëgjyqësore, siç janë komisionet e së vërtetës, të vendosë të gjitha faktet. Mendez thekson: „ Nëse aktgjykimi arrihet ose është e pamundshme të deklarohet për shkaqe të rrethanave legjislative, shteti prapë është i obliguar që t'i hetojë dhe zbulojë faktet, që të pranojë padrejtësitë të kryera në emrin e saj."[38] Për vetë pranimin se padrejtësia në emrin e shtetit është kryer, më saktë, se janë kryer krime të luftës, për Serbinë janë të mjaftueshme aktgjykimet e TPNJ-s dhe gjykatave vendore. Prandaj, është e domosdoshme të vendosen të gjitha faktet, të cilat do të ishin bazë e tregimit të ri. Vetëm në këtë tregim, të bazuar në faktet e vendosura nga ana e shteteve dhe të cilat shtetet i pranojnë, vetëm në këto duhet të bazohet politika e përmendoreve, edukimin, reformën institucionale dhe për fund vendosjen e paqes së qëndrueshme dhe të bashkëpunimit.



36 *Ibid*, përkthim L.B.

37 Juan E. Mendez, *Accountability for Past Abuses, Working Paper #233*, 1996, faqe 3, qasur me: https://kellogg.nd.edu/publications/workingpapers/WPS/233.pdf, përkthim L.B.

38 Juan E. Mendez, *Accountability for Past Abuses, Working Paper #233*, 1996, faqe 14, qasur në: https://kellogg.nd.edu/publications/workingpapers/WPS/233.pdf.

# Drejtësia Tranzicionale në Bosnje dhe Hercegovinë: E drejta për të vërtetën

Jasmin Hamzić

**Hyrje**

Bosnja dhe Hercegovina, në periudhën prej vitit 1992 deri në vitin 1995, ka qenë e përfshirë në konflikt të armatosur, i cili është karakterizuar me shkelje masive dhe sistematike të së drejtës humanitare ndërkombëtare e që ka rezultuar më humbjen e rreth 100.000 jetëve, derisa 2.2 milion njerëz kanë ikur ose janë shpërngulur përbrenda shtetit. Rreth 8.000 njerëz ende konsiderohen si të humbur.[39] Janë kryer edhe shumë shkelje të mëdha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Për shkak të lëshimit në mbrojtjen e drejtave të qytetarëve, në periudhën e përmendur, Bosnja dhe Hercegovina ka detyrime të caktuara në drejtimin e vendosjes së paqes shoqërore nëpërmjet Drejtësisë Tranzicionale, të cilat janë, fillimisht, pasojë e nënshkrimit të konventave ndërkombëtare si dhe si kushtëzim në rrugën e integrimit të mëtutjeshëm në Bashkimin Evropian. Këto detyrime kanë të bëjnë me vendosjen e lirisë rreth të kaluarës, sidomos vendosja e fatit të të zhdukurve, por edhe për masat e nevojshme që të merren vesh faktet për krimet, në mënyrë që përgjegjësitë të procedohen dhe të dënohen, që të arrihej një kënaqje materiale dhe simbolike e viktimave dhe që të sigurohen reforma, që do të parandalojnë përsëritjen e së kaluarës.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit, në vitin 1995, janë nisur disa iniciativa që të respektohen disa nga detyrimet e shtetit, përkatësisht në mënyrë që të zvogëlohen pasojat e shkeljeve masive të drejtave të njeriut gjatë viteve nga 1992 deri 1995. Iniciatori kryesor i aktiviteteve të ndërmarra në fushën e Drejtësisë Tranzicionale kryesisht ka qenë bashkësia ndërkombëtare, madje një numër i caktuar i aktiviteteve është nisur nga institucionet e të gjitha nivele të qeverisjes si dhe shoqëria civile.

Aktivitetet e ndërmarra në fushën e Drejtësisë Tranzicionale janë:

*Procedimi ndërkombëtar dhe vendor i krimeve të luftës.* Procedimi ndërkombëtar nëpërmjet punës së Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë, i themeluar me vendimin e Këshillit të Sigurimit, më 25.05.1993, pastaj të Këshillit për Krime Lufte të Gjykatës së Rrethit në Beograd, pastaj të gjykatave të shteteve të treta, në përputhje me parimin e juridiksionit universal. Procedimi vendor kryhet nëpërmjet 16 gjykatave dhe atë: Seksioni për krime të luftës të gjykatës së Bosnje dhe Hercegovinës, dhjetë gjykatave kantonale dhe pesë gjykatave të rretheve si dhe Gjykata themelore e Distriktit të Brçkos. Në këtë fushë, në dhjetor të vitit 2008, është miratuar Strategjia për procedimin e krimeve të luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë[40].

39 E qasshme: http://www.mrezapravde.ba/mpbh/mpbh_files/file/Izvjestaj%20o%20trazenju%20istine.pdf, e hapur me: Janar 2014, faqe 56.

40 E qasshme: http://www.tuzilastvobih.gov.ba/files/docs/drzavna_strategija_final_final.pdf, hapur me: Janar 2014.

*Kërkimi i të vërtetës, në çka bie e vërteta për personat e humbur dhe fatit të tyre, mbledhja e historive gojore, dokumentimi, arkivimi dhe dialogët e disa palëve të interesuara.* Janë shënuar shembuj të mbledhjes së historisë gojore, janë bërë filma dokumentarë dhe janë ndërmarrë aktivitete tjera nga ana e organizatave të shoqërisë civile.

Sa u përket iniciativave shtetërore, është e rëndësishme të theksohet miratimi i ligjeve për persona të humbur, me çka është themeluar Instituti për Persona të humbur, që nga iniciativat joqeveritare dhe qendra dokumentuese dhe hulumtuese.

Kanë ekzistuar disa iniciativa për themelimin e komisioneve për të vërtetën dhe pajtimin, nga të cilat, tri janë themeluar ndërsa vetëm një e ka kryer punën dhe raportimin e vet.

*Reparacionet, që nënkupton reparacionet materiale dhe simbolike, kthimi i pasurisë, memorialet*

Sa i përket kthimit të pasurisë, aty është arritur suksesi më i madh. Reparacionet materiale janë të rregulluara me ligjet e entiteteve dhe zbatohen në dy entitetet si pagesa mujore të invalidëve të luftës, viktimave civile si dhe luftëtarëve të demobilizuar. Reparacionet simbolike janë përfaqësuar nëpërmjet kërkimfaljes së kryetarit të RS Dragan Čavić[41], si dhe nëpërmjet anëtarit boshnjak të kryesisë Bakir Izetbegović[42]. Sa i përket memorialeve, këtu aktivitetet janë marrë pa rregullativë adekuate ligjore, ndërsa pamja e memorialeve, shpesh ka karakteristika të riteve pa funksion pedagogjik[43].

*Reformat institucionale, me theks në kontrollimin e kandidatëve për poste publike si dhe lustrimi*

Në këtë fushë janë kryer aktivitetet e kontrollimit (*Vetting),* ndërsa në drejtësi ato të riemërimit. Poashtu është themeluar një numër i madh i institucioneve, ndërsa janë aprovuar edhe një numër i caktuar i ligjeve, që janë të rëndësishme për konceptin e Drejtësisë Tranzicionale. Në pjesën më të madhe, aktivitetet e marra kanë qenë të iniciuara nga ana e bashkësisë ndërkombëtare ose të caktuara me Marrëveshjen e Paqes të Dejtonit, ndërsa elita politike vendore ka qenë zbatuese të këtyre ideve. Zbatimi i këtij mekanizmi ka pasur shumë lëshime, pasi që është parë që misioni i Kombeve të Bashkuara në Bosnjë dhe Hercegovinë, i cili, në fillim, ka kryer kontrollime, vetëm sipërfaqësisht e ka kryer detyrën. Nëpërmjet raportimit të Komisionit për Srebrenicën mund të arrihet në përfundim se një numër i konsiderueshëm i personave të përfshirë në gjenocidin në Srebrenicë ende janë aktivisht në shërbim[44].

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me organizatat joqeveritare ka bërë strategjinë e Ddrejtësisë Tranzicionale 2012-2016. Qëllimi i saj është që të arrihet deri te dialogu publik lidhur me ngjarjet e së kaluarës me qëllim të dhënies së respektit viktimave, të ndalohet kultura e mohimit si dhe të forcimit të besimit në mes të qytetarëve.[45]

## E drejta për të vërtetën

*E vërteta është e vetmja luftë kundër krimit. Përveç fakteve se krimi është kryer, e vërteta është arma më e fortë që ai të mos përsëritet më kurrë* (Jiftar Meiri)

E drejta për të vërtetën është e përfshirë në Konventat e Gjenevës, Deklaratën Univerzale mbi të Drejtat e Njeriut, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Qytetare dhe Politike dhe aktet tjera[46] dhe ka të bëjë, në kuptimin më të gjerë, me të drejtat e familjeve që të marrin informata për fatin e anëtarëve të tyre të zhdukur.

Ata, që kanë mbijetuar më së shumti duan të dinë se çfarë ka ndodhur me të dashurit e tyre. Kjo është bërë nëpërmjet kujtimeve, poezisë dhe madje edhe nëpërmjet shfaqjeve me qëllim të kujtimit. Të dihet dhe të kujtohet, është me rëndësi në mënyrë që ngjarjeve të trishtueshme t'u jepet vendi i tyre në histori.[47]

41 E qasshme: http://www.youtube.com/atch?v=jsB-Wvia3fI, hapur me: Janar 2014.

42 E qasshme: http://www.blic.rs/Vesti/Politika/214709/Bakir-Izetbegovic-se-izvinio-za-zrtve-Armije-BiH, hapur me: Janar 2014.

43 Eqasshme:http://www.mpr.gov.ba/aktuelnosti/propisi/konsultacije/Strategija%20TP%20-%20bosanski%20jezik%20fin%20doc.pdf,hapur me: Janar 2014, faqe 17.

44 E qasshme: http://www.mpr.gov.ba/web_dokumenti/Vodic%20kroz%20tranzicijsku%20pravdu%20u%20BiH.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 31-112.

45 E qasshme: http://www.mpr.gov.ba/aktuelnosti/propisi/konsultacije/Strategija%20TP%20%20bosanski%20jezik%20fin%20doc.pdf, hapur me: Janar 2014 , faqe 6.

46 E qasshme: http://ap.ohchr.org/documents/E/HRC/resolutions/A_HRC_RES_9_11.pdf, hapur me: Janar 2014.

47 Selma Leydesdorff, „How shall we remember Srebrenica? Oral History and Life Stories Versus Juridical Knowledge", in: Rusmir Mahmutćehajić and Desmond Maurer, ed: *Unity and Plurality in Europe: Multiculturalism and Tradition*, Sarajevo, 2008, faqe 81.

Në kuptimin e gjerë, ajo është e drejtë kolektive në njohje dhe mësim të historisë.[48] Vendosja e fakteve për krimet, gjetja e numrit të saktë të vrarëve dhe të zhdukurve, personalizimi i viktimave dhe mësimi i të vërtetës zyrtare do të duhej të kishin implikime pozitive në shoqëri, nëpërmjet arritjes së paqes, ndërtimit të besimit në mes njerëzve dhe parandalimit të konflikteve të reja.

Hapat e parë në drejtimin e vendosjes së fakteve për krimet që kanë ndodhur në Bosnje dhe Hercegovinë, në periudhën prej 1992 deri në vitin 1995ë janë marrë në fushën e të drejtës penale nga ana e gjykatave lokale dhe ndërkombëtare dhe gjykatave të shteteve të treta, që janë përgjegjëse për vendosjen e të vërtetës forenzike/gjyqësore. Megjithatë, procedimit gjyqësor është e nevojshme t'i bashkëngjitet edhe format jashtëgjyqësorë në mënyrë që, përveç të vërtetës gjyqësore, të formësohej edhe e vërteta zyrtare, në të cilën duhet të bazohet shkrimi historik lidhur me ngjarjet e luftës në të kaluarën.

Nuk ka shoqëri të lirë dhe demokratike pa fuqizim të plotë të drejtave të njeriut, lirive të vërteta dhe të drejtës në të vërtetën.

## Zgjidhja e fatit të personave të zhdukur

*Babai im ka qenë dy herë viktimë: një herë kur është vrarë, ndërsa të dytën kur i është fshehur trupi.*[49]

Sipas të dhënave të fundit nga Qendra Hulumtuese Dokumentuese, në periudhën prej 1992 deri 1995, kanë vdekur dhe janë zhdukur rreth 95.000 qytetarë të Bosnjës dhe Hercegovinës.[50] Instituti për Kërkimin e Personave të Humbur në Bosnje dhe Hercegovinë, në një konferencë për media, me rastin e Ditës së Personave të Zhdukur, 30.08.2013, ka nxjerrë të dhënat, që tregojnë se gjatë luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë janë zhdukur më shumë se 30.000 qytetarë. Deri më sot janë gjetur dhe zhvarrosur 23.000 mbetje mortore. Nga ky numër, më shumë se 20.000 janë identifikuar dhe varrosur në mënyrë të dinjitetshme ndërsa për 8.000 ende bëhen kërkime.[51]

Procesi i zgjidhjes së fatit të personave të zhdukur, pas luftës ka ecur shumë ngadalë dhe Dhoma e Përfaqësuesve të Asamblesë Parlamentare të Bosnjë dhe Hercegovinës ka aprovuar rezolutën nëpërmjet të cilës shpreh pakënaqësinë dhe lidhur me këtë kërkon që kryesia e Bosnje dhe Hercegovinës dhe Këshilli i Ministrave në mënyrë më aktive të përfshihen në zgjidhjen e këtij problemi.[52] Shoqata e Viktimave ka bërë presion në mënyrë konstante në mënyrë që të gjejë fatin e më të dashurve dhe kanë kërkuar që të rregullohet statusi i tyre si viktima.

Ligji për personat e zhdukur është miratuar në vitin 2004, ndërsa më nenin e 7 është paraparë formimi i Institutit për Personat e Zhdukur[53]. Mandati i institutit është hulumtimi i varrezave individuale dhe masive, zhvarrosja dhe identifikimi i mbetjeve, formimi i evidencës qendrore të të zhdukurve. Qëllimi i miratimit të këtij ligji ka qenë që të shpejtohet procesi i kërkimit të personave të humbur, identifikimi i tyre, që të vendoset numri i saktë i të zhdukurve, që të rregullohet statusi i familjeve të të zhdukurve dhe shoqatave të tyre si dhe të kompensohen dëmet në bazën e personave të zhdukur.

Problemin më të madh e paraqet moszbatimi i Ligjit, sidomos nenit 4, i cili në mënyrë të qartë sugjeron obligimet e të gjitha institucioneve të pushtetit në Bosnje dhe Hercegovinë që të ofrojnë të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që të zgjidhet fati i personave të humbur.

Instituti për persona të humbur mbështetet për hetimet që i kryen, në agjencinë shtetërore për hulumtim dhe mbrojtje (ASHHM), Agjensionin e Inteligjencës dhe Sigurisë (AIS), policitë kantonale dhe të entiteteve dhe nga hulumtimet e ekipeve hulumtuese në terren. Instituti bashkëpunon mirë me organizatat e shoqërisë civile dhe në punën e vet përdor dokumentacionin e tyre si dhe dokumentacionin e organeve të drejtësisë[54].



48 E qasshme: http://www.mrezapravde.ba/mpbh/mpbh_files/file/Izvjestaj%20o%20trazenju%20istine.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 51.

49 Selma Leydesdorff, „How shall we remember Srebrenica? Oral History and Life Stories Versus Juridical Knowledge", in: Rusmir Mahmutćehajić and Desmond Maurer, ed: *Unity and Plurality in Europe: Multiculturalism and Tradition*, Sarajevo, 2008, faqe 81-82.

50 E qasshme: http://www.hlc-rdc.org/?cat=266, hapur me: Janar 2014.

51 E qasshme: http://www.bljesak.info/rubrika/vijesti/clanak/u-bih-se-traga-za-jos-8000-nestalih-osoba-slaba-provedba-zakona-o nestalim-osobama/4374#rpctoken=514148025&forcesecure=1, hapur me: Janar 2014.

52 Lënda Selimović dhe të tjerët kundër Republika Srpska (CH01-8365 nga viti 2003).

53 E qasshme: http://www.ino.ba/index.php?option=com_content&vieë=article&id=24%3Azakon-o-nestalim-osobama&catid=11%3Azakoni&Itemid=35&lang=bs, hapur me: Janar 2014.

54 E qasshme: http://www.mpr.gov.ba/web_dokumenti/Vodic%20kroz%20tranzicijsku%20pravdu%20u%20BiH.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 69-70

## Formimi i komisioneve për të vërtetën dhe pajtimin

Pas përfundimit të luftës në Bosnje dhe Hercegovinë, në vitin 1995, shoqëria civile ka realizuar shumë projekte në fushën e vendosjes së fakteve dhe tregimit të vërtetës siç janë: dokumentimi i shkeljeve të drejtave të njeriut me anë të marrjes së deklaratave nga viktimat, shënimit të tregimeve pozitive nga lufta, kur fqinjët kanë ndihmuar, xhirimit të filmave dokumentar dhe aktivitete botuese.[55]

Tentimet e para për institucionalizimin e procesit të vendosjes së fakteve dhe tregimit të vërtetës janë bërë nga Fondacioni, Instituti Amerikan për Paqe (USIP) në bashkëpunim me Fondacionin Qytetar të Tuzllës dhe disa organizata tjera, në fund të viteve të nëntëdhjeta.[56] Këto organizata, së bashku, kanë dërguar një shkrim në shumë adresa, në mënyrë që të informojnë dhe të nisin debate për nevojën e vendosjes së institucioneve, që do të merren me vendosjen e fakteve për krimet nga vitet e nëntëdhjeta. Iniciativa ka siguruar përkrahjen e rreth dyqind organizatave të shoqërisë civile, institucioneve dhe individëve. USIP i ka mundësuar përfaqësuesve të organizatave, të cilat i ka kontaktuar që të vizitojnë mbledhje dhe konferenca të ndryshme në shtete të jashtme, ku janë takuar me punëtorë të dikurshëm të komisioneve për vendosjen e së vërtetës dhe pajtimit nga shtetet tjera, ekspertë, të cilët i kanë njoftuar për mënyrat e organizimit të trupave jashtëgjyqësore, si dhe me përfaqësues të TPNJ. Në mënyrë që të përmblidhet i tërë ky proces i njoftimit dhe informimit të shoqërisë civile, në vitin 2000 në Sarajevë është organizuar konferenca ndërkombëtare, e cila ka pritur një nga ekspertët më të mëdhenj botërorë në fushën e Drejtësisë Tranzicionale, Alexa Borainea. Boraine, në vitin 1995, është emëruar, nga kryetari i Republikës Jug-Afrikane Nelson Mandela, për nënkryetar të Komisionit për të vërtetën dhe pajtim në Republikën Jug-Afrikane.[57] Në konferencë kanë marrë pjesë edhe ish-prokurori i TPNJ Richard Goldstone, përfaqësuesit e më shumë se 100 organizatave të shoqërisë civile nga Bosnja dhe Hercegovina, si dhe individë nga shoqëria civile, që merren më çështjen e Drejtësisë Tranzicionale. Në këtë konferencë është paraqitur ideja për nevojën e themelimit të Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin në BeH, ndërsa Shoqata e qytetarëve "E vërteta dhe pajtimi" është dashur ta marrë iniciativën për formimin e këtij trupi. Rezultati i punës së kësaj iniciative është bërë drafti i Ligjit për Komisionin për të vërtetën dhe pajtimin, i cili asnjëherë nuk ka hyrë në procedurë parlamentare e as që është diskutuar për të.

Në fund të vitit 2005, USIP prapë ka tentuar që të kryejë planin fillestar, por tani me partneritet të ngushtë më OJQ-në "Projekti Dejton" dhe duke mos u kufizuar në rrjetëzim të shoqërive civile, por duke u fokusuar në lidhjen e elitave politike. As kjo iniciativë nuk ka pasur sukses, ndërsa ky grup punues asnjëherë nuk ka vendosur propozim konkret ligjor, edhe pse ka punuar në draftin e ligjit të kësaj Shoqate.[58]

Ana pozitive e këtyre iniciativave është rrjetëzimi i organizatave joqeveritare dhe krijimi i kulturës së dialogut.[59]

Si mungesa të këtyre iniciativave mund të përmendën jotransparenca, pasi që organizatat që kanë qenë partnere të USIP asnjëherë nuk kanë organizuar konsultime të gjëra brenda shoqërisë civile, ose ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve qeverisëse për pyetjet themelore lidhur me themelimin e një komisioni të tillë, dhe mospërfshirje në organizatat relevante të viktimave dhe organizatave joqeveritare për të drejta të njeriut në tërë këtë proces.

Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), në vitin 1997, së bashku më shoqatat e viktimave ka qenë kundër një projekti të tillë, duke u arsyetuar me bindjen se aktivitetet e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin mund të cenojnë mandatin e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe mund të vijë deri te një gërshetim i përgjegjësive, duke marrë parasysh se në këtë kohë ka filluar puna intensive në hetime. Përveç kësaj TPNJ ka qenë i rezervuar lidhur me deklaratat publike të viktimave, pasi që ka besuar se biseda në publik për krimet mund të cenojë



55 E qasshme: http://www.ba.undp.org/content/dam/bosnia_and_herzegovina/docs/Research&Publications/Crises%20Prevention%20and%20Recovery/Looking%20Back,%20Looking%20Forward-%20Promoting%20Dialogue%20through%20Truth-Seeking%20in%20Bosnia%20and%20Herzegovina/BiH_pogled_u_proslost_kao_put_prema_buducnosti.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 10.

56 E qasshme: http://www.civilnodrustvo.ba/files/docs/UNDP/Mehanizmi_suocavanja_s_prosloscu.exe.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 5.

57 E qasshme: http://ictj.org/about/alex-boraine, hapur me: Janar 2014.

58 E qasshme: http://www.mpr.gov.ba/web_dokumenti/Vodic%20kroz%20tranzicijsku%20pravdu%20u%20BiH.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 55.

59 E qasshme: http://www.civilnodrustvo.ba/files/docs/UNDP/Mehanizmi_suocavanja_s_prosloscu.exe.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 5.

hetimin ose lëndët e nisura si dhe sigurinë e dëshmitarëve, dëshmitarëve potencialë dhe familjeve të tyre. Në anën tjetër, mendimi i TPNJ ka qenë që ata, tani më, paraqesin platformë për drejtim të viktimave në publik me anë të dëshmisë e që është publike.

TPNJ ka qenë poashtu i bindur se Komisioni do të ketë kompetencën e garantimit të amnistisë, që ka qenë njëkohësisht edhe frika më e madhe e shoqatave të viktimave – frika nga racionalizimi i krimeve. Kompetenca e garantimit të amnistisë ka nxitur shumë polemika, ndërsa shoqata e viktimave ka menduar se themelimi i Komisionit për të vërtetën dhe pajtimit do të thoshte amnisti e kriminelëve, pasi që në këtë kohë bëheshin krahasime me komisionin për të vërtetën dhe pajtim të Afrikës Jugore, përkatësisht me kompetencën e saj që të garantojë amnisti për personat, që pranojnë krimin në mënyrë publike, për ata që kanë kryer ose urdhëruar ose në rastin kur kanë ndihmuar që të kapen të tjerët. Për këtë viktimat në pjesën më të madhe kanë besuar në mekanizmin gjyqësor për tregimin e të vërtetës.

Në kohën kur janë bërë diskutimet për formimin e një trupi hetues të tillë, problemi më i madh ka qenë mosinformimi, përkatësisht moskuptimi i rëndësisë dhe qëllimit të një komisioni potencial për të të vërtetën dhe pajtimin. Shumica e qytetarëve të BeH nuk ka qenë e njoftuar me mandatin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin në republikën Jug-Afrikane, e as me kushtet, nën të cilat garantohej amnistia. Besimi për amnistimin e mundshëm të kriminelëve ka qenë i pabazuar, pasi që në të dy propozimet për themelimin e një komisioni të tillë në mënyrë të qartë është saktësuar se Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin në BeH nuk do të ketë kompetenca që askujt t'i garantojë amnisti, nën çfarëdo kushtesh, ndërsa një përfundim i tillë ka ardhë në mënyrë që mos të cenohen proceset e krimeve të luftës që vetëm sa kanë filluar para TPNJ dhe para gjykatave të entiteteve në BeH.[60]

Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë me kohë ka ndryshuar qëndrimin e tij në lidhje me formimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin, dhe ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim. Këtë qëllime, në vitin 2001, në mënyrë të qartë i ka shprehur, në atë kohë, kryetari i TPNJ Claude Jorda, me rekomandime të caktuara, që kanë qenë: që komisioni të fokusohet në krime të kryera nga ana e personave në rang më të ulët në strukturën komanduese, që të bëhet një draft i rekomandimeve lidhur me reparacionet, që të bëhet analiza historike si dhe vendosja e kujtimit.[61]

## Komisioni për hetimin e ngjarjeve në dhe rreth Srebrenicës prej 10 deri 19 Korrik të vitit 1995 (Komisioni për Srebrenicën)

SI përgjigje në vendimin e Dhomës për të drejta të njeriut në rastin Selimović dhe të tjerët kundër Republika Srpska (RS)[62], dhe me reagimin e përfaqësuesit të lartë (OHR) në Bosnje dhe Hercegovinë (BeH), Qeveria e Republika Srpska, më 15 dhjetor 2003 ka formuar Komisionin për Srebrenicën. Vendimi i Dhomës ka qenë rezultat i 49 paraqitjeve, dhe më vonë edhe 1.800 aplikimeve, që i kanë bërë të afërmit e personave të lajmëruar si të zhdukur në ngjarjet e korrikut të vitit 1995 në rajonin e Srebrenicës, e për fatin e të cilëve nuk ka pasur gjetje të besueshme[63]. Obligimet e qeverisë së Republika Srpska kanë qenë që në afatin më të shkurtër të deklarojë të gjitha informatat, që kanë të bëjnë me zbulimin e fatit të personave të zhdukur, familjarë të paraqitësve të kërkesave, që të zbulohen lokacionet e varrezave individuale dhe masive, si dhe që të kryejnë një hetim të shpejtë dhe të paanshëm për ngjarjet, që kanë sjellë deri te shkelja e drejtave të njeriut, përkatësisht që të hetojë krimet e përmendura, të çfarë vëllimi janë, kush i ka urdhëruar dhe kush i ka kryer. Një nga prioritetet e punës së Komisionit ka qenë përpilimi i një liste sa më të saktë të personave të zhdukur në këtë periudhë, përkatësisht në vendosjen e fatit të personave të përmendur në vendimin e Dhomës për të Drejta të Njeriut.

Përfaqësuesi i lartë në Bosnje dhe Hercegovinë, Paddy Ashdown, ka dhënë kontribut të madh pasi që ka dhënë përkrahje të parezervë në implementimin e vendimit të përmendur të Dhomës për Drejta të Njeriut dhe e ka urd-



60 E qasshme: http://www.mpr.gov.ba/web_dokumenti/Vodic%20kroz%20tranzicijsku%20pravdu%20u%20BiH.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 56-57.

61 E qasshme: http://ictj.org/sites/default/files/ICTJ-FormerYugoslavia-Bosnia-Developments-2004-English.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 7.

62 E qasshme: http://www.hrc.ba/database/decisions/CH-02-10224%20i%20dr%20B.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 13.

63 E qasshme: http://www.hrc.ba/DATABASE/decisions/CH01-8365%20SREBRENICA%20Admissibility%20and%20Merits%20B.pdf, hapur me: Janar 2014.

hëruar kryeministrin dhe kryetarin e Republika Srpska që të sigurojnë të gjitha kushtet e nevojshme për punë të një Komisioni të tillë.[64]

Qeveria e RS, në mbledhjen e mbajtur më 25 dhjetor të vitit 2003, ka emëruar 7 anëtarë të Komisionit. Ata kanë qenë: Marko Arsović (kryetar), Milan Bogdanić, në atë kohë kryetar i zyrës për kërkim të të zhdukurve dhe zënëve robë të RS, Gojko Vukotić, Đorđe Stojaković dhe Milorad Ivošević, si përfaqësues të Qeverisë RS, Gordon Bacon, ishdrejtor ICMP në Sarajevë, më vonë konsulent në UNDP në Sarajevë, si përfaqësues i bashkësisë ndërkombëtare dhe profesori Smail Čengić, drejtori i Institutit për hetimin e krimeve kundër njerëzimit dhe drejtës ndërkombëtare në Universitetin e Sarajevës, si përfaqësues i shoqatës së të mbijetuarve. Në prill të vitit 2004, Përfaqësuesi i Lartë ka ndërruar kryetarin e deritashëm Marko Arsović dhe ka emruar Milan Bogdanović në këtë funksion, ndërsa Qeveria RS, në vendin e zbrazur në Komision ka emëruar Želko Vujadinović. Statusin e vëzhguesit e kanë pasur TPNJ dhe OHR. Komisioni ka formuar tri grupe punuese: njëri ka hetuar rolin e policisë, i dyti rolin e Ushtrisë së RS, grupi i tretë lokacionin e varrezave masive, ndërsa anëtari i shtatë, historiani Željko Vukadinović, është marrë më kontekstin historik.

Komisioni nuk ka pasur mandat e as që ka qenë platformë për zë të viktimave, që do të thotë se përfundimet e veta i ka bazuar në dokumentacion, qe rrjedh nga institucionet e RS, pjesërisht edhe nga disa institucione të Federatës BeH, si dhe nga disa organizata ndërkombëtare, që merren me hulumtimin e konflikteve ushtarake në territorin e ish-Jugosllavisë, nga viti 1992 deri 1995, dhe nga shoqatat e viktimave.[65]

Komisioni, më saktë, anëtarët e Komisionit nga populli serbë, ka punuar gjatë gjithë kohës me ndikim të madh të publikut të gjerë, ndërsa ka qenë e ngadalësuar edhe nga qytetarë të RS dhe nga elita politike.

Mandati i Komisionit, për shkak të kufizimeve kohore, ka qenë i shkurtuar në hetimin e vendekzekutimit, varrezave të viktimave dhe gjetjes së identitetit të viktimave, dhe nuk ka lënë hapësirë për dëshmi publike të viktimave në opinion. Megjithatë as ky variant i shkurtër nuk është plotësuar deri në fund. Konteksti historik dhe gjendja faktike e aktgjykimit: *Prokurori kundër Radislav Krstić* është marrë për shkak të kohës së kufizuar dhe racionalizimit të lëndës.[66]

### *Rezultati i punës së Komisionit për Srebrenicën*

Rezultatet e punës së këtij Komisioni janë shumë të rëndësishme, sidomos lidhur me zbulimin, deri atëherë e 32 varrezave të panjohura si dhe vërtetimin e identitetit të viktimave. Në rezultatin e saj më së shumti ka ndikuar mandati i Komisionit si dhe koha e shkurtër. Komisioni për Srebrenicën ka vërtetuar se në periudhën e përmendur janë vrarë 7.779 boshnjakë, që nuk ishte numër përfundimtar, në mënyrë që paraqet shkelje të rëndë të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe se Ministria e Punëve të Brendshme e Republika Srpska dhe Ushtria e Republika Srpska kanë marrë masa të fshehjes. Komisioni ka vërtetuar se 1.193 persona konsiderohen si të humbur, nga të cilët 1.135 persona kanë pësuar në periudhën në mes 10 dhe 19 korrikut të vitit 1995. Komisioni ka krijuar rekonstruktimin e ngjarjeve në Srebrenicë, si dhe rikonstruktim të rolit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ushtrisë së Republika Srpska. Komisioni ka vërtetuar edhe listën e kryerësve të mundshëm, është mbledhur dokumentacion i paparë deri atëherë për publikun dhe është krijuar baza e të dhënave.[67]

### *Analiza e punës së Komisionit për Srebrenicën*

Rezultatet e punës së Komisionit për Srebrenicën mund të përfaqësohen me konstatimin e përmendur në raportin e punës, ku thuhet se puna e këtij Komisioni është historike.[68] Raporti i Komisionit ka pasur kuptimin e ndalimit të heshtjes institucionale të Republika Srpska për krimet nga e kaluara. Komisioni për Srebrenicën është i vetmi komision i një qëllimi të tillë, që e ka përmbyllë punën e vet me një raport.

64 E qasshme: http://www.mpr.gov.ba/web_dokumenti/Vodic%20kroz%20tranzicijsku%20pravdu%20u%20BiH.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 60.

65 Komisoni për Srebrenicën – Raport, 11.06.2004. faqe 3-5.

66 E qasshme: http://www.mpr.gov.ba/web_dokumenti/Vodic%20kroz%20tranzicijsku%20pravdu%20u%20BiH.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 61.

67 Komisioni për Srebrenicën – Raport 11.06.2004.

68 Përfundimt e komisionit të Qeverisë RS për Srebrenicën 28.10.2004, faqe 1.

Kryetari i atëhershëm i Republika Srpska, Dragan Čavić, ka bërë një hap të madh duke vepruar sipas rekomandimeve nga raporti i këtij Komisioni, që kanë pasur të bëjnë me reparacionet simbolike, prandaj iu ka kërkuar falje në mënyrë publike viktimave për shkak të krimeve, që në emër të popullit serb i ka kryer Ushtria dhe Policia e Republika Srpska.

Puna e Komisionit, pa marrë parasysh kufizimin kohor, ka dhënë fakte jashtëzakonisht të dobishme, por në anën tjetër rezultatet e punës së këtij Komisioni nuk kanë pasur jehonë në publik, ndërsa puna e tij, siç është përmendur më lartë, është përcjellë me kundërshtim publik të qytetarëve dhe elitave politike në Republika Srpska, derisa anëtarët serbë të Komisionit kanë pasur presion të madh.[69]

### *Përfundimet e Qeverisë së Republika Srpska (RS)*

Qeveria e RS, më 10 nëntor të vitit 2004, me përfundimin e punës së Komisionit për Srebrenicën, ka miratuar përfundimet ku në mes të tjerash thuhet se Qeveria e RS pranon raportin e Komisionit, konfirmon që janë kryer krime të shkallës së gjerë, shpreh keqardhje dhe bashkëndjesi me familjet nga Srebrenica dhe në fund konsideron se puna dhe rezultatet e Komisionit do të kontribuojnë në krijimin e klimës së besimit në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në rajonin e gjerë.[70]

### Komisioni shtetëror për vërtetimin e së vërtetës për vdekjet e serbëve, kroatëve, boshnjakëve, hebrenjve dhe të tjerëve në Sarajevë, në periudhën nga 1992 deri 1995, Komisioni për Sarajevën

Shoqata e Viktimave Serbe nga Sarajeva Lindore, në vitin 2003, ka nisur iniciativën për themelimin e trupit punues, i cili do të merrej me hulumtimin e vrasjeve të serbëve në Sarajevë, pasi që sipas tyre edhe ndaj serbëve janë kryer krime gjatë rrethimit të Sarajevës nga ana e Armatës së Bosnje dhe Hercegovinës dhe Policisë së Republikës së Bosnje dhe Hercegovinës, ndërsa është përmendur vetëm viktimizimi i boshnjakëve.[71]

Kështu, përfaqësuesi i SNSD në parlamentin e BeH Slavko Jovičić ka thënë: "E vërteta është bërë në përgjithësi fiktive edhe pse e vërteta do të duhej të ishte parakusht për çdo gjë të dytë, tretë (...) Madje e vërteta është një e vetme dhe e pandarë dhe askush nuk ka të drejtë ekskluzive mbi të vërtetën, dhe ja, elita politike, intelektuale dhe mediale boshnjake e ka marrë në mënyrë të padrejtë mbi veten të drejtën që vetëm ata të jenë vlerësues të kësaj të vërtete."[72]

Përfundimi i diskutimeve parlamentare për këtë iniciativë ka qenë se vrasja e serbëve nuk mund të ndahet nga vrasjet e bashkësive të tjera etnike në Sarajevë. Sipas kësaj, Këshilli i ministrave, më 25 maj të vitit 2006, ka themeluar Komisionin për hulumtimin e të vërtetës për vrasjet e serbëve, kroatëve, boshnjakëve, hebrenjve dhe të tjerëve në Sarajevë, në periudhën nga 1992 deri 1995, Komisioni për Sarajevën.[73] Komisioni për Sarajevën është formuar nën presionin dhe në kontekstin e diskutimeve politike dhe manipulimeve si dhe diskutimeve të ashpra për mandatin e këtij Komisioni.[74]

Menjëherë pas themelimit të këtij Komisionit janë paraqitur mospajtimet në mes të anëtarëve rreth mandatit. E tëra ka kulmuar pasi që Këshilli i ministrave, si themelues në kërkesë të Komisionit ka dërguar përgjigje të paqartë lidhur me mandatin e tij. Emërimi i Cvetko Savić, i cili ka qenë shef i Shtabit të Përgjithshëm i Ushtrisë së Republika Srpska, për anëtarë të Komisionit për boshnjakët ka qenë problem.[75]

I tërë ky proces rreth formimit të Komisionit është përcjellë më kontradikta në publik si dhe politizim të madh e që është reflektuar në rezultatin e Komisionit, i cili vetëm ka bërë projektin shkencor-hulumtues e në thelb asnjëherë nuk ka filluar të funksionojë e as që është ndërprerë zyrtarisht.[76]



69 E qasshme: http://www.mpr.gov.ba/web_dokumenti/Vodic%20kroz%20tranzicijsku%20pravdu%20u%20BiH.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 61

70 Përfundimet e Komisionit të Qeverisë së RS për Srebrenicën, 28.10.2004.

71 E qasshme: http://forum.sarajevo-rs.com/index.php?/topic/2923-komisija-pogresna-misija/, hapur me: Janar 2014.

72 E qasshme: http://www.koreni.net/modules.php?name=Neës&file=print&sid=1307, hapur me: Janar 2014.

73 E qasshme: http://www.civilnodrustvo.ba/files/docs/UNDP/Mehanizmi_suocavanja_s_prosloscu.exe.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 6.

74 E qasshme: http://www.mrezapravde.ba/mpbh/mpbh_files/file/Izvjestaj%20o%20trazenju%20istine.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 11.

75 E qasshme: http://www.mpr.gov.ba/web_dokumenti/Vodic%20kroz%20tranzicijsku%20pravdu%20u%20BiH.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 64-65.

76 E qasshme: http://www.mpr.gov.ba/web_dokumenti/Vodic%20kroz%20tranzicijsku%20pravdu%20u%20BiH.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 66.

**Komisioni për të vërtetën dhe pajtimi i Kuvendit të Komunës Bijelina**

Kjo iniciativë është unike për atë se është rezultat i administratës lokale dhe e nisur mbi raportin (rekomandimet) e ndërmjetësuesit ndërkombëtar për Bosnje dhe Hercegovinën, më vonë Përfaqësuesit të lartë në Bosnje dhe Hercegovinë, Christian Schwarz-Shillingut, për Bjelinën, nga 15 shtatori i vitit 2004. Megjithatë, Komisioni është formuar tek në vitin 2008.[77]

Komisioni gjatë gjithë kohës ka pasur përkrahjen e komunës, fillimisht kryetarit, si dhe disa organizatave të shoqërisë civile, ndërsa me organizatën joqeveritare" E vërteta, drejtësia dhe pajtimi"/"Istina, pravda i pomirenje" nga Tuzlla është nënshkruar protokoll i bashkëpunimit.[78]

Organizatat e shoqërisë civile në Bjelinë, më së shumti Shoqata të viktimave boshnjake dhe serbe, si dhe OJQ për të drejta të njeriut, kanë qenë të njoftuara me punën e Komisionit dhe kanë qenë shumë kritikuese ndaj tij. Ato nuk kanë pasur besimin se ky Komision ka kredibilitet dhe se mund të vërtetojë të vërtetën për krimet, që janë kryer në komunën e Bjelinës. Problematike për to ka qenë se kush e përkrah në mënyrë publike punën e Komisionit, pra se cilët persona janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me këtë trup, pasi që në konferencën për vdekjet e fëmijëve në Bijelinë ka qenë prezent një person, i cili ka qenë në rrjetin për përkrahjen e të akuzuarit të Hagës Ratko Mladić, si dhe nëse Komuna e Bjelinës me të vërtetë është e gatshme që të përkrahë punën e tij si dhe përbërjen e propozuar të Komisionit.

Komisioni, në fillim të vitit 2009, ia ka paraqitur raportin përfundimtar deputetëve të kuvendit komunal për diskutim dhe aprovim, i cili në fund nuk është aprovuar.

Në rekomandimet për themelimin e Komisionit, në mënyrë të qartë, insistohet për transparencë në procese dhe se duhet të bazohet në konsultime.

Këtë Komision e kanë përcjellë shumë kontradikta rreth mënyrës së themelimit, mandatit të tij, që ka qenë i paqartë, zgjedhjes së anëtarëve, ashtu që ky proces i themelimit dhe punës së Komisionit mund të karakterizohet si jotransparent për atë se pothuajse të gjitha aktivitetet e Komisionit janë kryer larg syrit të publikut, publiku, në shumicën e rasteve, nuk ka qenë i njoftuar për ekzistimin dhe punën e Komisionit, përkatësisht nuk ka pasur konsultime të hapura në mes të shoqërisë civile dhe në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve qeverisëse.

Publiku nuk ka pasur besim në anëtarët e Komisionit, pasi që i ka konsideruar si të anuar etnikisht, dhe në favor të kësaj ka shkuar edhe mosbalancimi etnik i anëtarëve të Komisionit, ku janë propozuar gjashtë serbë dhe dy boshnjakë. dhe Për shkak të kësaj është lëkundur kredibiliteti se në Bjelinë shumica e viktimave janë boshnjakë.[79]

***Përfundim***

Edhe pse marrëveshja e përgjithshme kornizë për Bosnje dhe Hercegovinën, e vitit 1995, i ka dhënë fund luftës, e njëjta ka decentralizuar shtetin, gjegjësisht ka institucionalizuar ndarjet etnike të krijuara pas konfliktit. Kushtetuta e Bosnje dhe Hercegovinës, si Aneksi 4 i marrëveshjes së përgjithshme kornizë për paqe në Bosnjë dhe Hercegovinë, në preambulë thekson parimet e dinjitetit njerëzor, lirisë dhe barazisë, paqes dhe pajtimit, tolerancës, sovranitetit etj. Por, problemi shihet në faktin se kushtetuta nuk përkon me realitetin dhe nuk përmban instrumente për implementimin e këtyre parimeve në praktikë. Dinjiteti njerëzor shkelet në të gjitha nivelet e shoqërisë.

Edhe pse ka kaluar shumë kohë nga konflikti i armatosur në Bosnje dhe Hercegovinë, banorëve të saj ende nuk u janë ofruar informata të besueshme, që kanë të bëjnë me arsyet se pse ka ardhur deri te shkelja e të drejtave, përshkrim i lëndimeve, gjetjet e shkeljeve të drejtave dhe as që u është ofruar platforma për dëgjimin e tyre.

Në Bosnje dhe Hercegovinë ekziston një nevojë e madhe për mësimin e së vërtetës zyrtare, pasi që për momentin ekzistojnë tre versione etnike të kaluarës, më sakë, historia shkruhet për nevoja etnike, politike dhe ideologjike. Këto tri interpretime, që ekzistojnë mund të transferohen edhe në punën e mediave të ndara etnikisht, të cilat janë në shërbim të partive nacionaliste. Njëjtë, nëpërmjet këtyre tri të vërtetave, tri sistemet edukative në Bosnje dhe Hercegovinë në

77 E qasshme: http://www.mpr.gov.ba/web_dokumenti/Vodic%20kroz%20tranzicijsku%20pravdu%20u%20BiH.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 66.

78 E qasshme: http://www.fondacija-ipp.ba/novosti/Protokol_o_saradnji[1].doc, hapur me: Janar 2014.

79 E qasshme: http://www.mpr.gov.ba/web_dokumenti/Vodic%20kroz%20tranzicijsku%20pravdu%20u%20BiH.pdf, hapur me: Janar 2014, faqe 67.

mënyrë sistematike helmojnë fëmijët. Edhe më tutje ekziston ndarja në edukim, që si pasojë ka individë, që frikohen nga rrethi i tyre, frikohen nga të tjerët dhe ata që janë të ndryshëm, dhe rriten në frymën e mostolerancës. Në këtë mënyrë vihet baza për ndërtimin e mëtutjeshëm të mosbesimit ndaj të tjerëve dhe të ndryshmëve, dhe për ardhmëri potencialisht konfliktuoze dhe vazhdim të shkeljes të drejtave.

Rezultatet e deritashme në fushën e vërtetimit të fakteve dhe tregimit të vërtetës ende janë të këqija për shkak të mungesës së qëllimit të përbashkët të iniciativave, koordinimit dhe bashkëpunimit të dobët si dhe përfshirjes së dobët të publikut të gjerë në krijimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e këtyre iniciativave. Politizimi gjatë gjithë kohës vështirëson që në këtë fushë të bëhet ndonjë hap më i madh. Për shkak të ndarjes shoqërore, njerëzit flasin për përjetimet e luftës, kryesisht, me "bashkëmendimtarë", që e pamundëson procesin e pajtimit dhe ndërtimit të besimit në mes të njerëzve.

Problem të madh paraqet informimi i dobët i publikut dhe mosnjohja e Drejtësisë Tranzicionale dhe kontributit të saj të mundshëm në drejtimin e pajtimit si dhe rëndësia e saj në parandalimin e përsëritjes së historisë.

Një sistem i ndërlikuar politik dhe administrativ e pengon avancimin e shtetit në çfarëdo fushe. Hapësira e përgjithshme publike është kontaminuar me gjuhën e urrejtjes, që është bërë mënyra standarde e komunikimit, ndërsa mohimi e kualifikimeve të gjetjeve gjyqësore dhe mohimi i krimeve, që kanë ndodhur, janë ngjarje të shpeshta në diskursin politik, dhe prapë bëhet viktimizimi i viktimave.

# Ndikimi i Aktigjykimit të GJEDNJ-së *në Lëndën Maktouf dhe Damjanović Kundër BEH*, i 18 Korrikut 2013, në Proceset E Drejtësisë Tranzicionale në BEH

Maja Kapetanović



## I Shënimet Hyrëse

Në atmosferën ku puna e organeve shtetërore - gjyqësore të Bosnjë dhe Hercegovinës (BeH), që kanë për detyrë procedimin e lëndëve të krimeve të luftës (KL) është rënduar në mënyrë të theksuar për shkak të sulmeve shumëvjeçare të mediave dhe politikës në kredibilitetin e tyre. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ ose Gjykata Evropiane) më 18 korrik 2013 ka sjellë aktgjykimin e shumëpritur në rastin *Maktouf dhe Damjanović kundër BeH.* GJEDNJ ka vendosur në të mirë të dy të dënuarve për krime të luftës kundër popullatës civile, të cilët e kanë akuzuar shtetin e BeH për shkak të zbatimit retroaktiv të Kodit të Ri Penal, që është miratuar në vitin 2003. Me këtë aktgjykim nuk është kontestuar fajësia e të dënuarve, por GJEDNJ ka gjetur se ka ardhur deri të shkelja e Nenit 9 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ ose Konventa) pasi që Gjykata e BeH në aplikantët nuk ka zbatuar Kodin Penal e ish-Jugosllavisë (KP RFSJ) nga viti 1976, me qëllim të caktimit të dënimit, e çka është dashur të bëhet duke pasur parasysh se bëhet fjalë për kryerës të rangut më të ulët, dënimet e të cilëve kanë qenë afër minimumit ligjor. Aktgjykimi kufizohet në rrethanat e rastit konkret të aplikuesve dhe nuk ka kuptim të gjerë në të gjitha lëndët. Megjithatë menjëherë pas aktgjykimit të Gjykatës Evropiane, Gjykata Kushtetuese e BeH (GJK BeH) në periudhën, prej 22.10.2013 deri më 30.01.2014 ka aprovuar ankesat edhe të 13-të të dënuarve për krime lufte, në vendime të cilat, për mendimin e disa ekspertëve në mënyrë të "diskutueshme" bazohen në vendimin e GJEDNJ.[80] Rrethana t e këtyre rasteve nuk kanë qenë të njëjta si në lëndën e shqyrtuar para GJEDNJ. por në mes tjerash, fjala ka qenë për persona të dënuar për raste më të rënda, por edhe format më të rënda të krimeve të luftës, që ndonjëherë janë gjykuar në BeH, mes të cilëve edhe gjashtë persona të dënuar me dënime afatgjata, me burgim për veprën penale të gjenocidit të kryer në Srebrenicë. Pritet që GJ BeH të sjellë edhe dhjetëra vendime të tilla në të ardhmen. Për dallim prej GJEDNJ, e cila vetëm ka konstatuar shkeljen e të drejtave, GJK BeH ka ndërprerë dënimet fuqiplota të shkallës së dytë të Gjykatës së BeH, duke mos prekur, njëjtë si Gjykata Evropiane, në çështjen e fajësisë. Të gjithë personat e dënuar pas këtij vendimi janë lëshuar në liri nga mbajtja e dënimit. Ata do të qëndrojnë në liri deri në përfundim të lëndës së përsëritur në të cilën, pa e diskutuar fajësinë, duhet të caktohet dënimi sipas KP RFSJ.

Vendimet e përmendura kanë sjellë indinjatë të viktimave, posaçërisht atyre të Srebrenicës, të cilët vështirë se mund

80 Shiko artikullin/komentin në aktgjykimin e kryetarit të Njësisë Apeluese të Gjykatës së BeH Hilmo Vučinić, në gazetën javore *Dani,* të 22.11.2013, "Pasiguria juridike", nëntitull "Qëndrimi i marrë në aktgjykimin e Gjykatës Evropiane nuk ka mundur të implementohet në të gjitha rastet që i ka gjykuar pas këtij vendimi Gjykata Kushtetuese e BeH", poashtu shiko komentin e ekspertit juridik Goran Shimiq, të 18.11.2013, në portalin ditor online Klix.ba – që transmeton deklaratën për Al Jazeera TV: *Shimiq: Gjykata Kushtetuese e BeH ka zbatuar në mënyrë ta gabuar vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*".

ta kuptonin se si është e mundur që të gjinden në liri përgjegjësit e krimit më të rëndë në hapësirën e Evropës që pas luftës së dytë botërore dhe në të njëjtën kohë nuk janë liruar prej fajësisë.[81] Në anën tjetër, aktgjykimi ka shërbyer si nismë për deklarata të shumta të pabazuara, mirëpo ndezëse për pafajësi të dënuarve ose për gjoja mbajtjen e tyre shumëvjeçare "jashtëligjore", e cila, në tanimë Bosnjën e ndjeshme politikisht, ka ndikuar në mënyrë të dëmshme dhe të pariparueshme në proceset e pajtimit dhe ndërtimit të besimit në organet e gjyqësisë. Mbi të gjitha mund të thuhet se ngjarjet e tilla paraqesin pikëkthim në procesin e drejtësisë tranzicionale, të bazuar në vendimet gjyqësore të vërtetës dhe përgjegjësisë, si një mënyrë të drejtësisë tranzicionale të përhapur gjerë në BeH e pasluftës. Sikur dominoefekt, besimi në drejtësinë e që është ndërtuar me vite, është rrënuar në disa veprime të lidhura. Në rreshtat e mëposhtëm do të tentojmë të sqarojmë se si ka mundur të vijë deri të kjo dhe se cilët faktorë kanë ndikuar në "përmbytjen e gjyqësisë në BeH", siç e quajnë disa.[82] Do të tentojmë të shpalosim situatën e krijuar kur janë në pyetje gjykimet për krime të luftës në BeH, të tregojmë për gjenezën e saj, me vëmendje të veçantë në rolin dhe përgjegjësinë e GJEDNJ-së si organ i Këshillit të Evropës për mbrojtje të drejtave të njeriut, në dështimin për të njohur rëndësinë e madhe në lëndët për të cilat vendosin çështje dhe procese të ndjeshme të drejtësisë tranzicionale. Këto procese, siç është dëshmuar, mund të rrënohen lehtë dhe madje edhe vetëm për shkak të shpjegimit të pamjaftueshëm, jopreciz ose të papërfunduar të vendimit gjyqësor të një instance gjyqësore evropiane, e që në përfundim mund të cenojë seriozisht procesin e pajtimit në rajonin e BeH.

## II Procesimi i lëndeve të Krimeve të Luftës në BeH

Bosnjë dhe Hercegovina është shteti lider sa i përket procedimit të lëndëve të krimeve të luftës në gjykatat vendore. Në periudhën prej 1992 deri 2013 në BeH para gjykatave vendore janë përmbyllur, me vendim të plotfuqishëm, 343 raste të krimeve të luftës, përderisa edhe rreth 1300 raste tjera janë ende të pazgjidhura.[83] Fokusi në drejtësinë gjyqësore, si kusht i paqes së qëndrueshme në BeH, është i futur në vetë Kushtetutën e BeH, i cili është pjesë përbërëse e marrëveshjes së Paqes së Dejtonit.[84] Procesi i parë gjyqësor për krime lufte është kryer në hapësirën e të tanishmes Federatës BeH edhe para përfundimit të konfliktit (1992-1995).[85] Prej 1992 e dere më 1.03.2003[86] , në hapësirën e Federatës së BeH, me vendim të plotfuqishëm kanë përfunduar 79 lëndë, ndërsa në Republika Srpska nuk ka pasur raste të proceduara.[87] Sidoqoftë, hapat më seriozë në realizimin e së drejtës janë marrë me miratimin e Rezolutës 1503 të Kombeve të Bashkuara (KB), më 18.08.2003, brenda Strategjisë së përfundimit të punës së Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Jugosllavinë (TPNJ). Si një prej kushteve themelore për përmbushjen e Strategjisë Këshilli i Sigurimit i KB ka ftuar në themelim urgjent dhe fillim të punës të Këshillit të posaçëm për krime luftë brenda Gjykatës së BeH, ndërsa



81 Shiko p.sh. artikullin në gazetën ditore *Dnevni Avaz,* të 20.11.2013, "Viktimat paketojnë valixhet dhe ikin nga Podrinja".

82 Artikulli në gazetën javore *Dani,* të 15.11.2013, „(Dialogu i strukturuar) Përmbytja e gjyqësorit të BeH ".

83 Statistika e Gjykatës së BeH e marrë në ditën e kërkesës, më 10.03.2014. Sipas faqes zyrtare, në internet, të Prokurorisë për krime lufte në Republikën e Serbisë, në Serbi në total janë me vendim të plotfuqishëm 36 lëndë të krimeve të luftës, (qasje në Web-faqen, të datës 29.01.2014, http://www.tuzilastvorz.org.rs/html_trz/pocetna_lat.htm). Në Kroaci me vendim të plotfuqishëm janë përfunduar 122 lëndë për krime të luftës, qasur në web faqen zyrtare të Dokumenta, 29.01.2014.

84 Shiko Kushtetutën e BeH, Neni II – Të drejtat dhe liritë e njeriut, pika 8 – Bashkëpunimi: " Të gjitha organet kompetente qeverisëse në Bosnje dhe Hercegovinë do të bashkëpunojnë me dhe do t'u ofrojnë qasje të pakufizuar: të gjithë mekanizmave ndërkombëtare të drejtave të njeriut, që caktohen për Bosnje dhe Hercegovinë; trupat mbikëqyrëse që vendosen me cilëndo marrëveshje ndërkombëtare të përmendur në Aneksin I të kësaj Kushtetute; Tribunalin Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe sidomos t'i përmbahet urdhrave që janë të dhëna sipas Nenit 29 të Statutit të Tribunalit); dhe cilësdo organizatë tjetër të caktuar nga ana e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara me mandat sa i përket të drejtave të njeriut ose të drejtës humanitare".

85 P.sh. Lënda *Sretko Damjanović i Borislav Herak,* Gjykata Regjionale Ushtarake në Sarajevë Nr. K-I-14/93 i datës 12.03.1993.

86 Data e hyrjes në fuqi të Kodit të ri Penal të BeH, me të cilin lëndët e krimeve të luftës kanë kaluar nën kompetencën ekskluzive të Gjykatës Shtetërore të BeH.

87 ABA/CEELI dhe Shoqata e Prokurorëve të BeH, *Krimet e luftës në BeH, lëndët penale të përfunduara fuqiplotë në BeH,* Sarajevë, 2006.

bashkësia ndërkombëtare është ftuar që ta ndihmojë këtë projekt financiarisht.[88] Institucionet e reja duhej të jenë në gjendje që të marrin lëndë nga TPNJ, derisa vetëm lëndët më të vështira kundër kryerësve më përgjegjës do të duhej të kryheshin para TPNJ-së. Në Dhjetor të vitit 2004 është miratuar një paketë e ligjeve dhe është themeluar Seksioni për krime të luftës pranë Gjykatës së BeH dhe Seksioni i posaçëm për krime lufte pranë Prokurorisë Shtetërore të BeH.[89] Në periudhën prej 2004 deri në fund të vitit 2013 bashkësia ndërkombëtare ka investuar rreth 60 milion euro në ndërtimin e kapaciteteve të drejtësisë shtetërore për punë në lëndët e krimeve të luftës.[90] Tribunali i Hagës, prej vitit 2005 deri në 2007, i ka lënë BeH në total gjashtë lëndë të veta sipas rregullës 11*bis*[91], dhe ato lidhur me 10 persona të akuzuar. BeH në fund të vitit 2008 ka miratuar Strategjinë Shtetërore për punë në lëndët e krimeve të luftës, e cila një prej qëllimeve themelore e ka procedimin e kryerësve me përgjegjësinë më të madhe para Gjykatës në BeH e ka prioritet, ndërsa lëndët tjera para gjykatave tjera në BeH.[92] Vetëm Gjykata e BeH, deri më 10.03.2014 me vendim të plotfuqishëm ka përfunduar 122 lëndë të krimeve të luftës[93], mes të cilave bien edhe krimet më të rënda që ndonjëherë janë proceduar në BeH, siç është lënda *Milorad Trbić,* që është referuar nga Tribunali i Hagës,[94] dhe rasti *"Kravica"*(i cili lidhet me krimin e gjenocidit, që ka ndodhur në Srebrenicë në fermën bujqësore Kravica). Gjykata e BeH në shumicën e rasteve, që janë udhëhequr pranë kësaj gjykate, ka ushtruar Kodin Penal të BeH (KP BeH)[95], i miratuar në fillim të vitit 2003 nën ombrellën e reformës gjithëpërfshirëse të legjislacionit penal në BeH, ndërsa gjykatat në entitete edhe më tutje kanë zbatuar KP të ish- RFSJ të vitit 1976.

88 Rezoluta 1503 është miratuar në seancën e 4817 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, më 28 gusht të vitit 2003: "Duke marrë parasysh se forcimi i sistemeve kombëtare të drejtësisë është i rëndësisë së veçantë për funksionimin e shtetit ligjor, dhe sidomos për implementimin e strategjisë për përfundimin e punës të TPNJ-së dhe TPNR-së; Duke marrë parasysh se kushti themelor për arritjen e qëllimeve të mbylljes së punës së TPNJ-së është themelimi urgjent nën mbikëqyrjen e Përfaqësuesit të Lartë, dhe funksionimi sa më i shpejtë i Këshillit të veçantë pranë Gjykatës shtetërore të Bosnje dhe Hercegovinës (në tekstin më poshtë: 'Këshilli për krime lufte') të cilit mëpastaj TPNJ do t'i drejtonte të akuzuarit e nivelit të ulët dhe të mesëm [...] fton bashkësinë ndërkombëtare që në përputhje me strategjinë e përmbylljes së punës të gjykatave që të ndihmojë juridiksioneve kombëtare që të ngritin aftësinë e ndjekjes penale në lëndët që do të transferohen nga TPNJ" qasur me 29.2014, http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/RES/1503(2003) (në gjuhën angleze). http://www.tuzilastvorz.org.rs/html_trz/PROPISI/rezolucija_1503_lat.pdf (në gjuhën serbe).

89 Gazeta Zyrtare e BeH Nr 61/04: Ligji për ndryshimet dhe përmirësimet e Ligjit për Gjykatën e Bosnje dhe Hercegovinës, Ligji për ndryshimet dhe përmirësimet e Ligjit për Prokurorinë e Bosnjë dhe Hercegovinës, Ligji për transferimin e lëndëve nga ana e Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë tek Prokuroria e Bosnje dhe Hercegovinës dhe përdorimit të dëshmive të marra nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë në lëndët para gjykatave në Bosnje dhe Hercegovinë, Ligji për ndryshimet dhe përmirësimet e Ligjet për mbrojtjen e dëshmitarëve nën kërcënim dhe dëshmitarëve të rrezikuar, Ligji për ndryshimet dhe përmirësimet e Kodit Penal të Bosnje dhe Hercegovinës.

90 Biseda e 30.01.2014 me kryesekretarë Gjykatës së BeH, Biljana Potparić-Lipa, ish-kryesekretare pranë Zyrës ndërkombëtare të regjistrave (2004-2013), me detyrë për administrim të ndihmës donatore ndërkombëtare ndaj drejtësisë së BeH, në periudhën prej 2005 deri në fund të vitit 2012.

91 Rregulla 11*bis* (Transferimi i akuzës te një gjykatë tjetër Rregullat e procedurës dhe dëshmive të TPNJ-së:
„(A) Pasi që konfirmohet aktakuza dhe para fillimit të gjykimit, pa marrë parasysh a është i akuzuari nën mbikëqyrjen e Tribunalit Ndërkombëtar, kryetari mund të emërojë një këshill të përbërë nga tre gjykatës të përhershëm të zgjedhur nga përbërja e dhomave gjyqësore (në tekstin e mëposhtëm Dhoma për përcjellje), e cila vetëm dhe ekskluzivisht do të vërtetojë nëse lënda duhet t'u procedohet organeve të shtetit: (i) në territorin ku është kryer vepra penale; ose (ii) ku është arrestuar i akuzuari; ose (iii) kush është përgjegjës për këtë lëndë, a është e gatshme dhe e përgatitur në mënyrë adekuate që ta marrë lëndën,në mënyrë që organet kompetente menjëherë lëndën t'ia përcjellin gjykatës përkatëse me qëllim të gjykimit në këtë shtet...".

92 Shiko: Strategjia shtetërore për punë në lëndët e krimeve të luftës e miratuar me 28 dhjetor 2008, nga ana e Këshilli të Ministrave të Bosnje dhe Hercegovinës, faqe 12, qasur me 29.01.2014, http://pravosudje.ba/vstv/faces/docservlet?p_id_doc=13700.

93 Statistika e Gjykatës së BeH, e marrë me kërkesë të bërë me 29.01.2014.

94 Milorad Trbić 11.06.2007 është dorëzuar nga TPNJ tek organet e BeH. Para Gjykatës së BeH është shpallur si fajtor për veprën e përbashkët të gjenocidit, që është kryer në Srebrenicë në periudhën prej 12 korrik deri 30 nëntor të vitit 1995, si pjesëmarrës në ndërmarrjen e përbashkët kriminale.

95 „Gazeta Zyrtare e Bosnje dhe Hercegovinës" nr. 3/03, 32/03, 37/03, 54/04, 61/04, 30/05, 53/06, 55/06, 32/07, 8/10.

Gjykata dhe Prokuroria e BeH, që nga themelimi i tyre, kanë gëzuar përkrahje të fortë të bashkësisë ndërkombëtare dhe në vitet e para të punës së këtyre institucioneve, më saktë deri në fund të vitit 2012, sebashku me vendorët kanë punuar edhe prokurorë dhe gjykatës ndërkombëtar. Prezenca e tyre ka ndikuar në perceptimin e paanshmërisë së punës në lëndë. Sidoqoftë pjesëmarrjes së gjykatësve dhe prokurorëve të huaj i kanë kundërshtuar afër përfaqësuesit e disa partive politike në RS, të cilët në këtë akt e kanë parë si shkelje të sovranitetit shtetëror dhe kërcënim të procedurave gjyqësore[96]. Me zvogëlimin gradual të mbështetjes ndërkombëtare për punën e Gjykatës dhe Prokurorisë së BeH, si dhe me largimin e plotë të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në fund të vitit 2012, këto institucione kanë arritur nën goditje direkte të forcave politike vendore, të cilat ndikonin në largimin e organeve gjyqësore në nivel shtetëror ose zvogëlim të ndjeshëm të kompetencave të tyre. Në prill të vitit 2011 në Kuvendin Kombëtar të RS është miratuar vendimi për mbajtjen e referendumit, në të cilën qytetarët e etnitetit do të duhej, në mes tjerash, të deklarohen edhe për atë se a mbështesin Gjykatën dhe Prokurorinë Shtetërore të BeH. Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Catherine Ashton, me këtë rast ka reaguar në mënyrë të menjëhershme duke kërkuar ndryshimin e vendimit për referendum, dhe si kompensim ka ofruar fillimin e të ashtuquajturit *Dialogut të strukturuar* në mes të BeH dhe BE-së, në të cilën do të shtjelloheshin të gjitha pyetjet lidhur me punën e drejtësisë në BeH. Përkundër kësaj marrëveshjeje, në prill të vitit 2012, përfaqësuesit e dy partive në Parlamentin e BeH kanë shtruar propozimin e Ligjit për heqjen e Gjykatës dhe Prokurorisë së BeH.[97] Iniciativa nuk ka dhënë fryt, por se të gjitha këto goditje politike kanë tronditur themelet e drejtësisë së fortë shtetërore në BeH dhe kanë rezultuar me dënim të ashpër të bashkësisë ndërkombëtare.[98]

## III Problemi i vlefshmërisë kohore të Kodit Penal në krahasim me veprat kriminale të krimeve të luftës të kryera në periudhën prej 1992 deri 1995

Një prej parimeve themelore të kodit penal është parimi i ligjshmërisë, i cili thotë se askush nuk mund të jetë fajtor për veprën penale, e cila në kohën e kryerjes, nuk ka qenë e shkruar me të drejtën vendore ose ndërkombëtare dhe se askujt nuk mund t' i jipet dënim më i rëndë se ajo që është e përshkruar në kohën e kryerjes së veprës.[99] Më tutje, dhe ndoshta më e rëndësishmja për temën e këtij punimi, parimi thotë se nëqoftëse pas kryerjes së veprës penale, një herë ose më shumë herë ndryshohet ligji, duhet të zbatohet ligji, i cili është më i butë për kryerësin.[100] Prej parimit është paraparë përjashtimi në mënyrë që kjo që u tha më lartë nuk mund të ndalojë gjykimin ose dënimin e kujtdo për çfarëdo veprash të kryera ose jo të kryera, të cilat në kohën e kryerjes janë konsideruar si vepra penale me parimet e përgjithshme të drejtësisë, të cilat i pranojnë popujt e civilizuar.[101]



96 Shiko p.sh. deklaratën e Mladen Bosnić, kryetar i Partisë Demokrate të Srpskas, të datës 11.12.2009: ai ka thënë se praktika e deritanishme ka dëshmuar se gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë kanë qenë të koncentruar një pjesë në ndjekje të anëtarëve të SDS-it, ku shumë prej tyre janë burgosur për lajmërime të ndryshme penalë "për t'u dëshmuar në fund se të gjitha kanë qenë politikisht të montuara"(qasur me 29.01.2014 http://www.mojevijesti.ba/novost/23371/); deklarata e Krstan Simiq, delegat në Klubin e popullit serb në Dhomën e Popullit të Asamblesë Parlamentare të BeH" Në çfarëdo rasti është mirë që të shkojnë. Ata nuk kanë dhënë kontribut as në kuptimin profesional, as nuk kanë dhënë stimulim të caktuar në aspektin e drejtësisë, pasi që të gjithë këtu janë të bindur, e sidomos në Republika Srpska, se drejtësia ka qenë selektive kur bëhet fjalë për krime të luftës" (qasur me 29.1.2014. http://www.nezavisne.com/novosti/bih/Simic-Strane-sudije-i-tuzioci-nisu-polozili-173007.html); artikulli në web faqen e Radio Televizionit të Serbisë, të 23.11.2009 "Dodik kërkon referendum për gjykatësit ndërkombëtar ": "Republika Srpska do të organizojë referendum, ku qytetarët do të përcaktohen për vendimin e Valentin Inck, që të zgjasë mandatin gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në BeH, ka paralajmëruar kryeministri i RS Milorad Dodik, qasur me 29.1.2014. http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/11/Region/317521/Dodik+tra%C5%BEi+referendum+za+strane+sudije.html).

97 Propozim Ligjin në procedurën parlamentare e kanë dërguar bashkërisht klubet e deputetëve të Partisë të Socialdemokratëve të Pavarur dhe Partisë Demokratike të Srpskës në Dhomën e Përfaqësuesve të Asamblesë Parlamentare të BeH. Propozimi dy herë ka marrë notë negative të Komisionit Kushtetues-drejtësisë të Dhomës së Përfaqësuesve të Asamblesë Parlamentare të BeH.

98 Shiko artikullin në portalin informueswww.24sata.info të 24.1.2012, "Inzko Dodikut: 'Harro largimin e Gjykatës dhe Prokurorisë", qasur me 27.01.2014, http://www.24sata.info/politika/84503-inzko-dodiku-zaboravi-na-ukidanje-suda-i-tuzilastva.html.

99 Parimi është përmbledh në nenin 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ).

100 Shiko nenin 4 KP BeH*(op. cit, 16)* „Afati i vlefshmërisë i kodit penal".

101 Shiko nenin 7.2 KEDNJ, përkatësisht neni. 4a) KP BeH (*ibid*).

Në BeH ekziston pluraliteti i kodeve penale, të cilët kanë qenë në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve të luftës dhe deri më tani. Çështja e vlefshmërisë kohore të ligjeve në bazë ka të bëjë me pyetjen: cili prej këtyre ligjeve është i zbatueshëm për kryerësit e veprave të kryera, në periudhën e konfliktit të armatosur në BeH, prej 1992 deri në 1995. Edhe pse për këtë pyetje sipas teorisë të së drejtës penale gjithmonë zgjidhet *in concreto,* pra në varësi të rrethanave të rastit konkret, do të shohim që në krahasim me situatën në BeH ekzistojnë arsye për mendime të ndryshme dhe marrja e disa qëndrimeve dhe përfundimeve të caktuara.

Ne BeH, gjatë kohës së luftës, ka qenë në fuqi KP RFSJ-së, i marrë si ligj nga Republika BeH.[102] Ky ligj, në masë të madhe, ka reflektuar në normat e atëhershme në fuqi të së drejtës ndërkombëtare, të cilat RFSJ i ka inkorporuar në sistemin e drejtësisë.[103] Kështu ligji ka paraparë veprën kriminale të gjenocidit, krimit të luftës kundër popullatës civile, krimit të luftës kundër robërve të luftës dhe vepra tjera të kategorisë "Krime kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare" (Kreu XVI i ligjit). Prapë, ky ligj nuk ka reflektuar adekuat në të drejtën ndërkombëtare në fuqi në kohën e konfliktit në BeH. Si shembull, pavarësisht Kreut XVI të ligjit, krimi kundër njerëzimit nuk ka qenë i përshkruar si vepër penale e as forma e përgjegjësisë komanduese, e cila përfshinë edhe përgjegjësinë e mbikëqyrësit për dështim të parandalimit ose të dënimit të krimeve të vartësve, i cili sot është i pranuar gjerësisht në të drejtën ndërkombëtare. Sidoqoftë, padyshim se krimet penale të përmendura kanë qenë të dënueshme sipas të drejtës ndërkombëtare dhe të zbatueshme në BeH, në periudhën prej 1992 deri 1995.

Kur është në pyetje sistemi i dënimeve penale, të cilin e ka paraparë KP RFSJ si dhe në shumë shtete socialiste të Evropës lindore nuk ka ekzistuar dënimi i burgimit afatgjatë, por për format më të rënda të veprave penale është paraparë dënimi me vdekje. Kështu edhe për të gjitha veprat e krimeve të luftës KP RFSJ ka paraparë të njëjtin dënim: prej 5 deri në 15- vjet burgim e që ka qenë minimumi dhe maksimumi i përgjithshëm ligjor i dënimit me burgim[104], ndërsa për format më të rënda të veprës kanë mundur të dënohen me vdekje ose dënim me burgim prej 20 vjetësh.[105]

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit, BeH në Kushtetutën e saj i ka përfshirë protokollet e KEDNJ, të cilat i ka ngritur në rang të tekstit kushtetues, duke u dhënë primat ndaj të gjitha ligjeve tjera.[106] Me këtë BeH ka futur në fuqi edhe Protokollin nr. 6 sëbashku me Konventën, e cila ka të bëjë me eliminimin e dënimit me vdekje në kohë paqeje. Me Nenin 2 të këtij Protokolli ka mbetur mundësia që shteti në sistemin e vet të drejtësisë të parasheh dënimin me vdekje për veprat ë kryera në kohë të luftës ose në rrezikun imediat të luftës.[107] BeH ka pasur mundësi të një rregulle të tillë në legjislacionin e vet (KP RFSJ). Tek me miratimin e kodit penal të etnitetit të vitit 1999 FBeH dhe në vitin 2000 RS, dënimi me vdekje është shlyer në tërësi nga ligji vendor, ndërsa sistemi i dënimit ka futur dënimet afatgjata me burg, dhe atë: prej 21 deri në 40-vjet në FBeH, përkatësisht prej 21 deri në burgim të përjetshëm në RS, më vonë, me reformën e vitit 2003, është vendosur sistem unik i dënimit të burgimit afatgjatë në afat prej 21 deri 45-vjet burgim, në tërë BeH).[108] Me këtë, dënimi me vdekje në BeH është eliminuar, si në kushte paqeje ashtu edhe të luftës dhe kjo sipas informatave



102 BeH ka shpallur pavarësinë me 1.03.1992, ndërsa sipas rregullativës me plotfuqishmëri gjyqësore në Prill të vitit 1992 ka marrë ligjet, të cilat kanë qenë në fuqi në ish-RFSJ.

103 RFSJ ka qenë nënshkruese e të gjitha konventave relevante ndërkombëtare që kanë të bëjnë me krime të luftës, të cilat BeH i ka miratuar të plota, duke përfshirë edhe Konventën për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit nga viti 1948 dhe Katër Konventat e Gjenevës nga viti 1949.

104 Neni. 38 KPRFSJ „(1) Burgu nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë e as më i gjatë se pesëmbëdhjetë vjet. (2) Për veprat kriminale për të cilat është përshkruar dënimi me vdekje gjykata mund të caktojë dënimin deri në 20-vjet burgim."

105 Neni. 141 (Gjenocid), 142 (Krim lufte kundër popullatës civile), 143(Krim i luftës kundër të plagosurve dhe të sëmurëve), 144 (Krim i luftës kundër robërve të luftës), 148 (Përdorimi i mjeteve të ndaluara në luftë) KP RFSJ.

106 Neni II 2 i Kushtetutës së BeH: „Të drejtat dhe liritë e parapara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe në protokollet e saj, drejtpërdrejt zbatohen në Bosnje dhe Hercegovinë. Këto Akte kanë prioritet ndaj ligjeve tjera."

107 Shiko Nenin 1 dhe 2 Protokolli 6 të KEDNJ . Për diskutim rreth ekzistimit të dënimit me vdekje në legjislacionin e BeH në periudhën pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit, përkatësisht për rezervën e BeH lidhur me parime e Protokollit 6, dhe protokollit të Dytë shtesë në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Qytetare dhe Politike, shiko Azra Miletić, "Instituti i vlefshmërisë kohore të ligjeve në lëndët e krimeve të luftës para Gjykatës së BeH", *Sveske za javno pravo,*nr 7, Mars 2012, faqe 26, qasur me 30.01.2014, http://www.fcjp.ba/templates/ja_avian_ii_d/images/green/Sveske_za_javno_pravo_broj_7.pdf.

108 Në vitin 2001 ka hyrë në fuqi në BeH edhe Protokolli 13 në Konventën për eliminimin e plotë të dënimit me vdekje në të gjitha kushtet, sidoqoftë kjo nuk ka pasur rol të rëndësishëm praktik duke pasur parasysh se në atë kohë dënimi me vdekje në BeH vetëm ka qenë i hequr, siç është përmendur.

në dispozicion edhe para organeve të Këshillit të Evropës konsiderohet moment i heqjes së plotë të dënimit me vdekje në legjislacionin e BeH[109], e që në diskutimin e mëvonshëm do të jetë e një rëndësie të veçantë[110]. Megjithatë, ajo çfarë është me rëndësi është se vetëm pas 14.12.1995 (data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Dejtonit, pra, KEDNJ dhe Protokolleve të saj), dënimi me vdekje në BeH nuk ka mundur më të ekzekutohet. Kjo është konfirmuar edhe me vendimin e Gjykatës së Drejtave të Njeriut në lëndët *Sretko Damjanović kundër Federatës BeH dhe Borislav Herak kundër Federatës BeH,* të cilëve u është ndaluar që t'u ekzekutohen dënimet më vdekje ndaj të dënuarve.

## Zhvillimi i praktikave të ndryshme gjyqësore para gjykatave në BeH

### Praktika e gjykatave(supreme)të entiteteve

Pikërisht nga lënda e kontestuar *Herak dhe Damjanoviq,* në fund të zgjedhur nga Gjykata Supreme e FBeH,[111] është zhvilluar praktika e zbatimit të "prerë" të Ligjit të RFSJ-së, pra ligjit në të cilin dënimi sillet prej 5 deri në 15-vjet burgim, me mundësi eventuale të shqiptimit të dënimit deri në 20-vjet burgim për rastet më të rënda.[112]Me fjalë tjera, duke pas parasysh se në periudhën prej nënshkrimit të marrëveshjes së paqes e deri te miratimi i kodeve penale të entiteteve (1998 në FBeH dhe 2000 në RS) nuk ka mundur të kryhet dënimi me vdekje, ndërsa dënimet tjera nuk janë paraparë për format më të rënda të veprave, dënimi më i rëndë i aplikueshëm ka qenë dënimi prej 15 përkatësisht 20-jet burgim (për rastet më të rënda). Gjykata supreme e dy entiteteve ka gjetur se vetëm dënimet e mbetura për veprat e kryera para hyrjes në fuqi të ligjeve të reja mund të zbatohen. Në lidhje me këtë, as miratimi i mëvonshëm i KP BeH i vitit 2003 nuk ka ndryshuar në themel këtë praktikë të vendosur fortë në dy etnitetet dhe në Distriktin e Brçkos të BeH.

### Praktika e Gjykatave të BeH

Përkundër të gjithave, para Gjykatës së re të BeH është zhvilluar një praktikë tjetër. Në vitin 2003 në BeH vjen deri te një reformë e thellë e legjislacionit penal kur në fuqi hyn KP i ri i BeH së bashku me tri ligje tjera penale në BeH (KP RS, KP FBeH, KP Distriktit Brçko të BeH). Prej këtij momenti veprat penale të krimeve të luftës kanë kaluar ekskluzivisht nën përgjegjësinë e drejtësisë shtetërore (Gjykata dhe Prokuroria e BeH), dhe rregullat për to janë përcaktuar vetëm sipas KP shtetëror.[113]

KP i ri i BeH ka reflektuar të gjitha arritjet dhe zhvillimet e të drejtës ndërkombëtare deri në këtë moment. Përveç veprave që i ka përshkruar KP RFSJ, ligji i ri në mes tjerash ka përshkruar edhe krimin kundër njerëzimit dhe ka përfshirë një kuptim më të gjerë të përgjegjësisë komanduese, që i'u ka përshtatur zhvillimit modern të drejtës dhe praktikës ndërkombëtare. Kur janë në pyetje rregullat e dënimeve penale për veprat e krimeve të luftës, ligji i ri për shumicën e veprave të kësaj kategorie parasheh limitin e poshtëm prej 10-vjetësh dhe limitin e epërm prej 45-vjetësh të burgimit afatgjatë.[114]



109 Raporti i Komitetit për çështje politike para Kuvendit Parlamentar të Këshillit të Evropës, Doc. nr. 9287, të datës 5.12.2001, i përgatitur me rastin e aplikimit të BeH për anëtarësi në Këshill të Evropës, §46, qasur 30.01.2014, http://assembly.coe.int/ASP/Doc/XrefViewHTML.asp?FileID=9565&Language=en: §46*:* „The new Criminal Codes adopted by the Federation on 29 July 1998 and by Republika Srpska in June 2000 abolished the death penalty."

110 Për diskutim më të detajuar për kohën e heqjes së dënimi me vdekje si dënim në Bosnje dhe Hercegovinë shiko: Azra Miletić, *op.cit*, faqe 30-33.

111 Dhoma e të Drejtave të Njeriut, vendimi meritor CH/96/30 nga 1997/09/05. Vendimi mbi provueshmërinë dhe vendimit meritor CH/97/69 1998/06/12.

112 Dënimi me vdekje u është shqiptuar, në vitin 1993, Borislav Herakut dhe Sretko Damjanoviq për krim të gjenocidit dhe krimit të luftës kundër popullatës civile, para Gjykatës Ushtarake Regjionale në Sarajevë, fillimisht është zëvendësuar me dënim prej 40-vjetësh burgim, ndërsa sipas dispozitës kaluese të KP të ri të BeH të 1998 si shtesë Gjykata e Lartë e BeH kështu dënimin e ka ndërruar me 20-vjet burgim, duke gjetur se dënimi prej 40-vjetësh (burg afatgjatë) nuk ka ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës, prandaj ajo nuk mund të caktohet. Se fundi, në lidhje me Sretko Damjanoviq është lejuar përsëritja e çështjes dhe në procedurën e përsëritur është dënuar me 9-vjet burgim, ndërsa kërkesa e Borislav Herakut është refuzuar dhe ai ka mbajtur dënimin me 20-vjet burgim. Më detajisht për këto lëndë shiko *Krimet e luftës në BeH, procedurat e përfunduara plotfuqishëm në BeH 1992-2006, Akuza, ankesa, aktgjykime, "Shoqata Amerikane e Avokatëve për iniciativën e drejtësisë në Evropën Qendrore dhe të Evroazisë*a(ABA/CEELI) dhe Shoqata e Prokurorëve BeH" 2006 faqe 169-222.

113 Dallojnë qëndrimet e Gjykatës Supreme të Republika Srpska me ato të Gjykatës Supreme të Federatës me atë se sipas qëndrimit të Gjykatës Supreme të RS mund të jipet dënimi prej 20-vjetësh për format më të rënda të veprave penale të krimeve të luftës, duke marrë parasysh që sipas qëndrimit të kësaj gjykatë ky dënim ka ekzistuar si dënim i pavarur, i pavarur nga dënimi me vdekje. Qëndrimi i Gjykatës Supreme të Federatës BeH është që dënimi prej 15-vjetësh është dënimi maksimal që mund të jipet për këto vepra.

114 Shiko nenet 171, 172, 173, 174, 175, 177 i 179 KP BeH.

Që në gjykimet e para, para Njësisë për Krime Lufte, Gjykata e BeH ka filluar të implementojë KP i ri të BeH. I dënuari i parë për krime lufte para Gjykatës së BeH, Abduladhim Maktouf, është dënuar sipas KP të ri të BeH me 5=vjet burgim për krimin e luftës kundër popullatës civile, duke implementuar rregullat e zbutjes nën dënimin e paraparë me ligj prej minimum 10-vjet për këtë vepër, për shkak të ekzistimit të rrethanave lehtësuese. Gjykata e BeH në këtë lëndë ka marrë qëndrim të rëndësishëm që më vonë e ka implementuar edhe në lëndë tjera. Shkurtimisht, Gjykata ka gjetur se, duke shikuar në përgjithësi të gjitha lëndët e krimeve të luftës, e posaçërisht ato të transferuara nga TPNJ, ish-Ligji i RFSJ me dënimin maksimal prej 20-vjetësh (kur hiqet dënimi me vdekje) nuk mund të kryejë qëllimin e dënimit për këto vepra të rënda penale, për çka është arsyetuar të bëhet përjashtim prej përdorimit të detyrueshëm të ligjit më të butë që thuhet në Nenin 7.2 të Konventës. Gjykata poashtu ka theksuar ekzistimin e dënimit me vdekje si dënim maksimal në KP të RFSJ-së, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës, e cila është me siguri më e rëndë se dënimi prej 45-vjetësh duke e bërë KP të BeH ligj më të butë.[115]

**Qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese të BeH**

Maktouf menjëherë i është drejtuar GJK të BeH dhe është ankuar në këtë interpretim të Gjykatës së BeH, duke konsideruar se për të ligj më i butë është ai i RFSJ-së. GJK e BeH në vendimin AP–1785/06 të 30.03.2007 ka refuzuar kërkesën dhe ka marrë qëndrim të rëndësishëm nëpërmjet të cilit Gjykata e BeH do të zhvillojë praktikën e mëtutjeshme. Pra, GJK e BeH ka gjetur se përdorimi i KP BeH nuk paraqet shkelje të Nenit 7 të KEDNJ dhe ka konfirmuar qëndrimin e Gjykatës së BeH që në rastet e krimeve të luftës është i zbatueshëm përjashtimi i përdorimit të detyrueshëm të kodit më të butë penal, pra qëndrimit 7.2 të konventës. Por, GJ e BEH në këtë vendim ka theksuar një qëndrim shumë të rëndësishëm, duke komentuar praktikën e përdorimit të "në mënyrë të prerë" të ligjit të RFSJ zakonisht nëpër etnitete:

*§69.**Gjykata Kushtetuese konsideron se nuk është e mundur që thjesht të "anashkalojë" një dënim dhe të zbatohen tjerët, dënime më të buta dhe praktikisht të lejohen të dënuara në mënyrë joadekuate veprat më të rënda penale"** *(shkruar në tekstin e vendimit të GJK BeH)*

§89. Pas të gjitha të përmendurave **Gjykata Kushtetuese konsideron se "mungesa" e ligjeve të entiteteve në kuptimin e mospërcaktimit të këtyre veprave dhe garancive, shton obligim shtesë ndaj gjykatave të entiteteve që kur të gjykojnë për vepra penale të krimeve të luftës, duhet të zbatojnë Kodin Penal të Bosnje dhe Hercegovinës dhe ligjet tjera relevante dhe dokumentet ndërkombëtare të aplikueshme në Bosnje dhe Hercegovinë. Nga të lartpërmendurat del edhe obligimi që gjykatat e entiteteve të përcjellin praktikën gjyqësore të Gjykatës së BeH, si gjykatë shtetërore. Në të kundërtën, duke vepruar ndryshe, gjykatat në entitete do të shkelnin principin e sigurisë legjislative dhe sundimit të ligjit.** *(thënë në tekstin e vendimit të GJK të BeH).*

Pikërisht në themelet e këtyre qëndrimeve GJK e BeH ka zhvilluar praktikën e mëtutjeshme në të gjitha lëndët para Gjykatës së BeH. Përveç kësaj, i dënuari Maktouf iu ka drejtuar më tutje GJEDNJ në Strasburg duke kërkuar mbrojtjen e të drejtave nga Neni 7 i Konventës, dhe shumë shpejt me kërkesë të njëjtë iu drejtuar Gjykatës Evropiane edhe Goran Damjanović, i dënuar poashtu për krime lufte kundër popullatës civile, me 11-vjet burgim, prandaj lënda është zgjedhur me një vendim të vetëm të Gjykatës Evropiane e që do të vijë vetëm 5-vjet më vonë, më 18.03.2013. Në ndërkohë, në Gjykatën e BeH, në 2009, vjen deri te një kthim i rëndësishëm në praktikën gjyqësore dhe disa kështilla apeluese fillojnë që ta aplikojnë KP të RFSJ-së në disa raste më pak të komplikuara, pra në lëndë me pasoja të vogla, duke marrë parasysh se ky ligj parasheh një minimum më të butë të dënimit (5-vjet burgim, në krahasim me minimumin 10-vjeçar sipas KP BeH).[116] Duke marrë parasysh ligjshmërinë, e cila vë obligimin e përdorimit të ligjit më të butë për kryerësit në rrethanat konkrete të rastit, gjykata vjen deri te përfundimi se për kryerësin është më i butë KP RFSJ në rastet ku këshilli ka për qëllim që të dënuarin ta dënojë më butë, pra që të lëshojë dënim në minimumin ligjor, duke marrë parasysh se dënimet e parapara me KP RFSJ janë më të ulëta krahasuar me ato të parapara me KP të BeH. Kjo sidoqoftë nuk përjashton përdorimin e KP BeH në të gjitha lëndët më të rënda para Gjykatës së BeH, për shkak të ekzistimit të maksimumit ligjor më të butë (45-vjet burgim) në krahasim me KP RFSJ (dënim me vdekje). Mund të thuhet se gradualisht në Gjykatën e BeH ka lindur një praktikë e re, sipas së cilës, varësisht prej rrethanave të secilit rast, drejtimi i dënimit të akuzuarit konkret parashihet sipas ligjit, i cili aplikohet. Me fjalë tjera, nëse dënimi sillet në drejtimin e minimumit

115 Gjykata BeH, aktgjykimi nr. KPZH 32/05 të 4.04.2006, pjesë e shpjegimit në faqen 20-22.

116 Deri më 18.07.2013, pra datës së sjelljes së aktgjykimit të GJEDNJ *Maktouf dhe Damjanović,* Gjykata BeH ka sjellë në total 9 vendime me zbatimin e KP RFSJ në lëndët e krimeve të luftës; lënda e parë ka qenë Zijad Kurtović, nr. X-KRZH-06/299 i 25.03.2009.

e paraparë me ligj, vlen që të përdoret KP RFSJ si ligj më i butë, ndërsa nëse dënimi sillet në drejtimin e maksimumit ligjor, i zbatueshëm është KP BeH si ligj më i butë.[117] Mund të thuhet se pikërisht një qasje e tillë e Gjykatës së BeH, e cila varet nga rrethanat e secilit rast specifik, ka pranuar edhe GJEDNJ kur ka sjellë vendimin në rastin *Maktouf dhe Damjanović kundër BeH,* e që do të tregohet më poshtë.

Në ndërkohë, pra deri tek fillimi i procesit *Maktouf dhe Damjanović kundër BeH,* para GJEDNJ, para GJK BeH janë grumbulluar aplikacionet e të gjithë të dënuarve para Gjykatës së BeH, si për krime të luftës me pasoja të rënda, siç janë gjenocidi ose krimet kundër njerëzimit, poashtu edhe të dënuarve për lëndë më pak të komplikuara siç ishte rasti *Maktouf* ose *Damjanović.*[118] Çdo i akuzuar është ankuar në shkelje të Nenit 7 të Konventës. Për këto aplikime Gjykata Kushtetuese nuk ka vendosur deri në 2006 kur edhe kanë filluar të vijnë e deri më 2013, vitin kur GJEDNJ ka sjellë vendimin në lëndën *Maktouf* dhe *Damjanović kundër BeH.* Një mosreagim i tillë i Gjykatës Kushtetuese mund të arsyetohet me pritjen e vendimit të Gjykatës Evropiane, por është problematike në aspektin e respektimit të standardit të vendosjes në çështjet e supozuara të shkeljeve të drejtave njerëzore në afat të kuptueshëm, të cilin GJK e BeH është e obliguar ta respektojë.

**Pritjet nga GJEDNJ**

E gjitha e lartpërmendura tregon qartë dhe pritje të njëmendta në qarqet legjislative në BeH që Gjykata Evropiane do të zgjidhë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dilemat lidhur me aplikimin e kodit penal material në lidhje me të gjitha llojet e krimeve të luftës, si atyre më pak të komplikuara deri te ato më seriozet. Në këtë vështrim, një prej pyetjeve më të rëndësishme në të cilën GJEDNJ është dashur të jap përgjigje është: a ka ekzistuar në sistemin e drejtësisë të BeH në ndonjë kohë një "ligj" (i cili përmbushë kushtet kualitative të fjalës *ligj* në kuptimin e së drejtës konvencionale), e i cili për veprat më rënda përshkuan dënime prej 5 deri në 15 vite burgim (me mundësi të dënimit deri me 20 vite), pra ligj i cili nuk përmban dënimin me vdekje? Me fjalë tjera, a përmbush "ligji i cunguar" i RFSJ, i ciki ka hyrë në zbatim, kushtet e *ligjit* sipas standardeve konvencionale? Është e qartë se prej përgjigjes në këtë pyetje dallon edhe përgjigjja në pyetjenqendrore – cili *ligj* do të konsiderohet si më i buti për kryerësit, dhe si i tillë të zbatohet. Do të thotë, po qesë "ligji i cunguar" nuk përmbushë kushtet e *ligjit* sipas Konventës (e sidomos duke marrë parasysh që ligjbërësit si të tillë kur nuk e kanë aprovuar dhe se nuk siguron sistem *adekuat* të dënimit për shkeljet më të rënda të drejtave të njeriut), dhe me vetë këtë nuk ekziston, pra a mund të aplikohet ky si *ligji* më i butë? Ndërsa në anën tjetër po qesë një ligj i tillë i përmbushë këto standarde të konventës, shtrohet pyetja: a mundet në rrethanat e disa, rasteve më të rënda të aplikohet retroaktivisht KP BeH i 2003-tës, dhe të konsiderohet si përjashtim i lejuar pasi që mundëson dënimin *adekuat* të krimeve kundër njerëzimit dhe dinjitetit njerëzor siç e ka konsideruar Gjykata BeH, ndërsa e ka konfirmuar GJ e BeH? Ndryshe thënë, a mund poashtu të pranohet se zbatimi i ligjit të "cunguar" të RFSJ në format më të rëndë të veprës penale të krimeve të luftës potencialisht mund të paraqesë shkelje të disa të drejtave tjera të konventës, siç është e drejta për jetë, ndalim të torturës, e drejta për jetë private dhe familjare etj, të cilat mbrohen pikërisht me dënimin adekuat dhe efikas të sulmeve më të rënda në këto të drejta, e të cilat është i obliguar shteti që t'i sigurojë brenda obligimeve pozitive që i përkasin KEDNJ? Megjithatë, siç do të shihet nga vendimi i Gjykatës Evropiane, nga 18.07.2013 deri te një vendim i tillë gjithëpërfshirës nuk ka ardhë. Gjykata Evropiane nuk është argëtuar me këtë çështje komplekse e as nuk ka dhënë vlerësim për atë se nëse implementimi i KP BeH si i tillë është kundër Nenit 7 të Konventës duke lënë këtë çështje edhe ashtu të hapur. Prej këtij aspekti, mbajtja afatgjate e lëndës në GJK BeH vështirë që mund të arsyetohet nga pika e tanishme e shikimit.

Kur flitet për pritjet e GJEDNJ është e rëndësishme që të përmendet se që nga marrja e përgjegjësisë ekskluzive për punë në lëndët e KL nga ana e Gjykatës së BeH, organe të shumta relevante për përcjellje të punës në lëndët e KL me vite kanë treguar për praktikë të paharmonizuar të gjykatës në krahasim me gjykatat tjera në BeH, të cilat prapë e kanë zbatuar ligjin e vjetër. Në mes tyre, para së gjithash GJK BeH, e cila, në lëndën e cituar *Maktouf* të 2007 ka theksuar se entitetet duhet të përcjellin praktikën e Gjykatës së BeH.

Më tej, Komiteti për të Drejta të Njeriut e KB në raportin e 2012 ka shfaqur brengën për:

...mungesë të përpjekjeve që të harmonizohet praktika gjyqësore në lëndët e krimeve të luftës, që drejtohen në entitete, dhe për shkak të asaj gjykatat e entiteteve përdorin

117 Shiko lëndën e parë para Gjykatës së BeH, në të cilën është zbatuar KP RFSJ: Aktgjykimi nr X-KRZH-06/299 i 25.03.2009.

118 Sipas informatave nga burimi i Gjykatës së BeH, para GJK BeH gjinden rreth 40 aplikime të dënuarve për krime lufte para Gjykatës BeH, për të cilat GJK BeH nuk ka vendosur ende.

kodin penal të vjetër të ish-RFSJ-së, e cili në mes tjerash nuk përshkruan krimin kundër njerëzimit, përgjegjësinë komanduese, robërisë seksuale dhe shtatzënisë së dhunshme. Komiteti është i brengosur se kjo mund të ndikojë në konsistencën e dënimeve penale në entitete.[119]

Misioni i OSBE-së në BeH, e cila kryen monitorimin e gjykimeve për KL në tërë shtetin poashtu ka shprehur brengën në raportimin e 2008[120], dhe ka rekomanduar:

Misioni i OSBE-së në Bosnje dhe Hercegovinë rekomandon: Prokuroria dhe gjykatat e entiteteve dhe në Distriktin e Brçkos do të duhej që në të ardhmen, në lëndët e krimeve të luftës, të zbatojë Kodin Penal të Bosnje dhe Hercegovinës, në çka tregon edhe Gjykata Kushtetuese e Bosnje dhe Hercegovinës në vendimin e saj në lëndën *Maktouf.*

Së fundi, Komisioni Evropian brenda dialogut të strukturuar i ka dhënë rëndësi të madhe kësaj teme dhe ka aprovuar diçka rekomandime në këtë drejtim. Pritjet e saj kanë qenë drejtuar ndaj GJEDNJ.[121]

## II Vendimi I Gjykatës Evropiane Të 18 Korrikut Të Vitit 2013

Në fund, më 18 korrik të vitit 2013, është sjellë vendimi në lëndën *Maktouf dhe Damjanović kundër BeH*. Në komunikatën e dhënë të njëjtën ditë, Gjykata ka deklaruar:

Në aktgjykimin e sotëm të Këshillit të Lartë në lëndën *Maktouf dhe Damjanoviq kundër Bosnje dhe Hercegovinës* (lëndët nr. 2312/08 dhe 34179/08), e cila është përfundimtare, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut unanimisht ka vendosur se ka ardhur deri te shkelja e Nenit 7 (dënimi vetëm në bazë të ligjit) të Konventës Evropiane të Drejtave të njeriut [...] duke marrë parasysh llojin dhe peshën e këtyre veprave penale, për të cilat ushtruesit e kërkesës janë dënuar, (krim lufte e jo krim kundër njerëzimit dhe se asnjëra nga veprat e kryera nuk ka pasur si përfundim vdekjen), Gjykata ka konsideruar se ka mundur që t'u jipeshin dënime më të lehta nëse do të ishte përdorur Kodi Penal i vitit 1976. Duke marrë parasysh probabilitetin e lartë që implementimi i Kodit Penal të vitit 2003 ka dërguar deri të zbatimi i dënimeve më të rënda në kushtet specifike të rastit të lëndës, Gjykata më tutje ka dëshmuar se ndaj shtruesve të kërkesës nuk janë siguruar masa efikase të mbrojtjes nga shpallja e dënimeve të rënda.[122]

Më tutje, GJEDNJ në këtë lëndë ka vendosur edhe për shkeljen e nenit 6 (E drejta për gjykim të drejtë) si dhe nenit 14 dhe nenit 1 të Protokollit 12 (Ndalim i diskriminimit), dhe ka gjetur se në këtë çështje nuk ka shkelje të Konventës, duke i rrëzuar ankesat si dukshëm të pabazuara.

Thelbi i qëndrimit që ka marrë GJEDNJ në lidhje me Nenin 7 përbëhet në refuzimin e argumentit kryesor të qeverisë, i cili drejtohet për qasje të përgjithshme ndaj çështjes së ligjit më të butë. Qeveria, pra ka deklaruar se në të gjitha lëndët e krimeve të luftës është i zbatueshëm përjashtimi nga neni 7 i qëndrimit të Konventës së parë, i përmbajtur në qëndrimin e dytë të njëjtit nen[123] dhe më tutje se KP BeH do të duhej *gjithmonë* të konsiderohej më i butë për shkak të ekzistimit të dënimit me vdekje në ligjin e vjetër, dhe se as në rastin e implementimin e standardit nga qëndrimi i parë nuk do të mund të vihej në përfundim se ka pasur shkelje. Një argumentim i tillë ka qenë në gjurmë të qëndrimeve të marra në Gjykatën e BeH dhe GJK (të paraqitura më herët). Megjithatë Gjykata Evropiane ka refuzuar një qasje të tillë të përgjithshme, pikërisht duke konsideruar se kështu në mënyrë të pamjaftueshme merren për baze rrethanat specifike të rasteve të aplikuesve (me të cilat nuk kanë mundur të jipen dënime maksimale) pra, pamundëson vendimmarrjen *in concreto.* Argumentet e qeverisë janë refuzuar si të pazbatueshme te aplikantët konkretë, por nuk janë konsideruar si të pazbatueshme në rrethana tjera. Pra, GJEDNJ është përcaktuar për qasje shumë të ngushtë dhe të kufizuar, duke mos arrirë në çështjet më të rënda duke marrë parasysh për këtë se lënda konkrete nuk i prekë ato çështje në mënyrë direkte. Megjithatë, në këtë mënyrë GJEDNJ, madje i ka ikur



119 *Concluding Observations on the Second Periodic Report of Bosnia and Herzegovina, Adopted by the Committee at its 106th Session, 15 October to 2 November 2012,* qasur: 29.1.2014,http://www2.ohchr.org/english/bodies/hrc/docs/co/CCPR-C-BIH-CO-2.doc.

120 "Në rrugë drejt zbatimit unanim të ligjit në fuqi në rastet e krimeve të luftës para gjykatave në Bosnjë dhe Hercogovinë", OSBE, Gusht 2008.

121 Shiko rekomandimet në faqenwww.pravosudje.ba, qasur 30.2.2014.

122 http://sudbih.gov.ba/files/docs/Saopstenje_ESLJP_u_predmetima_Maktouf_i_Damjanovic_17_07_2013bos.pdf.

123 Teksti i qëndrimit 2 Nenit 7 KEDNJ: „Ky nen nuk ndikon në gjykimin ose dënimin e ndonjë personi i cili është fajtor për kryerje ose moskryerje, nëse kjo vepër në kohën e kryerjes ka paraqitur vepër penale sipas parimeve themelore të drejtësisë të pranuara tek popujt e civilizuar."

që të shtrëngohet me thelbin e një problemi shumëvjeçar të së ashtuquajturës "aplikimit retroaktiv" të KP BeH nga viti 2003, siç është përmendur më herët në tekst. Prapë, ajo çfarë GJEDNJ ka bërë të qartë kanë qenë dy gjëra:

1. Se argumentimi, të cilin e ka përdorur gjykata, pra vendimi i saj, nuk është i aplikueshëm në të gjitha format e krimeve të luftës, por vetëm në lëndët e krahasueshme me lëndët *Maktouf dhe Damjanović,* në kuptimin e pasojave të veprave. Kjo qartë thuhet në paragrafin§65:

Në fillim, Gjykata dëshiron të theksojë se *nuk është detyrë e saj të analizojë* in abstracto *nëse aplikimi retroaktiv i Ligjit të vitit 2003 në lëndët e krimeve të luftës është në vete jokompatibile me nenin 7 të Konventës* Kjo çështje duhet të vlerësohet për secilën lëndë individualisht, duke marrë parasysh rrethanat konkrete të secilit rast [...](kursiv M.K.)

Pra, çështje e ligjit më të butë vetëm mund të vlerësohet si *in concreto,* pra në lidhje me rrethanat individuale të lëndës dhe assesi *in abstracto.* Rrethanat konkrete të rasteve nuk kanë nisur çështjen e krimeve të rënda. Kjo na dërgon tek përfundimi i dytë i aktgjykimit:

2. Nëse rrethanat e rasteve to të ishin ndryshe, pra nëse ka qenë fjala për vepër me pasoja fatale, do të ishte e mundur që qasja e Gjykatës të ishte ndryshe dhe atëherë edhe argumentet e qeverisë të pranoheshin. Prapë, nuk mund të thuhet me siguri deri te çfarë përfundimi do të vinte Gjykata në fund:

§69. Në shikimin e argumentimit të Qeverisë se Ligji i vitit 2003 është më i butë për aplikantët se sa Ligji i 1976, duke marrë parasysh mosekzistimin e dënimit me vdekje, Gjykata thekson se vetëm për format më të rënda të krimeve të luftës, dënimi me vdekje ka qenë i zbatueshëm sipas Ligjit nga 1976. [...] *pasi asnjë nga aplikantët nuk është shpallur fajtor për krim me pasojë humbje të jetës,* krimet për të cilat ata janë dënuar është e qartë se nuk kanë hyrë në këtë kategori. Siç është përmendur në tekst, zotëri Maktouf ka marrë dënimin më të ulët të mundshëm ndërsa zotëri Damjanoviq ka marrë dënim që shumë pak kalon minimumin që përshkruhet me ligjin e vitit 2013 për krime lufte. *Në këto rrethana, është e rëndësisë së veçantë në këtë lëndë që të vendoset se cili ligj është më i butë në kuptimin e dënimit minimal,* dhe kjo është pa kurrfarë dyshimi Ligji i vitit 1976.

§70. Duhet të pranohet se dënimet e aplikantëve në këtë lëndë kanë qenë brenda kufijve, që janë përcaktuar edhe me ligjin e vitit 1976 edhe me atë të vitit 2003. Prandaj *nuk mundet që me siguri të thuhet se një prej aplikantëve do të merrte dënim më të vogël* nëse do të zbatohej ligji i vitit 1976. (kursiv M.K.)

Prandaj, çështja e zbatueshmërisë së KP BeH të vitit 2013 ka mbetur e pazgjedhur para GJEDNJ. Megjithatë, jemi të mendimit se ekzistojnë shenja si në aktgjykim, kështu edhe në vendimet tjera të kësaj Gjykate[124], që ka shumë mundësi që zbatimi i saj në lëndë me rrethana ndryshe (ekzistimi i pasojave vdekjeprurëse), përkatësisht në lëndë ku do të ekzistonte mundësia e dhënies së dënimi me vdekje sipas KP RFSJ – nuk do të ishte domosdoshmërisht kundër Konventës. Me fjalë tjera, nga paragrafi i cituar më lartë, 69 mund të përfundohet se nëse drejtimi i dënimit të akuzuarit në fjalë sillet drejt minimumit ligjor, duhet që vendimin e ligjit më të butë të bëhet duke krahasuar minimumet ligjore të dy ligjeve. Në mënyrë të njëjte nëse drejtimi i dënimit do të ishte drejt maksimumit ligjor (p.sh. rastet më të rënda të krimeve të luftës ose gjenocid) vendimi për ligjin më të butë do të duhej të bëhej duke krahasuar maksimumet ligjore të dy ligjeve. Këtu GJEDNJ është afruar qartazi me praktikën e re të Gjykatës së BeH të zhvilluar pas vitit 2009, shiko bil.39). Vetëm një interpretim i tillë i qëndrimeve të GJEDNJ ka kuptim nëse e dimë se kjo Gjykate në Prill 2012, në të njëjtën pyetje në lëndën *Boban Šimšić kundër BeH* të dënuar para Gjykatës së BeH për krim kundër njerëzimit me zbatim të KP BeH të vitit 2003, ka gjetur se nuk ka shkelje të nenit 7 të Konventës. Për më tepër GJEDNJ ka gjetur që gjithmonë kur bëhet fjalë për krim kundër njerëzimit duhet të zbatohet KP BeH i 2003-tës duke marrë parasysh se KP RFSJ nuk ka paraparë një vepër penale të tillë. Secili interpretim tjetër i qëndrimeve te GJEDN do të thoshte se kjo Gjykatë avokon për zbatimin e kornizës së dënimeve nga 10 deri 45-vjet burgim vetëm për krime kundër njerëzimit, ndërsa kornizës së dënimeve prej 5 deri 15 përkatësisht 20-vjet për të gjitha veprat tjera të krimeve të luftës, duke përfshirë edhe gjenocidin si formën më të rëndë të krimeve kundër njerëzimit, e që është shumë pak e besueshme.Megjithatë çfarë duket si lëshimi më i madh i GJEDNJ është që çështjen qenësore të përcaktimit të kriterit për peshën dhe formën e krimeve e ka sjellë në një parametër që e përcakton – "humbje të jetës", e të cilin e përmend vetëm rastësisht (§69), dhe këtu



124 Shiko lëndën *Šimšić kundër BeH*, nr. 51552/10, Vendimi i 10.04.2012.

duket si shembull. Pra, kur Gjykata thelbin e qëndrimit të saj e ka sjellë deri të pesha e veprës së kryer, është dashur në të njëjtën kohë në mënyrë më të saktë të definojë parametrat me rëndësi për një vlerësim të tillë, që do të ishte si shembull për gjykatat dhe gjykatësit kur në praktikë të zbatojnë racionalitetin e këtij vendimi: e kjo është qasja individuale ndaj secilës lëndë. Përveç kësaj, GJEDNJ nuk ka bërë ndarjen në mënyrë të qartë dhe jo të dykuptimtë për këto çështje, por ka dhënë shpjegim afatshkurtër të qëndrimit të saj se ka ardhë deri të shkelja e Nenit 7 të Konventës, duke i kufizuar, ndoshta edhe tepër, në rrethanat e rastit konkret. Në këtë mënyrë është lënë hapësirë për interpretime diametralisht të kundërta të aktgjykimit, që kanë rrjedhur, duke përfshirë edhe atë që përshkon vendimet kontestuese të GJK BeH.

Reagimet në aktgjykimin e GJEDNJ, të cilat kanë dalë menjëherë pas miratimit, tregojnë edhe për saktësinë e kërkesave për paqartësitë e saj. Në hapësirën politikisht jostabile të BeH postkonfliktuoze, vendimi është pritur me deklarata ngadhënjimtare të politikanëve, të cilët vendimit i japin rëndësi shumë më të madhe se sa që i jap vetë Gjykata Evropiane. Larg jasht kontekstit të vendimit, në faqet e shtypit të BeH, në ditët e para pas vendimit kanë mundur të lexohen përmbajtjet e mëposhtme: *Radojičić: Kreso duhet të jap dorëheqje pas vendimit në rastin Maktouf*[125]*[...] Ai thotë se me këtë vërtetohet e gjitha çfarë kanë thënë përfaqësuesit nga RS "për anshmërinë, paaftësinë dhe jo profesionalizmin e Gjykatës së BeH dhe disa institucioneve"* (www.klix.ba,18.07.2013.), *Milorad Dodik, kryetar i RS, dje ka thënë se ky vendim i rëndësishëm është satisfakcion për përfaqësuesit e RS. "Nuk presim që dikush të na falënderohet, por në secilin rast kjo do të forcojë luftën tonë të deritashme politike kundër Gjykatës dhe Prokurorisë së BeH "* (Nezavisne novine, 19.07.2013), *Me vendimin e gjykatës Evropiane për krime luftë në Strasburg [...] është vërtetuar "prishja" e sistemit të drejtësisë në nivelin e BeH, ka deklaruar ushtruesi i detyrës i drejtorit të Qendrës për Hulumtimin e Luftës, krimeve të luftës dhe kërkimit të të humburve të Republika Srpskas, Milorad Kojić* ( www.klix.ba, 18.07.2013.), *Në komunikatën e BORS*[126] *thuhet se Gjykata BeH me gjykimin sipas Kodit Penal të vitit 2003 në mënyrë të qëllimshme po shkelë të drejtat e njeriut, dhe posaçërisht të drejtat e Serbëve. [...] Në BORS përmendin se sipas këtij ligji gjykohet vetëm sërbët dhe jo edhe kroatët ose boshnjakët* (www.klix.ba, 18.07.2013.), *Urgjentisht të hiqet nga fuqia Ligji për Gjykatën dhe Prokurorinë e BeH* (titull,www.pressrs.ba, 19.07.2013), *A do të hiqen Gjykata dhe Prokuroria e BeH?* (titull, Dnevni list, 2.08.2013), *Do të kërkojmë ndërrimin e Kresos dhe Salihoviqit* (titull, Dnevni avaz, 26.08.2013),[127]*PDP kërkon heqjen e Gjykatës së BeH* (titull, Oslobogjenje, 20.09.2013.)

Në këtë mënyrë, gjykatësit në media janë thirrë në përgjegjësi për shkak të vendimeve të tyre, në të cilat është zbatuar KP BeH, e që paraqet presion të paparë deri më atëherë në punën e tyre. Ndërsa ndërrimin e kryetares së Gjykatës së BeH e ka kërkuar edhe Kuvendi Popullor i Republika Srpskas.[128]

## II Vendimet e Gjykatës Kushtetuese që kanë pasuar pas Vendimit të GJEDNJ

Pas vendimit të GJEDNJ, kanë rrjedhë një varg vendimesh të GJK BeH lidhur me aplikimet, që janë mbledhur në këtë Gjykatë përgjatë viteve. Është e rëndësishme të përmendet se GJK e BeH për nga karakteri nuk është Gjykatë e rregulltë[129] e as që është e detyruar të vendosë sipas ankesës, si një mjet i zakonshëm juridik, në vendimet e gjykatave tjera. Megjithatë, duke pasur parasysh që BeH nuk ka Gjykatë Supreme, prandaj Gjykatës Supreme i është dhënë kompetenca e apelimit: që të vendosë për çështjet e drejtave të njeriut, të mbrojtura me ligj gjithmonë, kur ato bëhen objekt i diskutimit për shkak të aktgjykimit të cilësdo Gjykatë të BeH[130]



125 Igor Radojičić është kryetar Kuvendit Popullor të Republika Srpska. Medgjida Kreso është kryetare e Gjykatës së BeH.

126 BORS: Organizata Luftëtare e Republika Srpska.

127 Referohet në deklaratën e Staša Košarac, Shefit të Klubit të Sërbëve në Dhomën e Popullit të Kuvendit Popullor Parlamentar të BeH. Goran Salihović është kryeprokurori i BeH.

128 Shiko online portal www.buka.com te 29.10.2013, titulli: „Përfundim i Kuvendit Popullor të RS: Medgjida Kreso menjëherë të jap dorëheqje!", qasur 10.03.2014.

129 Gjykata Kushtetuese BeH përbëhet nga nëntë anëtarë – gjashtë janë qytetar të BeH, ndërsa tre të huaj. Gjykatësit vendorë zgjidhen nga parlamentet e entiteteve (katër anëtarë zgjidhen nga dhoma e përfaqësuesve e Federatës BeH, ndërsa dy nga Kuvendi i Republika Srpskas) ndërsa tre anëtarët tjerë, që nuk janë shtetas të BeH, i zgjedh kryetari GJEDNJ.

130 Neni VI 3 (b) Kushtetutes BeH.

Pas vendimit të GJEDNJ, të 18.07.2013, GJ BeH ka sjellë gjithsej nëntë vendime të aplikimeve të 13 personave, që janë dënuar para Gjykatës së BeH me zbatim të KP BeH. Në secilin aplikim, pa përjashtim, GJK BeH ka gjetur shkelje të nenit 7 të Konventës, indirekt ose direkt duke u thirr në vendimin e GJEDNJ, dhe ka hequr aktgjykimet e plotfuqishme të shkallës së dytë të Gjykatës së BeH, të cilat kanë të bëjnë me aplikantët e përmendur dhe ka urdhëruar sjelljen e vendimeve të reja, ashtu që në proceset e reja nuk duhet të shqyrtohet fajësia e tyre, por vetëm çështja e dënimit. Vetëm në seancën e mbajtur, më 22.10.2013, GJK BeH ka sjellë gjashtë vendime në lidhje me dhjetë persona, prej të cilëve gjashtë kanë dënuar për gjenocid dhe kanë qenë në mbajtje të dënimeve afatgjatë me burg në kohëzgjatje prej 28 deri 33-vjet burgim.[131] Është e qartë se në mesin e vendimeve të GJK gjenden lëndë që për nga situata dhe përmbajtja ligjore plotësisht i përshtatën lëndës *Maktouf dhe Damjanović kundër BeH* para GJEDNJ (sikur lënda *Damjanović Zoran,* Vendimi-AP 325/08 i 27.09.2013), por edhe lëndë që dallojnë shumë. Një prej këtyre lëndëve është pikërisht rasti *"Kravica",* në të cilin gjashtë persona janë dënuar për gjenocid në Srebrenicë për vrasjen e rreth 1000 personave në fermën bujqësore Kravico, e cila njëkohësisht sipas përshkrimit faktit të ngjarjes është krimi individual më i rëndë për të cilin Gjykata e BeH ka bërë lëndë. Shkurtimisht, GJK BeH në të gjitha lëndët edhe në ato me dënime të shqiptuara të burgimit afatgjatë, prej 21 deri 45-vjet , ka gjetur se, përveç tjerash, për shkak të faktit se dënimi me vdekje nuk ka mundur të ekzekutohet në kohën e gjykimit dhe në të gjitha lëndët, në periudhën prej 2005 e këtej, duhet të zbatohen parimet e mbetura të dënimit sipas KP RFSJ.[132]Me fjalë tjera, shohim se GJK BeH i bashkohet qëndrimit të gjykatave supreme të entiteteve në BeH, që në lëndët e krimeve të luftës është dhe duhet të implementohet ligji i "i cunguar" i RFSJ, pra mbetja e dënimeve ligjore pasi që hiqet dënimi me vdekje.

Një qëndrim i tillë, përveç kësaj që nuk mund të lidhet me përfundimet e GJEDNJ, dhe duke pas parasysh se i njëjti nuk është lëshuar në vendime për këso situatash hipotetike, përfaqëson një qëndrim të ri të GJK BeH, me të cilin distancohet nga qëndrimi i marrë më herët të shprehur në rastin *Maktouf:*

68. Në praktikë, në asnjë shtet të ish-Jugosllavisë në legjislacion nuk ka ekzistuar mundësia e shqiptimit të burgimit të përjetshëm e as dënimeve afatgjate me burgim e që Tribunali Ndërkombëtar Penal për hapësirën e ish-Jugosllavisë, shpesh e ka bërë (rasti *Krstiq, Galiq etj).* Në të njëjtën kohë, koncepti i KP RFSJ ka qenë i tillë që nuk ka parashikuar ekzistimin e burgimit afatgjatë e as të përhershëm, por për rastet më të rënda ka përshkruar dënimin me vdekje, ndërsa për format më të lehta ka paraparë dënim deri në 15-vjet burgim. Pra, është e qartë se nuk mund të ndahet një dënim në tërësi nga qëllimi që duhet të arrihet me politikën e dënimit në kohën e vlefshmërisë të këtij ligji.

Duke shikuar në aktgjykime, është e qartë se GJK për largim të një praktike e tillë të mëhershme nuk ofron asnjë sqarim. Në asnjërin prej lëndëve të sjella pas vendimit të GJEDNJ, nuk gjejmë arsye për ndryshim të qëndrimeve të cituara më lartë, e që është shumë me rëndësi duke pasur parasysh se, siç kemi treguar, GJEDNJ nuk është marrë vetëm më lëndët me dënime potenciale maksimale e as me ato që kanë pasë



131 Shiqo lëndët GJK BeH: Vendimi numër AP-4065/09 i 22.10.2013. (Jakovljević Sobodan –dënuar me 28-vjet për gjenocid, Đinić Brano – dënuar me 32-vjet për gjenocid, Radovanović Aleksandar – dënuar me 32-vjet për gjenocid, Branislav Medan – dënuar me 28-vjet për gjenocid); Vendimi nr. AP-4100/09 i 22.10.2013. (Milenko Trifunović – dënuar me 33-vjet për gjenocid); Vendimi numër AP 4126/09 i 22.10.2013. (Mitrović Petar –dënuar me 28-vjet burgim për gjenocid), Vendimi numër AP-503/09 i 22.10.2013. (Andrun Nikola – i dënuar me 18-vjet burgim krim lufte kundër popullatës civile); Vendimi nr. AP 116/09 i 22.10.2013. (Mirko [Mile] Pekez – dënuar me 29-vjet për krim lufte kundër popullatës civile); Vendimi nr. 2948/09 i 22.10.2013. (Milorad Savić – dënuar me 21-vjet për krim lufte kundër popullatës civile dhe Mirko [Špire] Pekez – i dënuar me 14-vjet për krime lufte kundër popullatës civile).

132 Shiko vendimin nr.AP 4100/09 i 22.10.2013. (aplikanti Milenko Trifunović), §47 – 48: „Gjykata Kushtetuese tregon se nga çfarë u përmend qartë arrihet në përfundim se në kohën e sjelljes së vendimit të kontestuar, që jnaë sjellë gjatë vitit 2008 dhe 2009, nuk ka ekzistuar as mundësia teorike e as praktike që ankuesit t'i shqiptohet dënimi me vdekje për këtë vepër penale. Duke marrë parasysh, pra që nuk ka qenë e mundur që ankuesit t'i shqiptohet dënimi me vdekje, shtrohet pyetja se cili është dënimi maksimal që ka mundur t'i shqiptohet ankuesit sipas KP RFSJ. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese tregon se sipas parimeve të Nenit 38 qëndrimi 2 KP RFSJ thuhet se 'për veprat penale, për të cilat është paraparë dënimi me vdekje, mund të jipet edhe dënimi me 20-vjet burgim'. Sipas mendimit të Gjykatës Kushtetuese, nga parimi ligjor, i cituar qartazi vjen deri te përfundimi se dënimi maksimal për veprën penale të lëndës, në rastet kur dënimi me vdekje nuk është i aplikueshëm, është dënimi me burgim prej 20-vjetësh"

pasoja të rënda të veprave, por në mënyrë eksplicite është distancuar nda sjellja e vendimeve në gjendje të tillë hipotetike. Shtrohet pyetje në çfarë mase pra vendimet e GJK, në të cilat në mënyrë të njëanshme i qaset zgjidhjes së aplikimeve për shkak të shkeljes së nenit 7 të Konventës, duke mundësuar që gjykatësit, në lëndët e ardhshme kur ballafaqohen me të njëjtën pyetje ligjore, në përgjithësi të mund të vlerësojnë rrethanat në secilën lëndë *in concreto,* duke pasë parasysh peshën e pasojave të veprës penale, që është racionalja e vendimit të GJEDNJ.

Vendimet e GJK BeH janë kritikuar ashpër nga ana e komunitetit profesional në BeH. Gjykatësit e njësisë së Apelit të Gjykatës së BeH Miletić Azra dhe Vučinić Hilmo, janë deklaruar në mediat e shkruara duke dhënë intervistë dhe opinione, dhe duke theksuar në mes tjerash, që "nga argumentimi i vendimit të gjykatës Evropiane mund të arrihet një përfundim ndryshe nga ai të cilin e jep Gjykata Kushtetuese.[133]

Një vështirësi tjetër e ka shkaktuar fakti se GJK BeH, e cila nuk ka karakter të gjykatës penale, ka hequr vendimet e plotfuqishme të shkallës së dytë të gjykatës penale, Gjykatës së BeH të sjella në instancën e fundit dhe "i ka kthyer" në rigjykim.[134] *Për dallim prej gjykatës Evropiane që vetëm në mënyrë deklarative ka gjetur shkeljet, duke mundësuar që sipas rregullave të ligjit për procedurën penale të BeH (Neni 327 KPP BeH) të përsëritet lënda sipas procedurës së shkruar – me qëllim të heqjes së shkeljes së gjetur, e cila mundëson edhe rritjen e privimit të lirisë ndaj personave të dënuar, vendimit të GJK kanë sjellë në dilemë komunitetin e drejtësisë. Ky fakt pasi që heqja e aktgjykimeve të plotfuqishme nga ana e GJK BeH është praktikë e pazakontë, e cila është në ndeshje me rregullat ligjeve të procedurës penale në BeH, sipas së cilës aktgjykimi nuk mund të hiqet për shkak të zbatimit të gabueshëm të drejtave nëse faktet janë vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe pasi që lënda që tash duhet të udhëhiqet nuk është i paraparë me KPP të BeH.*[135] *Megjithatë, vendimet e GJK BeH në secilën rast janë përfundimtare dhe të obligueshme, ndërsa moszbatimi i tyre mund të paraqet shkelje të KP BeH. Të gjithë ata kundër të cilëve janë dhënë aktgjykime të plotfuqishme nga ana e GJK BeH janë hequr, në mungesë të aktgjykimit dënues si bazë ligjore për privim nga liria dhe në mungesë të parimeve të qarta për përcaktimin e paraburgimit në situatë të tillë, në një afat shumë të shkurtër janë lënë të lirë nga mbajtja e dënimit, sipas vendimeve që i ka sjellë Gjykata e BeH. Lëndët kundër këtyre personave duhet të përsëriten në procedurë gjyqësore të pacaktuar që nuk parashihet me KPP BeH) në mënyrë që, duke mos prekur në fajësinë e tyre, të zbatohet KP RFSJ në përcaktimin e dënimit.*

Reagimi në këto, që i përmendem më lartë, ishte shumë i fortë. Në njërën anë, shoqatat e viktimave kanë qenë në mosbesim për shkak të asaj çfarë ndodhi, për çka tregojnë edhe titujt në shtyp: *Viktimat e zemëruara me lirimin e kriminelëve të luftës: Ky është shpërblimi për gjenocid* (ëëë. klix.ba, 19.11.2013), *Viktimat paketojnë valixhet dhe ikin nga Podrinja, Nëntitulli*: *Murtaja e drejtësisë; reagimet në lirimin e gjakpirësve* (Dnevni avaz, 20.11.2013). Bashkësia ndërkombëtare, poashtu ka shprehur pakënaqësinë e saj.



133 Shiko intervistën më gjykatësen Azra Miletić, në javoren *Dani,* botuar më 31.10.2013; dhe poashtu artikullin e Kryetarit të Njësisë së Apelit në Gjykatën e BeH, gjykatësit Hilmo Vuqiniq, "Pasiguri juridike, qëndrimi i marrë në aktgjykimin e Gjykatës Evropiane nuk ka mundur të zbatohet në të gjitha lëndët që pas këtij vendimi i ka zgjidhur Gjykata Kushtetuese", javorja *Dani,* botimi i 22.11.2013.

134 Nëpërmjet situatës së përmendur ka ardhur deri të shprehja problematike e përgjegjësisë së Gjykatës Kushtetuese, e cila nuk ka karakter penal e as të gjykatës së rregullt, anëtarët e së cilës nuk i zgjedhë Këshilli i lartë i Gjykatave dhe Prokurorisë së BeH, por parlamentet e entiteteve, por prapë në lëndët e përmendura kryejnë rolin e gjykatës penale të shkallës së fundit me kompetencë në heqjen e aktgjykimeve finale dhe të plotfuqishme, që janë sjellë në shkallën e fundit para gjykatës së rregullt. Kjo lidhet me mosekzistimin e Gjykatës Supreme të BeH por, GJK BeH pjesërisht e merr këtë rol.

135 Është e rëndësishme të theksohet se përgjegjësia e GJK BeH është e përcaktuar me Rregullat e GJK BeH, të cilat i miraton kjo Gjykatë dhe të cilat nuk kanë karakter ligjor. Kështu Rregullat e sjella, siç shihet nga rastet konkrete, kanë në praktikë karakterin e ligjit. Në rastin konkret, Rregullat e GJK BeH kanë qenë në ndeshje me Ligjet procedurale penale, që janë në fuqi në BeH, me të cilat po qese Gjykata më e lartë në procedurën ankuese gjen se ka ardhur deri të zbatimi i gabuar i ligjit, siç është shkelja e nenit 7 të KEDNJ, nuk heq vendimin e gjykatës më të ulët, por gjykata ankuese vetë sjell vendimin, pra modifikon vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Me fjalë tjera, në rastin e shkeljes së tillë nuk vjen deri te heqja e aktgjykimi dhe kthimi në riaktgjykim , siç ka bërë GJK BeH. Deri te heqja e vendimit mund të vijë vetëm nëse gjykata më e lartë gjen se në procedurën e kaluar faktet nuk janë vendosur në mënyrë te drejtë ose të plotë ose se ka ardhur deri te shkeljet serioze të parimeve të procedurës penale, shkelje e nenit 6 të Konventës, e që nuk ka qenë rasti në lëndët para GJK BeH. Prandaj vendimet e GJK BeH që në rastet konkrete vepron si një gjykatë e lartë në krahasim me Gjykatën e BeH, dalin nga rregullat e lartpërmendura të procedurës penale të legjislacionit të BeH, rregullat e njëjta vlejnë edhe në procedurat penale të Republika Srpska, Federatës së BeH dhe Distriktit të Brçkos së BeH), që sjell pasiguri në drejtësi.

Ministri i punëve të jashtme të Mbretërisë së Bashkuar Uilliam Hag në tekstin me titullin *Reagim i ashpër lidhur me lirimin e kriminelëve* (Dnevni avaz, 22.11.2013), ka deklaruar: „Kjo është e vështirë që të kuptohet ", duke ftuar në përmbajtje nga vendimet e ngjashme në të ardhmen. Në anën tjetër, është shumë brengosëse, dhe njëkohësisht edhe më së shumti prezentë në media ishin reagimet e zyrtarëve politikë nga RS, të cilët gjykatësit e Gjykatës së BeH, dhe sidomos kryetaren e Gjykatës, e kanë ftuar në përgjegjësi për shkak të zbatimit retroaktiv të ligjit. Krutan Simić, deputeti serb në Dhomën Popullore të Kuvendit Parlamentar të BeH, në seancën pas sjelljes së vendimit të GJK, e ka quajtur situatën "Anatema bosnjo-hercegovase e llojit të vet" duke u referuar për personat, të cilëve u janë hequr aktgjykimet, dhe cilët ende nuk ishin liruar nga burgu.[136] Zëvendësi i ministrit të drejtësisë, Srđan Radul, në deklaratën për gazetën ditore "Nezavisne Novine" të datës 11.11.2013, veprimet e Gjykatës së BeH i ka quajtur diskriminuese.[137] Të njëjtën ditë, në gazetën "Dnevni List" është botuar lajmi: *Kallëzim penal kundër gjykatësve Miletić dhe Babić, Dnevni List mëson se në gjykatën e Zhupanisë në Sarajevë është paraqitur kallëzim penal kundër gjykatëses Azra Miletić dhe gjykatësit Miloš Babić, pasi që në mënyrë jashtëligjore kanë mbajtur në burg të paktën 7-ditë, dhjetëra sërbë të liruar.* Më në fund, pasi që GJK BeH në Janar 2014 ka sjellë edhe një vendim të përafërt, mbi bazën e të cilit , i dënuari Novak Đukić, gjeneral i Ushtrisë së RS, i cili ka qenë në mbajtje të dënimit prej 25-vjetësh burgim për krime kundër popullatës civile në Tuzëll, poashtu është liruar duke ju falënderuar zbatimit të gabueshëm të ligjit, me këtë rast, figura më e lartë e këtij entiteti ka deklaruar se është plotësisht i bindur në pafajësinë e Gjukiqit.[138] Pra, përveç deklaratave të shumta që kanë lidhje me rrënimin e legjitimitetit të Gjykatës së BeH, ka filluar që në nivelin më të lartë politik të krijohet bindje sipas së cilës personat e dënuar për veprat më të rënda penale paraqiten si viktima, ku shkohet deri në atë masë sa ai të deklarohet i pafajshëm.[139]

Në këtë kaos medial, bashkësia ndërkombëtare në BeH ka reaguar ashpër me një deklaratë të përbashkët, të cilën e kanë dhënë Përfaqësuesi Special i BE në BeH, Ambasada e SHBA, dhe Zyra e Përfaqësuesit të Lartë në BeH, me anë të se cilës dënojnë sulmet në pavarësinë e gjyqësisë pas aktgjykimit:

Dënojmë tentimet që të kryhet presion politik dhe ndikim i papërshtatshëm në këto institucione, siç ka bërë Kuvendi Popullor i Republika Srpska, më 29 tetor të vitit 2013. [...] Vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut duhet të kuptohen si mjet për përparimin e bazës për mbrojtjen e drejtave të njeriut dhe lirive bazike në një shtet, dhe jo të përdorën për të rrënuar pavarësinë e gjyqësorit.[140]

Në fund, Komiteti i Ministrave në Këshillin e Evropës, si i ngarkuar për përcjelljen e zbatimit të aktgjykimeve të GJED-NJ, në mënyrë të shpejtuar ka sjellë vendimin e 05.02.2012.[141] Me anë të këtij vendimi janë ftuar gjykatat vendore në BeH që kur janë duke zgjedhur ankesa për shkak të shkeljes së Nenit 7, me rastin e vendimit se cili ligj është më i përshtatshëm për të akuzuarin, të vlerësojnë rrethanat e secilës lëndë individuale, duke përfshirë edhe rrethanat e peshës së secilës vepër të kryer. Poashtu, në vendim është theksuar se autoritetet vendore, pra gjykatat, duhet të marrin masat e nevojshme që të sigurojnë vazhdimin e paraburgimit për personat e dënuar deri te përsëritja e procedurës nga ana e



136 Titull: *Simić, Shkelje e vrazhdë e drejtave të njeriut*, gazeta ditore „Glas Srpske", 4.11.2013.

137 Titull: *Radulj, të analizohen veprimet e Gjykatës së BeH*, gazeta ditore „Nezavisne novine", 11.11.2013.

138 Gazeta ditore „Nezavisne novine", e 25-26.01.2014, *Novak Đukić në liri javën e ardhshme*.

139 Shiko deklaratën e Sonja Biserko, në artikullin *Kriminelët bëhen viktima të rrejshme!,* gazeta ditore "Dnevni Avaz" e 27.01.2014: "Sonja Biserko, kryetare e Komitetit të Helsinkit për të Drejta të Njeriut në Serbi, thotë se është problem se edhe pse gjykimet për krime lufte nuk kanë sjellë deri te ballafaqimi me atë se çfarë ka ndodhur në këto hapësira, nuk ka aspekt etik në krejt këtë. Kjo do të thotë se në shoqëri ende nuk është bërë dallimi në mes të keqes dhe të mirës. Gjykatat tona dhe Tribunali i Hagës ende nuk kanë ardh deri te ajo pikë që rajoni me ndihmën e këtyre gjykimeve të kthehet nga barbarizmi në një kontekst të civilizuar. Për këtë duhet kohë, por këto gjykime deri më tani është e qartë se nuk kanë treguar këtë dozë të efikasitetit – konsideron Biserko."

140 *Deklarata e zyrës së përfaqësuesit të lartë, Delegacionit të Bashkimit Evropian/ përfaqësuesit të posaçëm të BE në BeH dhe Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në BeH* e datës6.11.2013, http://www.ohr.int/ohr-dept/presso/pressr/default.asp?content_id=48277 (qasur 30.01.2014).

141 Vendimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, e sjellë më1186. Seancën e 5.12.2013, Lënda kundër BeH,DH-DD(2013)1161, qasur me 30.01.2014: https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=2135665&Site=CM&BackColorInternet=C3C3C3&BackColorIntranet=EDB021&BackColorLogged=F5D383.

Gjykatës së BeH, nën kushtet që paraburgimi i tyre të jetë në përputhshmëri me Konventën. Zyra e përfaqësuesit të lartë në BeH ka përkrahur vendimin, duke theksuar se vendimi i GJNDNJ nuk duhet të zbatohet në të gjitha lëndët njëjtë.[142] Megjithatë, iniciativat e tilla diplomatike nuk kanë pasur asnjë ndikim në qëndrimet e marra juridike.

Duke marrë parasysh se lirimi në liri i personave të dënuar ka tërhequr vëmendje e qarqeve ndërkombëtare, Zyra për ekzekutim e GJEDNJ ka ftuar takim urgjent në Strasburg, më 12.12.2012, ku është dashur të takohen gjykatësit e Gjykatës së BeH dhe GJK BeH. Mirëpo gjykatësit e Gjykatës së BeH nuk i janë përgjigjur kësaj thirrjeje. Kryetarja e Gjykatës së BeH, Meddžida Kreso ka deklaruar se në takim është theksuar në mënyrë të qartë „ se gjenocidi dhe lëndët e rënda të krimeve të luftës, për të cilat janë paraparë dënime maksimale, dalin plotësisht jashtë kornizës, me fjalë tjera se parimet e këtij aktgjykimi nuk mund të zbatohen në këto lëndë."[143]

E gjithë kjo, tregon qartë se ajo çfarë ka ndodhur në BeH, në asnjë mënyrë nuk ka qenë pasojë e paraparë e vendimit të GJEDNJ-së në lëndën *Maktouf dhe Damjanović kundër BeH.* Prapë, deri te këto pasoja ka ardhur si rezultat i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i vendimit të GJEDNJ. Duket se çështjes së problemit kompleks të zbatimit të parimit të legalitetit në veprat penale të krimeve të luftës, është dashur që t'i qaset nga një qëndrim më gjithëpërfshirës nga ai të cilin ka marrë GJK e BeH dhe atë edhe nga të drejtat tjera të mbrojtura me konventë, përveç të drejtave nga Neni 7, dhe ato janë në mes tjerash e drejta për jetë, mbrojtje prej torturës, mbrojtje të jetës private dhe familjare dhe të drejta tjera, të cilat duhen të mbrohen nëpërmjet dënimit efektiv të sulmeve më të rënda në këtë to drejta. Por, këto pyetje do të mbeten të hapur për diskutime tjera profesionale



## B Nismat problematike politike që thirren në aktgjykimin *Maktouf dhe Damjanoviq Kundër BEH*

### 1. Ndryshimi i Ligjit të procedurës penale në BeH

Jo gjatë, pas marrjes së vendimit të GJEDNJ, në Kuvendin Parlamentar të BeH është nisur një iniciativë për ndryshimin e nenit 327 të KPP BeH. Në këtë nen definohen mjetet e jashtëzakonshme të përsëritjes së procedurës penale në përfitim të akuzuarit, i cili në mes tjerash përcakton:

(1) Procedura penale e mbyllur me aktgjykim të plotfuqishëm mund të përsëritet në përfitim të akuzuarit: [...]

f) nëse Gjykata Kushtetuese e Bosnje e Hercegovinës, Dhoma për të Drejta të Njeriut ose Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vërtetojnë se gjatë lëndës janë shkelur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore edhe nëse aktgjykimi është bazuar në këto shkelje.

Një rregullim i tillë i tekstit ekzistues të ligjit në mënyrë shumë kufizuese, siç edhe i përshtatet natyrës së kësaj mase të jashtëzakonshme, i mundëson të akuzuarit përsëritjen e procedurës të përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm, kur aktgjykimi kundër tij është bazuar në shkelje të drejtave të njeriut, që vërtetohet në aktgjykimin e organeve të lartcekura për mbrojtjen e drejtave të njeriut. Me qasje kufizuese në zbatimin e kësaj mase ligjore, ruhet siguria juridike, që nënkupton në thelb respektimin e vendimeve përfundimtare gjyqësore të sjella me procedura të ligjshme dhe vetëm rrallë ato të hetohen. Propozimi për ndryshimin e tërë nenit përbëhet nga shtimi i tekstit në fund të pikës f) që ai të tingëllojë kështu:

f) nëse Gjykata Kushtetuese e Bosnje e Hercegovinës, Dhoma për të Drejta të Njeriut ose Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vërtetojnë se gjatë lëndës janë shkelur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore edhe nëse aktgjykimi është bazuar në këtë shkelje në mënyrë që këtë të drejtë ta kenë edhe të dënuarit tjerë në lëndët për të cilat gjykata Evropiane nuk ka diskutuar

Një rregull e definuar në këtë mënyrë do t'i jepte të drejtë për masë të jashtëzakonshme ligjore një rrethi të pakufizuar të subjekteve. Me fjalë tjera, praktikisht kushdo i pakënaqur kundër të cilit, në mënyrë të plotfuqishme është mbyllë çfarëdo procesi gjyqësor, para Gjykatës së BeH do të kishte të drejtë që nga gjykata të kërkojë përsëritjen e procedurës dhe gjykata do të duhej ta shqyrtonte një propozim të tillë.

142 *OHR për zbatimin e aktgjykimit* Maktouf-Damjanović, portali www.vijesti.ba, 11.12.2013: „Komiteti i ministrave, që kryen mbikëqyrjen e zbatimit të vendimit të GJEDNJ me këtë ka konfirmuar edhe njëherë se aktgjykimi në lëndën *Maktouf i Damjanović* nuk duhet zbatuar ashtu që përmbajtja e saj të zbatohet në secilën lëndë të krimeve të luftës, por, secilin rast individual duhet analizuar në mënyrë të kujdesshme nga ana e ligjit gjithashtu nën dritën e peshës së veprave penale specifike."

143 Gazeta Javore „Dani", *Ligji dhe gjyqësori*, Vuk Bačanović, 20.12.2013.

Në këtë mënyrë, në tërësi do të ndryshohej karakteri i rregullës dhe do të ndryshohej qëllimi i saj. Do të thotë, masa e jashtëzakonshme ligjore, e cila zbatohet me përjashtim do të merrte karakter të masës së rregullt ligjore pa kurrfarë kufizimi në subjekte ose afate për shtrim të kërkesës. Në të njëjtën kohë me këtë hiqet kuptimi i ekzistimit të masave të rregullta ligjore dhe afateve të përcaktuara për to, në çka hyn edhe drejtimi tek Gjykata Kushtetuese ose gjykata Evropiane, me çka në tërësi rrënohet regjimi i tërësishëm i masave ligjore, i rregulluar në të drejtën procedurale penale dhe kështu edhe rëndi ligjor.

Përveç të përmendurave, dobësi e dukshme e propozimit, ajo që më shumë shqetëson, është se propozimi, gabimisht bazohet në vendimin e GJEDNJ në lëndën *Maktouf dhe Damjanović kundër BeH.* Në këtë aktgjykim është vërtetuar së shkelja e Nenit 7.1 të Konventës në lidhje me dy aplikuesit, që të dënuarve në këto lëndë u jep të drejtë që në bazë të pikës f) Neni 327 të kërkojnë nga gjykata përsëritje të procedurës. Në rastet konkrete, dy të dënuarit edhe e kanë bërë këtë, ndërsa Gjykata e BeH pas shqyrtimit i ka pranuar kërkesat dhe ka përsëritur procedurën, edhe pse as përsëritja si e tillë nuk është e detyrueshme me ligj.[144] Propozimi për ndryshimin e nenit 327 ka kaluar procedurën e miratimit në Dhomën Popullore në Kuvendit Parlamentar të BeH, por më tej dy herë ka marrë notë negative nga Komisioni Kushtetues në Kuvendin Parlamentar.

**Ndryshimi i ligjit për faljen në BeH**

Në dhjetor 2013, në rendin e ditës së Këshillit të Ministrave të BeH është vendosur propozimi i ndryshimit të Ligjit shtetëror për faljen në BeH, i cili pas aprovimit nga ky këshill është dashur të shkojë në procedurë parlamentare për aprovim. Me ndryshime propozohet fshirja e dispozitës së tashme, e cila e ndalon dhënien e faljes për veprën penale të krimeve të luftës, krimit kundër njerëzimit dhe gjenocidit. Në arsyetimin zyrtar të propozim tekstit të ligjit gjithashtu bëhet referim i gabuar në GJEDNJ në rastin *Maktouf dhe Damjanović kundër BeH,* si bazë për ndryshimin e ligjit. Me këtë thuhet se parimi i ndalimit të përdorimit retroaktiv të kodit penal, që përmendet në aktgjykim, zgjatet edhe në ligjin e faljes, i cili është aprovuar në vitin 2005, e i cili në kohën e kryerjes së veprave nuk ka pasur dispozitën, e cila e ndalon faljen për gjenocid, krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit. Megjithatë është e qartë se parimi i ndalimit të zbatimit retroaktiv të kodit penal ka të bëjë me dispozitat materiale të kodit penal, me të cilin definohen elemente të veprës penale dhe dënimit penal të parapara për këtë vepër. Dispozitat për faljen nuk kanë karakter të dispozitave penale, kështu që në to nuk mund të aplikohet parimi i ndalimit të retroaktivitetit. Prandaj është plotësisht e gabueshme të flitet për ndryshimet e propozuara të ligjit për falje me detyrimet e përmendura, që dalin nga implementimi i aktgjykimit *Maktouf dhe Damjanović kundër BeH.* Ekziston një pajtim i gjerë në planin ndërkombëtar, që shtetet nuk mund të amnistojnë ose të falin të akuzuarit për krime, nëse një shkelje e tillë paraqet shkelje të njëmendta të detyrimeve të shtetit sipas të drejtës ndërkombëtare. Në mes tjerash, me Konventën për gjenocidin, për të cilën BeH është nënshkruese, qartë definohet obligimi e dorëzimit ose procedimit të të akuzuarve për shkelje të rënda të Konventës. Propozimi përkohësisht është hequr nga rendi i ditës i Këshillit të Ministrave të BeH dhe ende nuk është shqyrtuar

## II Përfundim

Është e qartë nga analiza e mëparshme se çështja e vlefshmërisë kohore të ligjeve penale në BeH ka pasur rol të madh në proceset e pajtimit në BeH, kur është në pyetje procedimi i përgjegjësve për krime lufte. Gjithashtu është e qartë se aktgjykimi skematik i GJEDNJ ka tronditur proceset e pajtimit në BeH të bazuara në drejtësinë gjyqësore. Pikërisht për shkak të kësaj, ka pasur pritje të mëdha nga GJEDNJ, që kjo çështje të zgjidhet në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të pahamendur për të gjitha lëndët e krimeve të luftës. Megjithatë, edhe pse pa dyshim që ka pasur mundësinë që të bëjë këtë, GJEDNJ, pa arsye të qarta ka zgjedhur rrugë tjetër. Ka qenë e vlefshme që me shumë kujdes dhe precizitet t'i qaset çështjes së ndjeshme të ligjit të zbatueshëm dhe me vetë këtë edhe çështjes së dënimeve të përshtatshme për format më të rënda të shkeljeve të drejtave të njeriut të kryera gjatë luftës në BeH, e që mbrojtës suprem i tyre është pikërisht Gjykata Evropiane në Strasburg.

Posaçërisht, ngatërruese është fakti se lënda *Maktouf dhe Damjanović kundër BeH* është shqyrtuar para Këshillit të Lartë të GJEDNJ, dhe jo Këshillit të Ulët, i cili e ka pranuar së pari. Këshilli i Ulët, të cilin e përbëjnë 5 gjykatës të kësaj gjykate ka hequr dorë nga juridiksioni në të mirë të Këshillit të Lartë, që përbëhet nga 17 gjykatës, me të cilat udhëheq kryetari i GJEDNJ. Lëshimi i përgjegjësisë ndaj Këshillit të Lartë bëhet në raste komplekse dhe shumë të

144 Një prej lëndëve të përsëritura ka përfunduar (me aktgjykim të 13.12.2013. – lënda *Damjanović*), ndërsa i dyti (lënda *Maktouf*) ende. Me këtë është zbatuar aktgjykimi i Gjykatës Evropiane në rastin*Maktouf dhe Damjanović kundër BeH.*

rëndësishme, që tregojnë për çështje të rëndësishme lidhur me interpretimin e të drejtave nga Konventa dhe protokollet e saj.[145] Lëshimi i lëndës *Maktoud dhe Damjanović kundër BeH,* poashtu ka treguar se ka mundur të jetë fjala për të ashtuquajturin pilot rast, e që është termin i rezervuar për lëndët, që reflektojnë problem specifik të sistemit, pra, shkelje sistematike të drejtave të njeriut, në numër të madh të lëndëve të njëjta në një shtet të caktuar. Në lëndë të tilla, roli i GJEDNJ nuk është vetëm të vendosë nëse ka ardhur deri te shkelja në një rast specifik por, që të identifikojë një problem të sistemit dhe që shtetit t'i japë udhëzime të qarta në kuptimin e masave, që duhet ndërmarrë që ky problem të anashkalohet.[146] Megjithatë në deklarimin e parë në ditën e dhënies së aktgjykimit me 18.01.2014 GJEDNJ e ka bërë të qartë se aktgjykimit nuk i jep një karakter të tillë. Vetë teksti i aktgjykimit gjithashtu, pa dyshim tregon se çështja e të gjitha pyetjeve për drejtësinë e BeH (zbatimi retroaktiv i ligjit) është sjellë në një transmetim të ngushtë me zbatim të kufizuar, pa diskutim të gjerë lidhur me implikimet për lëndët tjera.

Megjithatë, edhe pse GJEDNJ ka zgjedhur që lëndës të mos i japë një rëndësi të madhe në mënyrë që të trajtojë si lëndë sistemuese, gjë që u kundërshtua nga shumë ekspertë vendorë[147], është e pakundërshtueshme që bëhet fjalë për aktgjykim me rëndësi të madhe për BeH. Pasojat katastrofale, që kanë ardhë në vetëm disa muaj nga miratimi i vendimit të Gjykatës Evropiane e kanë vërtetuar këtë, ndërsa zhvillimi i ngjarjeve para aktgjykimit të GJEDNJ është dëshmi e mangësive të saj, pra paqartësisë. Përderisa të gjithë faktorëve relevantë, në dhe jashtë BeH, iu kanë qenë të njohura qëndrimet e kundërta të Gjykatës së BeH dhe gjykatave të entiteteve lidhur me zbatimin e ligjeve në lëndët e krimeve të luftës, ndërsa brenda, lidhur me këtë fakt ka qenë e shprehur në gati secilin raportim relevant lidhur me drejtësinë në BeH, GJEDNJ ka refuzuar ta zgjidhë dilemën. Gjykata si organ i Këshillit të Evropës është mbrojtës suprem i drejtave të njeriut, të cilat më së shumti rrezikohen gjatë konflikteve të armatosura, është dashur të tregohet më e gatshme që të përballet me çështjen e rëndësishme të drejtës tranzicionale në BeH, të marrë përgjegjësinë e plotë për atë, për të cilën vendos dhe të përballet me esencën e çështjes, të cilën, pikërisht e ka nisur kjo lëndë. Ndërsa esenca e kësaj çështje mund të sillet deri te: a mundet që KP BEH i ri dhe bashkëkohor të zbatohet ndonjëherë në veprat penale të krimeve të luftës, të cilat nuk janë të kualifikuara si krim kundër njerëzimit dhe se a mundet që ky KP të zbatohet në raste të caktuara, ndër më të rëndët, të cilat në kornizën e dënimeve pa dyshim që janë drejt maksimumit ligjor, siç është rasti i krimit të gjenocidit në Srebrenicë. Me fjalë tjera GJEDNJ do të duhej të përgjigjej në pyetjen nëse zbatimi i ligjit të "cunguar" të RFSJ, pra mbetjes së kornizës dënuese pas heqjes së dënimit me vdekje, në këto lëndë, potencialisht do të ishte kundër parimeve që KEDNJ ka për bazë si dhe sisteme të mbrojtjes së drejtave të njeriut të Konventës. Në mes të tyre, mbi të gjithat është e drejta në jetë, e cila mbrohet me dënime efikase e jo simbolike për sulmet më të rënda në të. A mund të konsiderohet se një zbatim i tillë i ligjit është kundër obligimeve pozitive të shtetit? Nga praktika e deritanishme e GJEDNJ, siç është treguar më lartë, duket se përgjigja në këtë çështje ka mundur të jetë pozitive, por pas vendimit në lëndën *Maktouf dhe Damjanović kundër BeH* e gjitha ka mbetur vetëm spekulim. GJEDNJ ka zgjedhur rrugën më të lehtë dhe më formale, duke u kufizuar, mund të thuhet, shumë në rrethanat e rastit konkret, duke lënë që pyetjet më të rëndësishme të shtruara të zgjidhen në aplikimin e dikujt tjetër. Me këtë është hapur rruga për interpretim diametralisht të kundërt të aktgjykimit. Gazetarja e nderuar dhe ish-redaktorja e portalit *BIRN Justice Report,* Nidžara Ahmetašević, e ka përshkruar situatën me këto fjalë: "Çdo gjë do të ishte në rregull me këtë vendim, vetëm nëse gjykatësit në Strasburg do të kujtoheshin të ngrinin kokën pak jashtë ligjit të zbrazët dhe të shikonin për pasojat që një vendim i tillë mund t'i ketë për shtetin e më së shumti për viktimat, e ky është pothuajse secili qytetar i BeH, pasi që të gjithë jemi të prekur me ngjarjet e luftës në një mënyrë ose tjetrën, të cilëve edhe ashtu besimi në drejtësi u është rrënuar seriozisht."[148]

Është paralajmëruar që viktimat do të parashtrojnë aplikim



145 Rregulla 72 Rregullores GJEDNJ.

146 Rregulla 61 e Rregullores së GJEDNJ; shiko poashtu deklaratën – dokumentin e GJEDNJ "Pilot Judgements" që është e qasshme në http://www.echr.coe.int/Documents/FS_Pilot_judgments_ENG.pdf (qasje 30.02.2014.).

147 Shiko deklaratën e Liljana Mijoviq, ish gjykatëse e GJEDNJ, e cila në deklaratën e transmetuar në TV e Federatës së BeH, emisionin *Drejtë* të datës 02.12.2014, ka deklaruar se bëhet fjalë për aktgjykim, që tregon problem të sistemit dhe rëndësin e së cilës e ka përshkruar më lëndën *Sejdić Finci kundër BeH*, në të cilën GJEDNJ ka vërtetuar shkelje të drejtave të njeriut në dispozitat e Kushtetutës së BeH.

148 Online portal *Buka*, „Ligj pa drejtësi", Nidžara Ahmetašević, 18.11.2013. (http://www.6yka.com, qasur me 1.3.2014).

tek e njëjta Gjykatë (GJEDNJ) pikërisht për shkak të shkeljes së drejtave të tyre, pra, për shkak të vendimit të GJK BeH dhe Gjykatës së BeH.[149] Sipas deklaratës së kryetares së Shoqatës "Lëvizja e nënave të enklavave Srebrenica dhe Zhepa", viktimat do të kërkojnë mbrojtje sipas Nenit 3 të Konventës, e cila lidhet me mbrojtjen e viktimave nga tortura.[150] Por fundi i këtyre lëndëve eventuale do të mund të priste edhe pesë vite, e deri atëherë proceset që janë ndërtuar me mund përgjatë viteve do të dëmtohen afatgjatë dhe do të njollosej kredibiliteti i procedurave gjyqësore të përfunduara në BeH.

Si pasojë direkte ose indirektë të aktgjykimit të GJEDNJ, 13 persona të dënuar plotfuqishëm për krime të rënda të luftës, në mes të cilëve edhe gjashtë të dënuar për gjenocid, gjinden në liri dhe me këtë rast fajësia e tyre assesi nuk sillet në pikëpyetje. Është e qartë që dënimet e tyre afatgjata me burgim do të zvogëlohen në më pak se 20-vjet burgim. Është e sigurt që në mes të viktimave të krimeve të kryera në luftën në Bosnje dhe Hercegovinë, para së gjithash viktimave të gjenocidit në Srebrenicë, por edhe në tërë komunitetin mbretëron gjendje e fyerjes dhe mosbesimit në punën e gjykatave e sidomos asaj shtetërore. Kryetarja e Shoqatës "Nënat e enklavave Srebrenica dhe Zhepa", Munira Subašić në deklaratën e dhënë pas lirimit të dënuarve për gjenocid ka thënë: "Kjo çfarë ka ndodhur është edhe sulm në shtetin. Unë kam dëshmuar dhe përsëris që më nuk do të gjykojë në gjykatat tona ".[151] Besimi i viktimave është luhatur deri në atë masë që është e vështirë e imagjinueshme që prapë mund të kthehet. Kryetarja e Shoqatës "Nënat e Srebrenicës" Hatidža Mehmedović, duke komentuar lirimin e personave të gjykuar ka deklaruar: "Kjo është shpërblim për kriminelët. I lirojnë kriminelët e me mijëra ende nuk kanë dalë para ligjit e shumë nga më të dashurit tanë ende nuk janë gjetur. Kjo duhet t'i brengosë të gjithë. Kjo është vetëm mënyrë që të dënohet viktima. Pa drejtësi nuk ka ardhmëri e as shtet. Zoti u gjykoftë".[152]

Përfundimisht, si rezultat i drejtpërdrejt ose indirekt i praktikës së GJEDNJ dhe interpretimit të GJK BeH, në BeH për momentin është KP bashkëkohore e 2003-tës, e cila është rezultat i shumë përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare në BeH, dhe miratimi i së cilës ka qenë kusht për braktisjen e lëndës nga TPNJ të Bosnje dhe Hercegovinës, faktikisht i zbatueshëm vetëm në lëndët, të cilat kanë të bëjnë me kualifikimin si krim kundër njerëzimit, ndërsa për të gjitha rastet tjera të krimeve të luftës, duke përfshirë edhe gjenocidin, mund të zbatohet vetëm KP RFSJ. Kur dimë se kjo nënkupton kornizë tërësisht tjetër të dënimeve, pra nga 10 deri 45-vjet për krim kundër njerëzimit dhe nga 5 deri 20-vjet për gjenocid, nuk është e vështirë të shihet se sa janë tektonike lëvizjet e aktgjykimeve dhe ky shqyrtim që e kanë futur në sistemin e sanksioneve penale duke e bërë tërësisht i papajtueshëm.

Në praktikë kjo sjell edhe deri te kalkulime potenciale, posaçërisht në anën e prokurorëve, për atë që në lëndën konkrete të përcaktohet për një kualifikim më të rëndë juridik, gjenocid, kur për këtë ka baza nga rrethanat e rastit, ose të sigurojë dënim më të rëndë duke zgjedhur kualifikimin krim kundër njerëzimit edhe me çmimin e vendosjes të së vërtetës gjyqësore adekuate, që përshtatet me faktet. Kjo gjithsesi është zgjidhje e rëndë ku prokurori çështjen e ligjit dhe të drejtësisë e vlerëson sipas parimeve të veta, pasi që sistemi i drejtësisë, që përfshinë edhe praktikën e ndërtuar gjyqësore, nuk ka siguruar mekanizma të arritjes së drejtësisë e as mekanizma të marrëdhënies së njëjtë ndaj të akuzuarit. Kjo është poashtu edhe rrugë e gabuar, në të cilën në vend të vendosjes së sistemit të vlerave dënimi i kërcënuar reflekton peshën e veprës penale, ajo vendos sistem të pamoralshëm shoqëror dhe gjyqësor në të cilën pjesëmarrësit e veprave tentojnë të dëshmojnë që vepra penale e kryer është më e rëndë në mënyrë që të nxjerrin dënim më të butë. Kjo më së miri ilustron deklaratën e avokatëve, të cilët përfaqësojnë



149 Online portal *Glas Bosne*, 21.11.2013, „Viktimat nga Srebrenica do të paraqesin ankesë në Gjykatën e Strazburgut", (www.glas-bosne.com, qasur me 1.3.2014).

150 Deklaratë për agjencinë *Anadolija* i Munira Subašić, kryetare e Shoqatës "Lëvizja e nënave të Srebrenicës dhe Zhepës" portali online informativewww.tuzla.danas.info, 20.11.2013 (qasur me 1.03.2014): „Do të kërkojmë që, duke u thirrë në Nenin 3 të Konventës Evropiane, e cila lidhet me mbrojtjen e viktimave nga tortura, të anulojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të BeH, në mënyrë që kriminelët, të cilët ende janë kërcënim për viktimat mos të mund të lirohen. Ne viktimat të cilët kemi qenë edhe dëshmitarë në gjykata kemi pas probleme dhe kërcënime gjatë gjykimit, përkatësisht para lëshimit të kriminelëve, dhe posaçërisht do t'i kemi edhe tash. Poashtu, kërkojmë dorëheqjen e gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese që kanë marrë këtë vendim të nxituar dhe të turpshëm."

151 Gazeta Ditore *Oslobogjenje*, 19.11.2013. „Viktimat e zemëruara me lirimin e kriminelëve të luftës: Kjo është shpërblim për gjenocid, nënat nga frika do të shpërngulen nga Srebrenica" (nëntitull "Viktimat e krimeve të luftës dhe gjenocidit në Bosnje dhe Hercegovinë janë shokuar me vendimin e djeshëm të Gjykatës së Bosnjës dhe Hercegovinës që të ndalojë mbajtjen e dënimeve për dhjetë kriminelë të luftës të dënuar").

152 *Ibid.*

disa të akuzuar para Gjykatës së BeH: "Pra paramendoni deri sa kemi ardh deri te absurdi që t'i lutemi Zotit që të dënohet për gjenocid, dhe jo për krim kundër njerëzimit."[153] Së fundmi një vendosje e tillë e së vërtetës gjyqësore, e cila ndoshta edhe nuk do të jetë e motivuar ekskluzivisht me fakte të rastit specifik, por edhe me faktorë tjerë të përcaktuar nga parregullsitë e përmendura, e që do të mund të ndikojnë në tregimin historik të karakterit të krimeve, që kanë ndodhur në Bosnje dhe Hercegovinë, si një element i rëndësishëm në procesin e ballafaqimit me të kaluarën.



153 Deklarata e avokatit Miodrag Stojanović në artikullin "Absurdi në drejtësinë e BeH: Sa më e rëndë vepra, aq më i rëndë dënimi", slobodnaevropa.org, 8.03.2014, qasur në 10.03.2014.

# Mediat dhe mohimi

Dejana Nešić

*Më duket se sot ka mbetur i pari dhe i vetmi parim i të menduarit (dhe letrar-kulturor)i patriotizmit tonë: mos të mendojmë asgjë, t'i ndryshojmë faktet, t'i interpretojmë gabimisht të vërtetat më themelore, të shpërndajmë gënjeshtra, të ribëjmë kultin e frazave të zbrazëta, shkurtimisht të bëjmë atë që i kundërshtohet edhe shijes më primitive të mendjes së shëndoshë.*

Miroslav Krleža, "Rishikim letrar" (citati hyrës nga romani *Kultura e gënjeshtrës* të Dubravka Ugrešić, "Arkzin", Zagreb, 1996)

**Për gjenocidin.**

Në verën e 1991[154], Ushtria e Republika Srpskas ka hyrë në Srebrenicë, qytet në Bosnjën lindore, zonë e mbrojtur nga ana e Kombeve të Bashkuara. Ka vrarë më shumë se 8000 meshkuj dhe djelmosha të nacionalitetit boshnjak për vetëm disa ditë. Nëntë vite më vonë, Dhoma Gjyqësore e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) në rastin kundër gjeneral Radislav Krstić ka definuar këtë masakër si gjenocid.[155]

Plani i udhëheqjes politike dhe ushtarake të boshnjakëve serbë ka qenë që të dëbojë popullatën myslimane nga Srebrenica, si dhe që të gjithë meshkujt e aftë fizikisht nga Srebrenica të vriten. Me dhjetë dhe njëmbëdhjetë korrik 1995, duke ikur nga ushtria e boshnjakëve serbë, rreth 25 dhe 30 mijë boshnjakë myslimanë, kryesisht gra dhe fëmijë, por edhe meshkuj nga enklavat, kanë ikur në Potoqare afër Srebrenicës, ku ka qenë e vendosur baza e Kombeve të Bashkuara, duke kërkuar mbrojtje nga forcat e UN-it. Në të njëjtën kohë, duke vendosur që mos të lëshohen në mëshirë të forcave ushtarake serbe, rreth 15000 meshkuj boshnjakë kanë lëshuar territorin e Srebrenicës, duke u munduar të depërtojnë në territorin e kontrolluar nga ushtria boshnjake. Në ditët e ardhshme, ushtria e boshnjakëve serbë, së pari i ka ndarë rreth 1000 meshkuj nga gratë dhe fëmijët në Potoqare, duke i lejuar gratë dhe fëmijët që të shkojnë në Tuzëll, dhe pastaj ka zënë robërrreth 6000 meshkuj nga



154 Lufta në Bosnje dhe Hercegovinë ka zgjatur gati katër vjet, nga 1992 deri 1995, dhe për pasoja ka pasur gati 100.000 të vrarë dhe të zhdukur dhe gati 2-milion refugjatë dhe të zhvendosur.
Kampet e përqendrimit kanë qenë të vendosura në tërë territorin e Bosnje dhe Hercegovinës, dhe në to meshkujt, gratë dhe fëmijët janë zënë robër dhe mbajtur në kushte më johumanet, të nënshtruar trajtimit të vrazhdë, torturës dhe dhunës seksuale joselektive.
Në Bosnjën Lindore, territor i cili kufizohet me Republikën e Serbisë, pastrimi etnik i popullatës boshnjake myslimane është kryer me qëllimin që të dëbohen boshnjakët myslimanë edhe pse kanë qenë shumicë e popullatës në komunat kryesore të kësaj hapësire. Në qytetet Vishegrad dhe Srebrenicë, ku boshnjakët myslimanë kanë përbërë 60% të popullsisë para luftës, pas luftës së 1997 thuaja se nuk kanë ekzistuar.

155 *Prokurori kundër Radislav Krstić,* Aktgjykimi i Dhomës së Apelit, 19 Prill 2004, IT-98-33-A.

kolona, e cila po mundohej të arrijë deri te territoret boshnjake. Vrasjet sistematike dhe masovike të meshkujve dhe djemve boshnjakë të zënë robër kanë filluar më 13 korrik dhe kanë vazhduar deri në fund të korrikut të vitit 1995. Trupat e tyre janë varrosur në lokacione të shumëta në tërë territorin e Bosnjës Lindore nën kontrollin e ushtrisë së boshnjakëve serbë. Në muajt pasardhës, duke tentuar që të mbulojnë gjurmët e krimeve, shumë varreza masive janë zhvarrosur me qëllim që trupat të varrosen në lokacione tjera të fshehta. Për këto krime, shumë liderë politikë dhe ushtarakë të boshnjakëve serbë janë proceduar dhe dënuar para TPNJ-së. Sidoqoftë disa komandantë, me grada të larta dhe udhëheqës politikë nga Serbia, kanë qenë poashtu të akuzuar për gjenocid në Srebrenicë; më i rëndësishmi nga të cilët ka qenë Slobodan Milošević, ish-kryetar i Serbisë dhe Jugosllavisë dhe Momčilo Perišić, komandant i Gjeneral Shtabit të Ushtrisë së Jugosllavisë.

Për më shumë, në vitin 2007, 14-vjet pas gjenocidit, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë, duke vepruar në rastin e Bosnje dhe Hercegovinës kundër Serbisë dhe Malit të Zi për tentimin e shfarosjes së popullatës boshnjake myslimane të Bosnje dhe Hercegovinës ka gjetur se edhepse Serbia nuk ka qenë në mënyrë të drejtpërdrejtë përgjegjëse për gjenocid e as që ka marrë pjesë në të, ajo ka qenë përgjegjëse pasi që nuk ka mundur të parandalojë gjenocidin, si dhe se nuk ka bashkëpunuar me TPNJ në dënimin e kryerësve të gjenocidit, duke përfunduar se Serbia ka shkelur Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Gjenocidit.



## Konteksti dhe arsyet e miratimit të Deklaratës

Në janar 2009, Parlamenti Evropian ka miratuar rezolutën me të cilën thërret institucionet e Bashkimit Evropian që të shënojnë ditën e përvjetorit të gjenocidit në Srebrenicë me miratimin e datës 11 Qershor, si Ditë e komemomaracionit të gjenocidit në Srebrenicë në të gjithë BE-në, por fillimisht duke ftuar shtetet e Ballkanit Perëndimor, që ta bëjnë këtë. Duke ndjekur këtë iniciativë, në fillim të vitit 2010, ish-presidenti i Serbisë, Boris Tadić, i ka propozuar Qeverisë së Republikës së Serbisë që të miratojë Deklaratën për dënimin e krimeve të kryera në Srebrenicë. Për Deklaratën është diskutuar në mbledhjen e Qeverisë më 30 mars të vitit 2010.

Nuk është befasuese që një propozim i tillë ka arritur në këtë moment. Mungesa e dedikimit të Serbisë në bashkëpunim me TPNJ-në dhe mosgatishmëria e saj që të arrestojë të arratisurit e tjerë të Hagës kanë shkaktuar një hap serioz prapa në procesin e integrimeve evropiane. Bashkëpunimi me Tribunalin e Hagës ka qenë e rëndësisë primare për Holandën, e cila më parë ka parandaluar vazhdimin e procesit të euro-integrimeve të Serbisë derisa shumica e të arratisurve më të kërkuar të jenë ende në liri – dhe sidomos Ratko Mladić dhe Radovan Karadžić. Edhe pse Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim dhe Marrëveshja për tregëti dhe çështje tregëtare ndërmjet BE-së dhe Serbisë janë nënshkruar në Luksemburg, në prill të vitit 2008, hhHolandezët kanë ngrirë një pjesë të marrëveshjes së MSA-së me Serbinë pasi që Ratko Mladić ende nuk ishta arrestuar. Pra problemet e qeverisë demokratike me nacionalizmin në rritje në Serbi kanë bërë që shumica e shteteve evropiane t'i japë Serbisë mundësinë e hyrjes në regjimin e liberalizimit të vizave me BE-në në dhjetor të vitit 2009. Pas kësaj Serbia ka aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian në fund të dhjetorit të vitit 2009. Hapi i ardhshëm për Serbinë në procesin e euro-integrimeve ka qenë ratifikimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit nga shtetet anëtare në vitin 2010.

## Për Deklaratën

Drafti i Deklaratës, për dënimin e krimeve të kryera në Srebrenicë, ka qenë i shkruar duke ndjekur vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për gjenocidin e kryer në Srebrenicë në rastin Bosnje dhe Hercegovinës kundër Serbisë nga viti 2007 dhe gjithashtu në përputhje me obligimin e Serbisë që të respektojë konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat i ka ratifikuar. Sidoqoftë, motivet për miratim të Deklaratës, poashtu janë paraqitur si obligim moral ndaj gjeneratave të ardhshme në Serbi.

Në Deklaratë, të miratuar me shumicë minimale, nga 250 deputetë, 127 kanë votuar për miratimin e saj, Kuvendi i Republikës së Serbisë "më së ashpri dënon krimet e kryera ndaj popullit boshnjak në Srebrenicë, siç është theksuar në aktgjykimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë" dhe shpreh keqardhje (dhembshuri) dhe kërkimfalje për familjarët e viktimave për mossuksesin e Serbisë që të bëjë çfarë ka qenë e mundur që të parandalojë një tragjedi të tillë. Qeveria e Republikës së Serbisë, poashtu ka theksuar rëndësinë e arrestimit të komandantit të boshnjakëve serbë si dhe procedimin e tij para Tribunalit të Hagës, dhe ka theksuar përkrahjen e plotë për institucionet, që kanë mandatin e procedimit të përgjegjësve për krime lufte. Parlamentarët serbë, poashtu kanë shprehur pritjet e tyre se kolegët e tyre në rajon do të dënojnë krimet e luftës kundër serbëve, do të kërkojnë fajle dhe do të shprehin keqardhjen e tyre ndaj familjeve të viktimave serbe. Më tej, me anë të Deklaratës ftohen të gjitha palët e konfliktit në Bosnje dhe Hercegovinë, si dhe në shtetet tjera is-jugosllave që të "vazhdojnë procesin e pajtimit dhe forcimin e kushteve për bashkëjetesë, të bazuar në barazi të kombeve dhe njohje të plotë të drejtave dhe lirive njerëzore dhe të pakicave, ashtu që krimet e kry-

era mos të përsëriten më kurrë".[156]

Derisa nga bashkësia ndërkombëtare u nxituan me lëvdatat për Serbinë lidhur me Deklaratën, në rajon nuk ka qenë ashtu. Para së gjithash, viktimat e gjenocidit në Srebrenicë nuk kanë qenë të kënaqura me tekstin e Deklaratës dhe anashkalimit të përdorimit eksplicit të termit "gjenocid" dhe zëvendësimin e saj me fjalën "krim".

Për më shumë, ka pasur edhe grupe, sidomos në Serbi dhe në Republikën Srpska, entitetin e Bosnje dhe Hercegovinës, që kanë kritikuar Deklaratën për shkak të ndarjes së gjenocidit në Srebrenicë nga krimet tjera, posaçërisht ato të kryera ndaj viktimave me prejardhje serbe, që ka zbuluar një shoqëri shumë të polarizuar, e cila edhe më tej është e ndarë sa i përket të kaluarës së rëndë luftarake dhe trashëgimisë së krimeve të kryera gjatë të nëntëdhjetave.

## Definicioni

Ky punim tenton që të përcjellë raportimin e gazetës ditore "Blic"[157] gjatë dhe pas miratimit të Deklaratës për Srebrenicën, më 31 mars të vitit 2010. Qëllimi është që të hulumtohet niveli dhe vëllimi i mohimit në tekstet, që merren me këtë vepër të rëndësishme të Parlamentit Serb në kontekstin e ballafaqimit me të kaluarën në shoqërinë tranzicionale, siç është ajo serbe, pas ngjarjeve të luftës gjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar. Rezultatet e paraqitura të analizës paraqesin bazën për shikim në mënyrën se si në median e përmendur është përcjellë miratimi i Deklaratës. Gjithashtu në punim është e përfshirë edhe gazeta "Glas Javnosti", pasi që autorja ka konsideruar se ka pasur aso tekstesh, që me intonacionin e përdorur kanë tentuar që të mjegullojnë rëndësinë e miratimit të Deklaratës dhe të shtrembërojnë qëllimet si dhe pasojat e së njëjtës. Qëllimi është, pra, që të vendoset marrëdhënia e mediave dhe gazetarëve si bartës të një profesioni me përgjegjësi shoqërore ndaj realizimit të drejtës tranzicionale nëpërmjet raportimit objektiv dhe të saktë.

## Hyrje

Nëse "objektiviteti gazetaresk kuptohet si zgjedhja adekuate e lajmeve krahasuar me realitetin, të cilin ai lajm pretendon ta rindërtojë dhe aftësojë që ngjarjet të transmetohen ashtu si kanë ndodhur"[158], shtrohet pyetja se pse atëherë diskursi i gazetarisë në Serbi "ndihmon" mendimin publik, i cili përfaqëson trashëgiminë e të nëntëdhjetave? Vetëdija e gazetarëve për ekzistimin e diskursit publik, që lidhet me mohimin mes pranuesve, si pasojë e drejtimit shoqëror dhe mosgatishmërisë së tyre që të ballafaqohen me realitetin, që është parakusht për funksionimin e etikës gazetareske, aq thelbësore për kredibilitetin e profesionit, pasi që gazetari punon në shërbim të publikut.[159] Autori John Meril nuk përjashton thirrjen në objektivitet ose në respekt, por prapë i trajton si veti të individit. Poashtu ai pranon vetëm përgjegjësinë "që gazetari i lirë dhe i arsyeshëm i cakton për vetveten' ose përgjegjësinë e "një personaliteti të lirë në shoqëri të lirë'. Kjo është e vetmja rrugë për realizimin e përgjegjësisë gazetareske, e cila definohet si pluralizëm.[160] Mediat dhe veprimtaria e tyre përfaqësojnë një prej kushteve kryesore, që mohimin e sjellin në nivel të shprehjes publike. A do të ishte kundërpeshë e mohimit kushtimi i hapësirës mediale raporteve për krimet e luftës, gjykimeve për krime të luftës, iniciativave lidhur me ballafaqimin e të kaluarës së luftës? " Në këtë kuptim, gazetarët dhe mediat do të duhej të konsideroheshin si 'kryerës specifik: të realitetit dhe jo vetëm reflektues të thjeshtë."[161] A do të kontribuojë manipulimi i publikut me anë të politikave redaktuese në vendosjen e kontinuitetit me të kaluarën, të cilët janë pjesë e këtyre veprave të këqija. Të këqijat nga e kaluara janë në korrelacion të drejtë me mediat dhe dezinformimin e tyre, nxitjen



156 Deklarata e Kuvendit së Republikës së Serbisë për Dënimin e rimeve në Srebrenicë. E qasshme në: http://www.parlament.gov.rs/%D0%B0%D0%BA%D1%82%D0%B8/%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B0%D0%BB%D0%B0-%D0%B0%D0%BA%D1%82%D0%B0/%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B5%D1%82%D0%B0-%D0%B0%D0%BA%D1%82%D0%B0/%D1%83-%D1%81%D0%B0%D0%B7%D0%B8%D0%B2%D1%83-%D0%BE%D0%B4-11-%D1%98%D1%83%D0%BD%D0%B0-2008.1535.html.

157 Gazeta "Blic" është zgjedhur si gazeta më e lexuar ditore. Në krahasim me profilin e lexuesve dhe politikën redaktoriale, kjo gazetë ditore përmbush nevojat e komunikimit të qytetarit/es mesatar serb, i cili të paktën lexon shtypin ditor dhe ka në masë të caktuar një dozë të gjykimi kritik ndaj shoqërisë; Dubravka Valiq Nedelkoviq, "Reality show në çelësin digjital", *Medijski dijalozi,* numër 12, Tom 5.

158 Daniel Korni, *Etika e informimit*, „Clio", Beograd, 1999, faqe 77.

159 Profesioni gazetaresk është objektiv, ndërsa principet e raportimit gazetaresk janë respekti, saktësia dhe rëndësia. (Daniel Korni, *Etika e informimit*, "Clio", Beograd, 1999.).

160 John C. Meril, *The Imperative of Freedom*, "Hastings House", New York, 1974.

161 Daniel Korni, *Etika e informimit*, „Clio", Beograd 1999, faqe 78.

për luftë dhe gjuhë të urrejtjes. Roli i mediave në politikën bashkëkohore është i tillë, që ata edhepse të menduar si të hapur dhe të lirë, prapë duhet të jenë nën kontroll të rreptë dhe të fortë.[162] Pyetja e ballafaqimit me të kaluarën është ajo që i mbetet vetëdijes sonë dhe e cila bëhet kur brengosemi dhe dëshirojmë të dijmë se në çfarë shoqërie jetojmë, – këto janë fakte të rëndësishme nëse dëshirojmë ta njohim shoqërinë tonë.[163]

Kur është fjala për bashkësinë shoqërore, "pajtimi me të kaluarën" nënkupton që të dihet saktë se çfarë ka ndodhur dhe që kjo të pranohet hapur, pasi që pranimi si i tillë zyrtarizohet dhe hyn në diskursin publik. Se a do të arrihet pranimi dhe se në çfarë mënyre do të jipet ai, varet nga natyra e regjimit të kaluar dhe mbetjeve të fuqisë së tij, nga mënyra, në të cilën realizohet tranzicioni dhe karakteri i shoqërisë së re. Me gjithë atë ekzistojnë edhe arsye tjera për heshtje të së kaluarës dhe nxitjes së amnezisë kulturore.

## Analiza

Është e rëndësishme të thuhet se në periudhën e njëjavore, para dhe pas votimit të Deklaratës për Srebrenicën në Parlament, përveç një dite (e mërkurë 24 mars 2010), nuk ka pasur mungesë të shkrimeve për këtë temë. Të gjitha tekstet, që kryesisht për nga zhanri janë raport, madje ka edhe lajme dhe një komentim, i gazetares Gordana Suša, teksti "Për mënyrën dhe në emër të mënyrës", e diel 3-4 prill 2010, për arrestimin e aktivistëve të Iniciativës Rinore për Drejta të Njeriut për shkrimin e fjalisë "Kjo fjalë e rëndë e huaj gjenocid" në platonë para Parlamentit, i cili është një akt që dëshmon për kontekstin më të gjerë shoqëror në momentin e miratimit të Deklaratës, janë publikuar në rubrikën "Politika", në faqet 2 dhe 3, pra menjëherë pas faqes së parë, e cila flet për vetëdijen e bordit redaktues për rrëndësinë e temës. Sidoqoftë, pothuajse në të gjitha tekstet, Deklarata është përmendur në kontekstin e votimit të mundshëm dhe "numërimit" të votave të partive aktuale politike, si dhe nëpërmjet deklaratave të liderëve lidhur me mundësinë për të votuar pro ose kundër miratimit të këtij dokumenti. Kjo media e shtypur kryesisht në raportimin e saj është koncentruar në diskutimin e politikanëve për shumicën e votimit të Deklaratës, shumë më shumë se në vetë thelbin e temës. Do të mund të thuhej se një raportim i tillë ditor-politik ka një dozë të senzacionit që nuk i përshtatet seriozitetit të temës dhe detyrës gazetareske.[164]

Një prej titujve më ilustrativ është gjithsesi teksti i së enjtes, i 1 prillit 2010, një ditë pas miratimit të Deklaratës, me titull shokues "Qeveria ka shantazhuar shërbimin publik". Sipas fjalëve të Aleksandar Tijanić, drejtor i shërbimit Publik, RTS ka qenë e shantazhuar pasi që, siç thotë, ka dalë se "miratimi i deklaratës varet nga ata". Do të thotë përveç shfaqjes së rastit që pushteti të kryejë shantazh në politikën editoriale, Tijanić me arsyetimin e saj turpërues ka tentuar të na shpjegojë se transmetimi i Ligës së Kampionëve ka primat në krahasim me dënimin e krimeve të luftës në Srebrenicë. Për shkak të fitimit që sjellë shikueshmëria e Ligës së Kampionëve, Shërbimi Publik ka qenë i kërcënuar me "obligimin" që të japë transmetim të drejtpërdrejt të takimit të Kuvendit për miratimin e Deklaratës për Srebrenicën, të cilën në transmetimin e mbrëmjes e kanë shiquar gjithsej 1.781.00 njerëz[165], duke parashikuar se ky është obligim i tyre si moral edhe profesional.

Kundërshembull ose deri diku "dritë" e bardhë e këtij raportimi "Blic-i" e ka bërë me tekstin e 31 marsit 2010, metitull "Tregëtia për të dënuar krimin"[166]. Në hyrjen e tekstit lexuesve iu ka shpjeguar se shumica qeverisëse në mënyrë që të miratohet rezolutën për Srebrenicën, ka "tregëtuar" me interesa specifike. Më tutje thuhet se "me mbylljen e kësaj daljeje, teksti i Deklaratës nuk është miratuar as ndryshuar, edhepse disa deputetë të caktuar, dje pasdite, kanë pritur signal nga kreu i shtetit që në rezolutë të citohet aktgjykimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe të shtohet termi 'gjenocid'."



162 Noam Chomski, *Kontrollimi i mediave*, „Rubikon", Novi Sad, 2008, faqe 7.

163 Noam Chmski, *Kontrollimi i mediave*, „Rubikon", Novi Sad, 2008, faqe 30.

164 Duke shikuar titujt e teksteve gazetareske të „Blic" në periudhën e përmendur, në fund të punimit, për shkak të ilustrimit dhe forcimit të asaj çfarë u tha.

165 Sipas fakteve të „AGB Nilsen", kjo është trefish shikueshmëri nga ajo që në Serbi kanë zakonisht transmetimet e kuvendit, që tregon për interesimin e publikut për këtë temë.

166 Nëntitulli i tekstit thotë: "Palma mori të drejtën për funksion të dyfishtë, SPS tekstin për dënimin e krimeve ndaj serbëve, partitë boshnjake insistuan për 'gjenocid'".

Autorja konsideron, se si një shembull të dukshëm të mohimit gazetares, është shumë e dobishme të përmendet, madje pa analizë të raportimit të tërësishëm , gazeta "Glas javnosti', që siç duket, më së largu në këtë përpjekje. Pra gazeta para miratimit të Deklaratës për Srebrenicën ka pasur një botim më vete nën titullin "Letërnjoftimi i Srebrenicës", në të cilën autori Milivoje Ivanišević, publicist dhe hulumtues i krimeve të luftës në ish-Jugosllavi, siç është theksuar në shënimet hyrëse, ka shtruar një kronologji të ngjarjeve në Srebrenicë, që kanë paraprirë gjenocidin, ku së pari në pjesën hyrëse është shtruar qëllimi i autorit që nëpërmjet shkrimit të tij të tentojë të hedhë poshtë vërtetësinë e aktgjykimit të Tribunalit të Hagës se në Srebrenicë ka ndodhur gjenocidi dhe të dëshmojë qëndrimin e tij privat se në pyetje është krimi i luftës. Qëllimi është i dukshëm, që shtrohet në tekst, se vrasjet e boshnjakëve myslimanë të prezantohen si pasojë e vrasjeve të popullatës serbe në fshatrat serbe për rreth dhe me të të tentohet të jipet "arsyetim" dhe të minimizohet krimi. Titulli "Vuajtjet e serbëve deri në prill 1993" shkon në të mirë të kësaj teze. Autori paraqet listën e të vrarëve në pjesën "Kriminelët e shpallur viktima" dhe "Edhe vrasësit në mes të të varrosurve" nën shpjegimin se shumica e tyre kanë qenë pjesëtarë të ushtrisë së boshnjakëve dhe janë vrarë si ushtri, dhe jo si civilë të pafajshëm. Titulli "Mbrojtësi i padukshëm" tregon për mjekun britanik Simon Mardel, nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, i cili sipas të gjeturave të autorit ka nisur një pamflet të rrejshëm me informata se në Srebrenicë çdo ditë vdesin njëzet deri tridhjetë persona. Tekste të shumta si pjesë të kësaj tregojnë për shkelje të Konventës së Gjenevës nga ana e boshnjakëve, ndërsa, sipas pohimeve të tij, pjesa serbe gjithmonë i ka respektuar zakonet e luftës dhe armëpushimet e vendosura. Në diskursin politik kjo është e ashtuquajtur *mohim i implikimeve*[167](është arsyetuar ajo çfarë është bërë pasi është pasojë e diçka çfarë ka ndodhur, por edhe *mohim i interpretimit*[168], ka ndodhur diçka krejt tjetër – autori tregon për gjoja numër më të vogël të viktimave dhe viktimat i shpallë fajtore. Kjo është në të njëjtën kohë edhe *mohim i ekzistimit të viktimave*[169], pasi që diku ekziston një ndjenjë e brendshme shumëshekullore e popullit serb se si ata janë viktima. Prej këtu rrjedhë ndjenja se "ata e kanë filluar" ose se kanë "marrë atë çfarë kanë merituar', që fajin e gjuajnë në të lënduarit është shfajësim zyrtar. Mbrojtja është gati historike: viktimat e tashme janë kryerësit e mëhershëm.

Jemi dëshmitarë shumëvjeçar të tentimit që në diskursin zyrtar "përgjegjësia t'i shkruhet, të emëruar ose paemëruar, fuqive që thuajse nuk kanë asnjë lidhje me qeverinë dhe janë jasht kontrollit të saj "[170]. Diskursi politik është thirrë poashtu në të ashtuquajtura formacionet paraushtarake e që veprimi i të cilave ka qenë jasht kontrollit të shtetit. Krijimi i kushteve për demokraci dhe ligjshmëri nënkupton shikim prapa që të rrëzohet edhe diskursi publik, i cili e ka arsyetuar marrëveshjen e fshehtë, heshtjen ose moskokëçarjen.[171]

## Konteksti më i gjerë shoqëror

Për të kuptuar në mënyrë të drejtë profesionin e gazetarit, duhet shtruar disa pyetje. Çfarë është më të drejtën shoqërore e që duhet të rrjedhë nga komunikimi i qëndrimeve të kundërta nga e kaluara? Ku janë në raportimet mediale "të vërtetat personale", tregimet e viktimave të heshtura, përvojat subjektive të njerëzve që kanë heshtur? "Kulturat e mohimit nxisin mbylljen kolektive të syve, moshulumtimin e krimeve dhe normalizimin e tyre si diçka që i përket ritmit të përditshëm të jetës."[172]

## Në fund

Qëllimi i punës gazetareske është sjellja e së vërtetës faktike. Kjo nënkupton pikët e informatave objektive për ngjarje të caktuara dhe njerëz të caktuar: çfarë ka ndodhur saktësisht, kujt i ka ndodhur, ku, kur dhe si. Përveç nivelit profesional, në atë shoqëror kjo nënkupton shënimin e kontekstit, qëllimit dhe klishesë së shkeljes së drejtave të njeriut; analizimi i fakteve, i cili duhet të shkrijë çdo mohim lidhur me të kaluarën. Kjo më tej do të thotë diskualifikim i informatave të rrejshme, të cilat njëherë janë pranuar si të vërteta.[173]

Duke marrë parasysh se Srebrenica ka qenë temë e shumë spekulimeve në opinionin publik kombëtar dhe ndërkombëtar, duke filluar që nga spekulimi për numrin e viktimave



167 Stenli Koen, *Gjendja e mohimit*, "Samizdat B92/Edicija REČ", Beograd, 2003, faqe 162.
168 *Ibid.*
169 Stenli Koen, *Gjendja e mohimit*, "Samizdat B92/Edicija REČ", Beograd, 2003, faqe 172.
170 Stenli Koen, *Gjendja e mohimit*, "Samizdat B92/Edicija REČ", Beograd, 2003, faqe 170.
171 Stenli Koen, *Gjendja e mohimit*, "Samizdat B92/Edicija REČ", Beograd, 2003, faqe 342.
172 Stenli Koen, *Gjendja e mohimit*, "Samizdat B92/Edicija REČ", Beograd, 2003, faqe 159.
173 Stenli Koen, *Gjendja e mohimit*, "Samizdat B92/Edicija REČ", Beograd, 2003, faqe 326.

deri te "akuzimi i të akuzuarëve"[174], pra sulmimin e kritikuesve të jashtëm me standarde të dyfishta, dhe pa të drejta që të përzihen, mbretëron një qëndrim negativ i opinionit publik për Tribunalin e Hagës dhe domosdoshmërinë, që kryerësit e krimeve të rënda të luftës të përgjigjen për të njëjtat, deri te "thirrja për besnikëri më të madhe "[175].

Mohimi publik është nga kohët e kaluara: të gjitha teknikat e neutralizimit, racionalizimit, mënyra e të folurit, arsyetimi, të gjitha *cliche-të* vëzhguese duhet të dënohen. Një arsye është: zbulimi i së vërtetës si vlerë morale vetë prej veti. Një arsye e rëndësishme është ndjeshmëria e viktimave, që është sidomos e theksuar tek familjet dhe miqtë e viktimave.

Pas 5 tetorit në Serbi kanë ngecur lustrimi dhe sankcionet penale për gazetarë, nxitësit e luftës. Me këtë është dërguar mesazhi i pëlqyeshmërisë publike të gënjeshtrës dhe urrejtjes. Mediat pas 5 tetorit janë "tabloizuar", ndërsa gjuha e urrejtjes është privatizuar. Në përputhje me pritjet e dëshpëruara kanë pasuar heshtja dhe mohimi i krimeve me disa përjashtime.

Mediat e "papastruara" nuk janë në gjendje që të sillën në mënyrë kritike ndaj të kaluarës. Për këtë i ikin temës tabu shoqërore siç janë krimet e luftës dhe gjenocidit dhe nuk mundohen që të marrin qëndrim profesional. Në Serbi nuk ekziston publiku kritik i vërtetë, prandaj edhe në diskursin zyrtar dhe privat gjithmonë "përsërisim" temat e njëjta. Cenzura, ajo çfarë elitat e rrejshme duan që t'u transmetohet qytetarëve, autocenzura, ndjesia e brendshme e viktimizimit të serbëve, që nuk është as temë e asnjë diskutimi publik, mbajtja e pamjes stereotipike, e krijuar në mediat e të nëntëdhjetave, ideologjia nacionaliste, e cila edhe më tutje dominon, këto janë arsyet për mosekzistim të mediave të lira, profesionale dhe pamundësia që të krijojmë shoqëri më të mirë dhe më përparimtare.

...

Për fund është me rëndësi të shikohen disa deklarata të zyrtarëve serbë për Srebrenicën, për hirë të kuptimit më të mirë të marrëdhënies së publikut në Serbi ndaj kësaj çështjeje. Miratimi i Deklaratës është paraprirë me veprime të disa përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, siç është akti i kërkimfaljes publike, tanimë ish-presidentit serb Boris Tadić, që kanë mundur dhe në masë të madhe janë interpretuar në publikun vendor dhe më gjerë, si kryerje e përpjekjeve individuale, por sidoqoftë paraqesin një akt simbolik të reparacionit. Mbetet pyetja se çfarë është qëllimi i fjalëve të kërkimfaljes, që drejtojnë zyrtarët më të lartë. Përse ata nuk e kanë rëndësinë e gjestit të Willie Brandt nga vitet e largëta të 70-ta, i cili në dy gjunj kërkoj falje për viktimat e Hitlerit?

Gjatë vitit 2004, në mandatin e parë si kryetar i Serbisë, Tadić së pari ka shprehur qëndrimin se "mohimi i gjenocidit dhe krimeve janë pjesë përbërëse e debatit demokratik dhe janë të garantuara me kushtetutë, në bazë të lirisë së mendimit dhe shprehjes"[176], që me 10 korrik të vitit 2010, të vizitojë Qendrën Memoriale në Potoçar, duke thënë se shkuarja e tij në Srebrenicë është "akt i pajtimit dhe ndërtimit të urave në mes të popujve'. Që me 17 prill 2010, kryetari i atëhershëm Boris Tadić, ka publikuar artikullin me titullin "Kërkimfalja për Srebrenicën", në rubrikën e mendimeve të gazetës ditore me tirazhin më të madh në Amerikë "Uoll strit zhurnal", që e ka transmetuar agjencia kroate Hina.[177]

Boris Tadić ka kërkuar falje dy herë: në vitin 2004 në Sarajevë dhe në vitin 2007 në Zagreb. Shkuarja e kryetarit Serb në përkujtime në Srebrenicë është hapi i tij më i madh, ndërsa miratimi i Deklaratës për Srebrenicën në Parlamentin e Serbisë, pa marrë parasysh se është evituar fjala "gjenocid" konsiderohet kërkimfalja më e madhe ndaj Bosnje dhe Hercegovinës.[178]

Pas Boris Tadić edhe kryetari i ardhshëm i Serbisë ka dërguar kërkimfalje për Srebrenicën. Në fund të prillit të vitit 2013, kryetari i Serbisë Tomislav Nikolić, në emisionin "Intervju 20", në kanalin boshnjak BHT ka kërkuar falje për krimet, të cilat individët i kanë kryer ndaj boshnjakëve në emër të Serbisë dhe popullit serb. Nikoliq ka thënë se "nuk mund të përshkruajë se sa neveri ndjen kur përmendet Srebrenica". Sipas fjalëve të tij, Srebrenica është sinonim i krimeve të rënda, të cilat i kanë kryer disa pjesëtar të popullit serbë, për çka disa herë thellësisht ka kërkuar falje.[179] Në të



174 Stenli Koen, *Gjendja e mohimit*, "Samizdat B92/Edicija REČ", Beograd, 2003, faqe 154.

175 Stenli Koen, *Gjendja e mohimit*, "Samizdat B92/Edicija REČ", Beograd, 2003, faqe 155.

176 E qasshme në: http://balkans.aljazeera.net/vijesti/pocetak-kraja-negiranja-genocida; qasur më 26.01.2014.

177 E qasshme në: http://banjalukain.com/mediji/izvinjenje-za-srebrenicu-u-vol-strit-zurnalu; qasur më 26.1.2014.

178 E qasshme në: http://www.slobodnaevropa.org/content/balkan_zrtve_ratovi_izvinjenja_izetbegovic_tadic/2208585.html; qasur më 26.1.2014.

njëjtin emision ai ka thënë se "gjenocidi duhet dëshmuar". Tomislav Nikolić poashtu ka thënë se "çdo gjë që ka ndodhur në hapësirën e ishJugosllavisë, gjatë luftërave, ka pasur karakteristikat e gjenocidit".[180] Kërkimfalja ka pasuar pas disa deklaratave jo të duhura në fillim të mandatit që kanë pasur jehonë në rajon.

Duke i shfletuar titujt në fund të këtij punimi, që kanë përcjellë procesin e miratimit të Deklaratës, mund të shihet se kryetari i atëhershëm i Partisë Përparimtare Serbe, tash kryetari i Serbisë, Tomislav Nikolić, atëherë ka thënë se përparimtarët nuk do të votojnë për Deklaratën për Srebrenicën, nëse në të "edhe në shenja tregohet se populli serb ka kryer çfarëdo lloji të gjenocidit ".

Duke përmbledhur marrëdhënien e publikut serb ndaj gjenocidit në Srebrenicë, tetëmbëdhjetë vjet e gjysmë pas tragjedisë, mund të përmblidhet si mohim sistematik dhe relativizëm i gjenocidit të Srebrenicës, por edhe si mungesë të fuqisë së vërtetë për të bërë hapin në ballafaqim me të vërtetën. Sidoqoftë në institucionet kryesore shtetërore dhe në hapësirën mediatike praktikisht nuk ka vend për mohim të hapur të asaj çfarë ka ndodhur në Srebrenicë, që është në kundërshtim me qëndrimin e mëparshëm dominues të qëndrimit publik serb.

Lista e titujve të teksteve gazetareske:

Blic 23 mars 2010, – Miratimi i rezolutës së Srebrenicës, 30 mars, antrfile: Asnjë fjalë për deklaratë tjetër,

Blic, 25 mars 2010, – Parlamenti për Srebrenicë: Për shkak të votimeve, dënimi i krimeve në plan të dytë,

E premte, 26 mars 2010, – SNS nuk do të votojë për tekstin për Srebrenicën; Humbës Slavica Đukić Dejanović, Kryetari i Kuvendit: Drafti i rezolutës për Srebrenicën më shumë është fryt i kompromisit politik se sa dëshirës që në mënyrë të dinjitetshme të dënojë krimin e tmerrshëm; Komentet e lexuesve,

E shtunë, 27 mars 2010, – Nikolić: Koštunica kërkon arsye që mos të bashkëpunojë (intervju) – Do t'i propozojë Kryetarit të Partisë që mos të votojmë rezolutën në Srebrenicë; Komentet e lexuesve; SNS nuk do të votojë për tekstin e Srebrenicës,

E diel, 28 mars 2010, – Ftohtë: Tomislav Nikolić, Kryetari SNS – Ka deklaruar se përparimtarët nuk do të votojnë për deklaratën për Srebrenicën nëse në të "çoftë në shenja tregohet se populli serb ka kryer çfarëdo lloji të gjenocidit",

Jovanović: Serbisë i duhet e vërteta (lajm i agjencisë i marrë nga FoNet); Vesti: Srebrenica në procedurë; Dodik: Rezoluta e papranueshme,

E hënë, 29 mars 2010, – Kuvendi i Serbisë të martën për Srebrenicën – Deklaratën mund ta përkrahë edhe SNS,

E martë, 30 mars 2010, – Parlamenti sot për rezolutën për Srebrenicën – Me shumicë të dobët deri te dënimi i krimeve,

E mërkure, 31 mars 2010, – Debati në Kuvendin e Serbisë për Srebrenicën – Tregëtuan që të dënojnë krimin,

E enjte, 1 prill 2010, – Shteti do të paguajë dëmshpërblimin UEFA-së për mostransmetimin e Ligës së Kampionëve,

Tijanić: Pushteti ka shantazhuar shërbimin publik; antrfile: Kuvendin e përcollën një milion e gjysmë njerëz; Reagimet për miratimin e deklaratës,

E premte, 2 prill 2010, – Fitues: Boris Tadić, kryetar i Serbisë – Me iniciativën e tij Kuvendi i Serbisë më në fund miraton deklaratën, me të cilën dënohen krimet ndaj boshnjakëve në Srebrenicë; Humbës: Slavica Đukić Dejanović, kryetar i Parlamentit,

E shtunë – e diel, 3-4 prill 2010, - Vesti: Đukić Dejanović – Deklarata nuk i bën dëm RS; SNS – Pasoja të këqija; Gordana Suša: Për mënyrën dhe në emër të natyrës; Humbës: Dragan Marković Palma, lider i Serbisë së Bashkuar: Miratimi i dënimit të krimeve është kushtëzuar me vërtetim se mund të jenë dy fotelje; Blic hit - Ivica Dačič: Kriminelët kanë vetëm një kombësi – kriminele,

E hënë, 5 prill 2010, – Kuvendi për krimet ndaj Serbëve: Deklarata e re më së voni në qershor; Vesti - Štrbac: Deklaratë për të gjitha krimet,

E martë, 6 prill 2010, – Grupi Ndërkombëtar i Krizave për Deklaratën për Srebrenicën: Dënimi i krimeve dëshmi që Serbia ecën përpara; Lexuesit komentojnë: Deklarata e re më së largu në qershor.



179 "Unë gjunjëzohem dhe kërkoj falje për Serbinë për krimin që është kryer në Srebrenicë. Kërkoj falje për krimet, të cilat në emër të shtetit tonë dhe popullit tonë ka kryer cilido individ nga populli ynë. Kërkoj falje për çfarëdo mëkati që ka kryer pjesëtari i popullit serb në një kohë kur ka harruar për vetitë njerëzore, në atë që na ndanë nga kafshët. Nuk pres kërkimfalje për krimet e kujtdo ndaj serbëve, por unë kërkoj falje për krimet që i ka kryer cilido individ i popullit tonë", ka thënë Nikoliq në këtë rast. E qasshme në: http://www.youtube.com/ëatch?v=6U_Gr2ë8230.

180 E qasshme në: http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/Politika/1312408/Nikoli%C4%87+se+izvinio+zbog+Srebrenice.html; qasur me 26.01.2014.

# Drejtësia tranzicionale në BeH: E Drejta mbi të Vërtetëen

Denis Puteš



## Lufta në Bosnje dhe Hercegovinë

**Lufta në Bosnje dhe Hercegovinë** është emër gjithëpërfshirës për luftën ndërkombëtare të armatosur në territorin e Bosnje dhe Hercegovinës, e cila është udhëhequr në mes të 1 tetorit 1991 dhe 14 dhjetorit të vitit 1995. Palët kundërshtare kanë qenë Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe entitetet e vetëproklamuara serbe dhe kroate, në kuadër të Bosnje dhe Hercegovinës, Republika Srpska dhe Republika Kroate, Herceg-Bosnja, të cilat kanë qenë të mbështetura nga RF e Jugosllavisë dhe Republika e Kroacisë.

Të tri palët kane përdorur emra të ndryshëm për këtë luftë dhe marrin data të ndryshme për fillimin e saj. Kroatët e quajnë Luftë e Atdheut, e për fillimin e luftës marrin 1 tetorin e vitit 1991, kur UPJ (Ushtria popullore e Jugosllavisë) ka shkatërruar fshatin kroat Ravno, në Hercegovinën Lindore. Serbët e quajnë Luftë Atdhetaro-mbrojtëse, kurse për fillim te saj, marrin 3 marsin e vitit 1992, sulmin kundër kolonës së dasmorëve, në të cilin rast është vrarë babai i dhëndrit, (dasmor i vjetër), në Bashqarshi, në Sarajevë. Boshnjakët e quajnë Agresion kundër Bosnje dhe Hercegovinës, e për fillim marrin 1 prillin e vitit 1992, kur forcat paramilitare serbe sulmojnë qytetin Bijeline dhe kryejnë masakër kundër boshnjakëve. Ndonjëherë, si fillim i luftës, merret 6 prilli i vitit 1992, kurë është sulmuar Sarajeva.

Lufta ka qenë shkaktare e shpërbërjes së SFRJ-se, e konsideruar episod i ri i agresionit serb. Pas ndarjes sllovene dhe kroate nga Republika Federale e Jugosllavisë, gjate vitit 1991, Republika multietnike Socialiste e Bosnjës e Hercegovinës, e cila ka qenë e banuar me boshnjak, (44%), serbë ortodoksë (31%) dhe kroatë katolikë (17%), në referendumin e 29 shkurtit dhe 1 marsit të vitit 1992, është përcaktuar për pavarësi. Këtë e kanë kundërshtuar (refuzuar) përfaqësuesit politikë të serbëve (SDS), të cilët kanë bojkotuar referendumin dhe pamundësuan mbajtjen e tij në disa pjesë te vendit, në pjesën, ku në janar kanë shpallur Republikën Srpska të Bosnjës dhe Hercegovinës. Pas shpalljes së pavarësisë, (BE-eja dhe SHBA-të kanë pranuar pavarësinë e Republikës së B e H, më 6, respektivisht 7 prill, kurse në OKB është pranuar më 22 maj)., Serbët boshnjako-hercegovas, të cilët mbështeteshin nga qeveria serbe e Sllobodan Milosheviqit dhe Armata Popullore e Jugosllavisë (APJ-së), mobilizojnë forcat e veta përbrenda Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës, më qellim të përvetësimit të sipërfaqeve sa më të mëdha, të cilat do t'i shpallin si territore serbe, e cila pas pak shndërrohet në agresion serbomadh në tërë vendin, i përcjellur me spastrim etnik të boshnjakëve nga Podrinja, të kroatëve nga Bosanska Posavina, të boshnjakëve dhe kroatëve nga Bosanjska Krajina.

Ky në fillim ka qenë konflikt në mes të forcave serbe, i organizuar kryesisht në Ushtrinë e Republika Srpska (URS) në njërën anë dhe forcave kroate në Këshillin Kroat të Mbrojtjes (KKM) dhe Ushtrisë së Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës (URBeH), kryesisht të përbërë nga Boshnjakët, në anën tjetër. Prandaj, këtu bëhet fjalë për dy anë: agresorin serb dhe forcat ushtarake, të cilat mbronin BeH, kroatët dhe boshnjakët. Më vonë, kah fundi i vitit 1992, shpërthen lufta kroato-boshnjake, lufta përbrenda luftës, e cila pastaj përhapet në Hercegovinën e Mesme dhe Veriore. Me marrëveshjen e nënshkruar në Uashington, me 18 mars, është konstituuar Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, me të

cilën është ripërtërirë aleanca e boshnjakëve dhe kroatëve. Në operacionet e përbashkëta, ku rolin kryesor kishte ushtria kroate, është çliruar pjesa e madhe e Bosnjës Perëndimore. Përveç këtij konflikti, në Bosanska Krajinë, në shtator të vitit 1993, pasi që Fikret Abdić merr pushtetin në Velika Klladushë, shpërthen konflikti në mes të pjesëtarëve të ashtuquajtur Krahina Autonome e Bosnjës Përëndimore dhe Ushtrisë së Bosnjës dhe Hercegovinës (UBeH), i cili ka zgjatur gjer në vitin 1995.

Pas gjenocidit në Srebrenicë dhe masakrës së dytë në Markale, Aleanca Veriatlantike (NATO) ka intervenuar në kuadër të operacionit „Fuqia e qëllimshme", duke granatuar pozitat e rëndësishme të Ushtrisë së Republikës Srpska, e cila krahas çlirimit të Bosnjës Perëndimore, është treguar si vendimtare në përfundimin e luftës. Luftës i vjen fundi me nënshkrimin e Marrëveshjes së përgjithshme kornizë për paqe në Bosnje e Hercegovinë, në Paris, më 14 dhjetor të vitit 1995. Bisedimet paqësore të mbajtura në Dejton, në shtetin federal amerikan të Ohajos, kanë përfunduar më 21 nëntor të vitit 1995. Këto bisedime të suksesshme janë të njohura me emrin „Marrëveshja e Dejtonit", pjesë përbërëse e së cilës është Kushtetuta e Bosnjës dhe Hercegovinës, e cila përcakton Bosnjë e Hercegovinën e sotme.

Lufta është veçuar me sulme të ashpra dhe me granatime të tepërta dhe joselektive, me spastrime etnike, kampe përqendrimi, vrasje dhe dhunime masive. Ngjarjet, si bllokada e Sarajevës dhe gjenocidi në Srebrenicë, bëhen simbole të kësaj lufte. Sipas raporteve më të reja, në luftë kanë pësuar rreth 100.000 persona, kurse janë të zhvendosur 2.200.000, gjë e cila e bënë konfliktin më të përgjakshëm në Evropë, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

## Drejtëesia Tranzicionale në BeH

### Ç'është drejtësia tranzicionale[181]?

Drejtësia tranzicionale është lëmi, e cila studion mënyrën e veprimit ndaj shkeljeve të mëhershme të të drejtave të njeriut në shtetet në tranzicion dhe njëra prej instrumenteve më të rëndësishme të procesit të demokratizimit, për arsye se mund të funksionojë si katalizator efikas në pajtimin dhe stabilizimin postkonfliktuoz.

Drejtësia tranzicionale përfshinë mënyrën, në të cilën shoqëritë në tranzicion, nga regjimet autokratike në demokraci, apo nga lufta në paqe, përballën me trashëgiminë e shkeljes së vrazhdë dhe sistematike të të drejtave të njeriut.

Drejtësia tranzicionale[182] shpesh kuptohet si e drejtë ndërkombëtare dhe ndjekje kriminale, mirëpo, drejtësia tranzicionale ka qëllime më afatgjata, se sa gjykimi i kryesve të krimeve të luftës. Qëllimi i saj kryesor është ndërtimi i paqes dhe të ndihmojë në rrjedhat e demokratizimit nëpërmjet pajtimit dhe ripërtëritjes së shoqërisë.

Sipas Qendrës Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale mekanizmat e drejtësisë tranzicionale përfshijnë:

- thirrjet e shkelësve të të drejtave të njeriut në të kaluarën në përgjegjësi, nëpërmjet ndjekjes penale dhe formave të hetimit jashtëgjyqësor, siç janë mekanizmat për përcaktimin e së vërtetës;
- reparacionin për viktimat dhe angazhimet për plotësimin e kërkesave të tyre;
- transformimin e sistemit të sigurisë, ashtu që të përgjigjen për shkeljen e të drejtave të njeriut në të kaluarën dhe largimin potencial të shkelësve të të drejtave të njeriut nga institucionet publike, dhe
- reformimin e institucioneve më qellim të parandalojë shkeljen e serishme të të drejtave të njeriut nga e kaluara.

## Implementimi i Drejtësisë Tranzicionale në BeH

Bosnja dhe Hercegovina përballet me tranzicionin e dyfishtë, që do të thotë se në Bosnje dhe Hercegovinë ngjanë tranzicioni nga një sistem në tjetrin[183], kalimi nga lufta në paqe. Drejtësisa Tranzicionale është pjesë e preventivës së konflikteve dhe rimëkëmbja postkonfliktuoze, pas rënjës së një regjimi dhe përfundimit të luftës e që ndodhin njëkohësisht. Mirëpo, krijimi i së drejtës dhe lirisë në BeH ecën shumë ngadalë. Njëra ndër shkaqet themelore për ketë është se, forcat nga e kaluara, ende kanë fuqi të fortë politike, ushtarake dhe policore, të cilën e përdorin për bllokime të

181 Mark Freemam, „Ç'është drejtësia tranzicionale ", në „Forumi për drejtësitranzicionale", (2OO7) f.7-9.

182 Qendra ndërkombëtare për drejtësinëtranzicionale (ICTJ) është organizatë joqeveritare, e cila fuqizon iniciativat për ballafaqimin me të kaluarën në vendet postkonfliktuoze, më gjerësisht në www.ictj.org.

183 Kalimi nga totalitarizmi në demokraci.

shumta sistemore[184]. Poashtu, numri i kryesve dhe viktimave të krimeve të luftës është tepër i madh dhe sistemi penal i BeH nuk mund të merret me sukses me procedimin e tyre. Kriminaliteti i përgjithshëm është në rritje, e me te rritët edhe numri i lëndëve, çka paraqet rëndim shtesë në punën e gjykatave dhe prokurorive.

Ballafaqimi me të kaluarën në BeH është e një rëndësie strategjike për zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë boshnjako-hercegovase. Mekanizmat e gjertanishëm të drejtësisë tranzicionale në BeH janë udhëhequr kryesisht me veprimin e institucioneve ndërkombëtare dhe Zyrës së Përfaqësuesit Special (OHR-it). Në rrugën euroatlantike të BeH, këtë punë duhet marrë përsipër pushteti vendor, në radhë të parë për shkak të interesave të qytetarëve të BeH. Ministria për të drejta të njeriut dhe refugjatë të BeH, ka hartuar „Strategjinë e Drejtësisë Tranzicionale në BeH, 2012-2016" si ndër parakushtet thelbësore për ndërtimin e ardhmënisë stabile në Bosnje dhe Hercegovinë[185]. Anëtari i grupit të ekspertëve, që ka punuar në hartimin e strategjisë dhe ekspert i së drejtës tranzicionale dr. Goran Šimić ka thëne se „vetë strategjia përmban të gjitha mekanizmat e njohura të Drejtësisë Tranzicionale, përveç gjykimeve për krime lufte, sepse BeH ka strategjinë në këtë plan, „dhe se" me këtë dokument është paraparë edhe përcaktimi jashtgjyqësor i së vërtetës, mbi ngjarjet në BeH nga 1992 gjer më vitin 1995, mekanizmat e reparacioneve të viktimave dhe rehabilitimit të tyre, si dhe të ngritjes së qendrave memoriale. Gjithashtu, ka shtuar „se janë paraparë edhe reformat institucionale, të cilat janë në funksion të zbatimit të procesit të verifikimit të dëshmitarëve në të gjitha nivelet, respektivisht vendosje të institucioneve, të cilat kishin për të qenë me besueshmëri gjithëshoqërore, veçanërisht në mjediset e të kthyerve[186].



## Mekanizmat e drejtësisë tranzicionale në BeH

Në BeH ekzistojnë katër mekanizma themelorë të së Drejtës Tranzicionale:

- E drejta penale
- Reparacionet
- Reformat institucionale
- Përcaktimi i së vërtetës

### 1.1. E drejta penale

Procedimi i krimeve të luftës është mekanizmi themelor i Drejtësisë Tranzicionale, nëpërmjet të cilit përcaktohet përgjegjësia për krime të luftës e gjithashtu arrihet drejtësia për viktimat dhe vërtetësia gjyqësore. Gjykimi për krime të luftës duhet të dekurajojë kryesit potencialë dhe të fuqizojnë besimin në sistemin gjyqësor dhe sundimin e të drejtës. TPNJ[187] është formuar në maj të vitit 1993. Gjykimet e para kanë filluar në vitin 1994, kurse deri në përfundim të vitit 2009 janë proceduar 98 persona për BeH. Dhoma (seksioni) e veçantë për krime lufte në Gjykatën dhe Prokurorinë e BeH është themeluar ne vitin 2004. Numër i caktuar lëndësh është iniciuar dhe përfunduar në nivelin lokal, para gjykatave kantonale dhe themelore dhe në Gjykatën e Distriktit Brçko. Para Gjykatës së BeH, derig në fund të vitit 2009 janë akuzuar 135 persona. Para gjykatave kantonale në Federatën e BeH janë akuzuar 142 persona. Para gjykatave themelore të RS (Republika Srpska) janë akuzuar 62 persona, ndërsa para gjykatës së Distriktit Brçko (DB) janë akuzuar 8 persona.[188]

### 1.2. Reparacionet

Me reparacione kompensohen viktimat dhe familjet e tyre e gjithashtu tek viktimat vendoset besimi në shtetin e vet dhe promovohen pajtimi dhe solidariteti social i ndërsjellë. Mirëpo, BeH nuk ka të instaluar politikën unike mbi reparacionet. Në BeH reparacionet e gjertanishme kanë qenë kompensim nëpërmjet përkufizimeve administrative, të pranishme në ligjet mbi viktimat civile dhe të luftës, të cilat janë aprovuar në nivel të entiteteve si dhe nëpërmjet të kthimit të pasurisë me implementimin e ANEX-it VII të Marrëveshjes së Dejtonit. Ekzistojnë disa forma të ndryshme të kompensimeve, si është kompensimi në bazë të

184 Bllokadat në punë (bllokadat financiare, asgjësimi apo fshehja e dokumentacionit, kërcënim dëshmitarëve dhe viktimave) dhe korruptimi.

185 www.mhrr.gov.ba.

186 Shimiqi mbi strategjinë e së Drejtës TRANZICIONALE në B dhe H, 2 qershor, në dispozicion në: htpp:/www.javno.ba/slajd/imi-o-strategiji-tranzicije-pravde-u-bih.html.

187 Tribunali ndërkombëtar penal për ish- Jugosllavinë, i themeluar nga ana e Kombeve tëBashkuara, me seli në Hagë- www.icty.org.

188 Qendra hulumtuese dokumentuese nga Sarajeva, „Kujt i gjykojnë gjykatat në BiH", hulumtimi i fundit zyrtar mbi numrin e të akuzuarve për krime lufte, para të gjitha gjykatave në e BiH dhe „TPNJ ", www.idc.org.ba.

ligjit[189] dhe në bazë të vendimeve gjyqësore[190]. Ekzistojnë kompensimet simbolike dhe memorialet. Kompensimet simbolike paraqesin kërkimfaljet e kryesve ose kërkimfaljet në emër të kryesve të ndryshëm të krimeve[191]. Memorialet zakonisht paraqesin lapidarë si formë e kujtesës në ngjarjet e luftës së kaluar. Këta lapidarë në BeH, kryesisht u janë kushtuar pjesëtareve të bashkësive etnike, të cilat i ngrisin. Mirëpo, ekzistojnë edhe disa forma specifike të memorialeve, si Qendra Memoriale në Potoqari, e ngritur për të kujtuar viktimat e Srebrenicës , mirëpo ky memorial është nën juridiksionin e shtetit të BeH e jo të entiteteve, apo në rastin e Sarajevës, ku ekzistojnë lapidarë që tejkalojnë karakterin nacional, siç janë „Trëndafilat e Sarajevës“[192]

**1.3. Reformat institucionale**

Reformat institucionale nënkuptojnë dy forma të reformave e ato janë: verifikimi dhe lustracioni. Verifikimi paraqet hulumtimin (përcaktimin) e përgjegjësisë individuale të zyrtarëve institucionalë, në periudhën kur kanë ndodhur shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut, kurse lustracioni është i lidhur me përcaktimin e përgjegjësisë kolektive të pjesëtarëve të një partie politike apo institucioni.

Masa e parë e reformave institucionale duhej të ishte largimi i zyrtarëve të dhunshëm (agresivë) e të korruptuar nga sektori publik, për arsye se ky mekanizëm shërben të pengohen padrejtësitë në të ardhmen. Verifikimin dhe lustracionin në BeH e kanë zbatuar EUPM-a dhe OHR-i, mirëpo në mënyre të pamjaftueshme realizimit të saj i është qasur në mënyrë të lehtë dhe për ketë arsye kemi raste kur në disa stacione policore kanë punuar policët, të cilët pas zbatimit të verifikimit nga ana e EUPM-së, janë arrestuar nën akuza për krime të luftës dhe më vonë janë gjykuar[193]. Gjer më tani, puna e asnjë partie dhe institucioni nuk janë ndaluar e as që është shpallur përgjegjës për ndodhjet (krimet) në luftën e kaluar. Njëri nga shkaqet kryesore të këtij problemi është edhe mosekzistimi i ligjit mbi verifikimin dhe lustracionin në nivel të BeH.

Ekziston Komisioni Qendror Zgjedhor, i cili kontrollon kandidatët për vendin e deputetit, si dhe SIPA[194], e cila verifikon informatat mbi aktivitetin gjatë luftës së kandidatëve për pozitat e kryetarit, ministrit, zv. ministrit në Këshillin e Ministrave dhe në disa institucione tjera të radhës, të cilat pjesërisht, më sukses, kanë kaluar reformën e caktuar[195]. Mirëpo e tëra duket e pamjaftueshme për arsye se ende kemi njerëz me të kaluar të dyshimtë luftarake në kuadër të institucioneve dhe të cilët pengojnë punën e institucioneve të tilla, duke frenuar zhvillimin e mëtejshëm të BeH.

**1.4. Përcaktimi i përgjegjësisë**

Përcaktimi i përgjegjësisë është mekanizëm, i cili është i drejtuar në përcaktimin e fakteve. Aktivitet i rëndësishëm i këtij mekanizmi është ekzistimi (vendosja) e organeve për përcaktimin e fakteve. Këto organe quhen komisione për të vërtetën. Komisionet për të vërtetën[196] janë organe të përkohshme hetimi, organe jashtgjyqësore, të fokusuara në viktimat, të cilat i ka përcaktuar shteti dhe i ka autorizuar me



189 Ligji mbi bazat e mbrojtjes sociale, mbrojtjes së viktimave civile të luftës dhe mbrojtjes së familjeve me fëmijë të FBiH, i aprovuar më 1999, me Ligjin mbi viktimat civile të luftës të Republika Srpska – aprovuar më 1993.

190 Me ANEX-in VI të Marrëveshjes së Dejtonit është formuar Dhomapër të Drejtat e Njeriut, si pjesë e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, kurse pjesa e dytëështë institucioni i Ombudsman-it për të Drejtat e Njeriut. Dhoma për të Drejtat e Njeriut është formuar për të zgjidhur ankesat në lidhje me shkeljen e të drejtave të njeriut. Në fund të vitit 2003, Dhoma për të Drejtat e Njeriut pushon së funksionuari dhe të gjitha ankeset, të parashtruara kësaj gjykate gjer në fund të vitit i merr Komisioni për të Drejtat e Njeriut, kurse prej 1 janarit 2004 është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese të BeH.

191 Kërkimfalja publike të ish- kryetarit të RS-së, Dragan Čavić, për gjenocidin në Srebrenicë dhe kërkimfalja e anëtarit të tanishëm të Kryesisë së BeH, Bakir Izetbegović, për të gjitha krimet që i ka bërë Armata e BeH.

192 “Trëndafilat e Sarajevës“ paraqesin mbeturinat e shpërthimeve të granatave në asfalt, të mbushura me ngjyrë të kuqe.

193 Rasti i policëve nga stacioni policor në Prijedor, të cilët janë arrestuar në vendin e punës për krimet në shkëmbinjtë. e Koriqanit dhe më vonë të gjykuar për atë krim – Raporti nga gjykimi në lëndën Shkëmbinjtë e Koriqan-it, 2009.

194 SIPA ështëAgjenci shtetërore për hetimet dhe mbrojtjen e BeH – Raporti nga gjykimi në lëndën Shkëmbinjtë e Koriqan-it, 2009.

195 VSVT – Këshill i Lartë Gjyqësor dhe Prokuroria www.hipe.ba, Instituti për të humburit www.ino.ba, Gjykata Kushtetuese e BeH www.ccbh.ba, forcat e armatosura www.mog.gov.ba, OSA – agjencia informative siguruese www.osa-oba.gov.ba.

196 Qendra ndërkombëtar për të Drejtën TRANZICIONALE , www.jetj.org.

qellim primar të hetojnë dhe raportojnë për periudhat kyçe të shkeljes së të drejtave të njeriut si dhe të propozojnë format e kompensimit për shkelje masive të të drejtave të njeriut dhe masat, të cilat do të parandalojnë përsëritjen e këtyre shkeljeve në të ardhmen. Këto raporte kanë për qëllim të dokumentojnë krimet e luftës dhe përcaktojnë të vërteten mbi ngjarjet, si dhe të konstatojnë emrat e viktimave dhe kryesve, numrin e të vrarëve dhe të humburve.

Gjer më tani janë themeluar disa komisione të ndryshme në tërë botën[197]. Në BeH ka pasur shumë iniciativa për përcaktimin e fakteve nga lufta e kaluar. Do t'i përmendi vetëm ato të cilat, gjer më tani kanë dhënë disa rezultate, gjë që nuk është rasti me shumicën e iniciativave tjera. Me vendimin e Qeverisë së RS-es, më 15 dhjetor të vitit 2003, është formuar Komisioni për hulumtimin e ngjarjeve në dhe rreth Srebrenicës, nga 10 gjer më 19 korrik të vitit 1995, i cili ka rezultuar me raportin me mbi 7.779 personave të humbur në atë periudhë. Gjithashtu është themeluar Instituti për Persona të Zhdukur në BeH, themelues i të cilit është Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Humbur dhe Këshilli i Ministrave të BeH. Njeri prej mandateve të këtij Instituti është formimi i bazës unike të informatave mbi të humburit, në të cilën Instituti ka arritur të unifikojë listat e të gjitha subjekteve në luftën e kaluar, si dhe listat e organizatave të huaja, të cilat kanë qenë të kyçura në proces[198], mirëpo, gjer më sot, nuk i ka botuar rezultatet e atyre listave, për ç'arsye, edhe sot e kësaj dite, është lëndë e manipulimit nga të gjitha anët.

Gjer më tani në BeH më së shumti është manipuluar me numrin e viktimave në luftën e kaluar. Njëra prej arsyeve për këtë është se në BeH ekzistojnë më së paku tri të vërteta mbi konfliktin dhe nga kjo edhe versione të ndryshme për numrin e viktimave. Versionet e këtilla manipulojnë me 25.000 e gjer në 300.000-mijë e më tepër viktima. Mbi numrin e viktimave flasin edhe burimet vendore dhe të huaja, dhe kështu, sipas studimit të profesorit Ilijas Bošnjović dhe Arif Smajkić, nga viti 1997, numri i të pësuarve me vdekje dhe të humburve është 258.000 persona[199]. Sipas studimeve të profesorit Murat Praša, nga viti 1996 janë vrarë dhe humbur 328.000 persona[200]. Vladimir Žerjavić ka publikuar se në BeH janë vrarë 220.000 persona, 160.000 boshnjakë, 30.000-kroatë dhe 25.000 serbë[201].

Komisioni i Basson-it, më 1995 ka konstatuar se të vrarë dhe të humbur janë rreth 200.000[202]. Sipas hulumtimit të Georgea Kenney-it, nga viti 1995, ky numër ka rezultuar në mes të 25.000 dhe 60.000[203]. Mirëpo, asnjëri prej këtyre hulumtimeve nuk ka ofruar atë që ka ofruar Qendra hulumtuese-dokumentuese në hulumtimin e saj me titull" Libri Boshnjak i të Vdekurve.

## Libri Boshnjak i të Vdekurve – E drejta për të vërtetën

## Ç'është Libri Boshnjak i të Vdekurve ?

Si qëndron në të menduarit hyrës, ky libër është lapidar për njerëzit nga Bosnja dhe Hercegovina, të cilët kanë humbur jetën ose janë zhdukur në luftë nga 1991 gjer në vitin 1995. Është lapidar i vetëm i përbashkët i shtetasve të Bosnje dhe Hercegovinës, që kanë pësuar dhe janë zhdukur, pavarësisht nga feja e tyre dhe përkatësia nacionale. Qendra hulumtuese dokumentuese nga Sarajeva, në tetor të vitit 2012, ka publikuar Librin Boshnjak të të Vdekurve. Kryetari i QHD-së Mirsad Tokača, në katër vëllime, në më shumë se 4.000 faqe, ka përmbledhur dhe botuar emrat e të gjithë atyre ushtarëve dhe personave civilë, që kanë vdekur në luftën e kaluar. Sipas hulumtimeve të tij, numri i gjithmbarshëm i të vdekurve në BeH është **95.940,** prej të cilëve 38.239 janë civilë, kurse 57.701 ushtarë. Nëse shikohet struktura etnike, më së shumti kanë pësuar boshnjakët, 62.000, prej të cilëve 57.701 person civilë, pastaj serbë 24.953, prej të cilëve 4.178 persona civilë, kroatë 8.403, prej të cilëve 2.484 persona civilë[204].

197 Komisioni më i njohur dhe i pazakonshëm Jugafrikan për të vërtetën dhe pajtimin.

198 .Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, www.icrc.org, Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Humbur, www.ic-mp.org.

199 I. Bošnjivić dhe A. Smajkić „Popullata dhe humbjet demografike" në: Pasojat shëndetësore-sociale të luftës në Bosnje dhe Hercegovinë, Sarajevë 1997.

200 M. Prašo, Pasojat demografike të luftës 1992-1995, „Most" Mostar, 1996 fq.93.

201 V. Žerjavić, Tragiqna Bilansa, „Globus" , Zagreb, 1998.

202 Prof.dr. Cherif Bassiouni, profesor i drejtësisë në De Paul universitetin në Çikago dhe kryetar i Institutit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut. Me 1993 është emëruar për kryetar të Komisionit të ekspertëve për hulumtimin e shkeljes së drejtës humanitare ndërkombëtare në ishJugosllavinë, të inauguruar sipas Rezolutës tëKëshillit të Sigurimit.

203 G. Kenney, The Bosnian Calculatio, „New York Times", 1995.

204 Mirsad Tokača, Bosanska knjiga mrtvih „Qendra hulumtuese-dokumentuese" Sarajevë, 2012.

Krahas shënimeve themelore mbi personin e viktimizuar apo të zhdukur, pranë emrit të tij në libër, qëndrojnë edhe nacionaliteti, statusi , a është person civil apo ushtarak, formacioni, data, komuna e viktimizimit, gjë që tregon mbi kompleksitetin dhe peshën e vetë hulumtimit.

## Përse ky hulumtim?

Pas dhjetë e më shumë vitesh të nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit dhe përfundimit të luftës, nuk ka ekzistuar regjistrimi preciz i viktimave në territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës. Organet shtetërore nuk kanë qenë në gjendje, apo nuk kanë pasur dëshirë të mjaftueshme politike të punojnë në të. Në opinion janë të pranishme kundërshtime të ndërsjella dhe vlerësime të vrazhda të numrit të përgjithshëm të të vrarëve dhe personave të zhdukur. Në vend të dialogut, manipulimi me numra, pa fakte dhe hulumtimit gjithëpërfshirës, paraqiste elemente shtesë në thëllimin e mospajtimeve dhe stimulimin e atmosferës negative politike. Si shembull mund të mirën deklaratat konstante të kryetarit te RS-ka Milorad Dodik, për mohimin e gjenocidit në Srebrenicë dhe numrin e viktimave[205], apo fërkimet në mes të Milorad Dodik dhe ministrit të punëve të jashtme të BeH, Zlatko Llagumgjija, mbi numrin e viktimave, flet për atmosferën që mbretëron në Bosnje dhe Hercegovinë[206].

## Lënda e hulumtimit

Lëndë e hulumtimit të Mirsad Tokača dhe QHD-se janë të gjithë të vdekurit të Republikës së Bosnje dhe Hercegovinës, pavarësisht nga përkatësia nacionale, fetarë çfarëdo përkatësie tjetër, si dhe personat e zhdukur, mbetjet mortore, të të cilëve, mjerisht, ende nuk janë gjetur. Hulumtimi ka qenë i ndarë në dy pjesë; në pjesën e parë janë hulumtuar viktimat direkte të luftës, ndërsa në pjesën e dytë, viktimat indirekte të luftës. Nën nocionin „viktimat direkte të luftës“ janë të radhitur të vdekurit dhe personat të zhdukur, vdekja apo zhdukja e të cilëve kanë qenë të shkaktuara me operacione direkte ushtarake apo luftarake, siç janë granatimet, veprimet snajperiste, zjarri i pushkës apo artilerisë, minat, arrestimet dhe dërgimet në drejtime të panjohura. Nën nocionin „viktimat indirekte të luftës“ janë radhitur të gjithë personat, vdekja e të cilave është rrjedhojë (rezultat) i shkaqeve, të cilat nuk janë në lidhje direkte me veprimet ushtarake apo luftarake, mirëpo, janë në lidhje direkte më luftën, sic është vdekja nga uria, mungesa e barnave, pamundësisë së shfrytëzimit të ndihmës mjekësorë për shkak të veprimeve luftarake, fatkeqësitë si rrjedhojë e manipulimit me armë.

Periudha kohore, që përfshinë hulumtimi është periudha nga 1992 e gjer në vitin 1995, me theks në vitin 1991, kurse është përfshirë i tërë territori i Bosnjës dhe Hercegovinës, më të gjitha 110 komunat, konform me regjistrimin e popullsisë dhe organizimin territorial të shtetit para fillimit të luftës.

## Qëllimet e hulumtimit

Libri Boshnjak i të Vdekurve qëllimet e saj i ka ndarë në qëllime të përgjithshme dhe specifike.

Qëllimet e përgjithshme janë sa vijon:

- Të kontribuojë në përcaktimin e së vërtetës sa më të përafërt mbi përmasat dhe mënyrat e pësimit vdekjeprurës të të gjithë qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës.
- Të ruajë kujtimin për qytetarët që kanë pësuar vdekjen në periudhën 1991-1995.
- Të përcaktojë identitetin dhe rrethanat e pësimit të secilit person të vrarë apo të zhdukur individualisht, me sa më shumë shënime për secilin individ.
- Të kontribuojë në instalimin e besueshmërisë në Bosnje dhe Hercegovinë.
- Ti zvogëlohet hapësira e manipulimit dhe vlerësimeve të vrazhda mbi numrin e gjithmbarshëm të viktimave.
- Të mundësojë qasje të lirë shënimeve të mbledhura dhe informatave si dhe shikim e ndikim të papenguar të qytetarëve në përmirësimin eventual të fakteve gabimisht të përcaktuara në rezultatet e hulumtimeve, e me ketë, përmirësimin e të njëjtave.

Qëllimi specifik është dëshira në përcaktimin e të gjitha fakteve për persona, që kanë pësuar me vdekje apo janë zh-



205 Qeveria e RS-ka konteston numrin e përcaktuar të viktimave të gjenocidit në Srebrenicë, 20 prill 2010, Radio Evropa e Lirë http://www, slobodnaevropa.org/content/republika srpska vlada srebrenica komisija za srebrenicu/2019416. Html: me qasje në: www.otvoreno.ba.

206 Dodiku akuzon Lagumxhinë se zmadhon numrin e viktimave, 5 gushti i viti 2013, lajmet.ba, me qasje në:http://www.vijesti.ba/vijesti/bih/160090-Dodik-optuzuje-Lagumdziju-uvecava-broj-zrtava.html.

dukur. Në bazë të regjistrimit individual të viktimave dhe analizimit të fakteve të mbledhura, „Libri" ka për qëllim që sa më hollësisht të rikonstruktojë dhe vërtetojë raportet në mes të viktimave direkte dhe indirekte të luftës dhe për të dyja të konstatojë:

- distribuimin kohor të vrasjeve ose vdekjeve dhe asgjësimit të popullatës për shtetin në tërësi,
- distribuimin hapësinor të humbjeve njerëzorë (komunale dhe rajonale),
- strukturën gjinore të viktimave,
- strukturën e moshës së viktimave,
- statusin luftarak të viktimave (person civil apo ushtarak),
- raportin e përafërt e të vrarëve dhe të zhdukurve,
- numrin e të vrarëve dhe të zhdukurve sipas formacioneve ushtarake, si dhe
- strukturën nacionale të viktimave.

## Kritikat e hulumtimit



QHD dhe Mirsad Tokača kanë përjetuar kritika të shumta në llogari te hulumtimit të tyre, si nga Federata e BeH, ashtu edhe nga RS. Kritikat më të mëdha për punën e tyre nga Federata e BeH e kane marrë nga ana e prof. Dr. Smail Čekić, drejtorit të Institutit për Hulumtimin e Krimit Kundër Njerëzimit dhe të Drejtës Ndërkombëtare të Universitetit në Sarajevë, i cili më së shumti ka kritikuar metodologjinë dhe punën e QHD-se.[207]

Qekiqi vërteton se puna e QHD-së është jolegale dhe se kanë marrë shënimet e institucioneve tjera. Përveç kësaj, kritikë i është dërguar edhe në raportin në mes viktimave civile dhe ushtarake të parashtruara në libër. Profesori Čekić tërheq vërejtjen në atë se ekzistojnë shumë prej atyre, që kanë vdekur si civilë, por për arsye të ndryshme iu është pranuar statusi i ushtarit, në radhë të parë për shkak të beneficioneve për familjet e tyre. Këtë, Mirsad Tokača me atë se „ka vendosur që viktimat t'i radhisë konform statusit juridik që kanë, duke mos dëshiruar të involvohet në atë se kush është i vrarë si civil e tek më vonë ka marrë statusin e ushtarit, për arsye se konsideron se kjo mund të jetë faza e ardhshme e hulumtimit në të cilën duhet punuar"

Në anën tjetër, nga RSështë lavdëruar puna e QHD-së dhe Mirsad Tokača, për arsye se është thyer „miti boshnjak" mbi 200.000 boshnjakëve të vrarë. Mirëpo, pasi që ka dalë „libri boshnjak i të vrarëve, nga RSka kanë dërguar kritika të caktuara. Branislav Djukić, kryetar i Federatës së të Burgosurve të RSka deklaruar se në këtë rast kemi të bëjmë më manipulimin e viktimave. Për RS-ka veçanërisht është problematike fakti për viktimat civile të nacionalitetit serb, ku vetëm në periudhën prill-dhjetor të vitit 1992 kanë pësuar 557 civilë serbë nga granatimet e Ushtrisë së RS dhe „JNA"-së, në Sarajevën e rrethuar, kurse gjer në fund të luftës, numri i serbëve të viktimizuar nga snajperistët në Sarajevë, është rritur në 1.100, gjë që tregon se gati gjysma e serbëve të viktimizuar civilë, kanë pësuar mu nga Ushtria e RS dhe „JNA"-së. Sipas të dhënave të Institutit për Hulumtimin e Viktimave të Serbëve në shekullin XX, vetëm në Sarajevë kanë pësuar 8.504 serbë, nga 1992 gjer në virin 1995.

## Rezyme

Libri Boshnjak i të Vdekurve është padyshim njëri ndër projektet më kryesore, nga fusha e ballafaqimit me të kaluarën, të cilën e ka bërë një organizatë dhe, i cili është tejet i nevojshëm për zhvillimin e shoqërisë boshnjako-hercegovase, për arsye se kjo shoqëri ka të drejtë mbi të vërtetën. Edhe pse ka përjetuar kritika të shumta, si nga Federata BeH, ashtu edhe nga RS-ka – mbi atë se si është zvogëluar numri i boshnjakëve, apo se si civilët e vrarë serbë janë regjistruar si ushtarë, apo se si numri i viktimave dhe i të zhdukurve është zvogëluar, duke pasur parasysh formën e luftës që ka qenë, libri, gjer më tani ka dhënë pasqyrë më të mirë të viktimave dhe të zhdukurve, si për nga shënimet themelore të viktimave, ashtu edhe për nga ato detaje, si është data dhe komuna e viktimizimit.

Librin duhet konsideruar dhe kuptuar si fillim i punës në problematikën, e cila është një nga problemet e shoqërisë boshnjako-hërcegovase, e jo si fund i përpjekjeve që të vihet gjer të numri përfundimtar i viktimave dhe të zhdukurve në luftën e kaluar. Me këtë hulumtim është fituar numri prej 95.940 emrash, kështu që ky numër nuk mund të jetë më i vogël, respektivisht ky është numri minimal i viktimave,

207 S. Čekić, Hulumtimi i viktimave të gjenocidit, me vëmendje të posaçmeme në Bosnje dhe Hercegovinë – Teoria dhe metodologjia shkencore – pyetjet metodike dhe problemi „Instituti për Hulumtimin e Krimeve Kundër Njerëzimit dhe të Drejtës Ndërkombëtare i Universitetit KULT B" Sarajevë, 2007.

kurse vazhdimi i këtij hulumtimi mund të sjell gjer tek numri ekzakt i numrit të viktimave. Mirsad Tokača ka theksuar se „ekzistojnë edhe 5.100 raste të pazgjidhura, në të cilat duhet punuar".

Librin duhet pranuar edhe nga arsyet historike, për arsye se kontribuon kah ofrimi i të së vërtetës dhe zgjidhjes përfundimtare të problemeve për shkak të cilave një shoqëri ngec në zhvillimin e saj. Me ardhjen deri të numri përfundimtar i numrit të viktimave, jemi edhe më afër kyçës së çështjes në sistemin arsimor të BeH, dhe së përfundimisht të dihet se çka ka në luftën e kaluar. Duhet pranuar edhe nga aspekti që, Bosnjës dhe Hercegovinës mos t'i ndodhë ajo që ka ndodhur me Jasenovcin, me numrin e viktimave, më të cilin edhe sot e kësaj dite manipulohet dhe për çfarë arsye është burim ngecjeje për tërë rajonin.

# Gjykimet para TPNJ – Rasti Srebrenica – Popović dhe të tjerët

Jovana Spremo

*„As që e kemi vërejtur se si jemi tërhequr në marrëzinë e urrejtjes ndërkombëtare, se si fqinji me fqinjin nuk mund të jetonte më, se si vdekja vendosej në afërsinë tonë dhe ne as që e kemi vërejtur se ishim mësuar me të. Vdekja u bë realiteti ynë, fatkeqësisht e përditshme."*

*Dragan Obrenović, oficer URS*



## Hyrje

Gati dy dekada pas përfundimit së konfliktit të armatosur në territorin e Bosnje dhe Hercegovinës, qëndrimet e opinionit publik për faktet në lidhje me këtë konflikt edhe më tutje nuk përputhen. A ishte ky konflikt i armatosur konflikt i brendshëm apo konflikt ndërkombëtar, a është fjala për okupim apo agresion, a mund të flitet për gjenocid apo jo? Me rastin e ballafaqimit me krimet në të kaluarën, çfarë mund të konsiderohet si e vërtetë e drejtë? Praktika e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi sjell një shikim të detajuar për faktet në lidhje me krimet e kryera në territorin e ish-Jugosllavisë në luftërat 1991-2001[208].

Kur flasim për gjykimet për krime të luftës në territorin e ish-Jugosllavisë, ekziston një kulturë e përhapur e mosbesimit për punën e TPNJ-së, e cila ka sjellë deri te neglizhimi i rëndësisë së punës së saj, në shumicën e rasteve të zbatimit efikas të së drejtës humanitare ndërkombëtare dhe të së drejtës penale ndërkombëtare dhe krijimit të një praktike gjyqësore të shquar. Një nga krimet e përmasave të mëdha të shqyrtuara para kësaj gjykate ka qenë krimi i kryer në dhe për rreth Srebrenicës në periudhën nga korriku deri në tetor të vitit 1995.

Tema e këtij punimi nuk kërkon shqyrtim filozofik, politik ose moral të ngjarjeve, për të cilët janë akuzuar individë, të vetë veprave, për të cilat ata janë të dënuar apo të dënimeve, nëse kanë qenë të merituara apo jo. Ky punim përfaqëson, në mënyrë ekskluzive, paraqitje të rrjedhës së çështjes Popović dhe të tjerëve, po edhe vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje, lidhur me krimet në Srebrenicë[209]. Në fillim do të japim paraqitje jo vetëm të ngjarjeve në Srebrenicë, në periudhën, në cilën vendoset aktakuza dhe vendimi i shkallës së parë, por edhe atyre, që i kanë paraprirë ose kanë qenë pasojë të krimeve të shumëfishta, pas së cilës do të paraqesim shkurtimisht disa vendime të veçanta e që janë relevante për rastin që do të trajtohet. Do t'i kthehemi në fillim të ngritjes së aktakuzës kundër të pandehurve në këtë rast, ndërsa pjesa qendrore e punimit do të përbëhet nga përfundimi e Dhomës së Apelit, në rastin, të cilin e shqyrtojmë.

208 Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë është Gjykatë e Kombeve të Bashkuara, e themeluar në vitin 1993, i cili merret me krimet e kryera gjatë konfliktit në Ballkan, gjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit XX, më tutje në punim si TPNJ.

209 Në tërësi 19 individë janë akuzuar për krimet e kryera në Srebrenicë (sipas: ICTY, *Facts about Srebrenica*, p. 1).

## Rasti Srebrenica

Për t'u shpjeguar ndodhitë nga korriku i 1995 në dhe për rreth Srebrenicës, është e nevojshme që të shpjegohet prapavija politike e këtyre ngjarjeve. Komuna e Srebrenicës, në vitin 1991, kishte 37.000 banorë, në qytet rreth 3.500, nga të cilët tre të katërtat kanë qenë boshnjakë muslimanë, ndërsa një e katërta kanë qenë boshnjakë serbë. Që nga fillimi i luftës, Srebrenica ka qenë pjesë e interesimit të veçantë dhe rëndësisë strategjike për pjesëtarët e boshnjakëve serbë si dhe boshnjakëve muslimanë-[210] Pasi që Bosnja dhe Hercegovina, më 3 mars të vitit 1992 ka sjellë Deklaratën e pavarësisë, Kuvendi i popullit serb të BeH në mënyrë të njëanshme, më 27 mars të vitit 1992 shpalli Republikën Serbe të BeH, më vonë Republika Srpska). Shumë shpejt u vendosën gjashtë "qëllime strategjike" të popullit serb në BeH, nga të cilat i treti lidhej me rajonin e Srebrenicës dhe Zhepës: "Vendosja e korridorit në ultësirën e lumit Drina, përkatësisht eliminimi i lumit Drina si kufi në mes të dy shteteve serbe."[211]

Pas betejave të vazhdueshme në këtë rajon, gjatë viteve 1992 dhe 1993, në prill të vitit 1993, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, shpalli Srebrenicën "zonë të mbrojtur" dhe u nënshkrua marrëveshje në mes të Armatës së BeH[212] dhe Ushtrisë së Republikës Srpska[213], me anë të së cilës u shpallë zonë e demilitarizuar, në të cilën më vonë u dërgua një kontingjent i UNPROFOR-it[214]. Situata në këtë rajon u qetësua përkohësisht dhe ka mbetur stabile deri në pranverën e vitit 1995.

Presidenti i serbëve të Bosnjës, Radovan Karadžić, më 8 mars 1995, dha urdhrin me emrin *Direktiva numër 7,* e cila urdhëronte që fizikisht të ndahen enklavat e Srebrenicës dhe Zhepës. Në pjesën, ku në mënyrë konkrete përmendej Korpusi i Drinës, ka qenë e cekur "Me anë të aktiviteteve të planifikuara të përditshme dhe spontane të krijohen kushte të pasigurisë totale dhe padurimit si dhe të mungesës së perspektivës të ekzistimit dhe jetës të mëtutjeshme të vendasve në Srebrenicë dhe Zhepë."[215]

Në fillim të korrikut të vitit 1999 URS ka filluar sulmin ushtarak në enklavën e Srebrenicës , i njohur si operacioni *Krivaja 95,* me qëllim të okupimit të Srebrenicës. Enklava ra nën kontrollin e boshnjakëve serbë, më 11 korrik duke përfshirë edhe vetë qytetin e Srebrenicës. Sidoqoftë, që një ditë më parë, banorët e Srebrenicës kanë filluar të lëvizin drejt bazës së Batalionit Holandez në Potoçare, të cilët kanë qenë të përcjellë me të shtëna të pandalura ndaj tyre. Pas rënies së enklavës, 11 korrik, gra fëmijë dhe disa meshkuj janë drejtuar drejt Potoçarit, ndërsa shumica e meshkujve, në moshë për shërbim ushtarak, 10- 15.000, pjesëtarët e Divizionit 28 të Armatës 28 me civilë, i janë drejtuar territorit nën kontrollin e Armatës së BeH, përkatësisht drejt Tuzllës që do të thoshte depërtim në pozicionet e URS.[216]

Gjatë asaj kohe, rreth 20.000 njerëz, kryesisht gra, fëmijë dhe pleq janë mbledhur në bazën e Batalionit UN-it Holandez në Potoçare, pra para bazës. Në dy ditët e ardhshme përfaqësuesit e URS-së dhe Batalionit Holandez kanë mbajtur 3 takime në Hotelin "Fontana" në Bratunc, në të cilat kanë



210 Për boshnjakët muslimanë, pasi që para konfliktit shumica e banorëve të qytetit kanë qenë myslimanë dhe për arsye të vendosjes strategjike, pasi që Srebrenica gjendet saktësisht në mes të Tuzllës në veri dhe Zhepës në jug, të cilat ishin në periudhën, për të cilën flitet, nën kontrollin e boshnjakëve muslimanë. Për boshnjakët serbë, Srebrenica ka qenë e rëndësishme pasi që Podrinja e Mesme shtrihet buzë kufirit me Serbinë dhe për këtë arsye ishte e rëndësishme vendosja e vazhdueshmërisë së territorit, që ishte nën kontrollin serb në Bosnjë si dhe në Serbinë fqinje.

211 "Vendimi mbi qëllimet strategjike të popullit serb në Bosnje dhe Hercegovinë", 12 maj të vitit 1992, e publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republika Srpskas" vëllimi II, nr.22, kapitulli 386, 26 nëntor të vitit 1993 (sipas: Aktgjykimi në lëndën Prokurori kundër Popović dhe të tjerëve, Tom I, faqe 26).

212 Armata e BeH është themeluar më 15 prill 1992, nga pjesë të njësisë së atëhershme të Mbrojtjes Territoriale të Republikës së BeH dhe vullnetarëve të organizuar dhe gjatë luftës në BeH ka qenë forca zyrtare ushtarake e Republikës së Bosnje dhe Hercegovinës.

213 URS është formuar nga komponentë të Armatës Kombëtare Jugosllave dhe përbëhej nga gjashtë korpuse në baza gjeografike. Me rëndësi në këtë rast do të jetë Korpusi i Drinë*xhshuarve kombetar xhshuarve kombetar* s. URS është e organizuar në parimin e një komandimi.

214 Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara Nr. 824 (e qasshme në http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N93/262/07/IMG/N9326207.pdf?OpenElement).

215 Artikulli dëshmues P00005„Direktiva Nr. 7, Komanda e Lartë e RS-së", 8. mars të vitit 1995 faqe 2 (sipas: Aktgjykimi në lëndën Popović dhe të tjerët).

216 Vendimi me kërkesën e prokurorisë në lidhje me faktet, në të cilat është gjykuar. Si shtesë, faktet Nr. 251-252 „Në tentim për të ikur nga enklava, kolona e boshnjakëve muslimanë së pari ka lëvizur nëpër zonën e përgjegjësisë së Brigadës së Bratunacit [...]ka depërtuar drejt zonës së përgjegjësisë së brigadës së Zvornikut."

marrë pjesë edhe përfaqësues të banorëve të boshnjakëve muslimanë. Në këto takime u diskutua edhe logjistika e shpërnguljes së boshnjakëve muslimanë nga Potoçari dhe rrethina dhe janë dhënë shenja dhe kërkesa se banorët muslimanë në tërësi duhet ta lëshojnë Srebrenicën.

Me të marrë kontrollin ndaj bazës në Potoçare, më 12 korrik, pjesëtarët e forcave të boshnjakëve serbë, duke përfshirë njësitë e MPB-së, morën pozicionet përgjatë rrugës afër bazës. Gjatë periudhës, prej 11 deri 13 korrik në Potoçare kishte shumë pak ushqim dhe ujë. Sa i përket higjienës: gjendja ishte përkeqësuar si pasojë e mbingarkesës dhe mungesës së kushteve për qëndrim. Në orët e pasditës së 12 korrikut ka filluar transporti i grave, fëmijëve dhe të moshuarëve drejt territorit nën kontrollin e Armatës së BeH. Përparësia që u është dhënë këtyre banorëve në krahasim me meshkujt, që ishin në moshë të pjesëmarrjes në luftë, ka shërbyer si justifikim për ndarjen e meshkujve të boshnjakëve muslimanë, të cilët shumica u mbyllën në të ashtuquajturën "Shtëpi e Bardhë"[217]. Shumica e meshkujve, që sipas llogaritjeve kanë qenë rreth 300 dhe 400, nuk janë parë më të gjallë.

Ushtria e Republikës Srpska, më 12 dhe 13 korrik ka shpërndarë disa njësi përgjatë drejtimit Bratunac – Fushë Konjeviq me qëllim të angazhimit ushtarak dhe për të bllokuar kolonën e boshnjakëve muslimanë, të cilët lëviznin nga Srebrenica për në Tuzëll, e udhëhequr nga Divizioni 28 i Armatës së BeH. Në atë moment, plani i vrasjeve, që fillimisht ishte i drejtuar ndaj meshkujve në Potoçare, u zgjërua edhe në meshkuj, boshnjakë myslimanë nga kolona, të cilët ishin të zënë robër ose ishin dorëzuar. Shtabi Kryesor i URS ka urdhëruar komandantët e korpusit të Drinës, Brigadës së Zvornikut, Brigadës së Birçanit dhe Brigadës së Vlasenikut që të angazhohen në "zbulimin, bllokimin, çarmatosjen dhe zënien robër të grupeve myslimane, që shihen si dhe pengimin e kalimit të tyre në territorin musliman[218]".Një e treta e kolonës, në të cilën ishin rreth tre mijë pjesëtarë të Divizionit të 28, ka mundur që të kalojë. Të tjerët, duke ikur nga granatimi dhe gjuajtjet nga armët automatike, janë zënë robër ose vetë janë dorëzuar. Janë zënë robër rreth shtatë apo tetë mijë meshkuj boshnjakë muslimanë, dhe më pastaj janë dërguar në pika grumbulluese, të cilat janë bërë lokacione të vrasjeve masive.

Ditën e 13 korrikut 1995 ka filluar operacioni i vrasjeve. Të zënit robër kanë qenë të vendosur në lokacione të ndryshme, në të cilat gjatë ditëve të ardhshme ka ardhur deri te vrasja e 2000 njerëzve. Boshnjakët muslimanë janë vrarë në *luadhin në Sandiq*[219]*,në fushën Konjeviq,*[220] *në Kasabën e re*,në *breg të lumit Jadar*, *në ultësirën e Cerskës*. Vetëm në *depon në Kravicë për dy ditë janë vrarë rreth* 1.000-1.500 njerëz. Në periudhën prej 12 deri më 15 korrik ka ardhur deri tek vrasja e të zënëve robër në *supermarketin në Kravicë, Shtabin e Brigadës së Bratunacit si dhe rreth shkollës "Vuk Karadžić" në Bratunc.*

Kanë vazhduar vrasjet masovike në rajonin e Zvornikut. Boshnjakët musliman të zënë robër janë pushkatuar në afërsi të shkollës në Grbavc, ku janë vrarë në mes të 800 deri në 2500 njerëz)[221], tek diga në Petkovc, separacionit afër Kozlukit, janë vrarë më shumë se 1000 njerëz. Vrasjet më të mëdha kanë ndodhur në Ekonominë Ushtarake Branjevo, ku pjesëtarët e njësisë së 10 Diversante kanë vrarë rreth 1000 deri në 1200 njerëz. Këto vrasje, si dhe dy të mëparshmet, janë bërë në mënyrë të njëjtë. Shumicës u janë vendosur lidhëse në sy dhe u janë lidhur duart pastaj janë transportuar në lokalitete të afërme dhe janë pushkatuar. "Kanë qenë të kthyer me shpinë nga ne [...] i kanë nxjerrë njerëzit nga autobusi në grupe, dhe në grupe nga dhjetë i kanë sjellë, nga dhjetë, [...] dhe i kanë pushkatuar[222]."

Ngarkuesit dhe ata që i hapnin gropat, varrezat e përbashkëta ishin aty në kohën e vrasjeve, ose arrinin menjëherë pas vrasjeve për t'i groposur të vrarët në varreza masive. Pas këtyre vrasjeve masive, forcat e boshnjakëve serbë urdhëruan operacionin e "pastrimit" përgjatë enklavës dhe në rajonin e Zvornikut, në periudhën ndërmjet 16 dhe 27 korrikut kanë vazhduar vrasjet në përmasa më të vogla.



217 Johannes Rutten, rasti dëshmues P02178, Transkripti i pranuar në bazë të rregullave 92ter, KT. 2129–2130 (5 prill të vitit 2000) dhe xhirimet nga ajri me shenjat, të cilat i ka vendosur Rutten (sipas: Aktgjykimi në rastin Prokurori kundër Popović dhe të tjerët, Tom I, faqe 129).

218 Rasti dëshmues P00045, „Urdhër i Shtabit Kryesor të URS drejtuar Korpusit të Drinës" me nënshkrim të Milan Gvero, 13 korrik të vitit 1995, faqe 1 (sipas Prokurori kundër Popović dhe të tjerët, Tom I, faqe 148).

219 Shiko: Aktgjykimi në rastin Prokurori kundër Popović dhe të tjerët, Tom I, faqe 151-153,

220 Ibid., faqe 153 – 155.

221 Ibid., faqe 196.

222 Dëshmia e Dražen Erdemović, pjesëtar i njësisë diverzante 10.

Siç e kemi përmendur më herët, shumica e këtyre fakteve janë sqaruar para gjykimeve tjera në TNPJ. Një nga lëndët më të rëndësishme dhe të plotfuqishme ishte rasti *Prokurori kundër Radislav Krstić*[223]. Radislav Krstić, gjeneral dhe zëvendës i komandantit të Korpusit të Drinës së URS, është personi i parë i dënuar para TNPJ për gjenocid[224]. Dhoma e Apelit, në këtë rast ka ardhur në përfundim se është kryer krimi i gjenocidit kundër një pjese të banorëve muslimanë të Bosnjës si grup kombëtar, etnik ose fetar.

Vrasjet e meshkujve të aftë për luftë kanë pasur karakter masovik, ndërsa vendimi që ata të vriten ka ardhur pas vendimit për shpërnguljen e grave, fëmijëve dhe të moshuarve , që tregon se është ditur në mënyrë të qartë se cilat janë pasojat e këtyre veprimeve. Me këto vepra është pamundësuar mbijetesa e banorëve boshnjakë muslimanë të Srebrenicës, që implikon se nga operacionet e pastrimit etnik është kaluar në kryerje të gjenocidit. Dhoma e Apelit ka zhvlerësuar dënimin e shkallës së parë të Krstiqit, si pjesëmarrës në ndërmarrje të përbashkët kriminale për kryerje të gjenocidit (pika 1) dhe e ka shpallur atë fajtor për ndihmë dhe përkrahje të gjenocidit, duke e dënuar në 36-vjet burgim[225].

Rasti tjetër, përfundimet dhe të gjeturat e të cilit janë të rëndësishme për rastin Popović dhe të tjerët, është rasti *Prokurori kundër Momir Nikolić.* Momir Nikolić, që nga korriku i vitit 1995 deri te fundi i luftës ka qenë ndihmës i komandantit për siguri dhe punë informative të Brigadës së Bratunes së Ushtrisë të boshnjakëve serbë. Ai është deklaruar fajtor në pikën 5 të aktakuzës, ndjekjes në baza politike, racore dhe fetare si krim kundër njerëzimit. Në bazë të marrëveshjes për fajësi, Momir Nikolić ka pranuar që të dëshmojë në rastet tjera të TNPJ, duke përfshirë gjykime tjera, që janë në lidhje më Srebrenicën. Ka dëshmuar nga 21 deri më 28 prill të vitit 2009 për nevojat e lëndës Popović dhe të tjerët. Dhoma e Apelit ka marrë me hezitim dëshmitë e tij, pasi që disa herë është munduar që të zvogëlojë përgjegjësinë e tij për vepra të ndryshme. Dëshmia e tij ka qenë e rëndësisë për përkrahjen e fakteve, në rastet e sulmeve të snajperëve pas sulmit në vetë enklavën dhe gjatë lëvizjes e popullatës nga Srebrenica drejt Potoçarit.

Edhe një rast relevant është *Prokurori kundër Dragan Obrenović*[226], i cili ka qenë shef i shtabit dhe zëvendës i komandantit të brigadës së parë këmbësorie të korpusit të Drines së URS, ndërsa prej 8 Gushtit 1995 deri me 15 Shtator 1995 dhe prapë nga 18 deri 24 Shtator të 1995 ka qenë ushtrues detyre i komandantit të Brigadës të Këmbësorisë së Zvornikut. Dhoma e Apelit ka pranuar marrëveshjen për deklarimin për fajësi dhe pranim të fajit dhe ka shpallur Dragan Obrenoviqin si fajtor për Pikën 5 të akuzës, të ndjekur si krim kundër njerëzimit. Ai poashtu ka pranuar që të dëshmojë në rastet tjera para Gjykatës Ndërkombëtare duke përfshirë edhe gjykimet në lidhje me Srebrenicën. Kontribut të madh në vërtetimin e e fakteve mbi krimet në territorin nën komandën e Brigadës së Zvornikut ka dhënë edhe fakti se Obrenoviq, që nga 1998, i ka mundësuar Prokurorisë që të kryejë kontrollim të hapësirave të Brigadës së Zvornikut, duke e ditur që në këtë kontroll mund të gjinden informata që do të mund të inkriminojnë.

Sa here që flasim për krimet në Srebrenicë, është e rëndësishme që të përmendet rasti pasardhës – *Akuza e Bosnje dhe Hercegovinës kundër Serbisë para Gjykatës Ndërkombëtare e Drejtësisë.* Qeveria e atëhershme e Republikës së Bosnje dhe Hercegovinës ka nisur më 29 mars të vitit 1993, një rast para GJND-së me kërkesën që e atëhershmja RF Jugosllavia të shpallet fajtore për shkeljen e Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit dhe Gjenocidit. Pasi që është definuar në vitin 1996 që TPNJ ka juridiksion që të drejtojë këtë rast, është bërë polemikë nëse RF Jugosllavia ka pasur kontroll mbi forcat e URS-së, të cilat kanë kryer gjenocid në dhe për rreth Srebrenicës në vitin 1995. Gjykata ka gjetur se vendimi që të vriten meshkujt me aftësi ush-



223 Prokurori kundër Radislav Krstić, lënda nr. IT-98-33.

224 Sipas Statutit të TNPJ gjenocidi shënon cilëndo nga këto vepra të kryera më qëllim që në tërësi ose pjesërisht të shkatërrohet një grup kombëtar, etnik ose fetar si e tillë. Këto vepra janë: vrasjet e pjesëtarëve të grupit, ushtrimi i lëndimeve të rënda trupore ose shpirtërore ndaj pjesëtarëve të grupit, ushtrimi ndaj pjesëtarëve të grupit të kushteve të rënda të jetesës me qëllim të sjelljes deri te shkatërrimi i plotë ose i pjesërishëm fizik, vendosja e masave për ndalim të lindjeve brenda grupit dhe zhvendosja me forcë e fëmijëve nga një grup në grupin tjetër.

225 Prokuroria, më 5 maj të vitit 2006, ka paraqitur kërkesën me anë të së cilës nga Dhoma e Apelit, për rastin Popoviq dhe të tjerët, ka kërkuar që në mënyrë formale të pranojë 534 fakte, me të cilat është vendosur në aktgjykimin e shkallës së parë në rastin Krstić nga nëntori i vitit 2001 dhe aktgjykimin e shkallës së dytë, nga prilli i vitit 2004.

226 Prokurori kundër Dragan Obrenović, lënda nr. IT-02-60/2.

tarake, boshnjakë muslimanë nga Srebrenica, me të vërtetë është sjellë nga anëtarë të Shtabit Kryesor të URS, por se ky organ nuk mund të konsiderohet si agjent i Serbisë, përkatësisht se RF Jugosllavisë nuk ka kryer kontroll efektive mbi URS. Vendimi është sjellë me 26 Shkurt të vitit 2007 dhe është vërtetuar se Serbia kur është në pyetje gjenocidi i kryer në Srebrenicë në 1995 ka shkelur Konventën për parandalimin dhe dënimin e gjenocidit duke dështuar që të ndalojë gjenocidin si dhe pasiqë nuk ka dorëzuar Ratko Mladić, të akuzuar për gjenocid dhe pjesëmarrje në gjenocid, në Tribunalin Penal Ndërkombëtarë në ish-Jugosllavi. Serbia poashtu nuk ka respektuar obligimin nga dy "masa mbrojtëse të përkohshme", të cilat në prill dhe shtator 1993, i ka vendosur Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Ajo çfarë e bën këtë rast relevant dhe në kontekst me rastin me të cilin merremi, është qëndrimi i GJND-së se ekzistimi i qëllimit gjenocidal mbi dyshimin e arsyetuar dhe dëshmuar në rastin e masakrës së Srebrenicës, në korrik të vitit 1995, duke u thirrë në aktgjykimin e Tribunalit të Hagës, të cilin e kualifikojnë si gjenocid.

### Rasti *Prokurori kundër Vujadin Popović, Ljubiša Beara, Drago Nikolić, Ljubomir Borovčanin, Radivoje Miletić, Milan Gvero dhe Vinko Pandurević*

#### · Parahistoria e rastit



Nëse flasim për fillimin e çështjes para TPNJ, e cila më vonë u ndryshua në rastin Popović dhe të tjerët, është e rëndësishme të përmendet se kundër të akuzuarve në këtë lëndë më herët janë ngritur aktakuza në gjashtë lëndë të veçanta: Prokurori kundër Vujadin Popović[227], Prokurori kundër Ljubiša Beara[228], Prokurori kundër Drago Nikolić[229], Prokurori kundër Ljubomir Borovčaninić[230], Prokurori kundër Zdravko Tolimir, Radivoje Miletić dhe Milan Gvero[231] dhe Prokurori kundër Vinko Pandurević dhe Milorad Trbić[232].

Aktakuza e reviduar, konsoliduar dhe e ndryshuar është ngritur më 16 gusht të vitit 2006.[233] Me anë të saj janë akuzuar: *Vujadin Popović,* nënkolonel dhe ndihmës i shefit për siguri në Korpusin e Drinës të Ushtrisë së Republika Srpskës; *Ljubiša Beara,* kolonel dhe shef për siguri i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Republika Srpska; *Drago Nikolić,* lejtnant dhe shef i sigurisë në Brigadën e Zvornikut të Ushtrisë së Republika Srpska; *Ljubomir Borovčanin,* zëvendëskomandant i njësisë së policisë speciale të MPB-së së Republika Srpskas; *Radivoje Miletić,* kolonel i Shtabit të Operacioneve the Trajnimeve pranë Shtabit të Përgjithshëm të URS; *Milan Gvero,* ndihmës i komandantit për moral dhe çështje juridike dhe fetare pranë Shtabit të Përgjithshëm të URS dhe *Vinko Pandurević,* nënkolonel dhe komandant i Brigadës së Zvornikut së Korpusit të Drinës të URS.

#### · Vujadin Popović

Prokuroria e TPNJ-ës ka akuzuar Popović për përgjegjësi sipas nenit 7(1) të Statutit të TPNJ-ës, për *planifikim, nxitje, urdhërim, kryerje dhe në mënyra tjera ndihmesë dhe mbështetje e veprave kriminele të gjenocidit, bashkim më qëllim të kryerjes së gjenocidit, asgjësim, vrasje, ndjekje, shpërngulje të dhunshme dhe dëbim*[234]. Popović po akuzohet se ka qenë pjesëmarrës i ndërmarrjes së përbashkët kriminale të

227 Prokuroria kundër Popović, lënda nr. IT-02-57-PT, aktakuza fillestare e ngritur më 26 mars të vitit 2002.

228 Prokuroria kundër Beara, lënda nr. IT-02-58-PT, aktakuza fillestare e ngritur më 26 mars të vitit 2002.

229 Prokuroria kundër Nikolić, lënda nr. IT-02-63-PT, aktakuza fillestare e ngritur më 6 shtator të vitit 2002.

230 Prokuroria kundër Borovčanin, lënda nr. IT-02-64-PT, aktakuza fillestare e ngritur më 6 shtator të vitit 2002.

231 Prokuroria kundër Tolimir, Miletić dhe Gvero, lënda nr. IT-04-80-PT, aktakuza fillestare e ngritur më 10 shkurt të vitit 2005.

232 Prokuroria kundër Pandurević dhe Trbić lënda nr. IT-05-86-PT, aktakuza fillestare e ngritur më 9 nëntor të vitit 1998.

233 Prokuroria më 28 qershor të vitit 2005 ka dorëzuar kërkesën për ndryshimin e aktakuzës kundër nëntë të akuzuarve, duke propozuar një aktakuzë të përbashkët të konsoliduar dhe të ndryshuar. Dhoma e Apelit, në maj të vitit 2006 ka miratuar kërkesën e re të prokurorisë, kur është paraqitur Aktakuza e dytë e konsoliduar dhe e ndryshuar. Rasti Trbić, më 26 qershor të vitit 2006, është ndarë nga ky rast dhe i është drejtuar për zgjidhje Gjykatës Shtetërore të BeH në bazë të rregullave. Poashtu rasti Tolimir është ndarë nga lënda e përbashkët, duke marrë parasysh se Zdravko Tolimir ka qenë në liri kur aktakuza e dytë e konsoliduar dhe e ndryshuar hyri në fuqi. Prokuroria, pas arrestimit të tij ka tentuar që të bashkojë lëndën Tollimirit me këtë lëndë, mirëpo Dhoma e Apelit e refuzoj këtë kërkesë.

234 Popović, në pikën 1 të aktakuzës, akuzohet për veprën penale të gjenocidit, të dënueshme sipas nenit 4(3)(a); në pikën 2 për bashkim për kryerjen e gjenocidit, e dënueshme sipas nenit 4(3)(b); në pikën 3 për shfarosje, si krim kundër njerëzimit, e dënueshme sipas nenit 5(b); në pikën 4 dhe 5 për vrasje, si krim kundër njerëzimit, e dënueshme sipas 5(a), përkatësisht për shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës, e dënueshme sipas nenit 3; në pikën 6 për përndjekje si krim kundër njerëzimit, i dënueshëm sipas nenit 5(h); në pikën 7 për vepra jonjerëzore (shpërngulje e detyruar) si krim kundër njerëzimit, i dënueshëm sipas nenit 5(i); dhe në pikën 8 për deportim, si krim kundër njerëzimit, i dënueshëm sipas nenit 5(d).

vrasjeve me procedurë të shpejtë të meshkujve të aftë për luftë, boshnjakë muslimanë, nga Srebrenica dhe ndërmarrjes së përbashkët kriminale të zhvendosjes së dhunshme dhe deportimit të banorëve të Srebrenicës dhe Zhepës, së boshnjakëve muslimanë.[235] Vujadin Popović ka qenë shef për siguri i Korpusit të Drines dhe ka pasur gradën e nënkolonelit. Popović ka qenë eprori e organeve të sigurisë nga radhët e Korpusit të Drinës, ndërsa në kuptimin profesional në batalionin e Policisë Ushtarake të Korpusit të Drinës së URS. Në periudhën, për të cilën lidhet Aktakuza, Popović ka qenë i vetmi epror në organin për sigurinë e këtij korpusi.

Dhoma e Apelit ka dëshmuar përgjegjësinë e Popović për disa vepra, në bazë të pjesëmarrjes së tij në disa lokacione të caktuara, ose informacione, të cilat ai i kishte për ngjarje të caktuara, ka qenë i informuar për planet lidhur me meshkujt e aftë për luftë që kanë qenë të vendosur në Potoçar dhe zhvendosjet në rajonin e Bratunces dhe Zvornikut.[236] Është e pakontestueshme se ai ka qëndruar në Ekonominë Ushtarake në Branjevë pas vrasjeve, që kanë ndodhur atje, si dhe që u ka urdhëruar ushtarëve të URS-së që kanë qenë të vendosur atje, që të shkojnë në Shtëpinë e Kulturës në Pillic që t'i vrasin 500 boshnjakët muslimanë, që ishin të ngujuar aty. Përveç kësaj, Popović sipas dëshmive të paraqitura para Dhomës së Apelit, në shtator të vitit 1995, i ka dhënë urdhër Momir Nikolić, shefit të punëve të sigurisë dhe informimit pranë Brigadës së Bratunacit, që t'i zhvendosë dhe prapë t'i varrosë trupat e boshnjakëve musliman nga Gllogova.[237]

Pas dëshmive të paraqitura Dhoma e Apelit është bindur përtej dyshimit të bazuar se Popović ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe se ka ndarë qëllimin për arritjen e qëllimit të përbashkët, prandaj konsiderohet se ka qenë pjesë e kësaj ndërmarrjeje. Gjithashtu është vërtetuar se ka mundur të parasheh se përveç të vrasjeve masive ka mundur të vie edhe deri të "vrasjet e kushtëzuara me situatë" si pasojë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Në anën tjetër Dhoma e Apelit është e mendimit se nuk janë shtruar dëshmi të mjaftueshme se Popoviq ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në ndërmarrjen kriminale të zhvendosjes së dhunshme dhe të depërtimit të banorëve të Srebrenicës dhe Zhepës, boshnjakë muslimanë. Duke pas parasysh se është vërtetuar se Popović ka qenë pjesëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, ai konsiderohet si pjesëmarrës i vrasjeve ZZP – ka marrë pjesë në vrasjen e anëtarëve të grupit dhe me anë të këtyre vrasjeve iu ka shkaktuar lëndime të mëdha fizike dhe psikike anëtarëve të familjeve të viktimave dhe viktimave, që kanë përjetuar vrasjet, siç definohet në nenet 4(2)(a) dhe (b) të Statutit. Përveç kësaj është vërtetuar se ka marrë Popoviq ka marrë pjesë në operacionet e vrasjeve duke ditur se këto do të kontribuojnë në shkatërrimin e grupit. Dhoma e Apelit konsideron se ka pasur qëllim gjenocidal (vlerësim i aktit të vrasjes, armiqësi ndaj grupit, thirrje nënçmuese) dhe se Popović konsiderohet si fajtor për krimin e gjenocidit, shfarosjes dhe ndjekjes si krime kundër njerëzimit, në saje të pjesëmarrjes së tij në ndërmarrjen e përbashkët kriminalë të vrasjes. Është dënuar me *burgim të përjetshëm.*

### · Ljubiša Beara

Prokuroria e ka akuzuar Ljubiša Beara në të njëjtat baza sikur Vujadin Popović. Prej vitit 1992 dhe përgjatë periudhës, për të cilën bazohet aktakuza, Beara ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm i URS-së në Crna Rijeka, në rolin e shefit të Drejtorisë për siguri, me gradën e kolonelit. Funksioni i Bearas, në pozitën e shefit të Drejtorisë për Siguri ka përfshirë mbikëqyrjen e organeve të sigurisë së URS dhe Policinë Ushtarake të Shtabit Gjeneral si dhe punët e kundërzbulimit. Si oficer mbikëqyrës i organeve të sigurisë ai është dashur të informohet për punën e organit të sigurisë në mënyrë që t'u japë udhëzime, të vlerësojë dhe mbikëqyrë punën e tyre.



235 Për të qenë fjala për ndërmarrje të përbashkët kriminale është e nevojshme që të bisedohet për më shumë persona, që të ekzistojë një projekt i përbashkët, plan ose motiv, që përfaqëson dhe përfshinë kryerjen e veprave kriminale, që nuk duhet të jetë domosdoshmërisht ashtu e formuluar e as e dakorduar më herët, por, mund të jetë edhe e improvizuar në vendngjarje, si dhe i akuzuari të marrë pjesë në realizimin e qëllimit të përbashkët, qoftë duke kryer ndonjë vepër konkrete penale nga Statuti i TPNJ, ose që në ndonjë mënyrë tjetër të kontribuojë ose ndihmojë në realizimin e planit ose qëllimit të përbashkët, sipas Udhëzuesit të Tribunalit të Hagës, faqe 119.

236 Do të thotë se Dhoma e Apelit ka dëshmuar prezencën e tij në disa lokacione kyçe për ngjarjet që kanë rrjedhur. Ka marrë pjesë në takimin e Shtabit të Brigadës së Bratunacit me epror tjerë, ku në mes të tjerash është biseduar edhe për likuidimin e 8.000 mijë ushtarëve muslimanë, që kanë qenë të bllokuar në pyjet rreth Fushës Konjeviq. Ka raportuar për transportimin e të zënëve rob nga Bratunci në Zvornik, me qëllim që atje të vriteshin. Në ditën e 14 korrikut Drago Nikolić, Vujadin Popović dhe Ljubiša Beara, janë takuar në kazermën e ndërmarrjes „Standard", ku ka qenë i vendosur Shtabi i Brigadës së Zvornikut, për të biseduar për operacionin e vrasjes së robërve të sjellur aty. Ka qenë prezent në vendet e pushkatimeve në Grbavc, Roçeviq, Kozlluk, ku e kishte rolin e koordinatorit të vrasjeve.

237 Një prej varrezave primare, ku janë varrosur mbetjet e të vrarëve boshnjakë muslimanë në depon në Kravic.

Që të kuptohen përfundimet e Dhomës së Apelit duhet që të theksohet se Beara ka pasur rol kyç në orkestrimin e operacioneve të vrasjeve ashtu që ka planifikuar, koordinuar dhe mbikëqyrur bllokimin, bartjen, vrasjen dhe varrimin e meshkujve të aftë për luftë, boshnjakë muslimanë, në kohën, për të cilën flitet në këtë Aktakuzë[238]. Dhoma e Apelit, në bazë të disa dëshmive të nxjerra, ka dëshmuar praninë e tij në rajonin, ku janë kryer veprimet në fjalë[239]. Në një bisedë, më 15 korrik, në mes të Krstić dhe Beara, Beara ka folur në mënyrë të saktë për "3500 paketa, që duhen ndarë"[240], dhe pasiqë në atë kohë në Roçeviq janë gjendur rreth 1000 ndërsa në Kul dhe në Shtëpi të Kulturës në Pilliq edhe 1000 deri në 2000 të zënë robër, Dhoma e Apelit ka ardhur në përfundim se Beara ka organizuar ushtarët për ndihmë në operacionet e vrasjeve në këtë rajon. Sidoqoftë Aktakuza nuk përmban asgjë, që tregon se Beara ka marrë pjesë në rivarrosjen e trupave dhe nuk mund të mbahet përgjegjës për ato vepra.

Dhoma e Apelit, përtej dyshimit të bazuar, është bindur se Beara ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të vrasjes, si dhe se ka ndarë qëllimin e kryerjes së qëllimit të përbashkët, prandaj konsiderohet se ka qenë pjesëmarrës i kësaj vepre. Dhoma e Apelit ka konstatuar se Beara ka mundur që të parasheh që përveç vrasjeve të shkallës së zgjeruar do të kryhen edhe vrasje "të kushtëzuara sipas situatës" si dhe pasojat e ndërmarrjes së përbashkët kriminale të vrasjeve. Sidoqoftë nuk ka pasur dëshmi të mjaftueshme të dëshmohet se Beara ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në këtë, kështu që veprimet e tij, në lidhje me banorët e Srebrenicës dhe Zhepës, si dhe njohja e urdhëresave të Direktivës Nr. 9 dhe Direktivës Nr 7/1, nuk dëshmojnë se ai ka qenë pjesëmarrës ndërmarrjes së përbashkët kriminale të shpërnguljes së dhunshme të banorëve. Ai ka qenë i njohur me operacionin e vrasjes dhe pjesëmarrja e tij në këtë operacion ka qenë në nivel të lartë dhe të gjerë, dhe pasi që është ndodhur në shumicën e lokacioneve të vrasjeve masive ka pasur dijeni për numrin e viktimave. Në bazë të dijenisë së tij, veprimeve dhe fjalëve, Dhoma e Apelit ka ardhur në përfundim se Beara ka pasur qëllimin, duke marrë parasysh përmasat dhe vëllimin e operacionit të vrasjeve, që është kryer me dijeninë e tij, në bazë të udhëzimeve të tij dhe nën mbikëqyrjen e tij. Ai është penalisht përgjegjës për bashkim për kryerjen e gjenocidit, si dhe kryerjen e vrasjeve shfarosëse dhe të ndjekjes si krim kundër njerëzimit nëpërmjet ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Është dënuar më *dënim të përjetshëm me burg.*

### · Drago Nikolić

Prokuroria ka mbajtur Drago Nikolić si përgjegjës, sipas Nenit 7(1) të Statutit për "planifikim, nxitje, urdhërim, kryerje dhe në mënyra tjera ndihmesë dhe mbështetjen e veprave penale të gjenocidit, bashkim me qëllim të kryerjes së gjenocidit, asgjësim, vrasje, ndjekje, zhvendosje të dhunshme dhe deportim".[241] Nikolić është bërë shef për siguri i Brigadës së Zvornikut në korrik 1995 dhe ka mbajtur gradën e nënkolonelit në URS.[242] Si shef për siguri i Brigadës, Nikolić ka qenë organi kryesor këshilldhënës i komandantit të Brigadës në lidhje me përdorimin e Policisë Ushtarake, ndërsa nga ana



238 Beara ka qenë prezent në rajonin përreth Potoçarit, ndërsa më vonë edhe në Bratunc. Momir Nikolić ka dëshmuar se Beara ka përcjellë urdhërin tek Drago Nikolić se të zënit robër do të dërgohen në Zvornik, ku duhet të vriten, të cilin Dhoma e Apelit e ka marrë si të dhënë të besueshme të natyrës vetëdiskriminuese dhe vërtetimit të dëshmitarëve të tjerë. Poashtu ka marrë pjesë në kazermën e përmendur në "Standard", më 14 korrik me Popović dhe Nikolić, ku kanë shqyrtuar organizimin dhe koordinimin e operacionit të vrasjeve, prej nga është kthyer në Bratunac. Ka qenë prezent në Grbavc (Orahovac), Petkovc, Roqeviq dhe Pillic.

239 Beara në fjalën e tij përfundimtare ka pohuar se në periudhën në mes të 10 deri 16 korrikut nuk ka qenë në Bosnjën Lindore, në lokacionet, të cilat pretendon prokuroria, si dhe se nuk ka qenë i përfshirë në vrasjet masive të kryera gjatë kësaj periudhe, duke i sfiduar dëshmitë e disa dëshmitarëve dhe besueshmërinë e bisedave të gjetura.

240 Rasti dëshmues P01178a "Bisedat e gjetura, të 15 korrikut të vitit 1995" (Sipas: Vendimi në rastin Prokuroria kundër Popoviq dhe të tjerët, Tom II faqe 494).

241 Nikolić në Pikën 1 të aktakuzës akuzohet për veprën penale gjenocid, e ndëshkueshme sipas nenit 4( 3)(a);në paragraf 2 komplot për kryerjen e gjenocidit, të ndëshkueshme sipas nenit 4(3)(b); në paragrafin 3 të asgjësimit si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas neneve 5(b); në paragrafët 4 dhe 5, për vrasje si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas neneve 5(a), si dhe shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, të ndëshkueshme sipas nenit 3, në pikën 6 të persekutimit, si një krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas neneve 5(h) të paragrafit 7, për veprime çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Neneve 5 (i) dhe paragrafin 8, të deportimit, si një krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas neneve 5(d).

242 Zinxhiri komandues ishte në vartësi të komandantit Pandurević të Brigadës së Zvornikut, dhe kur bëhet fjalë për çështjen e sigurisë, ishte në vartësi sipas vijës profesionale të ndihmës-komandantit të Korpusit të Drinës për Siguri, Vujadin Popović.

profesionale të japë edhe urdhëra drejtpërsëdrejti komandantit të Policisë Ushtarake.

Nikolić ka marrë pjesë në takimin, në kazermën "Standard", ku është biseduar për operacionet e vrasjes. Dhoma e Apelit është bindur se në bisedat telefonike ka urdhëruar pjesëtarin e Batalionit të I të Brigadës së Zvornikut, që të bëjë sigurimin e të zënëve rob në shkollën në Kul dhe se me këtë e ka ditur se të zënit robë do të vriten. Jo vetëm se ka qenë i pranishëm në shkollën në Grbavc, por në mënyrë aktive ka marrë pjesë në organizimin e mbajtjes së të zënëve rob në shkollë, ku më pastaj janë vrarë.[243]

Duke marrë parasysh së më 13 korrik të vitit 1995, ka kuptuar që meshkujt e aftë për luftë, boshnjakë muslimanë nga Srebrenica, do të sjellën nga Bratunci në Zvornik, që aty të vriten dhe se ka marrë pjesë në aspekte të këtij operacioni, planifikim, përgatitje fizike dhe sigurimin e njerëzve. Dhoma e Apelit ka konstatuar se Nikolliq ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe se ka pasur qëllimin për arritjen e qëllimit të përbashkët, përkatësisht se ka qenë pjesëmarrës i ndërmarrjes së përbashkët kriminale të vrasjes. Për shkak të këtij përfundimi ai konsiderohet përgjegjës për vrasjet në shkollën në Petkovc. Megjithatë përveç që ka qenë i njohur për zënien dhe mbajtjen e të zënëve robë, boshnjakë muslimanë, ka pasur ndikim në sulmet në enklavën e Srebrenicës dhe rënien së saj. Nuk ka pasur informata lidhur me rrethanat e robërimit të tyre nga ana e URS-së. Dhoma e Apelit ka konstatuar se Nikolić nuk është fajtor për krimin e gjenocidit, por është fajtor për ndihmesë dhe përkrahje të të njëjtit. Duke përmbushur kushtin e diturisë, Nikolić është përgjegjës për kryerje të asgjësimit, vrasjeve dhe persekutimit, si krime kundër njerëzimit duke marrë pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të vrasjes. Është dënuar me *35-vjet burgim.*

### · Ljubomir Borovčanin

Ljubomir Borovčanin ngarkohet për krimet si të akuzuarit e tjerë. Ndonëse Borovčanin pos për veprat kriminale të përmendura më lartë të vartësve të tij, poashtu ngarkohet me përgjegjësinë e komandimit të të njëjtave, sipas nenit 7(3) të Statutit.[244] Ai gjatë periudhës, për të cilën flet aktakuza, ka qenë zëvendës i komandantit të Brigadës Speciale të Policisë MPB të Republika Srpska, ndërsa nga 10 korriku i vitit 1995, ka qenë komandant i forcave të përbashkëta të njësive të MPB-së, vartës të Korpusit të Drinës së URS, për pjesëmarrje në operacionin e Srebrenicës. Borovčanin dhe njësitet e tij janë vënë nën komandën e Korpusit të Drinës.[245]

Ai, në periudhën nga 11 deri 13 korrik, ka qenë në Potoçar, ku ka mundur të vërejë se si në Potoçar kanë arritur autobusë dhe kamionë për transport të banorëve. Ushtarët e tij më vonë kanë marrë pjesë në transportimin e banorëve muslimanë nën kontrollin e ABeH. Ekzistojnë dëshmi se ka mundur të vërejë kushtet dhe djegien e dokumenteve në dhe para "Shtëpisë së Bardhë" në Potoçar. Të njëjtën ditë, duke vepruar sipas urdhërit të Mladić, ka organizuar vendosjen e Trupës I të Njësisë Speciale të Policisë së Zvornikut dhe dy njësi të Brigadës Speciale të Policisë nga Shekoviqi, që të ndihmojnë që rruga Bratunac – Fusha Konjeviq të sigurohet nga kolona, që mundohej të depërtonte nga vijat e mbrojtjes së URS. Ka dëshmuar edhe për ngjarjet në Sandiq dhe Kravic.

Prokuroria ka mbetur pranë pohimit se veprimet e Borovčanin, pra komandimi i tij më forcat e MPB, që kanë ndihmuar URS në kontrollimin e banorëve boshnjakë muslimanë, kanë mundësuar realizimin e qëllimit të URS që në mënyrë të dhunshme të hiqen banorët boshnjakë muslimanë nga Srebrenica. Dëshmitë tregojnë se Borovčanin nuk ka qenë i njohur me planet që të hiqet popullata, pasi që nuk ka pasur qasje në dokumente strategjike e as që ka ditur për veprimet në Srebrenicë, para ardhjes së tij në atë rajon. Gjithashtu është vërtetuar se nuk ka ekzistuar qëllimi për zhvendosje të dhunshme. Nuk ka dëshmi të mjaftueshme se para incidentit në deponë, në Kravic, Borovčanin të ketë ditur për planin e vrasjes së boshnjakëve muslimanë. Pra, përfundimi i Dhomës së Apelit është se nuk ka ndarë qëllimin me anëtarët tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale të vrasjes që të kontribuojë në arritjen e qëllimit të përbashkët dhe se nuk ka qenë pjesëmarrës i kësaj ndërmarrjeje të për-



243 Në anën tjetër, Dhoma e Apelit nuk ka mundur të përcaktojë me siguri absolute praninë e Nikolić në Roqeviq, më datën 15 korrik të vitit 1995.

244 Neni 7 (3) i Statutit të TPNJ lidhet me përgjegjësinë komanduese dhe thotë : „Fakti se ndonjëra nga veprat, nga 2 deri në 5, nga ky Statut, janë kryer nga vartësi, nuk e liron eprorin nga përgjegjësia kriminale, nëse eprori ose ka pasur arsye që të dijë se vartësi po përgatitet për kryerjen e veprave të tilla ose që tanimë i ka kryer, ndërsa eprori nuk ka marrë masat e nevojshme për të parandaluar ose të dënojë kryesit."

245 Rasti dëshmues P00057, „Urdhëresa nr. 64/95 Ministrisë së Punëve të Brendshme të RS njësive të MPB-së" me nënshkrim të Tomislav Kovač, 10 korrik të vitit 1995 (sipas: Vendimi në lëndën Prokurori kundër Popović dhe të tjerët, Tom II faqe 545).

bashkët kriminale. Dhoma e Apelit është bindur se lëshimi i Borovčanin që të mbrojë të zënit rob, boshnjakë muslimanë, ka kontribuar në mënyrë të ndjeshme në asgjësimin, që është kryer më vonë në depo në Kravic. Është ardhur në përfundim se Borovčanin ka pasur kontroll efektive mbi forcat e MPB-së, dhe se mbanë përgjegjësinë penale sipas Nenit 7(3), për vrasje dhe asgjësim si krime kundër njerëzimit dhe vrasje, si shkelje e zakoneve të luftës. Përveç kësaj konsiderohet se ai mban përgjegjësi për vrasje, asgjësim dhe persekutim, si krime kundër njerëzimit. Dhoma e Apelit ka konstatuar se nuk ka kurrfarë indikacionesh për qëllimin gjenocidal të Borovčanin e as për pjesëmarrje me qëllim kryerjen e gjenocidit. Është dënuar më *17-vjet burgim.*

### · Radivoje Miletić

Radivoje Miletić është ngarkuar për përgjegjësi në bazë të Nenit 7(1) të Statutit për "planifikim, nxitje, urdhërim, kryerje dhe ndihmesë dhe përkrahje në mënyra tjera të veprave si vrasje, persekutim, veprime johumane (zhvendosje e dhunshme) dhe dëbim." Ai ka qenë shef i Departamentit për Punë Operative Trajnuese të Shtabit të Përgjithshëm të URS dhe ka marrë pjesë në përpilimin e Direktivës Nr. 7. Roli i Departamentit të Punëve Operative – trajnuese përbëhej nga planifikimi i aktiviteteve luftarake, koordinimi i punës së organeve tjera dhe përpunimi i dokumenteve luftarake. Prokuroria në mënyrë konkrete thekson se Miletić ka qenë njëra nga figurat kyçe në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të largimit me dhunë të popullatës së Srebrenicës dhe Zhepës – boshnjakëve muslimanë.

Shikuar në mënyrë formale si dhe në pyetjen e kaluar nga ana e mbrojtjes, përpilimi i Direktivës nr.7, në punimin e së cilës ka marrë pjesë, nuk bën pjesë në periudhën kohore për të cilën flet Aktakuza. Dhoma e Apelit është e bindur se Miletić është njoftuar me hollësi për të gjitha ndodhitë dhe situatën në Srebrenicë posa, është kthyer nga Beogradi në Crna Rijeka, më 12 korrik.[246] Është vërtetuar se Miletić ka pasur rol kyç koordinues në rrjedhën e informatave në Shtabin Gjeneral të URS.[247] Ka refuzuar që të hapë radhët mbrojtëse të URS, që t'i mundësohet kolonës së boshnjakëve muslimanë që të kalojë dhe ka urdhëruar që të përdoren të gjitha forcat njerëzore dhe pajisjet për luftim kundër kolonës dhe shkatërrimin e saj. Gjatë operacionit Zhepa, në periudhën nga 16 deri 17 korrik, Miletić u ka dhënë udhëzime njësive në terren dhe ka pasur rolin e koordinatorit të Shtabit të Përgjithshëm me forcat në terren.

Qëndrimi i prokurorisë ka qenë se Miletić ka kontribuar në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të zhvendosjes së dhunshme duke përpiluar Direktivën nr. 7 dhe në pjesëmarrjen në zbatimin e saj, si dhe me mbikëqyrjen e forcave myslimane dhe të dorëzimit të tyre dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të njësive të URS-së në enklava. Në bazë të dëshmive që i janë paraqitur Dhomës së Apelit është vërtetuar mbi dyshimin e bazuar se Miletić që nga fillimi, nga zbatimi deri te realizimi ka luajtur rol kyç në planin e shpërnguljes së dhunshme të boshnjakëve muslimanë nga Srebrenica dhe Zhepa. Ai ka marrë pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të largimit të dhunshëm të civilëve dhe ka ndarë qëllimin për kryerjen e kësaj vepre me pjesëmarrës tjerë, ndërsa veprat e tij, në mënyrë kumulative, përbëjnë kontribut të konsiderueshëm në këtë vepër. Dhoma Gjykuese ka konstatuar se është fajtor për vepra jonjerëzore (shpërngulje e dhunshme) duke marrë pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të shpërnguljes së dhunshme. Konsiderohet se ka kryer vepra me qëllim të realizimit të planit të largimit të boshnjakëve muslimanë, me qëllim të veçantë të diskriminimit në baza gjinore, racore dhe fetare. Është ardhë në përfundim se në situata të vrasjeve "të kushtëzuara nga situata", që rrjedhin nga ndërmarrja e përbashkët kriminale e shpërnguljes së dhunshme, e cila përfshinë shpërnguljen e dhunshme dhe vepra tjera jonjerëzore, të cilat përbëjnë krim kundër njerëzimit, ai në mënyrë penale është përgjegjës për vrasje, si krim kundër njerëzimit, dhe jo si krim lufte, si dhe për persekutim me anë të vrasjeve "të kushtëzuara nga situata" si krim kundër njerëzimit. Dhoma e Apelit e ka dënuar më *19-vjet burgim.*

### · Milan Gvero

Milan Gvero ngarkohet me të njëjtat krime sikur Miletić. Gvero ka qenë ndihmës i komandantit për moral, drejtësi dhe çështje fetare të Shtabit Gjeneral të URS. Detyra e tij ka qenë që të vlerësojë faktorë të ndryshëm që ndikojnë në moral, që të sigurojë që shpirti luftarak të jetë në nivelin më të lartë që ka përfshirë përcjelljen e situatës në njësi. Ka pasur rol të madh në krijimin e propagandave me ngjyrime

246 Miletić ka qenë i obliguar që Milanović t'i referojë gjatë mungesës së tij dhe me kthimin e tij në Shtabin Kryesor të URS-së. Dhoma e Apelit është bindur se për të kryer këtë detyrë është dashur që edhe vetë të jetë tërësisht i informuar.

247 Dhoma e Apelit ka nxjerrë dëshmi se Shtabi Kryesor pas prillit 1995, njësive vartëse u ka dërguar 11 njoftime në lidhje më konvojet humanitare, nga të cilat shtatë janë nënshkruar nga Miletić.

morale gjate operacioneve të ndryshme. Dhoma e Apelit ka ardhur në përfundim se Gvero ka qenë oficeri më i vjetër në Shtabin Gjeneral të URS-së të paktën gjatë një pjese të ditës së 13 korrikut, 19 korrikut dhe 25 korrikut të vitit 1995, gjë që i ka dhënë atij autorizime më të mëdha.

Në fillim të vitit 1995 Gvero ka marrë pjesë dhe ka folur, në referimin për gatishmërinë luftarake, në të cilën është biseduar për definimin e qëllimeve të mëtutjeshme politike dhe luftarake, strategji të udhëheqjes së luftës dhe bisedimeve paqësore, përkatësisht për prioritetet politike dhe luftarake të RS-së, për qëllimet tanimë të miratuara strategjike dhe detyrat e vitit 1995.[248] Ka marre pjesë në krijimin e urdhërave morale të disa prej dokumenteve strategjike të lartpërmendura.[249] Ka negociuar me përfaqësues të MKCK dhe UNHCR-it, që batalioni Holandez të dërgojë disa të lënduar dhe të sëmurë në Bratunac nga Potoçari.[250] Gjatë operacionit në Zhepë ka kryer detyra kyçe në lidhje me aktivitetet propagandistike.

i. Dhoma e Apelit ka ardhur deri në përfundim se duke shpërndarë informata të rrejshme dhe duke referuar në kërcënime serioze, Gvero ka dhënë kontribut në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të shpërnguljes së dhunshme të civilëve, i cili sipas karakterit është padyshim i rëndësishëm dhe se ai konsiderohet pjesëtar i kësaj ndërmarrjeje. Pasi që ka vërtetuar se kriteri i dijenisë është plotësuar, Dhoma e Apelit ka konstatuar se Gvero është fajtor për vepra jonjerëzore (shpërngulje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit. Gjithashtu është konstatuar se persekutimi si krim kundër njerëzimit është kryer duke zhvendosur dhunshëm mijëra civilë boshnjakë muslimanë nga Srebrenica dhe Zhepa, trajtim të vrazhdë dhe johuman dhe terrorizim të civilëve boshnjakë muslimanë dhe se Gvero është fajtor për persekutim, si krim kundër njerëzimit. Është dënuar më *5-vjet burgim.*

### · Vinko Pandurević

Vinko Pandurević konsiderohet përgjegjës sipas nenit 7(1) të Statutit për "planifikim, nxitje, urdhërim, kryerje dhe ndihmesë dhe përkrahje në mënyra tjera të veprave si vrasje, persekutim, veprime johumane (zhvendosje e dhunshme) dhe dëbim."[251] Thuhet se Pandurević ka qenë pjesëmarrës i ndërmarrjes së përbashkët kriminale të ndërmarrjes së ekzekutimit me procedurë të shkurtër dhe varrosjes së meshkujve të aftë për luftë, boshnjakë muslimanë nga Srebrenica dhe ndërmarrjes së përbashkët kriminale të zhvendosjes së dhunshme dhe dëbimit të popullatës së Srebrenicës dhe Zhepës, boshnjakëve muslimanë. Poashtu sipas nenit 7(3) të Statutit ngarkohet se si komandant, për veprat e vartësve të vet për veprat e lartpërmendura. Pandurević ka qenë nënkolonel dhe komandant i Brigadës së Zvornikut, të Korpusit të Drinës së URS-së.

Ai ka poseduar informata të plota për operacionin *Krivaja-95.* Në ditët e ardhshme ai ka marrë pjesë në sulmet dhe marrjen e enklavës, duke udhëhequr me grupin Taktik 1. Pas takimit me Krstić, të mbajtur më 15 korrik, Pandurević, me njësinë e tij GT-1, është nisur në drejtim të Zvornikut dhe rreth mesditës ka arritur në kazermën e kompanisë "Standard". Ai ka pasur qasje në faktet e sjelljes së një numri të madh të të burgosurve nga Bratunci dhe për atë se po kryheshin ekzekutimet e tyre. Shumë shpejt e kanë njoftuar për situatën në rrethinën e Zvornikut dhe është marrë vendimi që të lëshohej kolona, që po kalonte në afërsi të Nezuka. Është dakorduar të hapet korridori, nëpër të cilin kanë kaluar rreth 5000 njerëz, që ka qenë në kundërshtim me urdhërat që Pandurević ka marrë nga eprorët e tij. Pandurević ka qenë i informuar edhe për aktivitetet e Njësisë së inxhinierëve, që po punonte në varrosjen e të ekzekutuarve.

Duke marrë parasysh informatat, të cilat i ka pasur në dis-



248 Rasti dëshmues 5D00967, "Plani referues për gatishmërinë luftarake të vitit 1994", 29 dhe 30 janar të vitit 1995, me nënshkrim të Mladić (Sipas: Vendimi kundër Popović dhe të tjerët, Tom II, faqe 655)

249 Në mënyrë që të parandalojë bombardimin e NATO-s ai në bisedë telefonike me komandantin e Batalionit Holandez ka mohuar sulmet në këtë batalion duke pohuar se pozicionet e UNPROFOR-it po sulmohen nga ABeH dhe se ai nuk mund të bëjë asgjë që të ndalojë luftimet, pasiqë URS nuk sulmon as UNPROFOR-in e as popullatën civile të Srebrenicës.

250 Rasti dëshmues P04157, „Intervista të cilin MKCK i ka dhënë shtëpisë televizive Deutsche Welle", 20 korrik të vitit 1995, faqe 1.(Sipas: Vendimi kundër Popović dhe të tjerët,Tom II, faqe 669).

251 Pandurević, në pikën 1 të Aktakuzës rëndohet për veprën penale të gjenocidit, e dënueshme sipas nenit 4(3)(a); në pikën 2 të Aktakuzës, për bashkim për të kryer gjenocid, e dënueshme sipas nenit 4 (3)(b); në pikën 3 të Aktakuzës, për asgjësim si krim kundër njerëzimit, e dënueshme sipas nenit 5(b); në pikat 4 dhe 5 të Aktakuzës, për vrasje si krim kundër njerëzimit, e dënueshme sipas nenit 5(a), përkatësisht për shkelje të zakoneve the traditave të luftës, e dënueshme sipas nenit 3; në pikën 6 të Aktakuzës, për persekutim si krim kundër njerëzimit, i dënueshëm sipas nenit 5(h); në pikën 7 të Aktakuzës, për vepra jonjerëzore (zhvendosje e dhunshme), si krim kundër njerëzimit, i dënueshëm sipas nenit 5(i); dhe në pikën 8 për dëbim si krim kundër njerëzimit, i dënueshëm sipas nenit 5(d).

pozicion, Dhoma e Apelit, është bindur se ai, më 18 korrik ka qenë i njoftuar për përmasat e operacionit të vrasjeve. Përveç kësaj, Dhoma e Apelit konstaton se nuk ka dëshmi se Pandureviq me pjesëmarrësit tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale ka ndarë qëllimin që të kryejë krime, që kanë qenë qëllim i kësaj ndërmarrjeje. Dhoma e Apelit ka konstatuar se, më 23 korrik Pandurević nuk ka bërë asgjë që të kryejë obligimet e tij ndaj të zënëve robë e të plagosur, edhe pse ka pasur mundësi që të veprojë dhe duke mos vepruar ka ndihmuar dhe përkrahur vrasjen e dhjetëra të zënëve robë, boshnjakë muslimanë, nga spitali në Miliq. Sa i përket ndërmarrjes së përbashkët kriminale të zhvendosjes së dhunshme, Dhoma e Apelit është bindur se Pandurević ka qenë në dijeni për planin e largimit të dhunshëm të popullatës boshnjake muslimane nga enklavat në Srebrenicë dhe Zhepë por, se nuk është dëshmuar se ka qenë pjesëmarrës i kësaj ndërmarrjeje. Për më shumë, Dhoma e Apelit ka konstatuar se Pandurević ka ndihmuar dhe përkrahur veprën penale të zhvendosjes së dhunshme. Për përgjegjësinë e eprorit ndaj anëtarit sipas nenit 7(2) të Statutit, është përgjegjës për vepra kriminale, të cilat i kanë kryer pjesëtarët e Brigadës së Zvornikut gjatë operacionit të vrasjeve në rajonin e Zvornikut. Prandaj, Pandurević mban përgjegjësinë penale, sipas nenit 7(3) për vrasje, si krim kundër njerëzimit, për zhvendosje të dhunshme, si krim kundër njerëzimit si dhe për vrasje, si shkelje e zakoneve dhe traditave të luftës. Është dënuar me *13-vjet burgim.*



**Procesi i apelimit dhe shqyrtimet përfundimtare**

Vërtetimet, të cilat i kemi analizuar, janë përfundim i Dhomës së Apelit, e cila ka sjellë dënimin e shkallës së parë, më 10 qershor të vitit 2010. Me rastin e caktimit të dënimeve të shtatë të akuzuarve, në këtë rast janë marrë në konsideratë rëndësia e krimeve, për të cilat janë akuzuar, rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe praktika e përgjithshme e shqiptimit të dënimeve në gjykatat e ish-Jugosllavisë. Për shumicën e të akuzuarve, dorëzimi vullnetar është marrë si rrethanë lehtësuese. Vendimit iu është bashkangjitur dhe lënë mënjanë mendimi i kundërt i gjykatësit O-Gon Kvon dhe është lënë mënjanë mendimi i gjykatëses Kimberli Prost.[252]

Të gjithë të akuzuarit, pos Lubomir Borovčanin[253], kanë iniciuar procedurën e apelimit në vitin 2012. Rasti i apelimit në rastin e Milan Gvero është ndalur pas vdekjes së tij, në shkurt të 2013.[254] Diskutimi për ankesat e pesë të akuzuarve të mbetur ka filluar më 2 dhjetor të vitit 2013.[255] Vujadin Popović ka paraqitur fakte dhe të gjetura juridike të aktvendimit të shkallës së parë, duke kërkuar nga Dhoma e Apelit që ta zhvlerësojë dënimin dhe ta shpallë të pafajshëm , për të gjitha pikët e aktakuzës ose të caktojë gjykim të ri. Mbrojtja e Ljubiša Beara ka pohuar se ai nuk ka mundur të dënohet për pjesëmarrje në gjenocid, pasi që ai është liruar nga pika, që e rëndon për zhvendosje të dhunshme të popullatës dhe se nuk ka qenë pjesëmarrës i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, me qëllim vrasjen e mijëra meshkujve dhe djelmoshave të Srebrenicës, në korrik të vitit 1995.[256] Avokati mbrojtës i Drago Nikolić ka mohuar gjetjet e Dhomës së Apelit, sipa të cilës i akuzuari ka pasur rol të rëndësishëm në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, ndërsa mbrojtja e Miletić, praktikisht, ka tentuar që përgjegjësinë e tij kriminale, për të cilën akuzohet, ta bartë tek eprorët e tij. Në fund mbrojtja e Vinko Pandurević ka thënë se ai nuk ka mundur të ndikojë në operacionin e vrasjes së të zënëve robë srebrenicas, të cilët sipas urdhërit të Ratko Mladić janë kryer nga Ljubiša Beara dhe Vujadin Popović.[257] Në adresimin e tyre të akuzuarit, në fund të seancës, u kanë kërkuar falje viktimave për krimet e kryera por, kanë mohuar rolin e tyre në këto krime.[258]

Ky aktvendim ka pasë rol të rëndësishëm në dënimin e krimeve lidhur me Srebrenicën, pasi që edhe njëherë është

252 Të shikohet: Aktgjykimi në rastin Prokurori kundër Popović dhe të tjerëve, Tom II, faqe 833-861.

253 Ljubomir Borovčanin nuk është ankuar për dënimin, me të cilin , në qershor të vitit 2010, është shpallur fajtor për ndihmesë dhe përkrahje të asgjësimit, persekutimit, zhvendosjes së dhunshme, për të cilat është dënuar me 17-vjet burg, pastaj është dërguar në Danimarkë në vuajtje të dënimit.

254 „NDËRPRITET AKTI I ANKESËS NË RASTIN KUNDËR MILAN GVERO“ (e qasshme në: http://www.sense-agency.com/tribunal_(mksj)/obustavljen-zalbeni-postupak-u-predmetu-milana-gvera.25.html?cat_id=1&neës_id=14734, hapur me: 18. Janar 2014.).

255 „PESËSHJA E SREBRENICËS PARA DHOMËS SË ANKESAVE“ (e qasshme: http://www.sense-agency.com/tribunal_(mksj)/srebrenicka-quotpetorkaquot-pred-zalbenim-vecem.25.html?cat_id=1&neës_id=15549, e hapur me : 18. janar 2014.).

256 „BEARA DËSHIRON T'I IKË DËNIMIT PËR GJENOCID“ (e qasshme në: http://www.sense-agency.com/tribunal_(mksj)/beara-bi-da-izbegne-osudu-za-genocid.25.html?cat_id=1&news_id=15552, hapur në: 18 Janar 2014.).

257 „PANDUREVIQ PËR GJENOCID AKUZON MLLADIQIN, BEARËN DHE POPOVIQIN“ (e qasshme në: http://www.sense-agency.com/tribunal_(mksj)/pandurevic-za-genocid-krivi-mladica-bearu-i-Popoviqa.25.html?cat_id=1&neës_id=15562, hapur në 18 Janar 2014.).

vërtetuar kryerja e krimeve gjenocidale ndaj popullatës boshnjake të këtij qyteti. Në anën tjetër, lënda është shumë e rëndësishme në kushtet e kuptimit dhe zbardhjes së fakteve shtesë për kuptimin e fatit të meshkujve të vrarë. Por, ajo që mbetet si e padiskutueshme është këmbëngulësia e të akuzuarve, në deklaratat e tyre, se nuk janë fajtorë për kryerjen e krimeve, pavarësisht pranimit se ka ekzistuar krimi. Ky gjykim mund të konsiderohet si historik, pasi që të gjithë të akuzuarit janë dënuar me thuajse dënime maksimale për veprat që kanë kryer pa marrë parasysh se ky gjykim zgjati gati një dekadë. Pa dashur të supozojmë për të gjeturat e Gjykatës së Apelit në këtë lëndë, mbetet të shihet në të ardhmen se çfarë vendimi do të merret.

Krimet kundër boshnjakëve muslimanë të Srebrenicës dhe Zhepës janë vërtetuar, dëshmuar dhe mbetet vetëm që në mënyrë të plotfuqishme para ligjit të dënohen të gjithë ata që i kanë kryer këto krime ose kanë ndihmuar në kryerjen e tyre, sepse kjo është mënyra e vetme që të respektohen viktimat e shumta. Krimi i gjenocidit kërkon dënim me dënimet më të larta, pa lëshime se në një mënyrë duhet të ipet shembulli se krime të tilla nuk do të tolerohen në të ardhmen.



258 „ADRESIMI I TË AKUZUARVE NË FUND TË SEANCËS APELUESE TË SREBRENICËS“ (e qasshme në: http://www.sense-agency.com/tribunal_(mksj)/obracanje-optuzenih-za-kraj-srebrenicke-zalbene-rasprave.25.html?cat_id=1&news_id=15572, hapur në 19 Janar 2014).

# Srebrenica – Gjykimi ndaj Radislav Krstić

Srđan Vidačković

## 1. Hyrje

Gjykimi ndaj Radislav Krstić është, për nga rëndësia, një prej gjykimeve më të rëndësishme para Tribunalit Ndërkombëtar Penale për Jugosllavinë (TNPJ), duke marrë parasysh se gjatë zhvillimit të gjykimit, ky ish-komandant i Korpusit të Drinës, ka qenë i vetmi oficer i ranguar aq lartë i Ushtrisë së Republikës Srpska, i cili në atë kohë gjendej para këtij Tribunali. Në anën tjetër, rëndësia e gjykimit dhe aktgjykimit shihet në atë se është e para herë pas Luftës së Dytë Botërore dhe e para herë për krimet në Bosnje dhe Hercegovinë, që dikush në mënyrë të plotfuqishme është dënuar për gjenocid. Ajo çfarë duhet të theksohet është kontributi i këtij aktgjykimi në zhvillimin e të drejtës dhe jurispodencës penale ndërkombëtare.



Edhe pse faktet për Srebrenicën janë të prezantuara në literaturën profesionale dhe publiku i gjerë është i njoftuar me to, ky punim do të fillojë me rikujtim të shkurtër për vuajtjet e boshnjakëve myslimanë në këtë enklavë, për shkak të përmasave të krimit, i cili është kryer atje, në korrik të vitit 1995.

Në kapitullin e ardhshëm do të bisedohet për gjykimin e Radoslav Krstić dhe rolin e tij para, gjatë dhe pas tragjedisë srebrenicase. Pjesa e fundit e këtij punimi është njëkohësisht edhe më e rëndësishmja dhe në të do të bëhet fjalë për rëndësinë e aktgjykimit, me theks të veçantë për përgjegjësinë penale të gjeneral Krstić, për pjesëmarrjen e përbashkët penale, pra përë përgjegjësinë për gjenocid.

## 2. Krimi në Srebrenicë

Srebrenica, qytet ne Bosnjën Lindore, në fillim të luftës ka pasur rreth 37.000 banorë, prej të cilëve numrin më të madh e kanë përbërë muslimanët, 73-përqind, pastaj serbët 25-përqind. Për shkak të pozitës së saj, 15 kilometra nga kufiri me Serbinë, dhe për shkak të rëndësisë së madhe strategjike për boshnjakët serbë, ky qytet i Podrinjës së Mesme, që në fillim të konfliktit të armatosur në Bosnje dhe Hercegovinë, në vitin 1992, ka qenë i sulmuar nga formacionet paramilitare serbe, të cilat qytetin e kanë mbajtur nën kontroll javët e para.[259] Pas kësaj qyteti bjen nën kontrollin e boshnjakëve myslimanë, duke iu falënderuar aksioneve të Naser Orić, i cili arriti që deri në muajin e nëntë të vitit 1992 ta bashkojë Srebrenicën me Zhepën, ndërsa deri në janar të vitit 1992 të zgjerojë territorin e lirë në 900 kilometra katrorë.

Megjithatë, pas sulmit në fshatin serb Kravica, në muajt e parë të vitit 1993, forcat e boshnjakëve serbë janë përgjigjur me kundërofensivë dhe kanë ndërprerë lidhjen mes dy enklavave. Kjo ka sjellë edhe deri te një fluks i madh i refugjatëve boshnjakë në Srebrenicë, kështu që ky qytet atëherë kishte në mes të 50.000 dhe 60.000 njerëz.[260] Gjatë këtyre betejave ka arritur deri të krimet e para nga të dyja anët.

259 Fondi për të Drejtën Humanitare, *Aktgjykimet - Srebrenicë*, (Beograd: Fondi për të Drejtën Humanitare", 2005), faqe 77.

260 Raporti i sekretarit gjeneral për Srebrenicën, paragrafi 37.

Forcat e Armatës së BeH, nën udhëheqjen e Naser Orić, kanë kryer krime, në mes tjerash, edhe në hapësirën e rajonit Bihaq, pastaj në hapësirën e Bratuncit.[261] Për shkak të situatës së rëndë humanitare, por edhe kërcënimit të Ushtrisë së Republika Srpska, që do të sulmojë qytetin, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, në prill të vitit 1993, ka sjellë rezolutën, me të cilën Srebrenicën dhe rrethinën e saj e ka shpallur zonë të mbrojtur.[262] Si zona të mbrojtura në Lindje të Bosnje dhe Hercegovinës u shpallën, poashtu edhe Zhepa e Gorazhde. Duke ju falënderuar intervenimit të UNPROFOR-it është arritur marrëveshja për armëpushim ndërmjet dy palëve në luftim.

Direktiva e 7-të, e dhënë në mars të vitit 1995, nga ana e kryetarit të Republika Srpska, si dhe komandantit suprem të Ushtrisë së Republika Srpska (URS) Radovan Karadžić, kishte të bënte me strategjinë e URS lidhur me enklavat në Bosnjën Lindore.[263] Në të ceket si qëllim ndarja fizike i enklavave të Srebrenicës dhe Zhepës, dhe poashtu është dashur që nëpërmjet restrikcioneve të zvogëlohet përkrahja logjistike ndaj forcave të UNPROFOR-it, si dhe të krijohet pasiguri dhe kushte të jetës të padurueshme përnda banorët mysliman në Srebrenicë.

''Me mbrojtje intensive dhe aktive dhe në bashkëveprim me pjesë të forcave SRK në pjesë të betejës dhe rreth enklavave, të parandalohet depërtimi i armikut në drejtimet e zgjedhurat operative-taktike. Në mënyrë demonstrative dhe aktive, nëpërmjet implementimit të masave të maskimit operativ-taktik, të lidhim forca sa më të forta rreth vetes, në pjesë të betejës, ndërsa rreth enklavave Srebrenica dhe Zhepa sa më parë të kryhet ndarja e plotë e Srebrenicës nga Zhepa, me të cilën të ndërpritet edhe komunikimi mes këtyre dyjave. Me anë të aktiviteteve luftarake të përditshme, të planifikuara dhe të menduara, të krijohen kushte të pasigurisë së plotë, padurimit dhe mungesës së perspektivës në qëndrimin e mëtutjeshëm dhe jetës së banorëve në Srebrenicë dhe Zhepë.

Në rast të largimit të forcave të UNPROFOR-it nga Zhepa dhe Srebrenica, komandanti KD duhet të planifikojë operacionin nën emërtimin "Jadar", me detyrë thyerjen dhe shkatërrimin e forcave myslimane në këto enklava dhe çlirimin definitiv të Podrinjes."[264]

Zbatimi i kësaj Direktive ka rezultuar me mungesë të ushqimit, ujit dhe barnave e që ka sjellë edhe deri te katastrofa humanitare në Srebrenicë e si shkak i së cilës, forcat e Armatës së BeH kanë kërkuar zhbllokimin e korridorit. Në Direktivën 7-të më tutje thuhet:

''Nëpërmjet organeve ushtarake dhe shtetërore kompetente, që kanë për detyrë punën me UNPROFOR-in dhe organizatat humanitare, me aprovim të planifikuar dhe modest të kërkesave të zvogëlohet dhe kufizohet përkrahja logjistike e forcave të UNPROFOR-it në enklava dhe futja e mjeteve materiale për myslimanët e gjallë, duke i bërë të varur nga vullneti ynë i mirë, dhe në të njëjtën kohë duke i ikur dënimit të bashkësisë ndërkombëtare dhe opinionit publik botëror."[265]

Operacioni "Krivaja 95", përkatësisht sulmi në Srebrenicë fillon më 6 korrik të vitit 1995. Pa pothuajse asnjë rezistencë bie së pari pjesa jugore e enklavës dhe pas vetëm tri ditësh Ushtria e Republika Srpska hyn katër kilometra në thellësi të territorit të enklavës. Duke parë se nuk ka rezistencë më të madhe të Armatës së BeH e as të reagimit nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, kryetari Karadžić jep urdhrin që Korpusi i Drines të marrë Srebrenicëm. Forcat e NATO-s, më 11 korrik, me kërkesën e kolonelit Karremans, pjesëtar i batalionit holandez në Srebrenicë, kanë bombarduar tanket dhe pozitat artilerisë së URS mbi Srebrenicë, duke dashur që të ndalojnë depërtimin e mëtutjeshëm të URS. Pas kërcënimit se URS do të vrasë të gjithë ushtarët holandezë të zënë robë, aksioni i NATO-s është ndërprerë.

Ngjarjet, që ndodhen, i kanë detyruar banorët boshnjakë që të lëshojnë Srebrenicën dhe të drejtohen për në Potoqare, ku ishe gjendur baza e UN dhe objektet përcjellëse. Rreth 20-25.000 boshnjakë myslimanë, prej të cilëve pjesa më e madhe kanë qenë gra, fëmijë dhe të moshuar, ku ka pasur edhe rreth 300 meshkuj në vetë bazë, ndërsa jashtë saj edhe



261 Naser Orić është gjykuar para TNPJ, sipas aktakuzës për vdekjen e së paku gjashtë serbëve të zënë robër në stacionin policor në Srebrenicë, si dhe për sjellje të dhunshme ndaj të burgosurve dhe shkatërimin e fshatrave serbe, gjatë viteve 1992 dhe 1993. Edhepse prokurori ka kërkuar 18-vjet burg, ndërsa mbrojtja aktgjykim shfajësues, TNPJ e ka dënuar me dy vjet burgim për shkak të krimit kundër civilëve serbë, në periudhën prej viteve 1992 dhe 1993. Këshilli Apelues e ka liruar nga fajësia Oriqin në prill të vitit 2008.

262 UN Doc. S/RES/B19 (1993).

263 Komanda Supreme e Forcave të Armatosura të Republikës Serbe, Direktiva Nr.7, 8.03, të vitit 1995, faqe 8.

264 Ibid., faqe 8.

265 Ibid.

rreth 600 deri 900 të tillë. Për gjendjen, që ka mbretëruar në Potoqare në mesin e refugjatëve ka dëshmuar njëri nga pjesëtarët e forcave holandeze, kapiten Leendert Van Dujin: "Kanë qenë në gjendje paniku, kanë qenë të frikësuar dhe shtyheshin drejt ushtarëve, ushtarëve tanë, ushtarëve të UN, të cilët mundoheshin që t'i qetësojnë. Kemi parë njerëzit që rrëzoheshin, shkeleshin. Situata ka qenë kaotike."[266]

Ka pasuar transporti i femrave, fëmijëve dhe të moshuarve nga Potoqari drejt territorit, të cilin e ka kontrolluar Armata e BeH e që ka përfunduar në mbrëmjen e 13 korrikut. Transporti është bërë në tri takime, që janë kryer në hotelin "Fontana", prej 11 deri 13 korrik të vitit 1995. Në këto takime, përveç gjeneralit Ratko Mladić, kanë marrë pjesë edhe oficerë tjerë të URS, mes të cilëve edhe gjenerali Radislav Krstić, përfaqësuesit e UNPROFOR-it dhe përfaqësuesit jozyrtar të boshnjakëve myslimanë, Nesib Mandžić, Ćamila Omanović dhe Ibro Nuhanović. Në takim, gjenerali Mladić e ka bërë me dije në mënyrë të qartë që nga të gjithë autobusët do të ndahen meshkujt, ndërmjet 17 dhe 70 vjet, në mënyrë që të kontrollohen nëse janë kriminelë lufte. Autobusët për transport i ka siguruar URS.

Që atëherë është filluar me vrasjet, dhunimet, djegiet e shtëpive dhe zbatimi i vendimit për ndarjen e meshkujve gjatë transportit. Meshkujt janë ndarë, e më pastaj janë transportuar me kamionë në drejtime të panjohura. Vrasjet e para të meshkujve, të cilat i kanë parë pjesëtarët e UN-it janë kryer pas "shtëpisë së bardhë", në të cilën meshkujt janë zënë robër e më pastaj janë dërguar në Bratunac.

Derisa femrat, fëmijët dhe të moshuarit është munduar të shpëtohen duke shkuar në bazën e UN-it në Potoqare, një numër i madh i meshkujve të aftë për luftë, pjesëtarë të Divizionit të 28-të, të Armatës së BeH, pak para hyrjes së forcave të Mladić në qytet, më11 korrik, vendosin që mos të rrinë në Srebrenicë, por që të tentojnë depërtimin drejt territorin nën kontrollin e Armatës BeH. Kolona, e cila në disa drejtime ka tentuar depërtimin, ka numëruar rreth 10.000 deri 15.000 njerëz, e cila ka qenë në mes të 12-15 kilometrave e gjatë. Ushtria e Republika Srpska me çdo çmim ka tentuar të pengojë depërtimin e kolonës në territorin e sigurtë, dhe kolona gjatë tërë kohës, që prej 12 korrikut, ka qenë e ekspozuar ndaj sulmeve të rënda.

Pjesa e parë e kolonës ka mundur që të depërtojë në territorin nën kontrollin e Armatës së BeH më 16 korrik të vitit 1995. Srebrenicasit, të cilët nuk arritën që të depërtonin, janë zënë robër dhe janë mbajtur në lokacione të ndryshme, ku u janë bashkangjitur meshkujt, të cilët kanë mbetur në Potoqare, rreth 1000 veta. Numri më i madh i njerëzve nga kolona janë zënë robër në rrugën në mes të Bratuncit dhe Fushës Konjeviq më 13 korrik dhe janë transportuar në fushën e futbollit në Kasaben e Re, ose në livadhin tek vendi Sandiqi. Pasi, që autobusët, të cilët janë përdorur për transport të femrave, fëmijëve dhe të moshuarve, tash prapë janë liruar dhe kanë qenë në dispozicion, kanë shërbyer për transport të meshkujve të robëruar në vende, ku janë vrarë në ekzekutime masive të planifikuara paraprakisht.

Ekzekutimet janë bërë sipas një forme të caktuar, e cila tregon për faktin se kanë qenë të planifikuar dhe koordinuara në mënyrë të kujdesshme.[267] Vrasjet janë kryer kryesisht në lokacionet në ultësirën e Cerskes, në depon në Kravica, në ekonominë Ushtarake në Branjevc, Orahovc, te Kozluki dhe tek diga në afërsi të Petkovcit. Pas vrasjeve vinte makineria, e cila ishte aty për të bërë varrosjen e njerëzve në varreza masive. Gjatë vjeshtës të vitit 1995 është tentuar që të fshihen krimet, dhe trupat janë bartur në varreza dytësore, gjatë së cilës ka arritur edhe deri te dëmtimi i kufomave dhe deri te ajo që pjesë të ndryshme të kufomave të njëjta të varrosen në varreza të ndryshme. Deri te fillimi i gjykimit ndaj Radislav Krstić, janë gjetur lokacionet e 21 varrezave, nga të cilat 14-të kanë qenë varreza të para. Dëshmitë forenzike kanë treguar se bëhet fjalë për persona, që nuk kanë vdekur në betejë, por janë vrarë. Zhvarrosja ka treguar që viktimat para se të vriteshin kanë qenë të lidhura ose kanë pasur lidhëse në sy. Gjatë kohëzgjatjes së procedurës janë identifikuar 2028[268] trupa të vrara në Srebrenicë, ndërsa përfundimisht në korrik të vitit 2013, numri i viktimave të identifikuara dhe të varrosura ka qenë 6066.

Ajo çfarë ka ndodhur në Srebrenicë, ka pasur dhe ende ka pasoja të papara dhe katastrofike për familjet e boshnjakëve myslimanë nga ky qytet. Shumica e familjeve ka humbur anëtarët meshkuj, ndërsa shpesh kanë qenë në pyetje edhe tri gjenerata nga e njëjta familje që janë vrarë. Për shoqëritë patriarkale, në të cilat kanë jetuar këto familje, një humbje e tillë do të thotë edhe pasiguri dhe standard i ulët i jetesës për anëtarët e mbijetuar. Dhoma Gjyqësore, poashtu me të dre-

266 Fondi për të Drejtën Humanitare, *Aktgjykimet - Srebrenicë*, (Beograd: Fondi për të Drejtën Humanitare", 2005), faqe 90.

267 Ibid. faqe 366-417.

268 D. Manning, *Hetimi Srebrenica: Përmbledhje e provave Ligjore, Pikat e ekzekutimit dhe varrezat masive,* 2000, faqe. 7614.

jtë ka marrë parasysh edhe pasojat afatgjata, të cilat eliminimi i shtatë deri tetë mijë meshkujve nga Srebrenica do të ketë në mbijetesën e kësaj bashkësie. Duke konsideruar pasojat, Dhoma Gjyqësore, në mënyrë të drejtë është koncentruar për gjasat fizike të mbijetesës së kësaj bashkësie. Siç ka konstatuar Dhoma Gjyqësore, meshkujt e vrarë kanë përbërë diku rreth një të pestën e tërë bashkësisë srebrenicase. Dhoma Gjyqësore ka arritur në përfundim se duke pasur parasysh karakterin patriarkal të bashkësisë së boshnjakëve myslimanë në Srebrenicë, vrasja e një numri kaq të madh të meshkujve "padyshim do të ketë pasojë zhdukjen fizike të popullatës boshnjake myslimane në Srebrenicë [...] Shkatërrimi fizik i meshkujve, prandaj ka pasoja të rrënda për ka krijimi i pasardhësve në bashkësinë myslimane srebrenicase, me mundësi të zhdukjes së bashkësisë."[269] Nëpër çfarë vuajtjesh kalojnë femrat, që kanë humbur më të afërmit më së miri dëshmohet nga dëshmia e një nëne, djali i mitur i së cilës është vrarë në Potoqare: ''E ëndërroj gjatë gjithë kohës, e ëndërroj si vjen më sjell lule dhe më thotë "Nënë ja ku jam", Unë e përqafoj dhe e pyes "Ku ke qenë biri im", ndërsa ai më thotë: "Gjatë gjithë kohës kam qenë në Vlasenic." (Dëshmitarja DD, T.5769)

Nuk ka dyshim për atë se çfarë ka ndodhur pas marrjes së Srebrenicës edhe disa muaj më pastaj. TNPJ në aktgjykimin ankues, gjeneral Krstić, krimin në Srebrenicë e ka karakterizuar si gjenocid.

## 3. Gjykimi ndaj Radislav Krstić

Gjykimi ndaj Radislav Krstić, ish-komandantit të Korpusit të Drines së Ushtrisë së Republika Srpska, ka filluar më 7 dhjetor të vitit 1998, vetëm pesë dite pasi që në aksionin e forcave të NATO-s në BeH, të quajtura Stabilization Force (SFOR), është arrestuar në fshatin Vrshani, derisa po udhëtonte drejt Banja Llukës. Radislav Krstić është i lindur në fshatin Negjalishta, komuna Vlasenica, në vitin 1948. Në Vlasenic e përfundon shkollën fillore, ndërsa në Han Pjesak shkollën e mesme. Akademinë Ushtarake e përfundon në Beograd në vitin 1972 dhe para luftës fiton gradën e nënkolonelit të APJ. Me fillimin e luftës ka qenë komandant i Brigadës së 2-të motorike të Romanit, e cila ka qenë pjesë e korpusit Sarajevo-romane e më vonë e bashkangjitur Korpusit të Drines. Nga muaji i dhjetë i vitit 1994 e deri më 12 korrik të vitit 1995, ka qenë zëvendëskomandant i korpusit të Drinës. Komandën e Korpusit të Drinës, me rreth 15.000 ushtarë e ka marrë m 13 korrik të vitit 1995, kur është ngritur në gradën e gjeneral-majorit. Atëherë ai ka komanduar, në mes të tjerash, me Brigadën e Miliqit, Bratunaqit dhe Zvornikut ("Ujqërit nga Drina"), të cilët kanë pasur rol aktiv gjatë tragjedisë srebrenicase. Të gjitha veprat penale kanë ndodhur në zonën e përgjegjësisë së korpusit, në krye të cilit ka qenë gjenerali Krstić.[270] Aktakuza për gjenocid, krim kundër njerëzimit dhe shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës është ngritur më një dhjetor para TNPJ. Për të gjitha pikat e aktakuzës, gjenerali Krstiq është vetëdeklaruar si i pafajshëm. Aktgjykimet, që kanë pasuar në procedurën e shkallës së parë dhe të dytë janë disa nga më të rëndësishmet që i ka dhënë TNPJ. Kanë shkaktuar mjaft polemika, posaçërisht lidhur me aktgjykimin dënues për gjenocid, ndërsa është interesant vendimi i gjykatës, që gjenerali Krstić ka marrë pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, e cila para Këshillit Apelues është hequr.

Në procedurën para Këshillit Gjyqësor janë dëgjuar 103 dëshmitarë të akuzës dhe 13 dëshmitarë të mbrojtjes dhe dy dëshmitarë të Këshillit Gjyqësor. Gjenerali Krstić ka dëshmuar në vetëmbrojtje. Për 58 dëshmitarë janë përdorur masat mbrojtëse, ndërsa 9-të prej tyre kanë dëshmuar pas dyerve të mbyllura.

Në fokus të këtij punimi do të jetë analiza e aktgjykimit lidhur me gjenocid.



### 3.1. Dënimi për gjenocid

''Asnjë përshkrim nuk mund të ndjellë tmerrin e ngjarjeve të cilat janë zhvilluar në Srebrenicë gjatë këtyre nëntë ditëve, prej 10 deri 19 korrik 1995, si dhe vetë peshën e dijenisë që një njeri nën presionin e luftës mund të ulet në mizori të tilla. Gjatë pak më shumë se një jave, mijëra jetë janë shuar, rrënuar në mënyrë të pariparueshme ose thjesht janë fshirë nga faqet e historisë."[271]

Që të kuptojmë sa më mirë se çfarë nënkuptohet nën kuptimin e gjenocidit, si e ka definuar krimin në Srebrenicë TNPJ, do t'i kthehemi definicionit të gjenocidit që gjendet në nenet II dhe III të Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Gjenocidit. Sipas nenit II: "Në këtë konventë, gjenocid do to thotë cilado prej këtyre veprave të kryera me qëllimin që në mënyrë të plotë ose të pjesërishme të shkatërrohet grupi nacional, etnik, racor ose religjioz. Si të tilla janë:

269 Fondi për të Drejtën Humanitare, *Aktgjykimet - Srebrenicë*, (Beograd: Fondi për të Drejtën Humanitare", 2005), faqe 478.

270 Ibid., faqe 244.

271 Prokurori kundër Radislav Krstić, Lënda nrr. IT-98-33-T, Aktgjykimi, 2 gusht 2001, faqe 71.

a) Vrasja e pjesëtarëve të grupit (popullit të caktuar);

b) Shkaktimi i lëndimeve të rënda trupore dhe shpirtërore ndaj pjesëtarëve të grupit;

c) Ekspozimi i grupit ndaj kushteve të tilla jetësore, që shkaktojnë shkatërrimin e pjesshëm ose total të tij;

d) Duke vendosur masa për parandalimin e lindjeve përbrenda grupit;

e) Zhvendosja e detyruar e fëmijëve nga një grup në tjetrën."[272]

Aktgjykimi gjeneral Krstić i ka dhënë një kontribut të madh zhvillimit të drejtës dhe praktikës ndërkombëtare në definimin e gjenocidit, e cila është e domethënies së pamatshme për të gjithë, që merren me çështjen e këtij krimi dhe kodit dhe procedurës penale ndërkombëtare dhe të drejtës në përgjithësi.

Këshilli Gjyqësor, në pjesën më ndjeshme të aktgjykimi dhe mbrojtjes dhe për të bazuar vendimin e vet, ka marrë parasysh para së gjithash, qëllimin dhe objektivin e konventës të vitit 1949, të drejtën ndërkombëtare zakonore, praktikën gjyqësore, raportin e Komisionit për të Drejtën Ndërkombëtare, *travaux préparatoires* të statutit të Romës dhe praktikën e legjislacionit të shteteve. Sa i përket *actus reus-it* për këshillin Gjyqësor nuk ka pasur dyshim. Vrasjet dhe shkaktimi i lëndimeve të rënda trupore dhe shpirtërore kanë qenë elemente, që janë dëshmuar. Çfarë ka qenë problematike, ka qenë vendimi për elementin e dytë, për qëllimin. Këtu takohen dy qasje të ndryshme: të mbrojtjes dhe akuzës. Akuza ka supozuar se udhëheqja e boshnjakëve serbë ka pasur qëllim vrasjen e të gjithë meshkujve të aftë për luftë, ndërsa në anën tjetër mbrojtja ka konsideruar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme që të kënaqet ky element i rëndësishëm i qëllimit, por duke mos mohuar se është vrarë një numër i madh i meshkujve të aftë për luftë. Duke marrë parasysh vrasjet masive të cilat, me intensitetin më të madh janë kryer në mes të 13 dhe 16 korrikut dhe më pak deri më 19 korrik, si dhe mënyrën në të cilën janë robëruar njerëzit, mënyra sistematike e vrasjeve të tyre qartë ka treguar për qëllimin që të vriten të gjithë meshkujt civilë dhe pjesëtarë të ushtrisë, edhe pse në fillim qëllimi ka qene të likuidohen vetëm ata që janë ushtarakisht të aftë. Kjo është arritur të kuptohet nga urdhrat e gjeneral Zhivanoviqit, i cili në atë kohë ka qenë komandant i Korpusit të Drinës, ku përmendet lista e kriminelëve të luftës, të cilët duhet të gjinden. Pas kësaj urdhërese, ka ardhur vendimi për likuidimin e të gjithë meshkujve të aftë për luftë, pa dallim mes civilëve dhe ushtarakëve. Në bazë të gjithë asaj çfarë ka ndodhur, akuza gjen qëllimin për shkatërrimin e grupit, ndërsa mbrojtja prapë konsideron se qëllimi që të vriten të gjithë meshkujt e aftë për luftë nuk e arrijnë atë standard, që të shkatërrohet grupi si i tillë, çkae kërkohet për një krim siç është gjenocidi. Duke marrë parasysh Konventën për Gjenocid, Rezolutën 96 (1) të Asamblesë së Përgjithshme të KB dhe praktikën gjyqësore si burim i rëndësishëm i të drejtës, qartë vërehet se qëllimi i gjenocidit që të shkartohet grupi si i tillë dëshmohet me: ''Vetë grupi është qëllimi përfundimtar ose viktima e planifikuar e kësaj sjelljeje masovike dhe kriminale [...] Qëllimi duhet të jetë shkatërrimi i grupit "si i tillë", pra i një entiteti të veçantë dhe të ndarë."[273]

Tani do të fokusohemi në elementin tjetër, dhe këto janë grupet e mbrojtura, të cilat sipas definicionit grupe nacionale, etnike, racore ose fetare. Sa i përket krimeve në Srebrenicë, grupi i cili ka qenë i targeëuar ka qenë ai i boshnjakëve muslimanë. Akuza, në procedurën paraprake, flet për "popullatën boshnjako-muslimane të Srebrenicës" "[274], procedura finale e akuzës definon grupin si boshnjakë muslimanë nga Srebrenica, ndërsa në fjalën përfundimtare të akuzës thuhet se bëhet fjalë për "boshnjakë muslimanë nga Bosnja Lindore". Kjo mbrojtjen e ka nxitur që të reagojë se një grup i definuar në këtë mënyrë, boshnjakët muslimanë të Srebrenicës, nuk e përben një grup, që gjendet në definicion, duke thënë se "nuk mund të krijohet artificialisht, grupi, me përkufizim në një zonë gjeografike të caktuar ".[275] Këshilli Gjyqësor, lidhur me definimin e "grupit të mbrojtur", ka vendosur se duhet të përdoret shprehja: boshnjakët muslimanë" Grupi, në mënyrën si është definuar nga ana e akuzës, është pjesë e grupit të mbrojtur të definuar sipas Nenit 4. Është pyetje thelbësore nëse qëllimi për shkatërrimin e një pjese të grupit të mbrojtur paraqet gjenocid. Në këtë jep përgjigje edhe Konventa KMO ,e cila thotë "Qëllimi duhet të jetë shkatërrimi i grupit dhe jo vetëm i një ose



272 Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Gjenocidit, Neni 2.

273 *Draft i Kodit KMP* – Draft i kodit të krimeve kundër paqes dhe sigurisë së njerëzimit të Komisionit për të Drejtën Ndërkombëtare, Report of the International Law Commission on the Work on its Forty-Eighth Session, 6 May - 26 July 1966 /Raporti i Komisionit për të Drejtën Ndërkombëtare për punën e javës së katërdhjetë e tetë, 6. maj – 26 korrik 1996/, G.A.O.R., 51st Sess., Supp. No. 10, 30, U.N. Doc. A/51/10, faqe 88.

274 Paraprocedura hetimore e prokurorit bazuar në rregullat 65ter(E)(i), 25 shkurt 2000, par.12.

275 Procedura përfundimtare e të akuzuarit, par.104.

më shumë individëve, të cilët sipas rrethanave janë pjesëtarë të një grupi [...] Vepra kundër individit duhet të kryhet për shkak të përkatësisë së tij në grupin e caktuar dhe si hap drejt realizimit të qëllimit përfundimtar, që është shkatërrimi i grupit."[276] Duhet pasur parasysh faktin se një përqindje e madhe e boshnjakëve musliman është zhvendosur nga territori, të cilin e ka kontrolluar Korpusi i Drinës, dhe se URS ka pastruar në mënyrë etnike qytete të shumta dhe fshatra dhe se një pjesë e kësaj popullate ka ikur në Srebrenicë, e cila nga të 37.000 të dëbuarit, në atë kohë ka pasur në mes të 50.000 dhe 60.000 banorë, ndërsa territori i komunës është zvogëluar nga 900 $km^2$ në $km^2$. Banorët e Srebrenicës i janë nënshtruar granatimit, kolonat e ushqimit dhe ilaçeve kanë qenë të ndaluara, kështu që ka mbretëruar mungesë. Gjithashtu, ujësjellësi dhe rrjeti i rrymës elektrike kanë qenë të shkëputura. Operacioni "Krivaja 95" nuk ka folur në mënyrë specifike për dëbimin e muslimanëve nga Srebrenica, mirëpo për ndërprerjen e komunikimit në mes të dy enklavave, por edhe për zvogëlimin e territorit nën kontrollin e Armatës së BeH në vetë qendrën e qytetit. Duke marrë parasysh se nuk ka pasur rezistencë më të madhe as nga forcat e armatosura të boshnjakëve muslimanë e as nga reagimi i bashkësisë ndërkombëtare, që ka munguar. Kryetari i Republika Srpka jap urdhrin që të mirret edhe qyteti, që ka sjellë deri te dëbimi i popullatës civile dhe vrasjeve masive të muslimanëve srebrenicas. Çështja është nëse një sulm i kryer në këtë mënyrë ka pasur si qëllim që të shkatërrojë grupin sipas nenit 4 të Statutit. Këshilli Gjyqësor konstaton,, pa dyshim, se dëshmitë tregojnë se janë kryer vrasje të planifikuara, që verrtetojnë se është sjellë vendim që të vriten të gjithë boshnjakët muslimanë. Edhe pse nuk mund të flitet për datën e saktë se kur është sjellë ky vendim, Këshilli Gjyqësor është i bindur se një plan i tillë ka ekzistuar. Këshilli Gjyqësor ka shqyrtuar edhe shkatërrimin e objekteve kulturore dhe fetare, të cilat nuk janë veprime gjenocidi në vete, por në kombinim me shkatërrimin fizik dhe biologjik mund të konsiderohen "me të drejtë të plotë si qëllim që të shkatërrohet grupi".

Pjesë e definicionit, që ka të bëjë me fjalën *pjesërisht,* në aktgjykim shpjegohet në disa kuptime: me shpjegime të ndryshme të kuptimit të termit *shkatërrim i pjesshëm* si dhe praktikavegjyqësore, që e trajtojnë këtë term ndryshe. Pra, pyetja kryesore është se nëse grupi i viktimave srebrenicase përfaqëson pjesë të mjaftueshme të popullatës boshnjake muslimane për t'u konsideruar krimi kundër tyre ne bazë të nenit 4, pra si gjenocid. Interpretimet janë të ndryshme: që duhet të shkatërrohet një pjesë e konsiderueshme e grupit të mbrojtur, Komisioni për të Drejtën Ndërkombëtare deri te drafti i Konventës për Gjenocidin, ku thuhet se "shkatërrimi sistematik edhe i një pjese të vogël të një grupi të qenieve njerëzore paraqet një vepër mizore".[277] E drejta diskrete e secilit gjykatës është që të caktojë se çfarë është kjo e *mjaftueshme.* Këshilli Gjyqësor ka marrë qëndrim se qëllimi i shkatërrimit të grupit, dhe madje edhe shkatërrimi i pjesshëm "do të thotë aspiratë që të shkatërrohet një pjesë e posaçme e grupit, dhe jo cilido pjesëtar i këtij grupi".[278] Përfundim me rëndësi është që kryerësit e gjenocidit, pjesën e grupit, të cilën duan ta shkatërrojnë e konsiderojnë si entitet të ndarë, i cili si i tillë duhet të eliminohet. Këshilli Gjyqësor në këtë rast ka ardhur në këtë përfundim:

''Plani luftarak, që për pasojë ka vrasjen e një numri të caktuar të pjesëtarëve të një grupi të mbrojtur, në disa vende brenda një hapësire të caktuar gjeografike, nuk duhet pra, kualifikuar si gjenocid, pa marrë parasysh numrin e madh total të viktimave, pasi që nuk është i qartë qëllimi i grupit se janë kundër ekzistimit të grupit si të tillës. Përkundrazi, vrasja e të gjithë anëtarëve të grupit, të lokalizuar brenda një hapësire më të vogël gjeografike, edhe nëse si rezultat ka numër më të vogël të viktimave do të kualifikohet si gjenocid atëherë kur është kryer me qëllimin që të bëhet shkatërrimi i grupit si i tillë, i lokalizuar brenda një hapësire më të vogël gjeografike."[279]

Prokuroria dhe mbrojtja kanë paraqitur qëndrime të kundërta kur bëhet fjalë për dyshimin nëse vrasja e boshnjakëve muslimanë nga Srebrenica është kryer me qëllim që të shkatërrohet një pjesë e konsiderueshme e grupit apo jo?! Prokuroria ka paraqitur të gjitha dëshmitë për krijimin e territorit të "pastër", asaj çfarë ka pasuar pas rënies së Srebrenicës, ka përkujtuar në Direktivën nr. 7-të dhe ka ardhë në përfundim se vrasjet e meshkujve kanë pasur si pasojë shkatërrimin e bashkësisë boshnjake muslimane në Srebrenicë. Mbrojta në vazhdim ka luajtur me numra, duke krahasuar shifrën e 7.500 të vrarëve me 1.4 milion boshnjakët muslimanë, që sipas tyre nuk paraqet një pjesë të konsiderueshme të grupit. Poashtu i përmendin disa fakte,



276 Draft Kodi KMP, faqe 109.

277 Draft Convention for the Prevention and Punishment of Genocide Presented by the Secretary-General, June26th, 1947, UN Doc. E/447, faqe 24.

278 Fondi për të Drejtën Humanitare, *Aktgjykimet - Srebrenicë,* (Beograd: Fondi për të Drejtën Humanitare", 2005), faqe 391.

279 Ibid.

që shkojnë në dobi të asaj se qëllimi për gjenocid nuk ka ekzistuar, pasi që fëmijët, femrat, të moshuarit dhe të lënduarit janë kursyer dhe janë transportuar në territor të sigurtë dhe pohojnë se asnjë nga ekspertët ushtarakë, të cilët kanë dëshmuar, nuk ka arritur deri në përfundim se vrasjet kanë shërbyer si qëllim për arritjen e planit që boshnjakët muslimanë të shkatërrohen si grup.

Këshilli Gjyqësor, duke paraqitur faktet e pamohueshme rreth vrasjeve, ka arritur në përfundim se URS ka pasur qëllim që të shkatërrojë të gjithë muslimanët në Srebrenicë dhe se kryerësit e këtyre krimeve është dashur të dinë se vrasja e dy tre gjeneratave do të lënë pasoja afatgjata në tërë grupin. Vrasjet së bashku me dëbimin, shkatërrimin e shtëpive dhe objekteve fetare, ka pasur si pasojë zhdukjen fizike të muslimanëve në Srebrenicë dhe me këtë Këshilli Gjyqësor ka arritur në përfundim se në korrik të vitit 1995, në Srebrenicë është kryer gjenocid. Këshilli Gjyqësor megjithatë thekson se aty ku në vepër shihet shkatërrim fizik ose biologjik, shpesh gjinden edhe elemente të sulmit mbi trashëgiminë kulturore dhe fetare, si dhe në simbolet e grupit, sulme që me të drejtë të plotë mund të konsiderohen si dëshmi e qëllimit të shkatërrimit të grupit. Në këtë lëndë, prandaj Këshilli Gjyqësor, do të marrë si dëshmi të qëllimit për shkatërrimin e grupit edhe shkatërrimin e paramenduar të xhamive dhe shtëpive, që u përkisnin pjesëtarëve të grupit."[280]

Për sa i përket përgjegjësisë së gjeneral Krstić, në aktgjykimin e Këshillit Gjyqësor në detaje përmenden dhe analizohen të gjitha elementet e prokurorisë dhe mbrojtjes. Prokuroria ka marrë qëndrim se gjeneral Krstiq është përgjegjës për vepra penale sipas Nenit 7 (1) të Statutit, i cili përmban elemente të ndryshme të përgjegjësisë individuale penale siç janë: planifikimi, nxitja, urdhërimi, kryerja, ndihmesa dhe përkrahja si dhe pjesëmarrja në ndërmarrjen e përbashkët kriminale. Gjithashtu të akuzuarit i vihet në barrë edhe përgjegjësia komanduese për këto krime.

Në diskutimin e përgjegjësisë së Krstić, Këshilli Gjyqësor është fokusuar në dy lloje të veprave penale, dhe atë në krizën humanitare dhe krim të terrorit, që është kryer në Potoqare, dëbim i femrave, fëmijëve dhe të moshuarve si dhe ekzekutimet masovike të personave të aftë për luftë.

Sipas përfundimeve të Këshillit Gjyqësor, gjenerali Krstić ka pasur një rol qenësor gjatë gjithë operacionit në Srebrenicë. Fillimisht më 12 korrik, ai ka marrë pjesë në organizimin e autobusit për transportimin e femrave, fëmijëve dhe të moshuarve, ka ditur se meshkujt po ndahen dhe se me mijëra nga ta janë të zënë robër në përpjekje për të arritur territorin e sigurt. Ka qenë i qartë fakti se nga deklarata e gjeneralit Mladić e që thoshte se nëse në mes të boshnjakëve muslimanë ka kriminelë lufte nuk ka pasur asnjë kuptim. Gjenerali Krstić me 13korrik të vitit 1995 ka marrë komandën mbi Korpusin e Drinës dhe atë ditë veç është dashur të jetë në dijeni që mbi meshkujt e aftë për luftë po kryheshin vrasje masive, pra para se njësitë e këtij Korpusi, Brigada e Zvornikut dhe Bratunikut, të marrin pjesë në mënyrë aktive në këto krime. Megjithatë, këtu nuk përfundon ndihma e këtij korpusi në kryerjen e këtij gjenocidi në Srebrenicë, por kjo shihet edhe në atë se njësitet e tyre kanë marrë pjesë në varrosjen e trupave. Ndihma e Korpusit të Drinës ka qenë konkrete edhe gjatë nxënies, gjatë vrasjes dhe gjatë varrosjes së të vrarëve. Zinxhiri komandues gjatë kohës së marrjes së Srebrenicës ka qenë i rregulltë, që do të thotë që gjenerali Krstić ka pasur kompetenca komanduese dhe kontrolluese, pra ka pasur, siç përmendet në aktgjykim, kontrollë efektive në njerëz dhe mjete duke filluar nga 13 korriku. Nga kjo ditë ai mund të shihet si pjesë e planit që të vriten të gjithë boshnjakët muslimanë.

Këshilli Gjyqësor përfundon përtej dyshimit të bazuar se gjenerali Krstić, nga mbrëmja e 13 korrikut dhe më tej ka marrë pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale që të vriten meshkujt e aftë për luftë, boshnjakë muslimanë nga Srebrenica."[281] Nuk ka pasur dëshmi se ka marrë pjesë në përpilimin e këtij plani, por "ka pasur qëllimin gjenocidal që meshkujt të vriten". Këshilli Gjyqësor, poashtu ka arritur në përfundim që meshkujt e aftë për luftë nga Srebrenica kanë përbërë shumicën e konsiderueshme të grupit, pasi që vrasja e tyre do të thotë fund i të gjithë bashkësisë së boshnjakëve muslimanë në Srebrenicë: "Duke marrë parasysh se ai ka luajtur rol kyç në shpërngulje e dhunshme të femrave, fëmijëve dhe të moshuarëve, muslimanë, nga territori nën kontrollin serb, gjenerali Krstić pa mëdyshje ka qenë i vetëdijshëm për pasojat fatale, që vrasja e meshkujve do të ketë në aftësitë e bashkësisë boshnjako-myslimane në Srebrenicë që të mbijetojë si e tillë. Gjenerali Krstić, pra, ka marrë pjesë në vepra



280 Prokurori kundër Radislav Krstić, Lënda nr. IT-98-33-T, Aktgjykimi, 2 Gusht 2001, faqe 246.

281 Fondi për të Drejtën Humanitare, *Aktgjykimet - Srebrenicë*, (Beograd: Fondi për të Drejtën Humanitare", 2005), faqe 417.

282 Ibid., faqe 417.

gjenocidale të vrasjes së pjesëtarëve të grupit sipas Nenit 4(2)(a) me qëllim shkatërrimin e grupit."[282] Poashtu ai mban përgjegjësinë për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore dhe shpirtërore. Prokuroria është qasur në atë mënyrë që gjeneralin Krstiq në mënyrë alternative e ka ngarkuar për gjenocid [4(2) ose 4(3)(a)] ose për pjesëmarrje në gjenocid [4(3)(e). Një pyetje interesante, e cila është shfaqur para Këshillit Gjyqësor ka qenë e lidhur me atë nëse pjesëmarrja në ndërmarrjen e përbashkët kriminale i përgjigjet gjenocidit ose pjesëmarrjes në gjenocid, pra, nëse pjesëmarrësi i ndërmarrjes së përbashkët kriminale mund të kualifikohet si kryes ndihmues ose kryesor. Në përfundimin e saj Këshilli Gjyqësor përkujton se gjenerali Krstić ka marrë pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale me qëllim që të vrasë boshnjakët muslimanë nga Srebrenica dhe se që një qëllim i tillë i tij paraqet qëllim gjenocidal. Ai nuk ka qenë ai i cili ka vrarë, por ka qenë i rëndësisë së madhe në realizimin e këtij plani dhe prandaj gjenerali Krstić është fajtor për gjenocid sipas nenit 4(2)(a). Këshilli Gjyqësor e ka shpallur përveç të tjerave (përndjekjes dhe vrasjes), Radislav Krstić fajtor për gjenocid dhe i ka dhënë dënim 46-vjet burgim.

Në procedurën ankuese, mbrojtja është ankuar në vendimin e Këshillit Gjyqësor se gjeneral Krstiqi është përgjegjës për gjenocid, përsëri duke e vënë theksin në definimin *pjesës së grupit* dhe vendosjes së qëllimit për t'u shkatërruar grupi, por Këshilli Apelues ka vendosur që ankesa, sipas kësaj çështjeje, të refuzohet, prapë duke përkujtuar se çfarë ka ndodhur. "Këshilli Apelues me bindje të plotë deklaron se e drejta dënon, me formulime përkatëse, dëmin e madh dhe të përhershëm që është kryer dhe vrasjet në Srebrenicë i quan me emrin e tyre të vërtetë: gjenocid."[283]

Megjithatë në ankesën e vënë për pjesëmarrje në ndërmarrjen e përbashkët kriminale për të kryer gjenocid, përfundimi preliminar i Këshillit Apelues është se Radislav Krstić nuk ka qenë kryes kryesor, por e ka kualifikuar përgjegjësinë e tij si të ndihmues dhe përkrahës i gjenocidit, pasi që gjenerali Krstić ka qenë i vetëdijshëm i qëllimit të disa oficerëve të ranguar lartë të URS, që të kryhet gjenocid, dhe nuk ka bërë asgjë që ta ndalojë këtë. Sipas mendimit të Këshillit Apelues, Këshilli Gjyqësor nuk ka paraqitur fakte të mjaftueshme për të dëshmuar se edhe gjeneral Krstić ka pasur qëllim gjenocidal.[284]

Si përfundim, Këshilli Apelues ka anuluar vendimin e Këshillit Gjyqësor për pjesëmarrje të gjeneral Krstić në ndërmarrjen e përbashkët kriminale që të kryhet gjenocid, si dhe pohimin se ai ka qenë pjesëmarrës i drejtpërdrejt në vrasje, por e ka vlerësuar se secili nga ta ka qenë ndihmës dhe se ka përkrahur kryerjen e këtyre krimeve dhe e ka dënuar me 36-vjet burgim.

## 4. Përfundim

Aktgjykimi ndaj gjeneral Krstić është i pari, të cilën TNPJ e ka dhënë për gjenocid për Luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë, si dhe i pari i këtij roli në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. Rëndësia e këtij aktgjykimi duhet parë edhe në kontekstin e zhvillimit të drejtës penale ndërkombëtare si dhe praktikës gjyqësore, por edhe kontributet e proceseve gjyqësore pas kësaj. Kualifikimi juridik që e ka përkrahur Këshilli Apelues i TNPJ në rastin Krstić, është aprovuar edhe në disa lëndë tjera, që janë kryer para kësaj gjykate.[285] Poashtu, më 26 shkurt të vitit 2007, në lëndën e Bosnje dhe Hercegovinës kundër Serbisë, lidhur me shkeljen e Konventës për parandalimin dhe dënimin e gjenocidit, Tribunali Ndërkombëtar i Drejtësisë ka arritur në përfundim se veprat e kryera në Srebrenicë, të cilat bien nën nenin II (a) dhe (b) të Konventës, të kryera me qëllimin që pjesërisht të shkatërrohet grupi i muslimanëve nga Bosnja dhe Hercegovina si e tillë, dhe sipas kësaj këto janë vepra të gjenocidit, të kryera nga pjesëtarët e URS në dhe për rreth Srebrenicës, duke filluar më, përafërsisht, 13 korrik të vitit 1995.[286] Me këtë, ngjarjeve, nga korriku i vitit 1995, në qytetin lindor boshnjak, u është dhënë emri i tyre i vërtetë: gjenocid.



283 Ibid., faqe 482.

284 Ibid., faqe 529.

285 Rasti Popović dhe të tjerët, Ratko Mladić, Radovan Karadžić.

286 Application of the Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide (Bosnia and Herzegovina v. Serbia and Montenegro), Judgment, I.C.J. Reports 2007, faqe 297.

# Roli i mediave në procesin e pajtimit

Aldin Zenović

**Fjala hyrëse: Roli i mediave në procesin e pajtimit në hapësirën e ish-Jugosllavisë**

Masmediat moderne (gazetat, radio, televizioni dhe në kohët e fundit gjithnjë e më shumë edhe interneti) kanë rëndësi të madhe në formësimin e mendimit publik në botë, sepse brezi dhe kualiteti i informatave, që janë në dispozicion të shtresave të ndryshme të popullatës, si dhe mënyra në të cilën ato janë duke u prezantuar, në mënyrë madhore ndikojnë në qëndrimet e publikut në pyetje të shumta të interesit të përgjithshëm publik. Si në pjesët tjera të botës, edhe në hapësirat e ish-republikave jugosllave është i pashmangshëm ndikimi i mediave dhe rolit të tyre në formësimin e vetëdijes së gjerë publike.



Në procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes të shteteve, të cilat janë formuar në hapësirën e ish-RSFJ-së, dhe edhe më me rëndësi në procesin e formësimit të marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve, që kanë luftuar ndërmjet tyre gjatë viteve të 90-ta, roli i mediave është shumë i madh nëse jo edhe vendimtar.

Në procesin e pajtimit të popujve, të cilët deri vonë kanë qenë në luftë në hapësirën e ish- Jugosllavisë, mediat mund të ndikojnë në masën më të madhe në formimin e komunikimit pozitiv në mes tyre, si në procesin dhimbshëm të ballafaqimit të përbashkët me të kaluarën e përbashkët, poashtu edhe nëpërmjet respektimit të ndryshimeve të tyre kombëtare, kulturore dhe të identiteteve të ndryshme, ndërsa në masë edhe më të madhe duke i potencuar elementet kulturore dhe të tjera, që i kanë, të gjithë, të përbashkëta.

Megjithatë, pikërisht në fillim të viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar pjesa më e madhe e mediave më me ndikim (radio dhe TV stacionet më të dëgjuara dhe më të shikuara në frekuenca nacionale dhe gazetat me tirazhin më të madh në republikat e ish-Jugosllavisë) kanë qenë arma kryesore në shërbim të propagandës luftënxitëse dhe nxitjes ultranacionaliste në Serbi, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, ndërsa në masë më të vogël në republikat tjera.[287]

Me vendosjen në pozita udhëheqëse dhe të rëndësishme të kuadrove të përshtatshëm politikë, të cilët kanë qenë zëdhënës të politikave të tilla, është realizuar pothuajse kontroll e plotë ndaj informatave që i janë servuar publikut. Në këtë mënyrë, me anë të ndikimit destruktiv të mediave, publiku është përgatitur për konflikt të armatosur, sëbashku me degradimin ekonomik, social, moral dhe kulturor të këtyre shoqërive.

Në procesin e pajtimit mediat si të tilla kanë potencial të theksojnë ose zvogëlojnë fuqinë e simboleve të dëmshme që në një mënyrë paraqesin hap nxitës në përcaktimin e marrëdhënieve shoqërore (në rastin e popujve të ish-Jugosllavisë, simbole të tilla zakonisht paraqesin mite të ndryshme historike). Me vetë këtë, përfaqësimi medial i identitetit

287 Kemal Kurspahić, "Missed Opportunities in Postwar Bosnia", në: *Media and Global Change: Rethinking Communication for Development*, ur. Oscar Hemer dhe ThomasTufte, CLASCO, Buenos Aires 2005.

kombëtar historik bëhet i rëndësisë kritike në kuptimin e asaj se deri në çfarë mase mund të arrihet stabiliteti, në procesin e pajtimit dhe ndërtimin të identitetit të ri kombëtar dhe shoqëror.[288] Roli pozitiv ose negativ i mediave në një proces të tillë është i pamohueshëm. Në këtë kuptim është arritur një përparim i dukshëm në largimin e gjuhës së urrejtjes dhe mosdurimit nga mediat kryesore, Gjithsesi një retorikë e tillë nuk është zhdukur tërësisht, mirëpo në poshtërsinë e saj i është larguar formës në të cilën shprehet.

Sidoqoftë, gjuha e tolerancës, respektit dhe vlerësimit të dallimeve është bërë paradigma kryesore në gjuhën e përditshme të mediave kryesore në nivelin nacional (mainstream media).

Kjo gjuhë, është rezultat, në një pjesë të madhe, i lidhur me qëllimet e shteteve të rajonit që të anëtarësohen në Bashkimin Evropian (BE), i cili është për momentin njëri nga qëllimet e tyre kryesore strategjike. Një prej parakushteve për diçka të tillë është edhe përmbushja e standardeve evropiane, ndërsa një prej tyre gjithsesi se është edhe pavarësia e mediave më shkallë sa më të lartë të lirisë. Pikërisht në këtë qëndron edhe mundësia për promovim sa më të madh të procesit të pajtimit dhe përmirësimin e marrëdhënieve reciproke në hapësirën e ish-Jugosllavisë, jo vetëm për shkak të BE-së, por fillimisht për shkakun tonë. Përkrahje në këtë proces nuk duhet t'u ofrohet vetëm mediave kryesore, por ndoshta në masë më të madhe edhe mediave lokale.[289]

Kontribut në proceset e ballafaqimit me të kaluarën, kuptimit dhe pajtimit nuk jep vetëm raportimi medial në gjykimet e tribunalit të Hagës dhe në gjykata lokale, si dhe për projektet e shoqërisë civile, siç është Nisma për KOMRA dhe të tjerat, por edhe transmetimi i dëshmive individuale të personave, që kanë qenë viktima të krimeve të luftës në vitet e 90-të, ndonjëherë të shfaqura edhe nëpërmjet veprave dhe pikëpamjeve artistike. Si shembull të kësaj, temë të këtij punimi, do të paraqes: Raportimi i mediave në ekspozitën *Bogujevci – historia vizuale, homazh të gjitha familjeve dhe viktimave të luftës,* të Saranda, Fatos dhe Jehona Bogujevcit, e cila u mbajt ne Beograd, më 18 Dhjetor, të vitit 2013, me rishikim në raportimin e mediave të ndryshme për këtë rast, e që paraqet jo vetëm raportim të raportit të tyre ndaj ekspozitës, por në masë të madhe edhe për pikëpamjen e tyre në procesin e pastrimit nga e kaluara dhe përmirësimit të marrëdhënieve reciproke të popujve nga hapësira e ish-Jugosllavisë.

## "Nga jeni?"

### Rasti i fëmijëve të familjes Bogujevci

Nga 18 dhjetori 2013 deri më 12 janar të vitit 2014, në hapësirat e Galerisë *Podroom,* nën ombrellën e Qendrës Kulturore Beograd, është organizuar ekspozita e tre artistëve nga Podujeva: Sarandës, Fatosit dhe Jehona Bogujevcit, nën emrin *Bogujevci: – historia vizuale, homazh të gjitha familjeve dhe viktimave të luftës.* Tema e ekspozitës paraqet jetën e familjes Bogujevci, nga e cila familje janë vrarë tetë anëtarë në masakrëne Podujevës, më 28 mars të vitit 1999, sëbashku me gjashtë anëtarë tjerë të familjes Duriqi, që ishin fqinj.

Të katërmbëdhjetët janë vrarë nga anëtarë të formacionit paraushtarak *Shkorpionët,* nga përbërja e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë, e cila është dërguar në Kosovë gjatë bombardimeve të NATO-s ndaj, atëherë, RSFJ-së, në vitin 1999.[290] Masakrës i kanë mbijetuar pesë fëmijë nga familja Bogujevci, Saranda (1985), Fatosi (1986), Jehona (1988), Lirija (1990) dhe Genci (1993). Që të pestët sot jetojnë në Mbretërinë e Bashkuar ndërsa arti paraqet mënyrën e tyre të ballafaqimin me të kaluarën e tyre. Kështu edhe ka lindur ekspozita: *Bogujevci – historia vizuale, homazh të gjitha familjeve dhe viktimave të luftës.*



288 Monroe E. Price, Nicole Stremlau, "Media and Transitional Justice: Toward a SystematicApproach", *International Journal of Communication* 6, USC 2012.

289 Konsultimet rajonale me gazetarë/e dhe redaktorë/e për Draftsatutin e KOMRA-s, Ljublanë, Slloveni, 10 shtator, të vitit 2010 (transkriptim i incizimit të zërit).

290 Në masakrën në Podujevë janë vrarë: Shehide Bogujevci (1932), Nefise Bogujevci Lugaliu (1945), Shefkate Bogujevci (1956), Sala Bogujevci (1960), Fedrizije Llugaliu (1978), Nora Bogujevci (1984), Shpend Bogujevci (1986), ShpetimBogujevci (1989), Isma Duriqi (1930), Fitnete Duriqi (1963), Dafina Duriqi (1990), Arber Duriqi (1992), Mimoza Duriqi (1995) dhe Albin Duriqi (1997). Në momentin e kryerjes së krimeve viktima më e vjetër i ka pasur gjashtëdhjetë e nëntë vjet ndërsa viktima më e re dy vjet. Pesë fëmijë, edhe pse të plagosur rrënd i kanë mbijetuar masakrës: Saranda Bogujevci, viti i lindjes 1985 dhe kushërinjtë e saj më të afërt vëllezër dhe motra nga axha: Fatos Bogujevci,1986, Jehona Bogujevci, 1988, Lirije Bogujevci, 1990 dhe Genc Bogujevci, 1993.

Ekspozita përbëhet prej tri pjesëve: pjesa e parë është e lidhur me jetën e familjes Bogujevci para se të ndodhë masakra. Kjo pjesë paraqet një dhomë me dy krevate dhe fotografi të pjesëtarëve të vrarë të familjes Bogujevci. Pjesa e dytë e ekspozitës paraqet një hapësirë, në të cilën gjinden krevate të spitalit, në të cilët kanë qenë të shtrirë fëmijët e mbijetuar Bogujevci, në spitalin e Prishtinës. Në pjesën e fundit, të tretën, të ekspozitës shihet një instalacion me xhirime të dëshmisë së fëmijëve Bogujevci, në vitet 2003 dhe 2008, në gjykimet ndaj anëtarëve të *Shkorpionëve* të akuzuar për krimin në Podujevë, të cilët më vonë janëdënuar me burgim në kohë prej 20 dhe 15 vjetësh.

Ekspozita është organizuar nga Qendra Kulturore Beograd dhe fondi Heartefakt dhe ka zgjuar interesim dhe ka pasur vëmendje të madhe të publikut. Në mes të vizitorëve në hapje të ekspozitës kanë qenë edhe kryeministri i Serbisë, Ivica Dačić, lideri i Partisë Liberal Demokrate (PLD) Čedomir Jovanović si dhe disa politikanë tjerë dhe fytyra publike.

Vizita e kryeministrit serb Dačić në ekspozitë ka shkaktuar interesim të madh të mediave ndërsa vetë kryeministri në ekspozitë dha ngushëllimet e tij për krimet që kanë ndodhur në Podujevë në vitin 1999, duke i dënuar këto dhe krimet e tjera të kryera gjatë luftërave në hapësirën e ish- Jugosllavisë dhe duke vlerësuar se ekspozita të tilla do të duhej të organizoheshin edhe në qytete tjera të mëdha në hapësirën e ish-Jugosllavisë. Megjithatë, kërkimfalja mungon nga kryeministri pasi që ai konsideron se "më e rëndësishme se kërkimfalja është ajo që kryerësit e veprës janë dënuar me burg dhe se, kur ata i kanë kryer këto krime, nuk kanë vepruar në emër të Serbisë e as që i ka autorizuar dikush për diçka të tillë." Në deklaratën e tij kryeministri dha vlerësimin se të gjithë kriminelët duhet të përgjigjen për atë që kanë bërë, përkatësisht të dënohen, ndërsa siç thotë edhe vetë: "disa tanimë janë dënuar".

Në anën tjetër Saranda Bogujevci, me këtë rast, ka deklaruar se kërkimfalja as nuk është e pritur, mirëpo është e rëndësishme që opinionit të gjerë t'i përcillet porosia e ekspozitës për atë se krimet janë diçka që nuk njohin komb, fe ose përkatësi tjera, se kërkimfalja është diçka që duhet të pasojë më vonë dhe se për këtë duhet bërë presion në Serbinë që të pranojë dhe të kërkojë falje për krimet ndaj shqiptarëve.

Qëllimi i ekspozitës ka qenë që vizitorëve t'ju paraqesë se çfarë ka ndodhur dhe domethënien që ka pasur për ata që kanë mbijetuar.

Saranda, Jehona dhe Fatosi janë tre nga pesë të mbijetuarit, anëtarë të familjes Bogujevci, që janë vrarë në masakrën në Podujevë, më 28 mars të vitit 1999, sëbashku me gjashtë anëtarë të familjes Duriqi, që ishin fqinj. Këta, të katërmbëdhjetit, janë vrarë nga anëtarë të formacionit paraushtarak *Shkorpionët,* nga përbërja e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë, e cila është dërguar në Kosovë gjatë bombardimeve të NATO-s ndaj atëherë RSFJ-së në vitin 1999.

Për pjesëmarrje në krimet në Podujevë në Serbi janë kryer dy gjykime të ndara ndaj pesë anëtarëve të Shkorpionëve: së pari Saša Cvjetan, i cili në vitin 2005 u shpall fajtor dhe u dënua me 20-vjet burgim.[291]

Më vonë para trupit gjykues për krime lufte në Gjykatën Rajonale në Beograd u është shpallur aktgjykimi edhe disa anëtarëve tjerë të *Shkorpionëve:* Dragan Medić, Dragan Borojević, Željko Đukić dhe Miodrag Šolaja, të cilët me aktvendimin e kësaj Gjykatë, në vitin 2009, janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar me 20, përkatësisht 15-vjet burgim.[292]

Saranda, Fatos dh Jehona Bogujevci kanë qenë dëshmitarë në dy proceset, së pari në vitin 2003 në gjykimin kundër Saša Cvjetan dhe herën e dytë në gjykimin ndaj Medić, Borojević, Đukić dhe Šolaja. Dëshmitë e tyre kanë kontribuar në mënyrë të ndjeshme që të akuzuarit për krimet në Podujevë në fund edhe të dënohen.

Edhe përkundër asaj se një pjesë e fajtorëve për krimet kundër familjes së tyre janë dënuar, kujtimi në Marsin e vitit 1999 asnjëherë nuk i ka lënë qetë artistët e rinjë që tani jetojnë në Mbretërinë e Bashkuar. Kjo ekspozitë përfaqëson dëshmi jo vetëm për ata, por edhe për të gjitha familjet tjera që kanë pësuar jo vetëm në konfliktet e ish-Jugosllavisë po edhe kudo tjetër pasi që mesazhi i tregimit të tyre është universal dhe na përket të gjithëve, kudo që gjendemi.

Paraqitja mediale e ekspozitës së Sarandës, Fatosit dhe Jehona Bogujevcit në Qendrën Kulturore në Beograd, si në ditët para ekspozitës, të themi në njoftimin e saj, poashtu

291 "Podujeva 1999 – jashtë çdo dyshimi", Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, 2006, faqe 315-326.

292 *Gjykimi për krimet e luftës në Serbi, Podujevë II*–webfaqja zyrtare e Fondit për të Drejtën Humanitare, e qasshme: http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/podujevo_2.html, hapur me: Janar 2014.

edhe pas vetë ekspozitës ka qenë shumë e ndryshme, varësisht për cilat media bëhej fjalë dhe çfarë ishte orientimi i tyre politik. Mënyra e raportimit të tyre rreth ekspozitës flet për atë se çfarë rëndësie i është dhënë dhe se në çfarë mënyra paraqitej ekspozita nga këto media.

Një pjesë e mediave e ka paraqitur ekspozitën nën një dritë pozitive, media të tjera kanë dërguar mesazh të qartë ose të mbuluar negativ rreth saj, ndërsa të tjerët janë munduar që të paktën zyrtarisht të qëndrojnë neutral, ku shumë prej tyre i kanë dhënë rëndësinë e një ngjarjeje ditore.

Në mesin e mediave, që kanë raportuar në mënyrë pozitive ka qenë Radio Europa e Lirë. Në faqen kryesore të 17 dhjetorit të vitit 2013, një ditë para mbajtjes së ekspozitës, në webfaqenzyrtare të Radio Evropës së Lirë, është publikuar intervista me Bogujevcët me titull "Familja Bogujevci për REU: T'ia tregojmë Beogradit tregimin e Kosovës".[293]

Në tekstin e intervistës flitet, në pjesën më të madhe, për ngjarjet tragjike në Podujevë më 28 mars të vitit 1999 dhe për dëshmitë e mëvonshme në gjykimet ndaj pjesëtarëve të *Shkorpionëve,* që kishin marrë pjesë në krimet e zhvilluara në Podujevë. Një pjesë e vogël e tekstit, në fund, u është kushtuar detajeve për ekspozitën, kush janë organizatorët e saj, kush e përkrahë atë, etj. Në tekst vërehet se theksi është vendosur në aspektin njerëzor të tregimit, meqë në pjesën qendrore të tekstit janë vendosur vuajtjet dhe përjetimet e aktorëve pa u dhënë rëndësi të veçantë e të panevojshme disa detajeve dytësore lidhur me ekspozitën. Më shumë rreth ekspozitës dhe kuptimit që ajo ka pasur për njerëzit që kanë punuar në organizimin e saj mund të shihet në artikullin me titull "Kush i frikohet ekspozitës për krimet", të autores Mia David, drejtoreshë e Qendrës Kulturore Beograd, gjithashtu e publikuar në webfaqen e Radio Evropa e Lirë[294], në vazhdën e kolumnës së autores "Nga këndi im". Teksti është publikuar më 16 dhjetor, do të thotë dy ditë para mbajtjes së ekspozitës. Në vetë tekstin flitet rreth asaj se si mbajtja e kësaj ekspozite është e planifikuar që dy vjet dhe se si ekspozita është anuluar disa herë për arsye të ndryshme. Është kritikuar presioni i madh politik në media nga ana e atyre forcave që u pengone mbajtja e një ekspozitë të tillë dhe rreth diskutimit për rëndësinë e saj për kulturën, e cila sidoqoftë paraqet një prej përbërësve kryesor të identitetit kombëtar. Në fund, siç thuhet në artikull, ka qenë e rëndësisë së veçante që ekspozita të mbahet në hapësirat e një institucioni zyrtar pasi që jetërat njerëzore janë më të rëndësishme se çfarëdo politike.

Është interesant artikulli i Marko Simonović, në magazinën *Ora e Rërës,* n me titull: "Prej nga janë fëmijët e familjes Bogujevci?", të publikuar më 4 janar të vitit 2014[295], pra dy javë pas mbajtjes së ekspozitës. Temë e artikullit është vetë ekspozita dhe simbolika e asaj se çfarë i ka ndodhur familjes Bogujevci e që sipas autorit mund të ndërlidhet me krejt atë se çfarë ka ndodhur në Kosovë si dhe me marrëdhëniet shqiptaro-serbe në përgjithësi. Sipas autorit bëhet fjalë për një situatë jo të zakonshme, ku një organ i Republikës së Serbisë ka shpëtuar pesë jetë fëmijësh, konkretisht SAJ dhe komandanti i tyre Spasoje Vulević "Vuk", i cili ka marrë pjesë në mbajtjen e ekspozitës në Qendrën Kulturore Beograd, nga vdekja e sigurtë, të cilën ua përgatitke një organ tjetër i të njëjtës Republikë të Serbisë, njësia *Shkorpionët.* Për autorin është moment thelbësor, siç thotë edhe vetë ,"dorëzimi" i fëmijëve Bogujevci në sistemin shëndetësor të Republikës së Serbisë. Ai ka qenë një veprim që ka mundësuar shpëtimin e tyre. Autori flet për tri "dorëzime" të Bogujevcëve në sistemin e Republikës së Serbisë. Pasi, siç thotë autori, "largimit të plotë nga llogaritja e specieve njerëzore dhe lënies në mëshirë të *Shkorpionëve",* Bogujevcët janë "dorëzuar" në sistemin shëndetësor, pasi që "kanë pasur lëndime shumë të thella që t'iu mohohej ndihma", më pastaj në sistemin gjyqësor, pasi që "kanë pasur dëshmi shumë të rënda që t'u mohohej e drejta për të dëshmuar" dhe në fund në qendrën kulturore të kryeqytetit, pasi që kanë "sjellë ekspozitën, për të cilën Dačić dhe Vučić janë pajtuar se "duhet të mbahet"."

Autori flet për papërshtatshmërinë e pyetjes së parë, të cilën kryeministri Dačić, në hapje të ekspozitës, ua ka shtruar Bogujevcasve, e cila ishte: "Nga jeni?" Prapë, autori konsideron se është produktive që të shqyrtohet marrëdhënia e



293 Radio Evropa e Lirë, Intervistë, *Familja Bogujevci për REL: Do t'ia tregojmë Beogradit të vërtetën për Kosovën*, webfaqja zyrtare e REL, e qasshme: http://www.slobodnaevropa.org/content/sestre-bogujevci-izlozbom-zelimo-da-kazemo-istinu/25203555.html, hapur me: Janar 2014.

294 Mia David, "Kush i frikohet ekspozitës për krimin?", webfaqja zyrtare e REL, e qasshme: http://www.slobodnaevropa.org/content/mia-david-ko-se-plasi-izlozbe-o-zlocinu/25202423.html, hapur me: Janar 2014.

295 Marko Simonović, "Prej nga janë fëmijët e familjes Bogujevci?", Peščanik.net, e qasshme: http://pescanik.net/2014/01/odakle-su-deca-porodice-bogujevci/, hapur me: Janar 2014.

Bogujevcasve dhe Serbisë, pikërisht nëpërmjet një pyetjeje të tillë, e cila siç thotë vetë autori "ndoshta është shtruar me qëllimin më të mirë, por prej saj kanë dalë e tërë zbrazëtia dhe moskuptimi, të cilat Serbinë e ndajnë nga familja Bogujevci".

Duke e përmbyllur tregimin për "tri dorëzimet" autori vjen në përfundim se ekspozita paraqet mbyllje të rrethit. Siç thotë autori, shteti i Serbisë, pas krimeve të *Shkorpionëve*ka shpëtuar jetërat e pesë Bogujevcasve, ndërsa sot me ekspozitën e tyre "Bogujevci – historia vizuale, homazh të gjithë familjeve dhe viktimave të luftës", fëmijët Bogujevci "shpëtojnë Serbinë [...]me paqen e tyre, por edhe me shqetësimin produktiv, me normalitetin e tyre gati të papërballueshëm, me mosfyerjen dhe gatishmërinë që të tregojnë tregimin e tyre në Beograd". Siç përfundon autori, këta tre artistë "të pamatshëm me ne për nga përvoja dhe përkatësia, qëndrojnë aty ku ne kurrë nuk do të mundemi dhe me tregimin e tyre nuk na lënë që t'i anashkalojmë, mos t'i vëmë re ose t'i harrojmë."

Një artikull i rëndësishëm në magazinën *Kontrapress,* me titull "Ballafaqimi me art", është ai i autores Žarka Radoja, i publikuar më 19 dhjetor, një ditë pas hapjes së ekspozitës.[296] Përveç hyrjes së shkurtër, në të cilën disa fjalë iu kanë kushtuat demonstrantëve djathtistë, të cilët protestonin në kohën e hapjes së ekspozitës, pjesa më e madhe e artikullit i është kushtuar vetë ekspozitës, dëshmisë së fëmijëve Bogujevci si dhe rëndësisë së ekspozitës në vetë procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes të dy popujve, dikur luftues në hapësirën e ish-Jugosllavisë, e cila në këtë proces jep kontribut. Në artikull flitet për kërcënimet dhe presionet, me të cilat kanë qenë të ekspozuar organizatorët e ekspozitës nga ana e forcave politike, të cilave ekspozita e tillë nuk iu ka përshtatur, si dhe për fushatën negative, të cilën, kundër ekspozitës, e kanë zhvilluar media të ndryshme. Sidoqoftë kërcënimet dhe presionet si dhe fushata negative nuk kanë mundur të ndalin mbajtjen e ekspozitës, pasi që siç thuhet në artikull "duket se presioni nga ana tjetër ishte më i fortë", duke pasë parasysh përkrahjen e pjesëve demokrate dhe proeuropiane, të cilët e përkrahnin mbajtjen e ekspozitës. Në pjesën përfundimtare të artikullit u dha një shikim për vizitën e kryeministrit Dačić në ekspozitë dhe deklaratën, të cilën e dha për atë se do të ishte keq "të flitej për viktimat tona ose të tyre, pasi që viktimat janë viktima".

Aty është, pastaj, edhe deklarata e Nataša Kandić për rëndësinë e vizitës së kryeministrit Dačić, që ia bëri një ekspozite të tillë, pasi që ai kishte ardhur në cilësi zyrtare, si kryeministër i Shtetit Serb. Nataša Kandić ka deklaruar se "asnjëherë nuk ka ndodhur që viktimave t'u afrohet kryeministri, i cili vjen nga partia, e cila është përgjegjëse për çka ka ndodhur".

Nga artikujt që tregojnë në dritë pozitive ekspozitën e Bogujevcasveasve në Beograd duhet të ndahet edhe shkrimi autorial i Nataša Kandić me titull "Fëmijët shqiptarë po na zgjatin dorën", publikuar në gazetën *Danas* më 21 dhjetor të vitit 2013.[297]

Në tekst, së pari, flitet për fushatën mediatike kundër mbajtjes së ekspozitës, nën pretendimet nga teksti në *Veqernje Novosti,* të 13 dhjetorit të vitit 2013, me titull "Propaganda shqiptare në mes të Knez Mihajllova sit", si një prej shembujve më tronditës, që së bashku me kërcënimet dhe presionet e rretheve djathtistë në fund, pikërisht në datë të mbajtjes së ekspozitës, ka sjellë deri aty që mbajtja e ekspozitës të ndalohet nga ana e MPB-së. Sidoqoftë, për shkak të presionit të madh të organizatave joqeveritare në ditët para ekspozitës, vetë kryeministri Dačić është interesuar për mbajtjen e saj dhe me intervenimin e shpejtë të ministrit të policisë ndalimi është tërhequr, siç thuhet në tekst, në afat prej një ore dhe prej aty, siç thekson autorja e tekstit, kryeministri Dačić dhe nënkryetari i qeverisë Aleksandar Vučić "janë angazhuar që ekspozita të mbahet".

Autorja analizon rëndësinë e paraqitjes së Dačić në ekspozitë dhe deklaratën që ai e dha në ekspozitë duke e konsideruar si fakt vendimtar faktin se Dačić nuk ka ardhur si person fizik por, në cilësinë e kryeministrit, në emër të Qeverisë dhe shtetit Serb. Autorja poashtu kthehet edhe në qëndrimin e një pjese të publikut qytetar në Serbi, tek e cila ekspozita ka kaluar e pavërejtshme dhe ku paraqitja e kryeministrit Dačić në ekspozitë konsiderohet si marketing politik, duke konsideruar se ata janë ata njerëz që kanë qenë pjesë e pushtetit në vitet e nëntëdhjeta, kur është bërë politika e krimeve. Autorja konsideron se kjo poashtu është fakt, mirëpo e kthen me kritikë për publikun qytetar serb, që ka heshtur për krimet ndaj shqiptarëve dhe dëbimit të tyre gjatë bombardimeve të NATO-s së vitit 1999, kur edhe opozita ishte rreshtuar përkrah pozitës duke kërkuar nga NATO-ja që të ndërpresë

296 Žarka Radoja, "Ballafaqimi me art", Kontrapress.com, e qasshme:http://kontrapress.com/clanak.php?rub=ARTivizam&url=Suocavanje-s-umetnoscu, hapur me: Janar 2014.

297 Nataša Kandić, „Fëmijët shqiptarë po na zgjasin dorën", tekst i shpërndarënë webfaqen e gazetës elektronike, e-novine.com, e qasshme:http://www.e-novine.com/stav/95910-Albanska-deca-nam-pruaju-ruku.html, hapur me: Janar 2014.

bombardimet. Në anën tjetër, siç raportohet në tekst, nuk ka pasur kërkesa ndaj regjimit të Milosheviqit, që të ndërpritet me vrasjen dhe dëbimin e shqiptarëve nga Kosova si dhe me plaçkitjen dhe shkatërrimin e pronave të tyre, që janë kryer deri në fund të luftës dhe kampanjës ajrore të NATO-së. Më tej theksohet se viktimave u nevojitet një pranim i hapur, së pari nga përfaqësuesit e shtetit, prandaj kjo përfaqëson edhe obligimin e qeverisë së tanishme, e cila ,sipas tekstit, ka bërë përparim të dukshëm në këtë drejtim, ndoshta edhe më të madh se qeveritë e mëparshme. Me vetë këtë, në përfundim, theksohet se paraqitja e kryeministrit në ekspozitë dëfton një shenjë se përfaqësuesit e qeverisë së tanishme janë të gatshëm që të pranojnë dhe respektojnë viktimat shqiptare, e cila paraqet parakusht edhe për njohjen e viktimave serbe nga shqiptarët.

Nga mediat, të cilat në mënyrë pozitive kanë raportuar për ekspozitën, përveç gazetës së përmendur *Danas* duhet përmendur edhe disa media tjera si gazetën *Blic,* të cilat folën për ekspozitën me titull "Shqiptarët e rinj, që i mbijetuan masakrës, traumat e tyre i kthyen në projekt artistik", të 19 dhjetorit të vitit 2013[298]; në mënyrë fer dhe neutrale për këtë ka raportuar edhe televizioni B92. Në njoftimin për ekspozitën, një ditë para mbajtjes së saj.[299] Sa i përket vetë raportimit të Televizionit B92 për ekspozitën është folur për ekspozitën, vizitën e kryeministrit Dačić, deklaratat e tij lidhur me ekspozitën se si është e rëndësishme që të gjykohen përgjegjësitë për krimet, protestat e djathtistëve në afërsi të objektit të Qendrës Kulturore, ku është mbajtur ekspozita, si dhe për vendosjen e vetë ekspozitës.[300]

Në mënyrë fer dhe profesionale për ekspozitën kanë raportuar edhe mediat tjera si *Novi Magazin,* magazina *Akter* dhe media tjera të orientimit të njëjtë.

Nga mediat, të cilat kanë udhëhequr kampanjë negative kundër ekspozitës, në rend të parë, duhet ndarë *Vecernje Novosti*dhe mënyrën në të cilën, në këtë gazetë është shkruar rreth ekspozitës. Artikulli me titull "Propaganda shqiptare në mes të Knez Mihajllos" të autorit Lj. Begenišić të 13 dhjetorit të vitit 2013[301], pesë ditë para mbajtjes së ekspozitës, flet mjaftueshëm. Në artikull, ekspozita konsiderohet si provokim dhe propagandë brutale si dhe nxjerr mendimin, që ajo edhe më shumë do të shpërndajë antagonizmin në mes të dy popujve dhe shtrohet pyetja nëse në Prishtinë dhe Tiranë është e mundur të organizohet ekspozita për vrasjet dhe dëbimet e civilëve serbë nga Kosova, që nga viti 1999, si dhe në periudha tjera kohore, me përfundim se diçka e tillë do të ishte e pamundur të kryhej.

Vërehet një simpati ndaj viktimave të krimit nga Podujeva, ndërsa ekspozita përshkruhet si tentativë që populli serb të paraqitet si krimbërës. Në artikull kërkohet që edhe në Prishtinë, Tiranë, Beograd, Vashington, Bruksel dhe në vende tjera të organizohen ekspozita të viktimizimit të popullit serb në Kosovë, në mënyrë që bota perëndimore të njoftohet edhe me këtë.

Nëse *Vecrnje Novosti* kanë prirë në kampanjën kundër ekspozitës, prapa tyre nuk kanë ngecur as mediat tjera të orientimit nacionalist. Duhet përmendur artikullin në gazetën *Pravda* me titull "Për fotografitë e serbëve të vrarë nuk ka vend në Qendrën Kulturore të Beogradit", të 19 dhjetorit të vitit 2013.[302] Në artikullin e shkurtër nuk bëhet fjalë fare se për çfarë ekspozite bëhet fjalë, vetëm në një fjali të shkurtër përmendet ekspozita ndaj civilëve shqiptarë në Podujevë në vitin 1999, ndërsa temën kryesore artikulli në të vërtetë ua kushton katër vajzave, që kanë qëndruar disa orë para Qendrës Kulturore të Beogradit duke mbajtur fotografi të serbëve të vrarë, pasi që policia nuk u lejonte hyrjen në mënyrë që të shfaqnin fotografitë në ekspozitë.

E njëjta gazetë më 19 dhjetor, në ditën e ekspozitës, ka publikuar artikullin me temën "HULIGANËT E FEJSBUKUT:



298 M.Radović, „Shqiptarët e rinj traumat e tyre i shndërruan në projekt artistik ", e qasshme: http://www.blic.rs/Vesti/Drustvo/428673/Mladi-Albanci-koji-su-preziveli-masakr-svoje-traume-pretocili-u- umetnicki-projekat, hapur me: Janar 2014.

299 „Ekspozita Bogujevci – historia vizuale e artit ", e qasshme: http://www.b92.net/kultura/vesti.php?nav_category=270&yyyy=2013&mm=12&dd=17&nav_id=790041, hapur me: Janar 2014.

300 „Dačić: E rëndësishme të dënohen përgjegjësit ", e qasshme: http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2013&mm=12&dd=18&nav_category=12&nav_id=790726, hapur me: Janar 2014.

301 Lj. Begenišić, „Propaganda shqiptare në mes të Knez Mihajllovës", e qasshme: http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/drustvo/aktuelno.290.html:468398-Albanska-propaganda-usred-Knez-Mihailove, hapur me: Janar 2014.

302 I.M, „Për fotografitë e serbëve të vrarë nuk ka vend në Qendrën Kulturore të Beogradit ", e qasshme: http://www.pravda.rs/2013/12/19/za-slike-ubijenih-srba-nema-mesta-u-kulturnom-centru-beograda-foto/, hapur me: Janar 2014.

Djathtistët nëpërmjet rrjeteve sociale përgatisin ndërprerjen e ekspozitës"[303], ku shprehin gjoja brengën pasi që "në Fejsbuk profilet e organizatave më ekstreme djathtiste janë vendosur [...] statuse ku thirret në mbledhje masovike". Me tej në artikull citon udhëheqës të lëvizjeve djathtiste siç ishin "Obraz", "SNP Nashi" dhe "Zavetnici", në të cilat thirret për mbledhje në mënyrë që të shprehet qëndrimi i tyre. Me gazeta të tilla bashkohen edhe *Kuriri* dhe *Telegrafi.*

Kështu në *Kurir,* më 13 dhjetor 2013, u shfaq lajmi kryesor në rubrikën "Skandaloze" me titull "PROPAGANDA SHQIPTARE: Artistet nga Kosovë bëjnë ekspozitë në mes të Beogradit"[304], i cili në tërësi përcjell tekstin nga *Veçernje Novosti,* në të njëjtën ditë me titull "Propaganda Shqiptare në mes të KnezMihajllovës". Tabloidi *Telegraf,* me reçetë të *Kuririt,* poashtu në të njëjtën ditë, 13 dhjetor, përcjell tekstin me emër të njëjtë nga *Veçernje Novosti* me titull paksa të ndryshuar: "SKANDAL: Ekspozita shqiptare në mes të Knez Mihajllovës".[305] Teksti në të vërtetë është i përcjellur shkurtimisht për t'u dhënë më shumë hapësirë temave me të cilat merret ky tabloid.

Në kopjim të plotë dhe transmetim të tekstit nga *Veçernje Novosti gazeta elektronike srbin.info – gazeta e shpejtë serbe e internetit,* e cila pa asnjë ndërrim, më 14 dhjetor të vitit 2013, në plotësi përcjell tekstin nga *Veçernje Novosti* me titull identik "Propaganda shqiptare në mes të Knez Mihajllovës".[306] Më vonë *Kurir*për vetë ekspozitën, pas hapjes së saj, më 18 dhjetor, publikon artikullin me titull "GJENDJE E JASHTËZAKONSHME: Qendra e Beogradit ishte nën rrethim për shkak të ekspozitës së shqiptarëve të rinj".[307] Artikulli kryesisht merret me deklaratën e kryeministrit Dačić për nevojën që një ekspozitë e tillë të mbahet edhe në qytete tjera në hapësirën e ish-Jugosllavisë, duke përmendur se në ekspozitë kanë qenë edhe politikanë tjerë, si Čedomir Jovanović, Biljana Srbljanović dhe të tjerë.

Shkurtimisht flitet edhe për vetë ekspozitën dhe akterët e saj. Megjithatë në fillim të vetë artikullit flitet për protestat e grupeve djathtiste para Qendrës Kulturore në Beograd gjatë mbajtjes së ekspozitës, por siç është e dukshme nga vetë teksti i artikullit, ato protesta kanë kaluar pa incidente, prandaj nuk ka se për çfarë të arsyetohet titulli sensacional "GJENDJE E JASHTËZAKONSHME: Qendra e Beogradit ka qenë nën rrethim për shkak të ekspozitës së shqiptarëve të rinj". Sidoqoftë ky titull mund të shpjegohet si diletantizëm klasik gazetaresk.

Në disa media tema e ekspozitës ka shërbyer për kritika politike, ndërsa shembull i një artikulli të tillë është artikulli në gazetën *Danas* me titull "Pesë tregime dhe një mbret" autori i së cilës është Agron Bajrami, redaktor i gazetës prishtinase *Koha Ditore.*

Artikulli në gazetën *Danas,* me titull "Pesë tregime dhe një mbret"[308] flet për ndryshimet kushtetuese nga viti 1989, me anë të së cilave u zvogëluan përfitimet e krahinave autonome si Kosova dhe Vojvodina, ndërsa u fuqizua qeverisja qendrore e që u bë hyrje për shpërbërjen e Jugosllavisë, më pas për masakrën e Podujevës të vitit 1999, që ishte tema kryesore e ekspozitës së Bogujevcëve të rinj, më pastaj për karrierën politike dhe të kaluarën e kryeministrit të tanishëm të Serbisë Ivica Dačić, për pjesëmarrjen e tij në qeverisjen përgjegjëse për krimet dhe të kaluarën e tij që ai sot nuk mund ta fshijë ose zbukurojë pa marrë parasysh se ka ndryshuar petkun politik, që paraqet edhe mesazhin e autorit drejtuar lexuesve.

Është interesant artikulli i dedikuar ekspozitës, i publikuar në magazinën *Libreto,* me titull "Podujeva", të 21 dhjetorit



303 „HULIGANËT E FEJSBUKUT: Djathtistët nëpërmjet rrjeteve sociale përgatisin ndërprerjen e ekspozitës", e qasshme: http://www.pravda.rs/2013/12/18/fejsbuk-huligani-desnicari-preko-drustvenih-mreza-spremaju-prekid-izlozbe/, hapur me: Janar 2014.

304 „PROPAGANDA SHQIPTARE: Artistet nga Kosovë bëjnë ekspozitë në mes të Beogradit", e qasshme: http://www.kurir-info.rs/albanska-propaganda-umetnice-sa-kosova-prave-izlozbu-usred-beograda- clanak-1134341, hapur me: Janar 2014.

305 " SKANDAL: Ekspozita shqiptare në mes tëKnezMihajllovës", e qasshme: http://www.telegraf.rs/vesti/900297-skandal-albanska-izlozba-usred-knez-mihailove, hapur me: Janar 2014.

306 "Propaganda shqiptare në mes të Knez Mihajllovës", tekst i transmetuar nga *Veçernje novosti*, e qasshme: http://srbin.info/2013/12/14/albanska-propaganda-usred-knez-mihailove/, hapur me: Janar 2014.

307 "GJENDJE E JASHTËZAKONSHME: Qendra e Beogradit ishte nën rrethim për shkak të ekspozitës së shqiptarëve tërinjë", e qasshme: http://www.kurir-info.rs/vanredno-stanje-beograd-pun-policije-zbog-izlozbe-mladih-albanki-clanak-1141755, hapur me: Janar 2014.

308 Agon Bajrami, "Pesë tregime dhe një mbret", webfaqja zyrtare e gazetës *Danas*, e qasshme: http://www.danas.rs/dodaci/nedelja/pet_prica_i_jedan_kraj.26.html?neës_id=273724, hapur me: Janar 2014.

të vitit 2013.[309] Artikulli paraqet shikim krahasues të krimit në Podujevë nga viti 1999 dhe të sulmit terrorist në autobusin e kompanisë "Nish Ekspres" nga viti 2001, kur ngaë një bombë e vendosur kanë vdekur 12 udhëtarë të këtij autobusi, ndërsa janë lënduar 43 udhëtarë tjerë. Më pastaj bëhet paraqitja krahasuese ndaj gjykimi të pjesëtarëve të njësisë *Shkorpionët,* të cilët kanë kryer krimin në Podujevë dhe të cilët kanë qenë të dënuar me burgim me atë të gjykimit të Florim Ejupit, të akuzuar për vendosje të bombës, e cila i ka vrarë 12 udhëtarë të "Nish Ekspresit" dhe i cili me aktgjykim të vitit 2009 para Gjykatës në Prishtinë është liruar nga akuzat edhepse më parë është dënuar me 40-vjet burgim. Në artikull flitet poashtu për dëbimin e serbëve nga Podujeva dhe pjesa tjetër e Kosovës gjatë trazirave të Marsit të vitit 2004 si dhe me largimin e tyre të vazhdueshëm nga Kosova. Artikulli përfundon me ekspozitën e Bogujevcëve të rinj në Qendrën Kulturore të Beogradit, të cilën, siç thuhet në artikull, merr pjesë edhe kryeministri serb Ivica Dačić. Sikurse nëpërmjet artikullit të mundohet të tregohet disproporcioni në veprimet për t'u dënuar krimet e kryera nga ana serbe dhe ajo shqiptare, por nuk duket se artikulli është i drejtuar kundër ekspozitës. Ai më shumë duket si tentim, që në mënyrë të paanshme të shikohet në gjendjen e situatës. Se sa ia arrin artikulli këtij qëllimi u mbetet lexuesve që ta vlerësojnë.

Vlen të theksohet edhe artikulli në *E-novinama,* me titull "Mbrojtja tabloide nga propaganda shqiptare", të 14 dhjetorit të vitit 2013[310], të autorit Dušan Komarčević. Artikulli paraqet përgjigje në shkrimin e *Veçernjih Novosti* të ditës paraprake (tashmë të përmendur "Propaganda shqiptare në mes të Knez Mihajllovës") dhe paraqet një kritike të rreptë në llogari të artikullit në *Veçernje Novosti.*

Me anë të artikullit sulmohet retorika e *Veçernje Novosti* për shkrimin për ekspozitën, flitet për atë se si në artikull, në *Veçernje Novosti* nuk mund të gjendet asgjë për krimet e pjesëtarëve të njësitit *Shkorpionët* në Podujevë, me të cilin rast janë vrarë 14 civilë. Poashtu theksohet se në artikullin e përmendur heshtet fakti se pesë anëtarë të këtij njësiti janë dënuar me burgim për kryerjen e këtij krimi, ndërsa nuk flitet asgjë për faktin se artistët, që kanë krijuar këtë ekspozitë si të mbijetuar të masakrës në Podujevë, kanë dëshmuar në gjykimin kundër pjesëtarëve të njëjte të njësisë *Shkorpionët,* të cilët më vonë edhe janë dënuar, e as që mund të kuptohet në të ndonjë gjë për vetë ekspozitën dhe tematikën e saj.

Në këtë artikull të Dušan Komarčević në *E-novine* në mënyrë efektive rrëzohen pohimet e *Veëernjih Novosti* nga dita e kaluar, duke e lënë anën kundërshtare pa asnjë argument bindës.

Në fund të këtij shikimi të transmetimit medial rreth ekspozitës duhet të shikojmë edhe se në çfarë mënyre kanë raportuar mediat: si RTS (Radio Televizioni i Serbisë) dhe agjencitë e lajmeve Tanjug. RTS ka përcjellë ekspozitën në, mund të thuhet, mënyrë neutrale. Me titullin me emër "Ekspozita nën mbrojtjen policore: në webfaqen e RTS-it, të 18 dhjetorit të vitit 2013[311], ekspozita është shfaqur në mënyrë profesionale dhe neutrale. Flitet për ekspozitën, artisten nga familja Bogujevci, përvojën e tyre si të mbijetuar nga masakra në Podujevë dhe përmendet edhe dëshmimi i tyre në gjykimet e pjesëtarëve të *Shkorpionëve që janë gjykuar për këtë krim.*

Citohen deklaratat e kryeministrit Daçiq, të dhëna në ekspozitë, si dhe të Čedomir Jovanović, liderit të Partisë Liberal Demokrate (PLD) që në të ardhmen nuk mund të ndërtohet në fatkeqësinë e kujtdo. Agjencia e lajmeve Tanjug, me titull të njëjtë "Ekspozita nën mbrojtjen policore", gjithashtu më 18 dhjetori[312], flet për ekspozitën shumë më detajisht. Qasja është poashtu neutrale dhe profesionale.

Gjithashtu citohen deklaratat e kryeministrit Dačić, të dhëna në ekspozitë si dhe deklarata e Čedomir Jovanović se ekspozita përfaqëson simbol të tragjedisë të gjithë viktimave në luftërat e zhvilluara në hapësirën e ish-Jugosllavisë duke i dhënë notë pozitive ekspozitës si për diçka që i kontribuon ndryshimit gradual të perceptimit të publikut ndaj konflikteve reciproke të së kaluarës jo të largët.



309 *Libreto– hapur për çdo gjë (dhe për tjerat),* "Podujeva", 21.12.2013, e qasshme: http://www.libreto.rs/2013/12/21/, hapur me: Janar 2014.

310 Dušan Komarčević, „Mbrojtja tabloide nga propaganda shqiptare", e qasshme: http://www.e-novine.com/srbija/srbija-tema/95508-Tabloidna-odbrana-albanske-propagande.html, hapur me: Janar 2014.

311 "Ekspozita nën mbrojtjen policore",webfaqja zyrtare e Radio Televizionit të Serbisë, e qasshme: http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/125/Dru%C5%A1tvo/1473948/Izlo%C5%BEba+pod+policijskom+za%C5%A1titom.html, hapur me: Janar 2014.

## Përfundim

Shikimi në raportimin medial nga ekspozita *Bogujevci – historia vizuale, homazh gjithë familjeve dhe viktimave të luftës,* që është mbajtur në galerinë *Podroom*të Qendrës Kulturore të Beogradit, nga 18 deri më 21 dhjetor të vitit 2013, si dhe sjellja e mediave ndaj kësaj ekspozite, përfaqëson deri diku edhe vetë shikim në atë se si ato shikojnë procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes të shteteve të formuara në territorin e ish-Jugosllavisë si dhe përmirësimit të marrëdhënieve në mes të këtyre popujve të konfrontuar në të kaluarën jo të largët.

Vetë shikimi në mënyrën e raportimit të ekspozitës, si dhe reagimet kundërthënëse të mediave të ndryshme na zbulojnë fotografinë e një shoqërie thellësisht të ndarë në Serbi; shoqëri, e cila mundohet ta gjejë veten në rrjedhat moderne botërore e në anën tjetër bart një barrë të madhe të së kaluarës vetanake, nga e cila ende nuk është në gjendje të lirohet; shoqëri, e cila është e ndarë në pikëpamjet se çfarë ka ndodhur në territorin e ish-Jugosllavisë, gjatë viteve të nëntëdhjeta, si dhe në pikëpamjet nëse ky popull është vetëm viktimë apo edhe një nga kryerësit e çdo gjëje, që ka ndodhur në këto hapësira dhe që kanë shënuar dekadën e fundit të shekullit të kaluar, duke lënë gjurmë të thella në të gjithë ne që jetojmë këtu.

Nëse pyetemi se në çfarë mase kanë kontribuar ose penguar mediat në procesin e pajtimit në territorin e ish-Jugosllavisë, në këtë rast konkret me raportimin nga ekspozita e Bogujevcëve të rinj, është vështirë që të jepet kjo përgjigje. Një pjesë nga ta me siguri se ka dhënë kontribut në një proces të tillë dhe këtë ende vazhdojnë ta bëjnë, pjesa tjetër është munduar që ta instrumentalizojë ekspozitën në llogari të grindjeve shoqëroro-politike, ndërsa një numër tjetër i ka dhënë hapësirën e një artikulli të përditshëm duke u munduar të paktën të mbajë një marrëdhënie neutrale.

Megjithatë, ajo çfarë është më me rëndësi për ekspozitën u dëgjua dhe u kuptua. Nuk kaloi pa vërejtur. Ngriti valë, u ngritën shpirtrat e publikut, ndërsa qytetarët patën rastin të dëgjojnë dhe shikojnë një dëshmi, e cila mbi të gjitha është njerëzore, e cila kalon barrierat gjuhësore, kombëtare, fetare, kulturore dhe barrierat tjera, pasi që fillon nga premisa që e kemi të gjithë të përbashkët, premisa e dhembshurisë dhe njerëzisë, të cilat paraqesin një hap në rrugën e gjatë deri tek respektimi i dallimeve dhe bashkëjetesës së tyre.

Ky është një hap, të cilin në fund të gjithë duhet ta bëjmë. Përderisa shtetet e krijuara në hapësirën e ish-Jugosllavisë gjinden në procesin e gjatë dhe të dhimbshëm të tranzicionit drejt modelit të demokracisë liberale, të cilën mundohen ta arrijnë, deri atëherë edhe ekspozita si kjo do të krijojnë kontroversa në publik, deri atëherë kur të gjitha këto shoqëri nuk ballafaqohen me të kaluarën dhe nuk e pranojnë dualizmin e rolit të tyre si viktimë dhe si kryerës i krimeve. Vetëm atëherë do të mund të bisedohet për procesin e vërtetë të pajtimit në mes të popujve në hapësirën e ish-Jugosllavisë. Sigurisht mund të thuhet se ky proces në një mënyrë vetëm se ka filluar, mirëpo ne sapo jemi në fillim të kësaj rruge. Me të gjithë forcën dhe ndikimin në vetëdijen e publikut, mediat kanë dëshmuar dhe vazhdojnë të dëshmojnë se në këtë rrugë të gjatë dhe të vështirë, të një procesi të tillë mund të luajnë një rol të rëndësishëm nëse jo edhe vendimtar.

# Prijedor: Reparacionet Simbolike

Goran Zorić

## 1. Hyrje

### 1.1. Reparacionet simbolike

Reparacionet simbolike paraqesin një nga nënmekanizmat e konceptit teorik të Drejtësisë Tranzicionale dhe mund të definohen si masa të pushtetit të ndërmarra me qëllim që në mënyrë simbolike të pranohet e vërteta e krimit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut në të kaluarën. [313]

Reparacionet simbolike hyjnë në kategorinë e reparacioneve kolektive.

Praktika e deritanishme nga fusha e Drejtësisë Tranzicionale njeh disa lloje të reparacioneve simbolike:

Ø Memoriale (monumente përkujtimore dhe qendra memoriale) zënë një vend të rëndësishëm në ndërtimin e memories kolektive të krimeve të kryera në të kaluarën. Përveç kësaj, roli i tyre edukativ është i rëndësishëm edhe për ngritjen e vetëdijes tek gjeneratat e ardhshme, dhe me këtë, parandalimin e konflikteve në të ardhmen. Përveç ndërtimit të monumenteve përkujtimore dhe qendrave memoriale, ky lloj i reparacioneve simbolike mund të përfshijë edhe shpalljen e ditëve të caktuara të përkujtimit, emërtimin e rrugëve dhe shesheve me emrat e viktimave dhe të ngjashme.

Ø Mbledhjet përkujtimore dhe përkujtimet e viktimave mbahen me qëllim të dhënies së rrespektit për viktimat dhe shprehjen e solidaritetit, por edhe ndërtimin e memories kolektive për shkeljen masovike të të drejtave të njeriut nga e kaluara. Në veçanti i jepet rëndësi prezencës së zyrtarëve shtetërorë dhe zyrtarëve të lartë qeveritarë, si gjest simbolik i dhënies së respektit dhe shprehjes së solidaritetit me viktimat.

Ø Kërkimfaljet e burrështetasve përfaqësojnë deklarimet publike të përfaqësuesve të lartë shtetërorë në kuptimin e kërkimfaljes ndaj viktimave dhe familjeve të tyre për krimet, të cilat i kanë kryer apo kanë marrë pjesë në kryerjen e tyre përfaqësues të institucioneve të sistemit. Përveç kësaj, kanë rol edhe të ndërtimit dhe kthimit të besimit për viktimat në institucionet e sistemit, si dhe e zvogëlojnë mundësinë e mohimit të krimit.[314]

#### 1.1.1. Reparacionet simbolike në Bosnjë dhe Hercegovinë

Gjatë vitit 2010 në Bosnjë dhe Hercegovinë janë realizuar një sërë e takimeve konsulltative, të cilat si rezultat final kanë pasur draftimin dhe adoptimin e *Strategjisë për të Dre-*



312 „Ekspozita nën mbrojtjen policore“, webfaqja zyrtare e agjencisë Tanjug, e qasshme: http://www.tanjug.rs/novosti/110292/izlozba-pod-policijskom-zastitom.htm, hapur me: Janar 2014.

313 Fondi për të Drejtën Humanitare, Udhërrëfyes për reparacion(Vodič kroz reparacije), 2010, fq. 8.

314 Ibid, fq. 8 e më tej.

*jtën Tranzicionale në Bosnjë dhe Hercegovinë 2012-2016.* Në të, janë definuar caqet dhe masat e nevojshme për realizimin adekuat të mekanizmave të së Drejtës Tranzicionale, mirëpo edhe është nxjerrë një analizë e realizimit të deritanishëm të këtyre mekanizmave.

Në *Strategji* konstatohet se pothuajse në secilën komunë të Bosnjës dhe Hercegovinës ekzistojnë memoriale të ngritura në kujtim të viktimave të krimeve nga periudha 1992-1995 dhe atë në vende publike ku shihen mirë, si sheshet, hapësira përpara institucioneve, oborret shkollore, hapësira rreth udhëkryqeve të frekuentuara etj. Kryesisht bëhet fjalë për përkujtimore të dedikuara viktimave ushtarake, apo civile të njërit grup etnik, përkatësisht, të cilat janë kompatibile me politikat që janë dominante në atë bashkësi lokale.[315]

Në po të njëjtin dokument theksohet edhe ndikimi negativ i memorialeve të ngritura deri tani në kuptimin e monumenteve përkujtimore, kur ato janë ngritur si shprehje e rrespektit për viktimat e një grupi etnik në vendet e vuajtjes të një grupi tjetër etnik. Si fakt shtesë është nënvizuar efekti i pavolitshëm i këtyre memorialeve në kuadër të oborreve shkollore, të shkollave ku vijojnë mësimin fëmijë të grupit tjetër etnik, përkatësisht të kthyerit.

